

ENVER HOXHA

VEPRA

2

PROLETARË TË TË GJITHA VENDEVE, BASHKOHUNII

ENVER HOXHA

VEPRA

BOTONET ME VENDIM TE KOMITETIT
QENDROR TE PARTISE SE PUNES TE
SIQIPERISE



ENVER HOXHA

gusht 1944

INSTITUTI I STUDIMEVE MARKSISTE - LENINISTE
PRANË KQ TË PPSH

ENVER HOXHA

VELLIMI

2.

NENTOR 1943 - NENTOR 1944

SHTËPIA BOTONJËSE «NAIM FRASHËRI»
TIRANË, 1968

PARATHËNJE PËR VËLLIMET 1 DHE 2

Në dy vëllimet e para të Veprave të shokut Enver Hoxha hyjnë raporte, referate, fjalime, artikuj, letra, udhëzime, etj. të periudhës nëntor 1941 — dhjetor 1944.

Vendosja në dy vëllime e veprave të shkruara gjatë periudhës së Lustës nacional-çlirimtare është bërë thjesht për qëllime praktike, në mënyrë që të lehtësohet lexuesi në përdorimin e tyre.

Në veprat e kësaj periudhe një vend kryesor zënë problemet e organizimit të Partisë mbi baza marksiste-leniniste dhe përpunimi i vijës së saj politike.

Në to trajtohen probleme themelore të luftës për çlirimin kombëtar dhe të revolucionit popullor. Të tilla probleme janë bashkimi i popullit në një Front të vetëm Nacional-Çlirimtar, organizimi i kryengritjes së përgjithshme të armatosur dhe krijimi i Ushtrisë Nacional-Çlirimtare, ngritura dhe konsolidimi i pushtetit popullor. Në mënyrë të plotë përpunohet taktika e Partisë kundrejt «Ballit Kombëtar», «Legalitetit» dhe reakzionit në përgjithësi, gjithashtu edhe qëndrimi ndaj aleatëve të jashtëm të Luftës nacional-çlirimtare.

Trajtimi i këtyre problemeve përshkohet nga principialiteti marksist-leninist, sidomos nga parimi i vënjes së politikës marksiste-leniniste në plan të parë.

Në Veprat e shokut Enver Hoxha del qartë se si Partia ka zbatuar pa lëkundje vijën e luftës pa kompromis kundër pushtuesve dhe tradhiëtarëve, si e mobili zoit dhe e organizoi popullin në luftën e madhe antifa shiste nën parullën «Liria nuk dhurohet, por fitohet me vuajtje, me gjak e me sakrifical!», se si ajo nuk i bëri asnje lëshim parimor borgjezisë reaksionare, sidomos në çështjen e pushtetit politik, e njëkohësisht nuk lejoi asnje ndërhyrje të reaksionit imperialist anglo-amerikan në punët e brendshme politike e ushtarake.

Në to del gjithashtu në dukje qëndrimi parimor i KQ të Partisë Komuniste të Shqipërisë kundër orvatisjeve të udhëheqjes së ish-Partisë Komuniste të Jugosllavisë për të ndërhyrë në punët e brendshme të Partisë dhe të Luftës sonë nacional-çlirimtare. Njëkohësisht në Veprat e shokut Enver Hoxha spikat fryma e thellë e internacionalizmit proletar të Partisë, e solidaritetit të popullit shqiptar me të gjithë popujt që luftonin kundër fashizmit, sidomos me popujt e Bashkimit Sovjetik, si edhe me popujt fqinjë, jugosllav e grek.

Problemet organizative dhe ideologjike të Partisë, zbatimi i parimit themelor të ndërtimit e të funksionimit të Partisë — centralizmit demokratik — dhe kalitja ideologjike revolucionare e komunistëve janë konsideruar nga shoku Enver si kushti më i rëndësishëm për të kryer me sukses detyrat e mëdha e për ta çuar popullin në fitoren përfundimtare mbi armiqjtë e jashtëm e të brendshëm.

Në mënyrë të posaçme i është kushtuar kujdes unitetit monolit ideologjik dhe organizativ të Partisë. Ky unitet është farkëtuar dhe është ruajtur në luftë të pa-

pajtueshme parimore kundër oportunizmit e sektarizmit, kundër fraksionizmit dhe gjithë armiqve të breshtë Partisë. Partia ka luftuar njëkohësisht edhe kundër armiqve të komunizmit jashtë radhëve të saja.

Në vëllimin e parë të Veprave mungojnë disa dokumenta me rëndësi të madhe, si fjala e shokut Enver në Mbledhjen e grupeve komuniste shqiptare, nëntor 1941, referati në Konferencën e jashtzakonshme të Partisë, qershor 1942, referati në Konferencën e Pezës, shtator 1942, raporti në Konferencën e parë të Vendit të PKSH, të cilat janë asgjësuar ose kanë humbur e nuk janë gjetur ende.

DIREKTIVA PËR FORCIMIN E LIDHJEVE
ME BASHKIMIN SOVJETIK, PËR QËNDRIMIN
KUNDREJT «BALLIT KOMBËTAR», «LEGALITETIT»
DIIE MISIONEVE USHTARAKE ANGLEZE, PËR
FORCIMIN E FRONTIT, TË KËSHILLAVE DHE TË
USHTRISË NACIONAL-ÇLIRIMTARE, PËR
FORCIMIN E PARTISË DHE TË ORGANIZATAVE
TË TJERA ANTIFASHISTE

3 nëntor 1943

KOMITETEVE QARKORE TË PARTISE
KOMUNISTE TË SHQIPËRISË

Të dashur shokë.

Ju e dini se prej kohësh situata është kthyer në favor të koalicionit antifashist. Faktori kryesor për këtë ndryshim ka qenë Ushtria e Kuqe heroike. Që prej Stalingradit e deri më sot ajo s'i ka dhënë asnje minutë pushim ushtrisë gjermane, që po kalon nga tërheqja në tërheqje, nga disfata në disfatë, duke shkuar drejt katastrofës. Ofensiva e madhe sovjetike mbi Dniepër është në zhvillim të plotë. Sukseset e para dhe të mëdha tak-tike janë duke u shfrytëzuar në mënyrën më të mirë

nga strategjia gjeniale e Stalinit dhe nga trimëria e Ushtrisë Sovjetike. Gjermania ecën drejt një disfate decisive. Rezervat e saja nuk janë më të mjaftueshme për të përballuar fronte kaq të gjera dhe situata kaq kritike. Disfatat e parreshtura ushtarake e kanë ulur pa masë moralin e ushtrisë gjermane dhe të popullit gjerman, i cili po fillon të ngrejë krye kundër nazistëve. Ushtria gjermane e mundur, e lodhur, e gjakosur, po hyn në dëmrin e tretë në tokat sovjetike. Ajo do të ketë përballë ushtritë e freskëta dhc të stërvitura mirë të Sovjetëve, që do ta godasin dita-ditës më shumë dhe më rëndë, derisa ta shpartallojnë.

Në një situatë të tillë hapja e një fronti tjeter të madh në Evropë nga ana e aleatëve do të shpejtonte katastrofen për Gjermaninë. Ju e dini se kontributi anglo-amerikan në këtë luftë ka qenë dhe është shumë më i vogël se ai i Bashkimit Sovjetik. Kjo pikë, patjetër, do të ketë qenë një nga çështjet e bisedimeve në Konferencën e Moskës¹, domethënë se si të shpejtohet mbarimi i luftës, që konkretisht do të thotë se si alcatët anglo-amerikanë të marrin pjesë në një shkallë shumë më të gjerë në luftë.

Hitleri shch se ushtarakisht e ka të humbur luftën. Vetëm një kompromis mund ta shpëtojë atë, prandaj ai manevron me të gjitha forcat e tija për të mobilizuar

¹ Konferenca e Moskës e tre ministrave të punëve të jashtme të BRSS, të Britanisë së Madhe dhe të SHBA u mbajt më 19-30 tetor 1943. Në këtë konferencë u pranua si detyrë kryesore: shkurtimi i afatit të Luftës së dytë botërore, hapja sa më parë e frontit të dytë, forcimi i bashkëpunimit midis aleatëve në luftë dhe vazhdimi i këtij bashkëpunimi pas luftës.

reaksionin ndërkombetar. Këtë taktikë ai e ka ndjekur qëkur ka ardhur në fuqi dhe veçanërisht kur shpresonte të shkatërronte Ushtrinë e Kuqe. Por nuk duhet të harrojmë se këtë taktikë ai dje e përdorte për të sulmuar, kurse sot e përdor për t'u mbrojtur, për të shpëtuar kokën. Ai mundohet të ngjallë reaksionin në Angli dhe në Amerikë dhe të lidhet ngushtë me të, të influencoje kështu në politikën anglo-amerikane dhe të arrijë një kompromis, ku të sigurojë një pjesë të grabitjeve të tija. Por për t'i lënë kohë kësaj manevre që të zhvillohet dhe për ta bindur reaksionin anglo-amerikan se ai do të jetë një alcat i tij i vlefshëm, Hitlerit i duhet të mos jetë në kondita inferioriteti të madh. Edhe kjo është një arësy për të cilën ai ngul këmbë mc tërbim për të qëndruar në Dniepër.

Që tani shihet se kjo manevr e Hitlerit ka dështuar. Ka dështuar, sepse popujt anglez e amerikan po hyjnë dita-ditës në luftë të hapët kundër reaksionit të brendshëm dhe metodave të tija dhe janë një fuqi e madhe që e tremb reaksionin dhe e bën të hezitojë. Ka dështuar, sepse politika anglo-amerikane nuk mund të futet në një aventurë kaq të rrezikshme. Por ka dështuar sidomos, sepse ofensivat sovjetike, veçanërisht ajo mbi Dniepër, po i thyejnë brinjët Hitlerit, i kanë çelnikosur popujt liridashës dhe po i mobilizojnë dita-ditës kundër Gjermanisë dhe fashizmit.

Reaksioni, pra, nuk mund të shpëtojë duke pasur si flamur Hitlerin. Prandaj ai po pregetitet për një manevr të gjcrë, e cila dhe ka filluar të duket: puna është të pregetitet terreni për t'i dalë përpara Ushtrisë së Kuqe dhe lëvizjeve nacional-çlirimtare pas disfaçave të

tjera që do të ketë ushtria gjermane. Këto gjëra vihen re sidomos në vendet e pushtuara, vihen re në Jugosllavi me Drazha Mihajloviçin, në Shqipëri me «Ballin Kombëtar» e me të tjerë; këto gjëra vihen re në qëndrimin e aleatëve të Gjermanisë: Rumani, Hungari, Finlandë.

Cili do të jetë qëndrimi i Anglisë dhe i Amerikës karshi kësaj manevre të reaksionit? E para e punës duhet shënuar se Anglia dhe Amerika nuk është e mundur ta shtypin reaksionin në Evropë, por vetëm duan ta shkëputin nga Hitleri. Ato njojin akoma Drazha Mihajloviçin dhe bile e ndihmojnë. Ne shohim, me çështjen e Sikorskit¹ dhe me sjelljet e vetë misionit anglez këtu ndër ne, se ata mundohen të ngjallin e të forcojnë lëvizjen reaksionare kundër lëvizjeve nacional-çlirimtare. Në Konferencën e Moskës sigurisht kjo ka qenë një nga pikat e bisedimeve.

Lëvizjet nacional-çlirimtare në Evropë janë duke fituar dita-ditës terren; masa të gjera populli po zgjohen dhe po mobilizohen rreth tyre.

Në Itali reaksiuni me Badolion² e Viktorin dhe tërthorazi me përkrahjen e ushtrive aleate mundohet të vendlösë me metoda të tjera sundimin e tij. Ai mundohet veçanërisht të godasë Partinë Komuniste Italiane

¹ V. Sikorski, udhëheqës reaksionar polonez. Kryesoi qeverinë e mërguar poloneze në Londër (1939—1943). U shërbente qarqeve imperialiste anglo-amerikane.

² Udhëheqës ushtarak dhe politik italian. Kryeministër i qeverisë italiane pas rënjes së qeverisë së Musolinit (korrik 1943 — qershori 1944).

dhe ta largojë nga skena politike, sepse ajo është partia më e lidhur me masat, sepse ajo është partia që i shtyp kokën reaksionit dhe që udhëheq popullin për të vendosur pushtetin e tij. Përpjekjet e popullit italian dhe veçanërisht ato të Partisë Komuniste Italiane rrezikojnë dita-ditës më tepër reaksionin dhe e shtërngojnë Badolion të ndërrojë gjithmonë metoda.

Okupatori gjerman ka filluar një fushatë të gjerë në të katër anët e Evropës për të mobilizuar reaksionin dhe për të rrejtur popujt me parulla nacionaliste demagogjike që të çojnë vetëm në luftë kundër lëvizjeve nacional-çlirimtare. Kudo Hitleri po preqatit dhe po organizon në Evropë luftën kundër partive komuniste, kundër ngritjes së pushtetit popullor. Rreth këtij flamuri mblidhet reaksioni. Këtu armiku ka armën kryesore. Këtë duhet ta godasim.

Më tepër se kudo në Ballkan armiqqtë e lëvizjeve nacional-çlirimtare, me Hitlerin në krye, mundohen të shfrytëzojnë antagonizmat kombëtare për të forcuar frontin antikomunist të reaksionit, që Hitleri e ka emëruar «Federacioni Ballkanik» dhe në vend që të luftojë kundër zbarkimit eventual të aleatëve, po lufton dhe do të luftojë lëvizjet nacional-çlirimtare të Ballkanit.

Me ndihmën e reaksionarëve shqiptarë Hitleri mundohet të mobilizojë popullatën shqiptare të Kosovës dhe të Maqedonisë kundër popullatave serbo-malazeze-maqedone dhe ta përdorë çështjen e Kosovës për të hedhur mijegull dhe diversion në radhët e popullit shqiptar si dhe për të shtytur pseudopatriotët të luftojnë lëvizjen nacional-çlirimtare të popullit shqiptar. Me ndihmën e shovinistëve të brendshëm ai mundohet

të lidhë opinionin publik të këtushëm me politikën antiserbe dhe antigreke, që të çon në përleshje me armë kundër fqinjëve tanë, që shkakton diversione në lëvizjen tonë nacional-çlirimtare dhe që shërben si bazë për organizimin dhe forcimin e partive nacional-shoviniste, antinacional-çlirimtare dhe antikomuniste.

Afrimi i përfundimit të luftës kundër Gjermanisë dhe këlyshëve të saj, nga njëra anë, dhe forcimi i Ushtrisë Nacional-Çlirimtare Shqiptare dhe i lëvizjes sonë përgjithësisht, nga ana tjetër, e kanë zgjuar popullin dhe e kanë afruar më tepër me luftën tonë. Në çdo anë të Shqipërisë simpatia për ne po shtohet dita-ditës dhe bashkë me të edhe influenca jonë. Por kjo gjë ka shtënnë në aktivitet të madh edhe reaksionin, i cili po mobilizohet dhe po mundohet të mobilizojë masat rreth tij për ta kthyer situatën në favor të vet.

Ju e dini se ç'është dhe ç'bën «Balli Kombëtar», dini gjithashtu qëndrimin që duhet të kemi ne karshi tij. Me qarkoren e datës 10 shtator 1943 të Komitetit Qendror kjo shpjegohet mirë. Mund të riktheheni në të. Tani një gjë duket haptazi dhe kjo është se «Balli Kombëtar» bashkëpunon në të gjitha mënyrat dhe me këdo kundër lëvizjes nacional-çlirimtare, bashkëpunon veçanërisht me okupatorin gjerman. Në Fier e në Lushnjë «Balli» ka marrë komandën e qytetit nën hijen e bajonetave gjermane dhe kapërcen dita-ditës më tepër në poshtërsi dhe në luftë të pabesë kundër nesh. Kudo në vendet e tjera ai bashkohet me gjermanët përtë na luftuar me pushkë, me spiuallëk dhe me propagandë. Përveç rolit të Isa Toskës ai mundohet edhe të ruajë një farë indipendence si dhe dukjen e një farë

ilegaliteti karshi okupatorit gjerman, që të mos konsiderohet nga populli si vegël e Gestapos, kështu që të ketë nesër kreditin e duhur për të trashëguar sundimin e Hitlerit në Shqipëri dhe për të manevruar më lehtë. «Balli» preokupohet për të mobilizuar fuqi sa më të mëdha që të jetë e mundur, të çfarëdo tipi qofshin, për të luftuar sot dhe sidomos nesër, Partinë Komuniste, lëvizjen nacional-çlirimtare dhe për të shypur popullin shqiptar.

Por reaksiuni e sheh se «Balli» vetëm nuk mund të luftojë me sukses lëvizjen tonë dhe mundohet të organizojë dhe të mobilizojë forca nën flamuj të ndryshëm. Ai nxjerr në skenë figura të reja, që kanë një farë konsiderate në opinionin publik, si Mehdi Frashëri, nxjerr në skenë njerëz që gjatë regjimeve të kaluara me sundimin e tyre, ushtronin influencë në disa krahina, si Zogu.

Qëllimi i armiqvet tanë është që të mobilizojnë samë tepër forca rreth reaksionit, ta organizojnë këtë samë mirë, në një ose në shumë grupe, në qeveri të Gestapos ose jashtë qeverisë, por kundër nesh, dhe vëtëm kundër nesh. Ka tendencë që grupet reaksionare të centralizohen. Mehdi Frashëri tani (mundet ndonjë tjetër më vonë) ka dalë si një nga figurat politike rreth të cilët do të fillojë të bëhet ky grumbullim. Mustafa Kruja, Kolë Biba, Gjon Marka Gjoni, Shefqet Vërlaci e të tjerë reaksionarë, forcat e të cilëve nuk janë më të vogla se të të tjerëve dhe të cilët ishin në shërbim direkt të fashizmit italian, janë edhe ata në manevrën e madhe dhe të kombinuar antinacional-çlirimtare.

Këto kohët e fundit shihet një aktivitet i madh i

zogistëve me Fiqri Dinen¹ dhe bajraktarë të Veriut në krye. Ata mundohen të organizohen rrëth figurës së Zogut, të krijojnë një parti të fortë dhe të preqatitin terrenin (sidomos forcat) për kthimin e tij dhe të regjimit të mëparshëm. Kartën e Zogut po e përkëdhelin edhe gjermanët me emërimin e një «Këshilli të Renjencës» me kthimin e statutit të Zogut, me kthimin e pasurive të konfiskuara. Kartën e Zogut po e luan reaksioni, duke u rezervuar që ta skartojë ose ta luajë më haptas nesër. Ka filluar të përdoret figura e Zogut si gogol për të larguar masat nga lufta, si figurë e vetme që mund të shpëtojë reaksionin nga lëvizja jonë, ose, si thonë ata, «të shpëtojë Shqipërinë nga anarkia». Fjalët e shumë ballistëve dhe të shumë reaksionarëve të tjerë, që thonë se komunistët do të na detyrojnë të bashkohemi me Zogun, gazeta «Atdheu»² si edhe shumë reklama që i bëhen Zogut lart e poshtë, janë procesi i një manevre që ka për qëllim të mobilizojë reaksionin rrëth Zogut.

«Balli Kombëtar» dhe gjithë reaksioni flasin për anarki, për kaos, për ngatërresa që po ngjasin në vendin tonë, ku, thonë ata, s'po merr vesh i pari të dytin. Duan të akuzojnë lëvizjen nacional-çlirimtare dhe Partinë tonë si shkaktare të kësaj anarkie, duan ta paraqitit Partinë tonë si një parti që është kundër rregullit dhe që nuk mund të sjellë veçse kaos dhe anarki.

¹ Eksponent zogist dhe kryeministër kuisling (korrik — gusht 1944).

² Organ kryesor i organizatës tradhëtare të «Legalitetit» (tetor 1943 — gusht 1944).

Okupatori gjerman mundohet t'i japë Shqipërisë ngjyrën e një vendi indipendent; për këtë gjë duhet të ketë një aparat të shtetit në duar të shqiptarëve dhe një forcë ushtarake shqiptare, të cilat të bëjnë, si shërbëtorë të bindur, punën e Hitlerit, d.m.th. të luftojnë energjikisht lëvizjen nacional-çlirimtare. Reaksioni kurrë si sot nuk ka pasur kaq frikë nga lëvizja jonë dhe nuk ka qenë kaq i bashkuar të na luftojë me gjithë forcat e tija. Kështu që ai merr me gëzim dorën që i shtrin Hitleri, duke u përpjekur që lidhja me okupatorin të mos duket haptazi, në mënyrë që me shkatërrimin e fashizmit të mos shkatërrrohet edhe ai vetë. Reaksioni përpinqet të luftojë lëvizjen tonë gjatë okupacionit gjerman, të forcohet gjatë këtij okupacioni dhe ta vendosë më lehtë sundimin e tij më vonë, sepse edhe ai vetë është i bindur se Gjermania e ka luftën të humbur.

Manevra tjeter që përdorin armiku dhe reaksioni e që ju vetë e keni konstatuar në terren, është çështja e bashkimit, i cili kërkohet që prej Mustafa Krujës e deri te «Balli Kombëtar». Me këtë manevr ata duan dhe përpinqen të gënjejnë popullin dhe lëvizjen nacional-çlirimtare e sidomos duan që Partinë tonë Komuniste ta paraqesin si shkaktaren e mosbashkimit. Ky bashkim kërkohet me çdo kusht dhe me të gjithë: me Zogun, me «Ballin», me Mustafa Krujën, me «Komitetin Ekzekutiv», me «Këshillin e Regjencës» bile edhe me nazizmin gjerman. Këtë bashkim kërkon reaksioni. E kuptioni vetë se kjo fushatë e madhe «vëllazërimi» ka për qëllim ta largojet popullin nga Lufta nacional-çlirimtare, ta dezorientojë, t'i paraqesë tradhëtarët si

patriotë përpara popullit, ta likuidojë lëvizjen tonë dhe ta vërë popullin nën udhëheqjen e reaksionit. Flasin e bëjnë fushatë për bashkimin e nacionalizmit shqiptar, ndërsa Partinë Komuniste dhe komunizmin i paradesin si një parti të huaj dhe ideologji të huaj e në luftë të pamëshirshme kundër nacionalizmit shqiptar. Qëllimi i tyre është të shkëputin ata që s'janë komunistë nga lëvizja nacional-çlirimtare, të izolojnë Partinë tonë dhe ta qëllojnë më lehtë, duke e quajtur shkaktare të përçarjes, të terrorit dhe të vëllavrasjes. Mbi të gjitha ata përpiken ta paradesin Partinë tonë si një parti që punon kundër interesave kombëtare.

Përpara kësaj situate të jashtme dhe të brendshme, cili duhet të jetë qëndrimi i gjithë anëtarëve të Partisë dhe në ç'mënyrë ata duhet të veprojnë?

Duhet t'i kemi sytë drejt Moskës dhe çdo gjë ta shohim nën prizmin e luftës që bën Bashkimi Sovjetik, sidomos tani që u zhvillua Konferenca tripalëshe¹. Vendimet e marrura në këtë konferencë dhe politikën sovjetike ne duhet t'i tretim dhe t'u konformohemi pikë për pikë, se vetëm në këtë mënyrë nuk do të gabo hemi gjatë luftës sëcnë. Duhet të popullarizojmë në shkallë të gjerë sovjetët dhe luftën gjiganteske që po bën Bashkimi Sovjetik dhe të ngjallim në popullin tonë dashuri dhe respekt për URSS-in, për Ushtrinë e Kuqe dhe për Stalinin; duhet që populli ynë ta ketë kuptuar mirë se Bashkimi Sovjetik është ai që do të mbrojë kundër çdo dallge reaksiuni interesat dhe lirinë e po-

¹ Konferenca e Moskës e tre ministrave të punëve të Jashtme të BRSS, të Britanisë së Madhe dhe të SHBA.

pujve të vegjël. Me një punë të tillë të mbërrimjë gë Bashkimi Sovjetik të shihet me bindje prej popullit tonë si aleati më i singertë. Nuk duhet të trembemi se mos shkojmë majtas, duke popullarizuar URSS-in, por përsëri duhet të kemi kujdes të mos biem në provokacion dhe të arrijmë në rezultate të kundërtta me qëllimet tonë.

Duhet të popullarizojmë luftën nacional-çlirimtare të të gjithë Evropës dhe veçanërisht të jugosllavëve dhe të grekëve. Duhet ta shtrojmö haptazi, pa ndrojtje, problemin e vëllazërimit tonë me popujt jugosllavë dhe grek. Të demaskojmë pa mëshirë reaksionin dhe shovinizmin, që mundohet të na vërë në luftë me fqinjët, ta bindim popullin se interes i lartë i atdheut kërkon që të jemi të vëllazëruar me popujt grek e jugosllavë, t'ja heqim maskën shovinizmit, që mundohet të dalë si mbrojtës i Shqipërisë nga të huajt dhe t'i tregojmë botës se ne dhe vetëm ne (lëvizja nacional-çlirimtare) e mbrojmë Shqipërinë nga okupatorët dhe nga imperializmat e huaja. Duhet ta bindim popullin se lëvizja nacional-çlirimtare greke dhe jugosllave jo vetëm që nuk e cënon indipendencën tonë, por ndihmon për ta fituar.

Për «Ballin Kombëtar». — Në qarkoret tonë të ndryshme jua kemi theksuar shumë herë se çështë «Balli Kombëtar» dhe qëndrimin tonë karshi tij. «Balli Kombëtar», çerdhja e reaksionit, duhet luftuar pa mëshirë. Në Konferencën e dytë Nacional-Çlirimtare u theksuan qëndrimi ynë dhe konditat për bashkim ose bashkëpunim me të gjithë ata që janë jashtë Frontit Nacional-Çlirimtar dhe me «Ballin Kombëtar». Për-

sa·u përket elementeve të papërlyer ose të gabuar deri dje dhe që gjejnë rrugën e drejtë, qëndrimi ynë duhet të jetë qëndrimi i caktuar në rezolucionin e asaj konference. Përsa i përket bashkimit ose bashkëpunimit me reaksionin ose me «Ballin Kombëtar» si organizatë, kjo çështje nuk shtrohet më, por shtrohet çështja se si t'i luftojmë ata. «Balli Kombëtar» dhe çdo organizatë tjetër jashtë lëvizjes nacional-çlirimtare shkrihen me reaksionin. Në luftën që do të bëni kundër këtij reaksiuni duhet të përpinqeni të shkaktoni diferençime në radhët e tija, dhe me elementin që largohet nga ai, të afrohemë. Puna kryesore që duhet të keni parasysh është që ta ndani reaksionin nga populli dhe ta stërvitni këtë të fundit të hyjë në luftë kundër tij. Qëndrimi ynë i drejtë dhe i vendosur kundër reaksionit nuk duhet të na shpjerë në sektarizëm dhe elementët e gabuar e që c'kuptojnë gabimin t'i përbuzim dhe t'i hedhim në shportën e reaksionarëve. Kini parasysh se në radhët e «Ballit Kombëtar» dhe të gjithë reaksionit ka shumë vetë të pasqaruar, viktima, që nuk e kuptojnë luftën tonë kundër armiqve të jashtëm dhe të brendshëm. Është detyra jonë t'i sqarojmë, t'i afrojmë gjithmonë më tepër në pozitatona dhe me qëndrimin tonë të drejtë, që nuk duhet të shkojë as në sektarizëm as në kompromis, t'i shkëputim njëherë e mirë nga reaksiuni. Duhet të mundohemi t'i shtërngojmë të gjithë të marrin pozita karshi situatës dhe t'i largojmë ata nga pozitat e pritjes «së momentit të përshtatshëm» për të hyrë në luftë kundër okupatorit ose për të na goditur prapa krahëve. Me këta elementë miqësia platonike e fjalët e bukurë nuk duhet të mja-

ftojnë, sepse këto mund t'i bëjnë vetëm të fitojnë kohë, të ruajnë pozitat e tyre atantist¹, të kenë përkrahjen tonë sot, kështu që nesër, me «famën» e tyre «të mirë» në popull, të manevrojnë në kurrizin tonë. Por s'duhet ta kuptioni këtë qëndrim tonin si një përpjekje për t'i hedhur këta në krahët e reaksionit, përkundrazi, qëndrimi ynë duhet t'u japë të kuptojnë atyre të pavendo-surve mirë e të pasqaruuarve se duhet t'i lënë pozitat e pritjes, nga të cilat fiton vetëm armiku.

Për të mbërritur në këto rezultate duhet t'ja bëjmë të qartë popullit qëndrimin tonë, mendimin e Partisë sonë, vijën politike të saj. Popullit duhet t'i tregojmë se ç'ka bërë Partia dhe ç'po bën. Duhet të popullarizojmë në kulm Partinë tonë heroike, sakrificat në gjak që ajo ka dhënë për çlirimin e atdheut; duhet të vëmë në dukje rolin udhëheqës të saj në këtë Luftë nacional-çlirimtare, ngritjen e moralit e të vullnetit të popullit tonë, gjallërinë dhe heroizmin që ajo ka ngjallur në rininë shqiptare, shpirtin e sakrificës e të organizimit, i cili është një model. Duhet, gjithashtu, të jetë e qartë në popull se ç'është lëvizja nacional-çlirimtare, ç'janë këshillat dhe ç'është Ushtria Nacional-Çlirimtare; popullit duhet t'ja bëni të qarta qëllimet e armikut dhe të reaksionit, kur këta përpiken të konfondojnë lëvizjen nacional-çlirimtare me Partinë Komuniste. Duhet të përpikeni që ta zgjeroni Frontin Nacional-Çlirimtar dhe në të të grumbullohet gati gjithë populli ynë, populli i ndershëm dhe luftëtar, populli që i dhimbet vatani dhe liria; me këtë mënyrë ta

¹ Pritjeje.

bindni popullin, dhe ky të shohë konkretisht se në Fron-
tin Nacional-Çlirimtar janë grumbulluar të gjithë ata
që luftojnë për interesin e Shqipërisë dhe për t'i bërë
varrin okupatorit. Jashtë këtij fronti mund të ketë ve-
tëm persona të shkëputur e që kanë vetëm një dëshiri
rë të mirë: t'i shërbejnë çështjes kombëtare, porse kon-
kretisht nuk i kanë shërbyer dhe vazhdimi i qëndrimit
të tyre jashtë këtij fronti, në vend që t'i shërbejë, e
dëmton. Përsa u përket grupeve ose partive politike
që qëndrojnë jashtë këtij fronti ato duhet të luftohen
si parti reaksionare, që direkt ose indirekt bëjnë lo-
drën e okupatorit, se reaksiuni, që të mundë të gjenjnjë
elementin me tendenca demokrate dhe ta shkëpusë kë-
të nga lëvizja nacional-çlirimtare ose që mos ta lërë të
shkojë në këtë front, po mundohet të dalë në skenë me
një «parti socialdemokrate» kukull. Elementë të «Ballit»
si Skënder Muço, renegatë të Nacional-Çlirimtares si
Sotir Kondi dhe agjentë të tjerë të reaksionit, po përp-
piliten të krijojnë parti të tilla po që nuk po guxoj-
në të dalin në shesh.

Populli duhet të shohë mirë se reaksiuni është vegël
e armikut. S'duhet të lejojmë që të imponohet në po-
pull pikëpamja e reaksionit se gjoja ndërmjet nesh dhe
këtij të fundit luftohet për çështje ideologjike; ne lu-
ftojmë kundër reaksionit, së pari, se ky është kokë e
këmbë në shërbim të okupatorit dhe, së dyti, se ky
punon për të përjetësuar regjimet antipopullore. Lufta
jonë kundër reaksionit është një pjesë e luftës kundër
okupatorit, prandaj është e pandarë nga kjo. Duhet t'ja
bëni të kuptueshme popullit se fushata e reaksionit për
bashkim është demagogji e fëlliqur dhe se ne duam

bashkimin e vërtetë, se ne punojmë për këtë bashkim e se jashtë Luftës nacional-çlirimtare nuk ka dhe nuk mund të ketë bashkim. Duhet të kemi kujdes të madh dhe të bëjmë çmos që reaksionarët e lëvizjet e tyre t'i demaskojmë mirë si përçarës, si terroristë, si vëllavrasës. T'i theksojmë popullit se «rregulli» që kërkon reaksioni është okupacioni i huaj, është bajoneta e milicit, është kërbaçi i spiunëve. Ata bëjnë çmos, duke paguar kriminelë e duke shpikur mënyra të poshtra, për të hedhur vendin në kaos dhe në anarki, ta lodhin popullin, ta gënjejnë dhe t'i imponojnë vullnetin e tyre, d.m.th. terrorin më të zi. Kur çetat tona ishin vetëm ndër malet e Shqipërisë, vjedhjet, hakmarrjet dhe çrregullimet filluan të zhduken, dhe fshatari ynë filloj të jetojë në një siguri që s'e kishte parë kurrrë deri atë ditë. Me çetat e «Ballit» filluan krimet, vjedhjet, çrregullimet; nuk mund të ishte ndryshe, sepse këto kishin dalë për të prurë kaosin dhe anarkinë, që janë armiq të mëdhenj të lëvizjes nacional-çlirimtare. Kjo është e vërteta dhe jo e kundërsa si mundohen të tregojnë reaksionarët.

Duhet të kemi një qëndrim të qartë karshi Zogut dhe zogistëve. Këta të fundit kanë filluar të lëvizin, disa duke vepruar individualisht, disa të tjerë pak a shumë të organizuar; një pjesë dëshiron të hyjë në Frontin Nacional-Çlirimtar dhe disa të tjerë, si Bazi i Canës, janë prej kohësh në këtë front, ku qëndrimi i tyre është i lëkundshëm. Pëshpëritet se është formuar një farë partie zogiste me Bazin dhe, patjetër, me gjithë elementët e falimentuar, si bajraktarët, parazitë të regjimit të Zogut, dhe reaksionarët që po lënë vaporin e

«Ballit Kombëtar» që ka filluar të mbytet. Kjo parti thuhet se do të kërkojë të hyjë në Frontin Nacional-Çlirimtar. Të gjithë zogistëve të organizuar ose jo, me Zogun bashkë, ne u themi në mënyrën më kategorike dhe çiltas se për të hyrë në lëvizjen nacional-çlirimtare duhet të pranojnë vijën e Këshillit Nacional-Çlirimtar integralisht, se duhet të mbyllin defterët e së kaluarës e se koha e vjetër nuk mund të përsëritet më, se duhet të mos e shtrojnë në asnjë mënyrë çështjen e regjimit, por të luftojnë për një Shqipëri të lirë demokratike dhe popullore, ku populli të zgjedhë regjinin që dëshiron vetë. Ata duhet të lënë mënjanë të gjitha pretendimet e tyre dhe bashkë me to edhe dallaveret. Ata duhet t'u hapin luftë gjithë reaksionarëve, armiq të luftës që bën populli shqiptar për t'u çliruar. Kësisoj u përgjigjemi ne zogistëve. Por ne nuk mund të humbim kohë në bisedime me ta; duket qartazi se ata po lëvizin për të luftuar; reaksiioni i demaskuar me «Ballin Kombëtar» përpinqet të gjejë flamuj të tjerë, me të cilët, qoftë nga brenda qoftë nga jashtë, të luftojë lëvizjen nacional-çlirimtare. Për këtë arësy le të fillojmë t'i demaskojmë dhe t'i luftojmë, duke ja paraqitur popullit në dritën e vërtetë, se ata nuk kanë bërë kurrgjë kundër okupatorit, por, përkundrazi, hapët ose tërthorazi, kanë bashkëpunuar me të dhe tani duan të përfitojnë nga lufta jonë për të rivendosur regjinin e skllavërisë. Mos të hezitojmë t'i godasim edhe me armë ata njerëz që përpinqen (si p.sh. në Dibër, ku zogistët hëngrën një dru të shëndoshë nga ana e forcave tona) të pengojnë luftën tonë. Kundër zogizmit duhet të bëhet agjitation në shkallë të gjerë në popull, por deri në një direktivë tjetër të mos zihet emri

i Bazit të Canës, në trakte o komunikata...¹. Kjo gjë nuk ju ndalon aspak të demaskoni gazetën «Atdheu», manevrat e zogizmit dhe zogistët e terreneve tuaja; nuk ju ndalon gjithashtu që të preqatitni terrenin për një fushatë të gjerë dhe për një luftë të hapët kundër Zogut, nuk ju ndalon që të flitni kundër Musa Jukëve dhe të ngjallni në popull antizogizmin.

Brenda në radhët e reaksionit ka dhe do të ketë patjetër divergjenca, por ne nuk duhet ta flemë mendjen dhe të shpresojmë shumë në këto, sepse reaksionarët kundërshtimet më të mëdha dhe armiqësinë e kanë kundër nesh e jo kundër njëri-tjetrit. Kjo s'do të thotë që ne të mos përfitojmë nga divergjencat e tyre.

Nëpërmjet luftës politike kundër reaksionit, në-përmjet luftës me armë kundër forcave të armatosura reaksionare dhe, në radhi të parë, kundër okupatorit, populli do të mobilizohet rreth nesh gjithmonë më tepër, do të bëhet më konshient dhe do ta bëjë Luftën nacional-çlirimtare me të vërtetë luftë të tij. Për këtë arësyë duhet të kemi kujdesin më të madh që të mos hidhemi vetëm kundër reaksionit, as në luftën politike as në luftën me armë, por të marrim edhe popullin me vete, sepse përndryshe populli fillon e mbetet si neutral dhe, duke qenë në këto pozita, ai mund të influencohet lichtë nga armiku. Okupatori gjerman dhe veglat e tija mundohen ta bindin popullin shqiptar se këtu s'ka okupacion

¹ Në këtë kohë Këshilli i Përgjithshëm Nacional-Çlirimtar nuk kishte përjashtuar akoma nga radhët e veta Abaz Kupin (Bazin e Canës) dhe e kish thirrur atë në takim për të sqaruar pozitën e tij.

dhe ta bëjnë që të harrojë se këtu gjendet ushtria gjermane. Ky është një rrezik për ne, sepse e bën popullin që të largohet nga lufta. Duhet që, përveç luftës me armë kundër gjermanëve, të bëjmë edhe një luftë politike më të gjerë dhe më të thellë kundër demagogjisë naziste. Duhet të luftojmë asamblenë, komitetet, komisionet, këshillat e çfarëdo gjë të ngritur nga gjermanët. Të demaskojmë dhe të luftojmë rreptësisht tradhëtarët si Mehdi Frashëri, Fuat Dibra, Pater Anton Harapi, Lef Nosi¹ e të tjerë dhe të likuidojmë në popull besimin se gjoja këta nacionalistë, që s'janë veçse agjentë të Gestapos, e kanë marrë këtë detyrë të detyruar nga gjermanët, ose për «të mirën e Shqipërisë». Gjermanët me gojën e tradhëtarëve thonë se ne nuk ju ndjekim, prandaj mos na ndiqni. Pranimi i kësaj vije është kompromis, është mohim i Luftës nacional-çlirimtare dhe çon në likuidimin e lëvizjes sonë dhe në forcimin e pozitave të reaktionit. Prandaj duhet ta mbajmë popullin vazhdimishët në luftë kundër okupatorit dhe t'i ngjallim me të gjitha mënyraturrejtjen kundër tij.

Për këshillat nacional-çlirimtare. — Kohët e fundit ju është dërguar rezolucioni i Konferencës së dytë Nacional-Çlirimtare si edhe Statuti dhe Rregullorja e Këshillave Nacional-Çlirimtare. Nga ana tjetër, kurdoherë që Komiteti Qendror ju ka çuar letra e direktiva, ju ka theksuar veçanërisht rëndësinë e këshillave nacional-çlirimtare, rolin e tyre në këtë luftë dhe mënyrën e

¹ Mehdi Frashëri, Fuat Dibra, Lef Nosi dhe Pater Anton Harapi përbënë «Këshillin e lartë të Regjencës» të krijuar nga pushtuesit gjermanë në tetor të vitit 1943.

punimit në to. Ju këshillojmë që këto rezolucionë, rregullore, qarkore t'i punoni me kujdesin më të madh dhe në terren t'i aplikoni në mënyrë që rezultatet të jenë konkrete dhe të shëndosha, sepse duhet të kuptioni mirë se këshillat nacional-çlirimtare s'janë gjëra formale, por bazat e regjimit demokratik dhe organizmat e vërteta të Luftës nacional-çlirimtare. Me gjithë këshillat e udhëzimet që ju janë dhënë nuk është arritur në rezultatet e duhura; në shumë vende nuk ekzistojnë akoma këshilla kurse në disa vende të tjera ato janë vetëm formale. Patjetër atje ku këshillat janë në këtë gjendje, atje reaksiioni lëviz, atje ai bën fole, kurse ndër vende të tjera, ku ato janë ngritur në bazë të Statutit dhe të Rregullores, i gjithë populli merr pjesë në to, lufton dhe ndihmon parreshtur lustën. Që të mundin këshillat të punojnë si duhet, duhet të caktoni shokë që të merren me këtë punë dhe që t'i kushtojnë aktivitetin më të madh kësaj çështjeje. Këta shokë jo vetëm t'i formojnë këto këshilla, por t'u japid gjallëri dhe jetë, t'u shpijen eksperiencën dhe vullnetin e tyre, të ndihmojnë dhe të ngrenë të gjithë elementët nationalistë që marrin pjesë në to dhe t'i bëjnë konshientë të detyrës që u ka ngarkuar populli. Këshilli duhet të mobilizojë tërë popullin dhe të bëhet një organizim i fortë me një aparat të shëndoshë organizativ. Në çdo fshat të formohen këshillat, të formohen këshillat e komuneve, nënprefekturave dhe të qarkut dhe këto të lidhen ngushtë me Këshillin e Përgjithshëm Nacional-Çlirimtar, nga i cili do të marrin udhëzime e direktiva dhe të cilat do t'i dërgojnë çdo herë raporte të imta për veprimtarinë e tyre dhe për situatën politike të qarkut. Sikundër ju theksohet në qarkoret e mëpar-

shme, që të mund të funksionojnë si duhet këto këshilla, duhet të formohen seksione të ndryshme në gjirin e tyre dhe këto seksione, duke pasur në krye nga një kompetent, të organizojnë punën, duke përfshirë të gjithë jetën shoqërore, politike të fshatit o të qytetit. Këshillat, në radhë të parë, duhet të mbledhin ndihma për ushtrinë tonë, të bëjnë fushata për dimër, i cili po afrohet i egër për luftëtarët tanë që janë nëpër male. Përsa u përket ndihmave në të holla duhet të kemi kujdes të mos i ngatérrojmë xhepat: fondi nacional-çlirimtar duhet të shkojë në duart c këshillave, të cilat ja jepin Shtabit të ushtrisë dhe vetëm ndihmat e Partisë shkojnë në kasën e Partisë. Këtu duhet të keni kujdes të madh, sepse pasqyra e llogarive duhet të jetë e qartë. Direktivat që çohen prej Këshillit të Përgjithshëm Nac.-Çl. duhet që shokët e Partisë t'i punojnë nëpër këshilla dhe t'i bëjnë të qarta, t'i bëjnë të zbatohen jo me dekrete e me forcë, por me bindje. Literaturën që dërgon Këshilli i Përgjithshëm Nac.-Çl., si trakte o gazeten «Bashkimi», ta shpërndani në të katër anët e Shqipërisë, ta shumëzoni, po të keni mundësi, dhe ta punoni më së miri. Forcimi i këshillave nac.-çl. do të thotë forcim i luftës sonë, do të thotë çlirim i shpejtë i popullit dhe i atdheut tonë.

Për Bashkinin e Gruas Antifashiste Shqiptare. — Me autorizimin e Komitetit Qendror është marrë iniciativë dhe u është dërguar gjithë qarkorëve një qarkore¹, me të cilën këshilloheni që të filloni punën për krijimin

¹ Qarkore e KQ të PKSH në lidhje me krijimin e organizaçës Antifashiste të Grave Shqiptare, 14 prill 1943. (Shih: Enver Hoxha Vepra, vël. 1, f. 262).

e organizatës së Bashkimit të Gruas Antifashiste Shqiptare. Kjo është një organizatë dhe jo një formulë e bukur për t'u përmendur në konferenca. Roli i gruas në këtë luftë është i madh dhe lufta e sotme me plot sakrifica e ka vënë në dukje, prandaj duhet të punoni me të ashtu si punohet me një organizatë. Duhet ta ngrini nga themellet këtë organizatë dhe ta çimentoni, t'i jepni jetë dhe gjallëri këshillave të gruas antifashiste në mëhallë, në fshatra e në qytete. Të krijohen sa më parë këto këshilla dhe të mos mbetet vetëm një dëshirë e mirë. Shoqet tona t'ja kushtojnë punën më të madhe krijimit dhe forcimit të një aparati organizativ të shëndoshë të Gruas Antifashiste. Organizimi i shpejtë i këtyre këshillave do të shpejtojë Konferencën e Vendit të organizatës së Gruas Antifashiste Shqiptare. Prandaj ju duhet të keni kujdes që të zgjidhet aty këshilli i qarkut me anë të një konference të qarkut dhe të caktohen delegatet për Konferencën e Vendit. Me pëlqimin e Konferencës së dytë Nacional-Çlirimtare, Këshilli i Gruas Antifashiste të qytetit të Tiranës ka marrë përsipër organizimin e kësaj konference.

Për Bashkimin e Rinisë Popullore Antifashiste Shqiptare. — Në një qarkore të Komitetit Qendoror të Rinisë¹, drejtar komiteve qarkore të rinisë, shpjegohet mirë se ç'është kjo organizatë, pse krijohet dhe si funksionon. Punojeni mirë atë qarkore. Duhet t'i jepet ndihma më e madhe komitetit qarkor të rinisë, që të or-

¹ Qarkore e Komitetit Qendoror të Rinisë Komuniste Shqiptare «Mbi krijimin e organizatës së Rinisë Antifashiste Shqiptare», 20 shtator 1943.

ganizojë konferencën e qarkut të Bashkimit të Rinisë Antifashiste, ku do zgjidhet komiteti i qarkut dhe delegatët për Konferencën e Vendit. Rinia Antifashiste bërenda mundësive do të dërgojë delegatët e saj për konferencën e qarkut. Por ju mos pritni dhe bëjeni konferencën sa më parë, në prani të delegatëve ose të një delegati të këshillit nacional-çlirimtar të atjeshëm; në qoftë se vjen delegati i Rinisë Antifashiste mirë, në mos ardhëtë, puna le të vazhdojë.

Të keni kujdes që shokët e rinisë, që dërgoni në çeta ose brigada, t'i shoqëroni me shënimë mbi punën e tyre dhe mbi aftësinë e tyre dhe të këshilloni shokët e çetave të grupit e të zonës që t'u japid përgjegjësinë e duhur, në mënyrë që shokët, të cilët mund të drejtojnë punën e rinisë, të mos ngarkohen me punë që mund t'i bëjë edhe një partizan i thjeshtë.

Për mbarëvajtjen e punës me rininë janë përgjegjës të gjithë shokët e Pártisë; mungesa e interesimit nga ana juaj për këtë sektor mund të shkaktojë që rinia të fillojë të shkëputet nga Partia. Por interesimi nuk duhet të kuptohet në mënyrë të ngushtë, interesim nuk do të thotë të bësh kontroll të thatë dhe burokratik; interesim do të thotë të studjosh dhe të njohësh mirë vijën organizative të rinisë, problemet e saja, nevojat e saja në qarkun tuaj, t'i vish në ndihmë, ta këshillosh, ta udhëzosh dhe të dish ta shtiesh në punë dhe ta përdorësh sa më tepër për forcimin e Partisë sonë dhe të Luftës nacional-çlirimtare. Fatkeqësisht, ne konstatojmë se interesimi juaj për rininë ka qenë më tepër formal. Ne dëshirojmë dhe duhet të kemi patjetër përmirësimë në këtë pikë, dhe në raportet tuaja që na çoni duhet të flitet për ri-

ninë, të flitet në mënyrë konkrete, ku të duket interesimi dhe kompetenca juaj.

Për Ushtrinë Nacional-Çlirimtare. — Problemi kryesor i Luftës nacional-çlirimtare është problemi i forcimit të ushtrisë sonë. Krahas me çështjen organizative të Partisë, çështja e ushtrisë duhet të preokupojë shokët udhëheqës dhe gjithë anëtarët e Partisë. Të dyja këto çështje janë të lidhura ngshtë njëra me tjetrën, por në këtë pikë do të kufizohemi vetëm t'u bëjmë disa vërejtje përsa i përket çështjes ushtarake. Batalionet që ndodhen në qarkun tuaj duhet të janë kurdoherë në ofensivë kundër armikut të jashtëm dhe të brendshëm, dhe, njëkohësisht, ushtarët tanë t'i lartësoni politikisht, në mënyrë që ata të bëhen konshientë për luftën që bëjnë. Nga ana tjetër, duhet të kryeni mobilizimin në pull, dhe ky mobilizim të mos ketë për qëllim grumbullimin e elementeve jo të përshtatshëm për luftë e që largohen në goditjen e parë me armikun, por në radhët e ushtrisë sonë duhet të mobilizoni fshatarë, punëtorë që e kanë në shpirt luftën për çlirim. Duhet të zgjedhim për ushtrinë tonë udhëheqës të përshtatshëm, trima dhe të ndershëm; nuk lejohet që ndër këto komanda të mbani elementë që mund të diskreditojnë dhe të pengojnë luftën tonë. Nga batalionet sulmuese duhet të rekrutoni elementët më të shëndoshië dhe më trima për të formuar brigadat, kur të merrni urdhëra nga Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacional-Çlirimtare. Shihet në radhët e ushtrisë sonë një farë burokratizmi, i cili duhet të zhduket, sepse pengon zhvillimin e luftës dhe i lejon shokët partizanë të gjejnë justifikime për plogështinë e tyre. Nga ana tjetër, kjo ngadalëson ritmin e luftës, e

çila duhet të mbajë kurdoherë karakterin e një lufte guerriljeje e të shpejtë. Në disa qarqe ushtria jonë ka humbur deri diku atë ashpërsinë që duhet të ketë në luftë, dhe në disa vise të tjera disa çeta dhe batalione, në vend që të jenë kurdoherë në vende ku goditet armiku, përpiken të shtrojnë gunat e të gjejnë kuarteret e dimrit. Që të mund të kemi një ushtri të fortë duhet patjetër që ju të interesoheni, të formoni Partinë në ushtri dhe shokët¹ të jenë udhëheqësit dhe ata që do t'i japin zjarr e gjallëri kësaj ushtrie. Deri tani nuk kemi parë që këto direktiva të merren me gjithë seriozitetin e duhur dhe të zbatohen. I jeni vënë çështjes ushtarake, keni mobilizuar masa, por këto nuk do të kenë atë gjallëri, në qoftë se u mungon udhëheqja e duhur nga Partia. Nuk mjafton, sikundërqë është në realitet (mjerisht i hidhur), të keni celula ndër batalione e ndër çeta, por duhet që këto celula të bëjnë me të vërtetë detyrën e tyre. Shokë të Partisë në ushtri në shumë raste s'bëjnë tjetër, vegse merren me gjëra të vogla, si punë korrierësh e blerës plaçkash për çeta, punë që mund t'i bëjnë partizanë të thjeshtë, në vend që këta të organizojnë konferenca e kurse të ndryshme në ushtri. Kjo gjendje duhet patjetër të zhdukët; mos dëgjohen më komisarët dhe zëvendëskomisarët të justifikojnë inaktivitetin e tyre, duke thënë se s'mund të mblidhnin dot celulën ose të bënин konferenca, pse kanë qenë në udhëtime e të tjera gjëra të tillë. Vetë karakteri i luftës sonë është lëvizës dhe prandaj s'është një justifikim për anëtarët e Partisë të mos bëjnë detyrën e tyre. Të këshillohen shokët

¹ Anëtarët e Partisë.

që të ruajnë dhe të ngrenë emrin e Partisë në radhët e partizanëve, të jenë të ashpër ndaj gjithë anëtarëve të Partisë, e sidomos ndaj komisarëve e zëvendëskomisarëve, kur ata nuk bëjnë detyrën e tyre. Celulat e batalioneve e byrotë e shtabeve të kenë kujdesin më të madh që çdo shenjë dobësie nga ana e anëtarëve të Partisë, të mos lihet të shkojë pa u qortuar e pa u korrigjuar. Shokët tanë në ushtri duhet të jenë model për të tjerët. Provë që qarqet e kanë lënë pas dore organizimin e Partisë në ushtri është fakti se numri i anëtarëve të Partisë në atë sektor nuk po shtohet; burimi i madh për anëtarë partie, luftëtarë të vendosur dhe të provuar, siç është sektori i ushtrisë, ka mbetur shterpë. Po formohen brigadat me elementë të ndryshëm të dërguar nga çdo terren, por mungojnë anëtarët e Partisë, sepse këta mungojnë në radhët e ushtrisë. Dhe për të kompletuar këtë mungesë detyrohem i t'i nxjerrim kuadrot nga qytetet. Këtë gjë e themi vetëm për të treguar se sa pak punohet në ushtri, në atë sektor ku Partia jonë ka shpresat më të mëdha të rekrutojë anëtarët e Partisë nga shtresa katundare. Në këto momente, mobilizimi është në rendin e ditës dhe duhet të bëhet me sistem. Duhet një herë të studjohet nga qarkori se cilët janë anëtarët e Partisë që duhet të shkojnë në ushtri. Për këtë gjë duhet të kini parasysh që ndër qytete, duke mbajtur disa kuadro mjaft të shëndosha e të afta për të kryer punën, nuk duhet të sakrifikonit kuadro të tëra në rast të një reaksioni nga ana e armikut. Një pjesë të këtyre kuadrove duhet ta dërgoni në radhët e ushtrisë me detyra dhe udhëzime të caktuara. Nga ana tjetër t'u shpjegohet celulave rëndësia e mobilizimit dhe mënyra se si ta bëjnë;

të preqatiten drejtuesit e rinisë, këshillat nacional-çlirimtare dhe grupet edukative për fushata të gjera mobilizimi. Në konferenca të gjera të popullit në qytete e fshatra, në konferenca të gjera të rinisë të shtrohet si pikë kryesore çështja e forcimit të ushtrisë dhe e mobilizimit. Në këto konferenca ose mitingje ata që janë gati të dalin në çetë, dhe sidomos shokët tanë të Partisë dhe të rinisë, të dalin në fund të bisedimeve dhe të thonë se do të shkojnë në ushtri, duke ftuar edhe të tjerët të venë me ta. Të bëhen fushata mobilizimi për brigadat, e veçanërisht në rininë e qytetit. Duhet ta shihni mirë e ta kuptioni njëherë e përgjithmonë se pa ushtri të organizuar, sidomos pa brigada të forta, nuk mund t'i bëjmë një luftë serioze okupatorit, nuk mund ta mobilizojmë gjithë popullin shqiptar, nuk mund t'ja thyejmë kokën reaksionit. Kur kërkojen elementë nga Shtabi i Përgjithshëm për brigadat e ndryshme që janë formuar, shokët e terreneve, në vend që të çojnë, sipas direktivave që u jepen, elementët më të zgjedhur e më luftëtarë, çojnë ata që u vijnë më për mbarë. Kjo trengon se shokët e Partisë s'u vënë veshin ose nënçmojnë rëndësinë e brigadave, që janë formacionet e vërteta të ushtrisë sonë të rregullt dhe që pak nga pak do të thin gjithë elementët e shëndoshë për të krijuar, më në fund, ushtrinë tonë të vërtetë. Shokët e terreneve përgjithësisht e shohin punën ngushtë dhe pikëpamjet e tyre nuk dalin jashtë terrenit ku janë. Duke pasur frikë se mos dobësohet terreni, ata nuk shohin vlerën e madhe që ka brigada, e cila po të mbajë në gjirin e saj elementë qind për qind të vendosur do të jetë në gjendje të bëjë mrekullira dhe t'i japë ndihmën në çdo më-

nyrë dhe në çdo sektor terreneve të ndryshme ku ajo-kalon. Prandaj duhen dërguar shokët më të mirë në ushtri e sidomos në brigada. Përgjithësisht ushtria jonë ka nevojë për komisarë, zëvendëskomisarë e shokë të zgjedhur, që ta ngrenë ushtrinë, t'i shumojnë celulat në radhët e saja dhe t'i çelnikosin, që kështu të mos përsërijet më fakti i hidhur që në ushtrinë tonë të ketë celula që s'janë celula. Mos mbani të grumbulluar në qytet shokë të shumtë, por i dërgoni në ushtri. Në qytet, me një numër të vogël shokësh, por të vendosur, me një organizatë të Rinisë, me një organizatë të Gruas Antifashiste dhe me këshillat nacional-çlirimtare pa asnje dyshim puna do të shkojë mbarë. Është një krim që në ushtri, ku ka grumbullim, të mos kemi anëtarë të Partisë, të mos kemi celula, të mos kemi organizatë. Edhe shokët përgjegjës të punës, si anëtarë të qarkorit, sekretarë organizativë ose politikë, të lartësojnë sa më parë shokë të rinj dhe t'i lenë zëvendës në punët e tyre, sepse detyra shpejt do t'i thérresë që ata të hidhen në radhët e ushtrisë. Duhet të vendosim për këtë gjë dhe puna të mos hiqet zvarrë. Me një qarkore¹ drejtuar gjithë zëvendëskomisarëve politikë të reparteve të ndryshme të Ushtrisë Nacional-Çlirimtare nga ana e Komitetit Qendror theksohet detyra e tyre dhe kujdesi që duhet të vënë për organizimin e Partisë në ushtri. Veçanërisht ju rekomandohet që të këndohet e të punohet referati

¹ Udhëzim i KQ të PKSH, 23 shtator 1943 drejtuar gjithë zëvendëskomisarëve politikë të çetave, batalioneve dhe brigadave të Ushtrisë Nacional-Çlirimtare. (Shih: «Dokumenta kryesore të PPSH», vell. I, f. 164, Tiranë 1960).

mbi Ushterinë Nacional-Çlirimtare¹, i cili duhet të shumëzohet dhe të vihet në dorë të çdo anëtari të Partisë. Ju është theksuar dhe herë të tjera se puna e Partisë në ushtri nuk varet nga komitetet qarkore. Përsa u përket brigadave, kjo është dhe mbetet fjalë për fjalë këshfu. Përsa u përket batalioneve dhe çetave të grupit e të zonës, kjo nuk duhet të merret shumë ngurtë. Organizata e Partisë ndër to varet edhe ajo prej Komitetit Qendror, prej nga merr direktiva dhe ku raporton me anën e komisarit të Shtabit të Përgjithshëm, por vazhdon të mba jë lidhje dhe të ndihmohet nga komiteti qarkor i terrenit, për arësyse se kanë mjaft punë të përbashkëta.

Çështjet e brendshme të Partisë. — Rëndësia e çështjes organizative të Partisë ju është theksuar në çdo letër, por nuk shihet në organizatat ai zell dhe ai kujdes i madh që shihej përparrë për këtë çështje me kaq rëndësi. Kjo ka kaluar në dorë të dytë dhe është një gabim i madh, se duhet të dimë se pa pasur një parti të fortë, të organizuar më së miri me kuadro të shëndosha dhe të edukuara, të dala nga lufta e nga përpjekjet, rezultatet do tëjenë të pakta. As ushtria, as rinia, as organizatat e tjera antifashiste nuk mund të jenë në lartësinë e duhur, në qoftë se organizativisht çalon Partia jonë. Që prej shokëve udhëheqës deri tek anëtari i celulës e anëtari i grupit simpatizant, duhet të shkunden njëherë e mirë dhe t'i shohin punët dhe situatën më konkretisht. Barra që rëndon mbi supet e Partisë sonë, është jashtëzakonisht e rëndë dhe për ta ngritur këtë barrë

¹ Referat i mbajtur në Konferencën e parë të Vendit të PKSH.

e për të dalë matanë fitimtarë, duhet të kemi koskën e kurrizit të shëndoshë, duhet të kemi Partinë tonë të organizuar dhe të fortë, duhet t'i kemi shokët në lartësinë e duhur politike dhe ushtarake, që të mundin në këto momente e situata të vështira e decizive të përballin çdo të papritur dhe të orientohen pa u gabuar. Për këtë shkak duhet që shokët udhëheqës të ndihmojnë parrestitur shokët ndër celula, t'i ngrenë politikisht dhe teorikisht, t'u ngarkojnë punë me përgjegjësi, t'u kërkojnë rezultate. Në barazim me punën, që po zhvillohet e që zmadhohet, duhet që edhe ju të përdorni mënyra punimi të reja, se vetëm kësisoj mund të përballoni detyrat e domosdoshme që ju vihen përpara. S'është më ajo punë e vogël, kur në mbledhjet e qarkorëve diskutohej puna e pesë raporteve të ardhura nga celulat, tanë hapen para jush horizonte të gjera punimi. Për këtë shkak duhet të ndani punën, duke formuar rreth çdo përgjegjësi një rrjetë shokësh, simpatizantësh, miqsh dhe së bashku të kryeni detyrat që ju ngarkon mbledhja e qarkorit. Seksione të ndryshme duhet të formohen për shtypin e propagandën, për financën, për ushtrinë etj.

Shtypit e propagandës duhet t'i vini kujdesin më të madh. Komunikatat, traktet, gazetat të shtypen me kujdes dhe të shpërndahen kudo në popull. Seksioni i propagandës duhet të jetë kurdoherë zgjuar, për të demaskuar çdo manevër të armikut dhe për të sqaruar shokët dhe publikun mbi çdo situatë. Këtë literaturë duhet ta punoni me kujdes në celula e në grupe, pse atje shokët do të mësojnë qëndrimin politik të luftës sonë dhe të Partisë. Të shumëzohen broshurat dhe librat, si domos «Historia e Partisë Komuniste (bolshevikë)», dhe

kjo jo vetëm që të vihet në dorë të çdo anëtarë të Partisë, por edhe të mbahen konferenca e kurse mbi të. Një punë e tillë do t'i ngrejë shokët politikisht dhe do t'i pajisë ata me armën më të shëndoshë, që është teoria marksiste.

S'dëgjohet fare se në ç'gjendje janë financat e Partisë. Si po konstatojmë, ato janë të përziera me fondin nacional-çlirimtar. Ky është një gabim, të cilin duhet përnjëherësh ta ndreqim. Kuotizacionet dhe ndihmat që mblidhen për Partinë duhet të shkojnë në arkën e Partisë, s'ka gjë pse ato të prishen për nevojat e ushtrisë, por duhet patjetër të dihet kontributi në të holla që i ka dhënë Partia luftës. Janë neglizhuar krejtësisht fushatat që mund të bëhen për mbledhje ndihmash për Partinë Komuniste. Këto fushata duhet të vihen në zbatim, pse janë edhe një mjet propagandistik.

Puna me nacionalistët, që është shumë delikate, duhet t'u ngarkohet shokëve të nirë, të cilët të dinë ta paraqesin si duhet vijën e Luftës nacional-çlirimtare, të dinë të dalin nga situata të vështira dhe t'u japid gjallëri e jetë këshillave nacional-çlirimtare. Organizata e Rinisë dhe ajo e Gruas Antifashiste duhet të ndihmohen seriozisht dhe në asnjë mënyrë të mos nënvleftësohen, sepse kur në mëhallat t'i kemi të forta këshillat nacional-çlirimtare, këshillat e rinisë, këshillat e gruas, ne e kemi mobilizuar të tërë mëhallën, e kemi hedhur të tërë në luftë. Këtu do të ndjehet nëse organizativisht Partia është e shëndoshë.

Puna me misionet angleze. — Në shumë krahina ndodhen misione angleze, të cilat përpilen të futin hundët në çështjet politike e sidomos në çështjet e brend-

shme organizative dhe ushtarake tonat. Ato mundohen të bashkohen me reaksionarët, t'i organizojnë këta për t'i pasur vegla të tyre për kohën e zbarkimit. Këtë punë oficerët anglezë disa herë e bëjnë tërthorazi, disa herë haptazi. Atyre u duhet një lëvizje e fortë dhe me kredi në popull, prandaj përpinqen të ngrenë prestigjin e «Ballit Kombëtar», ta futin këtë në luftë kundër gjermanëve për ta pasur si mbështetje për më vonë. Por të mos harrojmë se atyre u intereson, para së gjithash, lufta kundër gjermanëve, të cilën këtu në Shqipëri e bën vetëm lëvizja nacional-çlirimtare, prandaj ata do ta ndihmojnë patjetër lëvizjen tonë. Duhet të kemi me ta një sjellje korrekte, por edhe një qëndrim të qartë dhe të prerë. Ata nuk duhet të përzihen në punët e brendshme, nuk duhet në asnjë mënyrë të merren si arbitra ndërmjet nesh dhe reaksionit. Në u pëlqeftë lufta jonë kundër reaksionit mirë, përndryshe derën e kanë të hapur. Në rast se shihet se oficerët anglezë luajnë dallave-re, në rast se ju keni fakte ose dokumenta mbi këtë gjë, atëherë të raportohet menjëherë në Shtabin e Përgjithshëm dhe, në qoftë se çështja është e rëndë dhe puna s'pret, atëherë të shoqërohen pranë komandës së misio-nit anglez në Shqipëri (me anën e Shtabit tonë të Përgjithshëm); në asnjë mënyrë mos të lihen të futin hu-nëtët në punët tona, në ushtrinë tonë.

* . * *

Letrat ose raportet që i dërgohen Shtabit të Përgjithshëm, Këshillit të Përgjithshëm, Gruas Antifa-shiste dhe Rinisë Antifashiste duhet të përbajnë gjë-

ra në kompetencë të tyre dhe jo t'i shkruhet, p.sh., Shtabit për çështje partie, ose në të njëjtën letër që i shkruhet Shtabit, t'i shkruhet edhe Komitetit Qendror të Partisë, siç ka ndodhur shpeshherë. Letrat të kenë mirë adresën në krye.

Ju rekomandojmë edhe një herë kujdesin më të madh që qarkoret dhe letrat e Komitetit Qendror të ruhen dhe të mos bien në asnje mënyrë në dorë të armikut; gjithashtu përbajtja e tyre të mos bjerë nëasnje mënyrë në vesh të armikut. Nga qarkoret dhe nga letrat ju duhet të nxirri vijën dhe taktikën, me të cilën do të punoni në organizatë, në popull dhe kundër armikut. Kjo nuk do të thotë se do të dilni në popull me qarkoret fjalë përfshirë fjalë. Ju theksojmë edhe që të gjithë anëtarët e qarkorit t'i këndojnë mirë qarkoret dhe letrat e Komitetit Qendror dhe, mundësisht, të mblidhet herë pas here aktivi i qarkut ose vetëm i qyletit ose i krahanës dhe aty këto të punohen. Sidoqoftë në të gjitha celulat duhet të çohet fjalë e Komitetit Qendror dhe të punohen direktivat e tija.

Të fala shoqërore
Për Komitetin Qendror të Partisë
Komuniste të Shqipërisë

S h p a t i

*Botuar për herë të parë
në «Dokumenta kryesore
të PPSH», vëllimi I,
Tiranë 1960*

*Botohet sipas origjinalit, që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

**LETËR DREJTUAR KOMITETIT QARKOR TË
PARTISË KOMUNISTE TË SHQIPËRISË PËR
BERATIN, ME ANËN E SË CILËS DËNOHEN
LIDIJJET E DOBËTA ME KOMITETIN QENDROR
DIIE KOMPROMISI ME GJERMANËT NË BERAT**

5 nëntor 1943

Të dashur shokë,

E morëm raportin tuaj pa datë, dhe me justifikimet që paraqitni për vonesën e raportevet. Komunis-tët nuk kërkojnë kurrë të gjejnë justifikime por mba-rojnë punën që u ngarkohet me përpikëri. Nga shokët e Beratit s'kemi parë asnjëherë raporte si duhet dhe në kohën e caktuar. Dhe pas dy-tre muaj heshtjeje ju na bëni nga një raport, ku kérkon kurdoherë ndjesë për vonesën e tij. Të tilla mënyra punimi duhet të mbarojnë njëherë e mirë, pérndryshe do të merren masa, bile shumë rigorozë. Mënyra e punës suaj dhe e lidhjeve me Komitetin Qendror do të tregohet në gjithë organizatat si një shembull i keq, në mënyrë që të mos përsëritet më.

Kompromisi me gjermanët është një nga punët më të këqia që mund të ketë bërë një qarkor i Partisë. Të gjitha mund të priteshin, por një vepër e tillë nuk mund

të pritej kurrë nga ju. Këto janë konsekuencat e shkëputjeve të lidhjeve me Komitetin Qendror. Ky kompromisi juaj me gjermanët do të jetë një nga pikat e bisedimeve të mbledhjes së ardhshme të Komitetit Qendror, ku do të merren vendime për këtë çështje.

Përsa i përket çështjes së Fierit, ai është i lidhur me Vlorën dhe s'është ndonjë çështje kaq e koklavitur si e tregoni ju. Kjo s'ju ndalon që në rast se keni material propagandistik me shumicë, gjë që nuk kujtojmë, t'ja dërgoni.

Qarkorja që ju çohet duhet të punohet me kujdesin më të madh në qarkor, ku të marrin pjesë të gjithë anëtarët e tij si edhe Gjin Marku, i cili të thërritet apos-tafat për këtë gjë.

Të fala shoqërore
Për Komitetin Qendror

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë, si-pas origjinalit që gjendet në Arkirin Qendror të Partisë

LETËR DREJTUAR KOMITETIT QARKOR TË
PARTISË KOMUNISTE TË SHQIPËRISË PËR
ELBASANIN MBI PREGATITJEN E KUADRIT
DHE MBI FORCIMIN E PUNËS POLITIKE
NË USHTRI

8 nëntor 1943

KOMITETIT QARKOR TË ELBASANIT

Të dashur shokë,

Nga raportet e ndryshme që po marrim prej komandave ushtarake të qarkut tuaj, si edhe nga letrat dhe informatat prej miqve të lëvizjes sonë, na rezulton një fakt, që shokët e Partisë në ushtri nuk janë në lartësinë e duhur dhe nuk e bëjnë detyrën si duhet. Kësaj situate duhet paljetër t'i jepet fund. Të këshillohen komisarët, zëvendëskomisarët dhe komendantët që janë shokë partie, të jenë shembull për të tjerët, shembull guximi, trimërie, sakrifice dhe kujdesi për batalionet e tyre dhe për partizanët që udhëheqin dhe komandojnë. Ta dinë njëherë e përgjithmonë komisarët dhe zëvendëskomisarët e gjithë batalioneve se anëtarë partie, që atë kërkojnë parreshtur t'u dërgojë qyteti, nuk ka. Batalionet janë të vetmet burime të sigurta, ku mund të rekrutohen anëtarë partie të vendosur dhe që ta duan Partinë me gjithë shpirt, pse atje ekziston grumbullimi

dhe atje duket puna e vërtetë e një komunisti që i kanë ngarkuar detyrën e komisarit e të zëvendëskomisarit. Atje këta njerëz do të duken se si punojnë me masat e popullit. Mjerisht konstatojmë se batalione prej 204 vëtësh si ai i Dumresë, që ka kohë që po lufton, kërkojnë komisarë dhe zëvendëskomisarë nga Komiteti e nga Shtabi. Pyesim atë qarkor se çfarë punë partie në ushtri kanë bërë ata shokë që ndodhen në atë batalion. Nga ana tjetër duhet të këshillohen ata shokë të atij batalioni, veçanërisht komandanti dhe komisari, që të kujdesen më shumë për partizanët dhe në udhëtimet e tyre t'i lenë ca mënjanë rehatet dhe shtëpitë e mira, të rrojnë tok me partizanët, të hanë e të flenë me ta. Nga ana tjetër këta shokë, e në përgjithësi të gjithë shokët në batalione, i kanë lënë krejt pas dore konferencat për ushtrinë. Kjo e metë të korrigohet sa më parë, duke lajmëruar shokët nga ana juaj. Nga ana jonë do të lajmërohen me anë qarkoreje drejtuar zëvendëskomisarëve. Këtë gjë ta bëni sa më parë, duke u çuar nga një letër të gjithë shokëve të batalioneve, derisa të formohet këtu komanda e grupit, nga e cila të varen të gjitha batalionet e të mundim kësisoj të organizojmë dhe të lidhim organizatën e ushtrisë me Shtabin.

Shumë të fala
Për Komitetin Qendror të Partisë
[Enver Hoxha]

*Botohet për herë të parë, si-
pas origjinalit që gjendet në
Arkivin Qendror të Partisë*

**LETËR DREJTUAR KOMISARIT POLITIK TË
BATALIONIT TË BËRZESIITËS NË LIDIJE ME
SIGURIMIN E USHQIMEVE DHE ME RRITJEN
E FRYMËS LUFTARAKE TË BATALIONIT**

8 nëntor 1943

SHOKUT HILMI SELENICA
KOMISAR POLITIK I BATALIONIT PARTIZAN
BËRZESHTË

I dashur shok,

Me anë të Shtabit të Përgjithshëm jemi në dijeni për të gjitha kërkasat e batalionit tuaj. Me anë të kësaj letre dëshirojmë të sqarojmë me ty, dhe këtë t'ua komunikosh vetëm shokëve të Partisë, disa çështje të atij batalioni. Pikësëpari është çështja e furnizimeve. Sido-mos shokët e Partisë duhet të kenë kuptuar mirë se lufta jonë është një luftë partizane, e lëvizshme, dhe një-kohësht të kenë parasysh që këtë luftë e bën populli shqiptar dhe më shumë populli i varfër. Lëvizja jonë nuk ka burime të tjera për të furnizuar batalionet dhe çetat, përveç ndihmave të popullit. Ju, në një letër që i drejtoni komandës, i kërkoni asaj komande deri pjata dhe qepshe. Nuk na duken aspak të tepërtë e të ekzagjeruara nevojat tuaja, por duhet të dini një gjë, se

Shtabi i Përgjithshëm nuk është në gjendje t'ju furnizojë juve deri në thika. Këto sende ju duhet të përpinqeni t'i gjeni nga populli dhe në rast se nuk i gjeni, të bëni edhe pa to. Toni i letrës suaj ka edhe karakterin e një letre që parashikon për batalionin tuaj preqatitjen e kuartiereve të dimrit. Me hedhë zahire, si me thanë, se vjen bora dhe zihen rrugët. Është e vërtetë se bie borë. Shtabi do të mendojë për grurët dhe bukën e batalionit, por vetëm për raste shumë kritike në dimër. Ju s'duhet të mendoni asnjë minutë se tani çdo gjë do t'ju vijë e preqatitur dhe nuk keni përveçse të lajmëroni Shtabin. Shokë, duhet të keni parasysh se jemi të varfër dhe se arma jonë kryesore në këtë luftë është vullneti ynë i fortë e i çelniktë. Duhet të keni parasysh se dimri do të jetë i egër për ne që luftojmë ndër male, por kjo s'duhet të na trembe aspak, kemi kaluar dhe dimra të tjerë, ju duhet të jeni shpirti i repartit, shpirti i gjithë partizanëve dhe duhet patjetër t'i preqatitni partizanët për të kapërcyer çdo pengesë. Ata duhet të dinë e të mësojnë se lufta s'bëhet pa sakrifica dhe se do të qëllojë që të rrimë edhe pa ngrënë një ditë e dy ditë e që do kemi edhe ftohtë ndër male. Luftëtarët e vërtetë, që luftojnë për t'ja mbërritur idealit të shenjtë, do të ëduken në këto momente të vështira. Këtij qëllimi nuk mund t'ja arrijmë përnjëherësh. Për këtë arësy, ju, shokë të Partisë, dhe veçanërisht ti, si komisar politik i batalionit, dhe zëvendëskomisari të jeni kurdoherë zgjuar, të bindni luftëtarët për situatën dhe në repartin tuaj të mos formohet një atmosferë pritëse të sendeve që janë pozitish, pa të cilat sikur nuk mund të bëhet lufta dhe të kalohet dimri. Shtabi i Përgjithshëm do t'u përgjegjet

sigurisht letrave tuaja, por ju në batalionin tuaj duhet t'i mësoni partizanët dhe komandantin të udhëhiqen më këtë frymë dhe të mendojnë në këtë drejtim.

Çështja tjetër dhe më kryesorja është puna që do të bëni ju në batalion. Kjo është me një rëndësi të jasht-zakonshme dhe këtej varet forca e atij batalioni, për-parimi i tij, vendosja dhe çelnikosja.

Në rast se ju, anëtarët e Partisë, nuk punoni si duhet atje brenda, ai batalion do të mbetet një batalion në letër; në rast se ju nuk i ngrini politikisht dhe ushtarakisht partizanët që udhëhiqni, ai batalion nuk do ta kryejë dot misionin që i ngarkon populli. Faji do të bjerë vetëm mbi ju, ju do të jeni përgjegjës. S'është me të vërtetë punë e lehtë, por për ne komunistët s'ka pengesa, se me vullnetin tonë të çelniktë duhet t'i kapërcejmë pengesat. Ju jeni të rinj, por vullnetin dhe guximin e keni të madh; në luftë, në përpjekje do të fitoni eksperiencën e luftëtarit të vërtetë komunist, se atje është shkolla jonë e madhe. Duhet që të gjithë ju, e sidomos ti dhe zëvendëskomisari, të jeni kurdoherë në këmbë për ta udhëhequr batalionin, për t'i këshilluar partizanët. Duhet që çdo javë a dy herë në javë të mblidhet batalioni ose populli i fshatit a rajonit ku gjendeni dhe t'u mbash konferanca të qarta, ku t'u shpjegosh çdo gjë, qoftë të natyrës politike, qoftë ushtarake ose ndonjë problem lokal. Të ndani punën me shokët e tjerë të Partisë dhe në celulë të kërkohen rezultatet nga të gjithë shokët. Ai që s'kryen detyrën si ushtar i vërtetë i Partisë, ai e ka tradhëtuar Partinë Komuniste dhe popullin tonë. Shokët e Partisë duhet të jenë në radhë të parë të luftës, të sakrificës; në asnjë mënyrë nuk lejohet që komisarët

dhe zëvendëskomisarët të marrin pamjen e kapedanëve dhe të njerëzve me funksione të larta. Megjithëqë Partia atyre u ka ngarkuar me të vërtetë një barrë me shumë rëndësi, duhet që sjelljet dhe qëndrimi i tyre të jetë i thjeshtë, se në thjeshtësinë qëndron prestigji i funksionit, ashtu si qëndron edhe rigoroziteti i zbatimit të detyrës.

Ju duhet të keni parasysh se batalioni juaj duhet të meritojë emrin e batalionit partizan. Të ketë shpirtin sulmues, të jetë kurdoherë në pritë kundër armikut dhe tradhëtarëve, të jetë një organizator i vërtetë i të gjitha këshillave të atij qarku. Të evitohen plogështia dhe tendencat me ndejtë nëpër baza. Kjo taktikë e vdes shpirtin e batalionit. Atë batalion e zënë reumatizmat, si me thanë, dhe s'meriton me mbajt emrin partizan. Të evitohet burokratizmi në radhët tuaja. Në qoftë se ju do të arrini t'i përbushni këto detyra dhe të gjitha ato që janë shënuar në broshurën që sigurisht e keni dhe e keni punuar e që quhet «Ushtria Nacional-Çlirimtare», ju do t'i shihni shpejt frytet e përpjekjeve tuaja, ju do të keni një batalion që do të jetë tmerri i armikut dhe i tradhëtarëve, ju do të keni përbushur detyrën e rëndë që ju ka ngarkuar Partia jonë e dashur, për të cilën jeni të gjithë gati për të dhënë edhe pikën e fundit të gjakut.

Shumë të fala
Për Komitetin Qendoror të Partisë
[Enver Hoxha]

*Botohet për herë të parë, si-
pas origjinalit që gjendet në
Arkivin Qendoror të Partisë*

**LETËR DREJTUAR KADRI HOXHËS MBI
DOBËSITË NË ORGANIZIMIN E USHTRISË
NACIONAL-ÇLIRIMTARE NË QARKUN E
ELBASANIT DHE MBI PËRGJEGJËSITË E
TIJ PËR KËTË GJENDJE**

16 nëntor 1943

Kadri Hoxhës

Çermenikë

Gjendja e vajtueshme ushtarake, e sidomos në pikë-pamje komande, në qarkun e Elbasanit më detyron të të drejtohem shoqërisht dhe të të bëj disa vërejtje të hidhura. Konsekuençat e rrjedhura nga kjo gjendje do të jenë shumë të këqia për ne, dhe patjetër përgjegjësia më e madhe do të bjerë mbi dy shokë partie me detyra të caktuara dhe me përgjegjësi të mëdha, dua të them mbi ty dhe Bacën. Do të përgjigjeni sigurisht përpara Partisë për këto situata të vështira.

Konstatoj se në qarkun e këtushëm, megjithëse Shtabi i Përgjithshëm ka dhënë urdhër këtu e dy muaj që të formohej Komanda e Grupit të Elbasanit si edhe komandat e qarkut e të vendit, as që janë bërë të paktën

tentativat për me e zbatue këtë urdhër. Dhe është shkak-tuar një gjë që, me largimin e Bacës, s'merr vesh i pari të dytin. Komanda mungon krejt. Çdo batalion dhe çdo çetë vepron pas kokës së vet, vepron ose nuk vepron është puna e vet, s'ka kush i heq vërejtjen, s'ka kush e udhëzon, s'ka kush e drejton. Për këtë situatë s'është përgjegjës vetëm Baca, por edhe ti. Nga raportet e shokut Bacë rezulton se gjatë një kohe shumë të gjatë ti ke treguar një plogështi të madhe, që e ka penguar mjaft preqatitjen ushtarake. Për këtë çështje, sigurisht kur të vijë Baca, do të sqarohet çdo gjë përsa i përket veprimtarisë tënde.

Vetëm kam edhe unë vërejtjet e mia karshi punës tënde gjatë kohës që jemi ne këtu¹. Gjëja që më hidhëron më tepër është se raportet e shokut Bacë, përsa i përket vërejtjeve që i bënte punës tënde, po i konfirmoj dhe vetë. Kam folur kurdoherë hapët me çdo shok, gabimet që u kam parë, ua kam kritikuar, pa pasur as ndrojtjen më të vogël se prekeshin ose jo. Kështu kam dashur dhe dëshiroj të veprojnë ndaj meje. Kështu duhet të veprojë çdo komunist që e do Partinë. Këtë parantezë e bëj se në bisedimin e shkurtër që bëmë, me keqardhje konstatova se përpara kritikës së vogël, që bëra për mbarrëvajtjen e punës, ti u shprehe në një mënyrë që s'është komuniste, duke thënë se preferoje më mirë të tërhiqeshe, se ne kishim formuar mendim të keq për ty. Një mendim i tillë nuk lejohet jo vetëm të shprehet, por as të kalojë në trutë e një komunisti, sepse në mes tonë

¹ Në këtë kohë Shtabi i Përgjithshëm i UNÇSH e kishte qendrën në Labinotin e Sipërm të Elbasanit.

çdo gjë shpjegohet dhe sqarohet. S'mund të ketë kurrë në mes komunistësh prapamendime dhe qëllime.

Para dhjetë ditësh a më shumë ty të është ngarkuar Komanda e Grupit të Elbasanit dhe natyrisht barra ta formosh këtë grup dhe të na e propozosh sa më parë. Por puna kryesore është që kjo komandë të hyjë sa më parë në funksionim, se nuk mund të shkohet përpëra. Të ishte shpjeguar sa e madhe ishte kjo mungesë, bille vetë të kam pasë dhënë dhe disa raporte që çonin çetat e Bërzeshtës e të Sopotit që t'i shqyrtoje dhe t'u jepje përgjegje, kurse ti as që veprove, por shkove dhe i le. Duke e ditur këtë nevojë të madhe ti ke kaq kohë që s'po dëgjohe gjëkundi. Ti qëndron si pa gjë të keqe atje ku ke qëndruar gjithë kohën, në bazën e famshme dhe në Orenjë. S'jemi aspak në gjendje të kuptojmë se çfarë pune po bën në bazë. Atje ti, sipas letrës së fundit, s'ke përvçe 18 partizanë. Çuditemi si mund të të rrighet te Guri i Muzhaqit o në Orenjë, kur gjithë bota po zien, kur gjithë ushtria jonë e Elbasanit është pa krye dhe e shthurur, kur je në gjendje të kuptosh se ti je një shok që duhet të shohësh më gjerë se sa rrathi i ngushtë i Orenjës dhe i 18 partizanëve që ke në bazë! Kjo me të vërtetë na çudit dhe presim të na japësh shpjegime. Kuptohet vetëvetiu se kjo mënyrë punimi që po bën, nuk mund të justifikohet duke thënë, jo duhej rregulluar buka, jo komunikatat, jo duhej vajtur tek kryetari i këshillit o në dasmën e katundarit. Ti ke përpëra detyra më me rëndësi që të ngarkon Shtabi dhe Partia. Në qoftë se s'ke arritur të kesh shokë që t'i bëjnë këto, atëherë është për t'u vajtar puna jonë.

Lila, realiteti është i hidhur: gjithë batalionet tona

në këtë zonë janë të shthûrura, gjithë krahinat janë në lëvizje, gjermanët po u ndajnë armë armiqve të popullit, shokët nga çdo anë kërkojnë ndihma për t'i bërë ballë kësaj situate. Gjermanët po grumbullojnë ushtri në Elbasan. Përpara kësaj situate nuk i lejohet askujt të kërkojë justifikime të vogla për të larë përgjegjësitë. Të pyesim: Kush duhet të mendojë për këtë situatë, kush e njeh qarkun dhe njerëzit më mirë? Megjithatë ne s'të kemi pritur, kemi vepruar, por veprimi ynë direkt ka edhe konsekuenca të këqia për ne. Duke bërë ne detyrën e komandës së grupit, tërë Elbasani dhe krahinat e kanë marrë vesh që Shtabi i Përgjithshëm është këtu. Këtë e ka marrë vesh dhe armiku dhe ky preqitet përsëri të na sulmojë.

Me një urdhër të mëparshëm të thërrisnim të merrje pozitat me batalionin tënd përpara Labinotit, Godoleshit, Xibrakës. Ti nă u përgjegje se ke vetëm 18 vetë dhe se këta duhen për të ruajtur Bacën dhe na numëroje të tjerët, të cilët ishin të zënë në null e në furrë, e ku ta di unë. Shokut D., i cili të ka pyetur prej sa vetash përbëhet batalioni yt, tani, që të kanë ikur një pjesë në Dibër, ti i je përgjigjur se arrin në 150 vetë. Si bëhet që tani po nă dalin vetëm 50 vetë këtu? Megjithatë, edhe në rast se s'kishe fuqi, ty s'të lejohej asnjë minutë të qëndroje aty dhe të mos vije këtej, ku situata duhej ta merrje me mend që ishte e vështirë, se nuk mund të bënim më kot një urdhër të tillë. Duhej patjetër të vije këtej dhe çetë e Shëngjergjit ta drejtonte një zëvendësi yt. Të vije të rregulloje pozitat e Godoleshit, Labinotit e Xibrakës me çetat e vendit. Nga kush pritje që të bëheshin këto? Apo kishe ndonjë zëvendës tjetër ushtarak

që t'i merrte këto masa? Nuk mund të them se ti jenjë shok që s'i mendon këto, dhe për këtë arësyё përgjegjësia jote është e madhe.

Duhet të dish se pozitat, që të ishin caktuar të zije me anën e urdhërit të Shtabit, janë krejt të hapta. Armiku ka grumbulluar forca në Elbasan, flitet për një operacion këtej. Ne, Shtabi, s'kemi asnë mbrojtje, s'kemi asnë korrier elbasanas, që të na lajmërojë ose të dërgojmë të shohim se a është hedhur rruga, a ruhet rruga, a është minuar. Nuk do të jetë aspak në nderin tuaj, si komunist dhe udhëheqës ushtarak i këtij qarku, që armiku të hyjë e të djegë Labinotin e Godoleshin, pa u hedhur asnë pushkë nga ana jonë. Do të jetë një turp për ju dhe për gjithë lëvizjen që armiku të rrezikojë në çdo moment Shtabin e Përgjithshëm, i cili s'ka asnë mbrojtje.

Ky është realiteti. Komunistët s'mjaftohen me konstatime, por duhet të njojin të metat dhe t'i përvishen punës: Ai që s'njeh gabimet, s'mund kurrë t'i korrektojë ato dhe të shkojë përpara. Lila, pra, me të marrë letrën të lesh bazën dhe të nisesh me urgjencë për këtu ku jemi ne.

Të fala shoqërore

[Enver Hoxha]

Botohet për herë të parë, si pas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

**LETËR DREJTUAR BABA MUSTAFA XHANIT
MBI SITUATËN LUFTARAKE BREND A VENDIT,
MBI QËNDRIMIN E ABAZ KUPIT SI DHE MBI
VEPRIMTARINË SABOTUESE TË MISIONEVE
USHTARAKE ANGLEZE**

21 nëntor 1943

I dashur Baba Faja,

Për situatën e Dibrës e kemi marrë vesh. Reaksioni atje duhet goditur në kokë, pse ai kurdoherë do të ngrëjë krye dhe do të na godasë. Haxhiu¹ na ka kërkuar që ne të dërgojmë brigadën²; e kuqtojmë fare mirë situatën, por brigada ishte edhe në Pezë. Tani nuk dimë se si qëndron puna në Dibër. Letra e fundit që na shkruante Haxhiu na thoshte se paria, Xhem Hasa dhe gjermanët po pregetiten të na bien. Nga ana tjetër, partizanë që janë shkëputur nga batalionet e Dibrës na thonë se gjermanët kanë hyrë në Dibër. Sa për Dibrën, ne, në letrat që i kemi shkruar Haxhiut, i kemi thënë që s'duhet të ngulte këmbë me e mbajtë qytetin, sido që qyteti

¹ Haxhi Lleshi.

² Brigada III S.

ka një rëndësi morale dhe prestigji. Por taktika e luftës sonë është lëvizëse, dhe përparrë forcave të mëdha ne dō të luftojmë, por edhe nuk do të ngulim këmbë që të dëmtohem. Sidoqoftë do të marrim, sigurisht, ndonjë raport nga Haxhiu.

Bazi i Canës po lot shumë dallavere të poshtra. E kemi thirrur shumë herë të vijë të piqet, tanë e presim që të vijë më datën 25 të këtij dhe t'i qërojmë hesapet me të¹. Do të jemi një pjesë e madhe e këshilltarëve², por dëshironim që të jesh edhe ti, edhe Haxhiu. Ta dinim më shpejt këtë gjë, do të të lajmëronim që të gjendeshe edhe ti, por, në rast se e merr shpejt këtë letër dhe mund të gjendesh më 25 te Guri i Muzhaqit, eja.

Në Pezë kemi pasur luftime të ashpra me gjermanët dhe ballistët e poshtër³, të cilët po marrin armë nga gjermanët. Atje ka qenë edhe Brigada III dhe e çau rrethimin, duke vrarë shumë gjermanë si edhe katër ballistë. Nga ana jonë patëm 5 të vrarë dhe 6 të plagosur. Manevrimin e brigadës e pengoi shumë ushtria e Xhavitit⁴

¹ Abaz Kupi ishte thirrur disa herë nga Kryesia e Këshillit të Përgjithshëm N.-Çl. për të dhënë llogari mbi veprimtarinë e tij sabotuese kundër luftës dhe Frontit Nacional-Çlirimtar. Ai u kishte bërë bisht këtyre thirrjeve dhe nuk u paraqit as më 25 nëntor. Takimi u bë, më në fund, më 7 dhjetor 1943 në Shëngjergj. Në këtë mbledhje Kryesia e Këshillit të Përgjithshëm e dënoi veprimitarinë armiqësore të Abaz Kupit dhe mori vendim për ta përjashtuar atë nga Këshilli i Përgjithshëm dhe Shtabi i Përgjithshëm, si armik i popullit.

² Anëtarët e Këshillit të Përgjithshëm Nacional-Çlirimtar.

³ Operacioni armik në Pezë prj 5 deri më 9 nëntor 1943.

⁴ Shprehje popullore për të treguar një ushtri që tërhiqet në mënyrë të çrregullt.

(italianët), që ishte në Pezë dhe që nga frika, e tmerruar, s'i ndahesh brigadës, se donte të mbrohej prapa saj.

Në Vlorë dhe Gjirokastër ballistët po hanë grushte të rënda dhe haptazi ata janë bashkuar me gjermanët, saqë dje radio Tirana tha se forcat gjermane, tok me çetat shqiptare në Vlorë filluan spastrimin kundër çetave komuniste. Ta merr mendja se këto çeta shqiptare s'janë veçse balliste. Radio Tirana «ka harruar» të thotë emrin.

Në Korçë batalionet tona janë përpjekur me gjermanët në Bilisht, kanë prishur 4 automobila dhe kanë vrarë 40 gjermanë. Nga tanët kanë mbetur 4 të vrarë dhe 10 të plagosur. Kudo jemi në ofensivë, dhe reaksioni, me ballistët në krye, po grumbullohet që të na godasë. Të gjithë janë të bashkuar, që prej Mehdi Beut. Lumo Skëndos dhe deri te Bazi i Canës, i cili s'e lot akoma haptazi letrën e tij. Por për së shpejti do ta detyrojmë që të mbajë qëndrim.

«Miqtë»¹ që të erdhën aty po e lozin shumë bishtin. Gjenerali² është pjekur me Lumo Skëndon, me Bazin, dhe përpinqet që këta t'i ngrëjë sepse e sheh që kanë rënë në llumin e tradhëtisë, por këtë e bën në disfavorin tonë. Ai kërkonte të jepte nga Londra një deklaratë të Lumo Skëndos, ku thoshte se «Balli» ka luftuar dhe po lufton kundër gjermanëve. Ne i ramë kokës dhe ai s'kish se ç'thosh.

Ne i thamë që «Balli Kombëtar», si organizatë, është i lidhur me okupatorin dhe ne jemi në luftë me të. Me

¹ Anëtarët e misionit ushtarëk anglez.

² Deiviz, kryetar i misionit ushtarëk anglez.

të gjithë elementët e «Ballit», që e kuptojnë gabiminë dhe që japid prova se e luftojnë me të vërtetë armikun, ne bashkëpunojmë dhe jemi vëllezër me ta. Për çështjen e Dibrës gjithashtu i folëm për qëndrimin jo të mirë të oficerëve anglezë dhe bashkëpunimin e tyre me Fiqri Dinen e zagarët e tjerë. Dhe atje nibeti dhe s'foli fare. Prandaj edhe ti mbaj një qëndrim të prerë dhe të drejtë karshi tij. Mos të na marrë për leshko dhe të na e hedhë, se qëllimi i tyre është të na mbajnë me fjalë dhe me premtimë dhe, nga ana tjetër, të ndihmojnë me çdo mënyrë reaksionarët për t'i pasur një forcë kundër nesh, ose për të neutralizuar lëvizjen tonë. Këta kërkojnë të futin hundët në ushtrinë tonë, të mësojnë sa ushtarë kemi, ç'forca kemi dhe përpiken të futen në komandat tonë e të japid ata urdhëra. Nga ana tjetër, ata duan të njohin deri te komandanti i thjeshtë i njësive tona, që kështu të mundin të gjejnë ndonjë të çarë për të futur hundët o për të mbjellë përçarje. Prandaj ki kurdoherë mendjen me ta. Sillu ashtu si e di vetë, urtë e butë, por, kur të shohësh se ata do të kërkojnë të futin gishtërat, prejua pa frikë hiç. Ke plot të drejtë, se jemi në të drejtë. Gjithkush në shtëpinë e tij dhe aleati të qëndrojë si aleat, pa u përzier në punët tona. Mos u gënjeni aspak nga premtimet e tyre. Ata kanë fjalë boll, por asgjë s'vjen. Ndihma në të holla s'po japid fare. Ndihmat që kanë dhënë deri tani janë qesharake dhe janë vetëm ato që di ti që më parë, kanë shtuar edhe disa të tjera, të cilat i kanë dhënë në terrenet e ndryshme si në Pezë e gjetkë, por qesharake.

Prandaj, i dashur Baba Faja, merre me mend vetë se si duhet të qëndrosh karshi tyre. Atje ku ata sillen të

drejtë, edhe ne do të sillemi të drejtë, por atje ku ata do të kërkojnë të na e hedhin, ne të marrim masa. Për çdo gjë që të ngjasë këtej, e sidomos përfundimet e bisedimeve që do të kemi me Bazin, do të të vëmë në korrent. Ti na vërë në korrent për situatën e atjeshme dhe marrëdhënjet me miqtë.

Shumë të fala

Enver Hoxha

*Botuar për herë të parë në
„Dokumenta të Shtabit të
Përgjithshëm dhe të Koma-
ndës së Përgjithshme të
Ushtrisë Nacional-Çli-
rimtare», vëllimi I,
Tiranë 1965*

*Botohet sipas origjinalit, që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

LETËR DREJTUAR KOMITETIT QARKOR
TË PARTISË KOMUNISTE TË SHQIPËRISE
PËR VLOREN MBI QENDRIMIN NDAJ
«LEGALITETIT», MISIONEVE USHTARAKE
ANGLEZE, «BALLIT KOMBËTAR» DHE MBI
FORCIMIN E PUNËS SË ORGANIZATËS
SË PARTISË

22 nëntor 1943

KOMITETIT QARKOR TË PARTISË KOMUNISTE
TË SHQIPËRISE PËR VLOREN

Të dashur shokë,

Muarëm raportin tuaj më datë 11.XI.1943. Para një
jave ju kemi çuar një qarkore të gjatë¹, besojmë se e
keni marrë dhe e keni punuar në të gjitha celulat dhe
se udhëzimet që ju jepen i zbatoni në jetë dhe në luftë.

Lodra e okupatorit dhe e tradhëtarëve si edhe e kë-
lyshëve të tyre të «Ballit Kombëtar» dita-ditës po bëhet
e qartë. I gjithë reaksioni po grumbullohet dhe përpinqet

¹ Është fjala për direktivat e KQ të PKSH, të 3 nëntorit 1943 (shih në këtë vëllim, f. 1.).

të formojë një grup të vetëm, i cili, nën mbrojtjen e bajonetave gjermane, të godasë lëvizjen tonë dhe të saborojë luftën. Të gjithë këta reaksionarë, që nga Mehdi Beu, Rexhep Mitrovica, Ali Këlcyra, Mithat Frashëri, Mustafa Kruja, Kolë Biba, Tromara e kompani, lozin letrën e Zogut. Armikut i intereson fort të luhet ajo lettër, se s'sheh asnjë rrezik prej saj, përkundrazi fitim, se te Zogu gjejnë «refugium peccatorum» të gjithë elementët e poshtër dhe të dënuar si kriminelë lufte. Nga ana tjetër çështja e Zogut është një çështje që e prek shumë popullin shqiptar, i cili e urren Zogun dhe regjimin e tij, kësisoj armiku kërkon të krijojë diversione dhe tëshmangë luftën që po i bëhet nga shqiptarët. Bazi i Canës në këtë mes del si përfaqësues zyrtar i Zogut, si zëvendësi i tij, që prej së larti, dhe gjoja si njeriu i «pastër» dhe i «papërlyer», «trim i trimave». Ky hiqet sikur po ua lot të tërëve, se me të gjithë po përlyhet, që prej Mehdi Beut dhe deri te Mustafa Kruja. Puna e tij po zhvillohet në mënyrën e vjetër bajraktarçë, aq dinake, sa edhe pa kripë dhe pa themel, si e kanë zakon ta bëjnë mercenarët xhahila, si bajraktarët. Të gjithë njëri-tjetrit ja kanë me hile, të gjithë kërkojnë të lidhin penjët deri në momentin e favorshëm, për të térhequr jorganin gjithsecili në këmbët e veta. Me ne Bazi ndjek këto rrugë: ai forcat e tij akoma s'i ka hedhur zyrtarisht kundër nesh, si kanë bërë të tjerët, por efektivisht ai s'qëndron me ne. Për të bërë lodrat e tij, ose në momente kur ai e sheh veten të dobët, hiqet se është me ne, ose bën rolin e neutralit. Por në rrethe të ngushta, të mos flasim në rrethet e tij, ai flet keq për Partinë tonë dhe për lëvizjen nacional-çlirimtare, ai kërkon dhe për-

piqet të na bëjë varrin, ai është më i poshtër se një ballist. E kemi kërkuar të piqet me Këshillin e Përgjithshëm, na ka shtyrë pjekjet, por së shpejti do të piqemi me të dhe do t'i vëmë pikat mbi «i». Por lodra e tij është e qartë. I mbështetur në reaksionin, dhe tërthorazi, deri tani, në gjermanët, ai bën lodrën e okupatorit, duke lënë mënjanë luftën kundër gjermanëve, duke na luftuar ne dhe duke kërkuar të risjellë me anë të horrave regjimin e terrorit. Ju duhet me e demaskue këtë lodër, Zogun dhe të gjithë reaksionin si dhe pikën ku synon ky: të përçajë popullin dhe të shpartallojë Luftën nacional-çirimtare. Por deri në lajmërimin tonë ky demaskim, përsa i përket Zogut dhe Bazit, të bëhet boll me gojë, kurse me shtyp me një farë terezie dhe politike. Shpejt do të vijë dita që të sqarohet qëndrimi ynë.

Bazi i Canës dhe reaksiuni kanë përkrahjen e heshtur deri diku të misionit anglez, i cili, duke mos marrë qëndrim të hapët kundër Zogut, që shumë herë e përmend me përbuzje, përpinqet të ngrejë Bazin e Canës, duke kujtuar se është i vetmi person «i papërlyer», rreth të cilit të grumbullohet reaksiuni dhe të mbështetet Anglia për punën e vet. Anglezët u përpoqën shumë që ta ngrenë «Ballin Kombëtar» nga lluca ku ka rënë; ata përpinqen të ngrenë elementë si Lumo Skëndua e të tjere nga balta e tradhëtisë dhe t'i futin të paktën në luftë, qoftë dhe për formë, për t'i pasur si mbështetje, por qëndrimi ynë i drejtë dhe intransigjent kundrejt këtyre tradhëtarëve bëri që anglezët të mos ta lozin letrën hapët dhe të fshchin dorën. Anglezët duhet me i gjykue ashtu si na paraqiten në terren dhe të veprojmë me prudencën më të madhe karshi tyre. Misionet e tyre këtu

sa venë po shtohen dhe vazhdojnë të vijnë të tjerë oficerë. Këta trumbëtuan se vijnë të ndihmojnë luftën tonë me material dhe sende të tjera. Kjo ndihmë ka qenë qesharake. Tani këtë pretekst po e vazhdojnë dhe justifikohen kur u vihen shpatullat në mur, duke thënë se ndihmat do të vijnë muajin tjetër, ose bën kohë e keqe, ose do të vijnë me vapor e tjera dëngëla. S'duhet të gënjehem. Duhet të kuptojmë mirë qëllimet e tyre. Ata kërkojnë të futin hundët në punët tona; ata duan të përzihen në politikën e brendshme, duke na ngatërruar letrat; ata duan të futin hundët në ushtrinë tonë dhe këtë ushtri ta komandojnë ata dhe ta drejtojnë për qëllimet e tyre; ata dëshirojnë të futin gishtërat në organizatat tona. Përpiken të përdorin çdo mjet. Mjeti kryesor që kanë përdorur është të dërgojnë në çdo zonë tonën një mision ushtarak të tyre me një kryetar misioni, i cili vepron indipendent nga të tjerët dhe lidhet drejt me Kajron¹. Misioni i këtyre është me vëzhgue, me ndërhye, me djallëzue, me ble me pare, po të shikojnë se u shkon, me njoftë deri komisarët dhe komandanët e njësiteve dhe me gjetë një të çarë për me konsolidue rrjetën e tyre. Cilido është përgjegjës për punën e tij dhe kur njëri nga këto misione zihet në kllapë, tjetri lan duart dhe thotë: «Faleni X-in për gabimin që bëri, se s'ishte në korrent ose është axhami» etj.

¹ Në Kajro kishte selinë e vet Shtabi i dytë regjional i Drejtorisë së operacioneve speciale të Ministrisë së Luftës Ekonomike të Anglisë, i cili u krijua në vitin 1941 dhe kish për qëllim të mbante nën kontroll lëvizjet nacional-çlirimtare në vendet e Evropës Qendrore dhe Juglindore.

Kemi pasë me ta prova të hidhura. Në Dibër oficerët anglezë kanë bisedue dhe gati bashkëpunue me reaksionarët si Fiqri Dine dhe, kur shokët tanë po luftonin kundër Xhem Hasës dhe gjermanëve, ata përpinqeshin dhe dërgonin letra në Shtabin tonë për të ndaluar luftën. Anglezët ndërhyjnë te ne për të ndaluar luftën kundër reaksionit. Mos t'ju duket aspak çudi. Përparrë këtyre situatave dhe përparrë qëndrimit tonë, misioni anglez luan rolin e budallait, e të gabuarit, dhe shtihet sikur do ta ndreqë përnjëherësh gabimin. Pra, shokë, kujdes të madh me ta. Mos u gënjeni prej fjalëve dhe premtimeve të tyre; kudo që të shihni se ngatërrojnë ujërat, mos leni asnjë kusur, me ashpërsi i ndaloni. Në rast se puna e tyre është flagrante në disfavor të luftës dhe në favor të reaksionit e të okupatorit, me i arrestue dhe me i çue në Shtabin tonë, prej ku do të kërkojmë përnjëherësh që të merren masa kundër tyre. Me ta të silleni korrekt dhe mund t'i sillni në aksione të shohin si spektatorë dhe asgjë tjetër. Asnjë informatë të mos u jepet në lidhje me ushtrinë tonë dhe organizimin tonë.

Për formimin e tri grupeve partizane, që Shtabi i Zonës I Operative të Vlorës ka ndër mend të formojë, është fare mirë. Vetëm shokët e Partisë në ushtri duhet të përpiken që këto grupe të jenë të gjalla dhe batalionet ose çetat që i përbëjnë të mos kenë karakterin e çetave territoriale, por të jenë çeta sulmuese. Shokët duhet të dinë se taktika e luftës sonë qëndron po ajo e para, d.m.th. luftë guerrile, dhe kjo luftë kundër një armiku të egër, të armatosur deri në dhëmbë, kundër reaksionit që po grumbullohet dhe që ndihmon haptazi okupatorin. Në këtë kohë të dimrit ne duhet të kemi

batalione me gjithë kuptimin e fjalës të mbushura me partizanë të mirë dhe jo me njerëz për numër. Këto bataljone duhet të ruajnë karakterin e lehtë dhe sulmues, duhet të jenë të formuar me elementë të vendosur.

Shtabi i Përgjithshëm ka dhënë urdhër që të formohet në qarkun e Vlorës një brigadë. Shokët dëhet të mendojnë seriozisht për këtë gjë. Formimi i brigadave duhet të jetë preokupacioni më i madh në çështjen ushtarake, se një brigadë e krijuar me elementë të formuar, dhe jo me çfarëdo njerëzish siç e kanë kuptuar disa shokë, është sigurimi i plotë i fitores së sotme dhe të nesërme. Brigada është formacioni i vërtetë i ushtrisë sonë popullore, formacion që do të thëthijë pak nga pak gjithë elementët e vendosur të çetave ose batalioneve sulmuese për me mbërritë kësisoj në një ushtri të vërtetë dhe me shpirt luftarak, ashtu si e duam ne. Pa pasur brigadat, duhet ta dini mirë, nuk do të mundim dot të shkojmë aq shpejt përpara. Prandaj t'i viheni punës, dhe shokët që janë në shtabe dhe në ushtri shpejt ta krijojnë këtë formacion, ku ju duhet të çoni kuadrot më të mira, më të vendosura, se në atë grumbull luftëtarësh të vendosur do të shumëzohen kuadrot e çelnikta të Partisë.

«Ballit Kombëtar» duhet t'i bini pa mëshirë, se ai është krejt i lidhur me okupatorin dhe vegël e tij. Në asnjë mënyrë të mos gënjeheni të bini në ujdi me këtë organizatë; elementët e gabuar të afrohen, pasi të po-hojnë botërisht gabimin e tyre dhe ç'mendojnë për «Ballin». Këtë mënyrë pranimi natyrisht mund ta bëni me ndonjë element që ka mbajtur një qëndrim jo korrekt kundër lëvizjes sonë, por sa për katundarët

s'është nevoja aspak; ata të afrohen, t'u mbahen konferanca dhe t'u tregohet tradhëtia e «Ballit».

Organizatës së Partisë i vini gjithë forcën. Të ngri ni kuadrot, t'i edukoni, t'u jepni iniciativë në punë dhe t'i udhëzoni në luftë. Shokët më me eksperiencë t'u shpjegojnë situatat e ndryshme që kalojnë, t'i orientojnë shokët e rinj, sepse rruga nuk është kaq e lehtë. Një-kohësish nuk duhet me hedhë në zjarr kuadro të tëra, kuadrot duhet edhe me i ruejtë. Kjo s'do të thotë se s'duhet të punojmë dhe të mos luftojmë; jo, duhet të luftojmë dhe ca më shumë se kurdoherë, por në momente kur reaksiuni është shumë i madh, s'ka gjë pse puna të ngadalësohet pak që të mos vriten kuadrot më të mira për të rifilluar luftën pak më vonë me një ritëm më të madh. P.sh. aksionet tuaja që keni bërë në Vlorë tanisë fundi që futët njësitë me bomba dore, kur reaksiuni ishte i madh, kur gjithë banditët e «Ballit» të bashkuar me gjermanët po na gjurmonin, janë aksione shumë të hazarduara¹ që na kushtojnë jetë shokësh, të cilët do të jenë të vlefshëm. Aksioni është i guximshëm, ai ngrë moralin e popullit, por duhet edhe të gjykohet mirë në raste të tillë. Përsa i përket ndryshimit që bëtë në qarkor, s'kemi asnje kundërshtim, vetëm shoku Ali² duhet të dijë që detyra që i ngarkohet është shumë e rëndë, por kemi bësim se shoku Ali do ta kryejë këtë barrë që

¹ Me rrezik.

² Ali Demi, Hero i Popullit, i cili u ngarkua në këtë kohë sekretar politik i Komitetit qarkor të PKSH për Vlorën. Këtë detyrë ai nuk mundi ta kryente pasi me 20 dhjetor 1943 u vra në përpjekje me pushtuesit gjermanë.

po i ngarkohet me ndihmën e gjithë shokëve të qarkorit dhë të shokut Besnik, i cili të pyetet kurdoherë dhe të përfitonit të gjithë nga eksperienca e tij dhe gjakftoh-tësia shembulllore.

Shoku Besnik s'ka dyshim që do ta ndihmojë kurdoherë qarkorin e Vlorës, si i deleguar i Komitetit Qendror, kurdoherë që të jetë i lirë, të marrë pjesë në mbledhjet tuaja dhe t'u ndihmojë në çdo gjë. Por puna e tij kryesore duhet të jetë barra e rëndë dhe me një rëndësi të jashtzakonshme që i është ngarkuar si zëvendëskomisar i Zonës I Operative. Konkretisht këtij i mungon sigurisht koha për me krye dy detyra me kaq rëndësi, si ato që kishte deri tanë. Në këshillin e qarkut të Vlorës përsëri qenja e Besnikut lot një rol të madh, se atje ai çon prestigjin e Partisë dhe peshën e eksperiencës së tij, por edhe ajo detyrë lyp punë dhe kohë. Prandaj shoku Besnik të këshillohet që njëkohësisht, duke qenë në këshill, ai të përpinqet që t'i japë punë, të ngrejë, të hedhë përpëra ndonjë shok tjetër partie që sigurisht do të ketë në atë këshill. Në këtë mënyrë jo vetëm që Besniku do të jetë më i lirë për me krye barrën kryesore, por formojmë dhe kuadro të tjera, preqatitja e sigurimi i të cilave po bëhen dita-ditës një problem i vështirë që duhet zgjidhur. Në këtë drejtim duhet të punojmë të gjithë për forcimin e kuadrove, krijimin e kuadrove të reja, se puna po zgjerohet, detyrat bëhen më të rënda, përgjegjësitë më të mëdha. Mbi supet e anëtarëve të Partisë rëndojnë përgjegjësi shumë të mëdha. Duhet eshtren e kurrizit ta kemi të fortë, duhet Partinë ta kemi të fortë, duhet kuadrot t'i kemi të çelnikta. Këtë lyp prej gjithë shokëve Komiteti Qendror i Partisë. Të gji-

thë në punë në këtë drejtim, nga varet fitorja jonë e sotme dhe e nesërme!

Të fala shoqërore
Për Komitetin Qendror të Partisë

S h p a t i

*Botohet për herë të parë, si-
pas origjinalit që gjendet në
Arkivin Qëndror të Partisë*

**LETËR DREJTUAR KOMISARIT TË GRUPIT TË
PEZËS MBI GJENDJEN USHTARAKE E POLITIKE
NË PEZË, MBI QËNDRIMIN NDAJ MISIONEVE
USHTARAKE ANGLEZE DHE MBI GJENDJEN
NË DIBËR, NË VLORE E NË BERAT**

22 nëntor 1943

I dashur shoku Shule,¹

Mora vesh për luftën e Pezës, këndova dhe të dy letrat e tua që i çoje Hysenit. U gjëzuam shumë që ai sulm gjerman nuk na ka kushtuar shumë humbje në njerëz dhe në armatime, përsa ju përket juve, dua të them zonës së Pezës.

Disa vërejtje desha të bëja përsa u përket këtyre veprimeve, sidiqë janë vërejtje të përgjithshme që ti i ke konstatuar vetë. Por duhet të mundohesh që pësimet të na bëhen mësime dhe të mos gjendemi më në pozita të këqia.

Hulusiu çështjen e batalioneve të Pezës e bëri një disfatë totale, gjë që nuk e besova. Ai thosh me plot bindje se nga gjithë batalionet kishin mbetur vetëm tridhjetë vetë dhe të tjerët ua kishin dhënë këmbëve. Një gjë kuptoj, dhe këtë ja bëra vërejtje Hulusiut, se ai s'ka

¹ Pseudonimi i shokut Kristo Themelko.

ditur aspak të manevronte dhe të zotëronte situatën. Është e pabesueshme që të linte gjithë materialin e rëndë, që nga mitralozat dhe deri te mortajat; pastaj të një-qind mushkat të lëshuara rrugës tamam si në një disfatë komplete! Sigurisht me një manevrim të tillë, morali i partizanëve ulet gjithashtu dhe i popullit kur sheh të tërhiqen në këtë mënyrë. Gabimi i dytë i Hulusut ishte vonimi i daljes nga Peza dhe moszbatimi i urdhërit që i dhamë, urdhër që s'ishte dhënë më kot, por me arësyte të madhe. Në këtë çështje keni pasur faj dhe ju, e sidomos ti. Në asnjë mënyrë ti nuk duhej të pengojë brigadën të dilte nga terreni i Pezës, sepse atë e priste një detyrë më me rëndësi. Nga ana tjetër ti duhej të mendoje se në një terren të vogël si rrëthi i Pezës nuk mund të manevrojnë gjithë ata ushtarë të ngarkuar rëndë si ishte brigada dhe batalionet, duke pasur nëpër këmbë dhe gjithë italianët. Pastaj arësyja përse largohet brigada duhej të të shtynte që këtë ta lejoje të shkonte sa më parë, jo vetëm ta lejoje, por ta urdhëroje të shkonte sa më parë. Duke mos dalë brigada në momentin e kërkuar, veç tërheqjes që bëri në këtë mënyrë, por edhe mungoi të vente në Dibër, ku Haxhiu përballoi tri herë me radhë sulmet e reaksionit dhe të batalioneve gjermane. Do të të flas më vonë për këtë. Tani jemi duke e organizuar këtë brigadë dhe përpinqemi me i gjetë disa mitraloza të rëndë.

Çështja e Pezës qëndron ndryshtë. Dhe unë e gjykoj kështu. Të gjithë e keni keqkuptuar rolin e qarkut të Pezës. Të gjithë e konsiderojnë Pezën si «Moskën». «Duhet me çdo kusht të mbrohet Peza, duhet me çdo kusht të ushqehet Peza, duhet me çdo kusht të furnizohet

•Peza». Unë s'mendoj kësisoj. Peza ka rëndësinë e madhe të vet, por Peza dhe batalionet e Pezës nuk duhet asnje minutë të harrojnë të bëjnë luftën partizane.

Si kudo edhe në Pezë lufta duhet të jetë luftë guerrilesh dhe jo pozicioni e mbrojtjeje, sikundër që është konstatuar. Për ta bërë këtë luftë guerrilesh nuk duhet me pasë njësite të rënda me elementë të pavendosur. Batalionet e Pezës s'e kanë atë karakter. Prandaj duhet riformim. S'kemi nevojë tani për tani për elementë që bëjnë vetëm numër. Luftën duhet ta bëjmë edhe të shpejtë, të jemi në ofensivë; kemi për të shkuar momente të këqia në dimër kundër një armiku të egër që s'i ka hedhur armët dhe që ndihmohet prej gjithë reaksionit. Për t'i përballuar të gjitha këto pengesa, duhet që batalionet tona të jenë të provuara, me vullnet të fortë, të regjur në shi dhe në borë, të durojnë ditë të tëra pa ngrënë dhe të mos tremben nga plumbi. Prandaj batalionet tuaja duhet të reduktohen, të shkurtohen. Puna s'prishet në këtë mënyrë, por do të shkojë përpara. Kemi fitime të shumta po të veprojmë kësisoj. Para së gjithash me batalione të tilla do të sulmojmë dhe jo të rrимë në një vend, se kështu do të na pakësohen furnizimet e ushqimeve, do të pakësohen depot, dhe çetat tonë do të lëvizin më lehtë. S'na duhen bashibozukë, Shüle, na duhen partizanë të fortë e trima si Myslimi. Numri na duhet për më vonë, kur ta fitojmë, tani na duhen ushtarë për luftë.

C'ngjan në Pezë: batalionet e Pezës me boll elementë të pavendosur po hanë e pinë, furrat po punojnë ditë e natë, sikur të ishte ushtri e një shteti të madh, depot janë plot, 500 kuintalë makarona, 300 kuintalë

miell etj. etj. materiale. Në këtë situatë atje patjetër është tendenca të mos sulmojmë, se na prishet baza, të ruajmë depot, të na pregetitet buka në kohë, të rregullojmë transportin e furnizimeve nga Durrësi dhe nga Kavaja. S'mund të sulmohet në këtë mënyrë. Prandaj duhet patjetër të ndërrohet taktika e luftës, taktika e veprimeve, të ndërrohet mentaliteti që mund të ekzistojë aty, t'u jepet batalioneve gjallëri dhe shpirt ushtrisë, të hidhen në ofensivë. S'ka terren më të përshtatshëm se Peza për luftë guerrilesh. Objektiva për ta goditur armikun ka nga të katër anët, vendi s'të pengon aspak, se gjithë Peza është e djegur dhe s'ka se ku shkon më tej. Në vend që të vijë armiku t'ju sulmojë, me batalione të riformuara në mënyrën e sipërme ju duhet ta provokoni armikun dhe ta futni në gryka e ta grini. Në qoftë se me të vërtetë duam të luftojmë, lufta bëhet vetëm në këtë mënyrë dhe jo ndryshe. Në lidhje me këtë po të përsëris dhe një gjë, që ta kam thënë kurdoherë, se terreni i Pezës po përkëdhelet shumë. Tirana dhe Durrësi s'punojnë veçse për Pezën. Kjo duhet të mbarojë njëherë e mirë. Terrenet e tjera, Shule, s'kanë një kokërr gruri. Martaneshi s'ka bukë të hajë, Çermenika gjithashtu, pa leri të tjerat si Gjirokastra e Vlora. Prandaj vëre pak gishtin në kokë për këtë punë. Myslimit duhet t'i thuash se ka edhe terrene të tjera të mjeruara ende më keq nga Peza, dhe Myslimi e kuption këtë. Germanët kanë djegur e bërë hi 12 katunde të Kurveleshit, ku s'kanë hiçgjë, edhe atje ka partizanë që luftojnë trimërisht. Shokëve në Tiranë u kam shkruar që furnizimet të bëhen me rregull dhe Pezës t'i jepet vetëm ajo që i bie dhe aspak më shumë.

Përsa u përket atyre që kanë dezertuar, e sidomos si S-në me shokë, thirri në Pezë, i shkoni në gjyq dhe i dënoni. Këtë ta bësh patjetër dhc të merret shembull nga shokët tanë. S'duhet aspak të jesh i butë. Çdo gjë gjykoje me gjakftohtësi, por kur e ke marrë vendimin, mos u tërhiq aspak, po ta kesh të drcjtë. Në radhët tonë duhet të ketë disiplinë dhe vetëmohim.

Tani, Shule, të gjitha këto që po të them sigurisht ti i mendon edhe vetë dhe jam i sigurt se do t'i vësh në zbatim. Përpiqu që terrenit të Pezës t'i japësh shpirtin partizan, ta bësh të konsoliduar, të punojë si një blok, të zhdukësh mentalitetin e vjetër dhc kuptimin e keq për mënyrën e luftimit. Po të arrish në këto rezultate, sigurisht atëherë s'kemi më nevojë për ty që të rrish atje. Duhet të arrish në këtë rezultat patjetër. Jepu shpirt shokëve të Partisë, shkundi, shtyji dhe do të arrish shpcjt. Mbështetu fort te Myslimi. Lere mënjanë mënyrën e punës së vjetër të Pezës, punës së Mustafës¹. Puno me një frymë të re. Duhet patjetër të bësh një revolucion, si me thënë, në çdo gjë në terrenin e Pezës. Jam i sigurt se do ta bësh tok me Myslimin. Zgjidh shokun më të mirë që ke afër, ngreje atë, pregete për të të zëvendësuar, kështu të jesh i lirë dhe jo i nevojshëm për atë terren, por shumë i nevojshëm për punë të tjera.

Shoh se i kërkon Hysenit lajme nga terreni dhe udhëzime të ndryshme, se ke nevojë. Ke shumë të drejtë. Tani po të them diçka, shkurtimisht, se kam mjaft

¹ Mustafa Gjinishi, i cili kurdiste intriga me qëllim që të fuste përqarje në organizatën e Partisë dhe të dobësonte grupin partizan të Pezës.

punë. Duhet të kemi kujdes të madh nga «aleatët tanë - të dashur». Në asnë mënyrë s'duhet që këta të mësojnë numrin e forcave tona, të mos futin hundët në radhët e ushtrisë dhe të Partisë, duhet me qenë me ta shumë të prerë. Gjeneralit të tyre anglez i kemi rënë kokës, sa që i thamë: «Po i zumë oficerët tuaj me reaksionarët që po na luftojnë, ne ju lajmërojmë se do t'i pushkatojmë». S'ka thënë asnijë fjalë, i ka pranuar të tëra kritikat tona, por ka thënë: «Të na falni se oficerët tanë janë të rinj» etj. etj. Shumë dallavera kërkojnë të lozin, reaksionin po e ndihmojnë mjaft me qëndrimin e tyre dhc sidomos Bazin. Këtë të fundit e kemi thirrur të piqemi dhe të qërojmë hesapet, ai na largohet, dy herë na ka shtyrë pjekjen dhe na e ka lënë për datën 1 dhjetor.

Bazi kishte konvokuar një mbledhje më 20 në Zall-Herr për të formuar partinë zogiste, ose më mirë për të grumbulluar reaksionin rrëth Zogut, duke pasur edhe Mehdi Beun brenda.

Në Dibër reaksiuni na goditi tri herë. Herën e parë në Peshkopi, ku forcat tona triumfuan, sigurisht të kanë çuar komunikatën; herën e dytë në Dibër, edhe atje tanët shkuan mirë dhe i shpërndanë reaksionarët, të cilët u rigrumbulluan dhe sulmuan për të tretën herë me forca të mëdha dhe me gjermanë dhe muarën Dibrën e Peshkopinë. Shokët tanë u tërhoqën nga këto dy qytete. Humbjet kanë qenë herën e fundit: katër të vrarë dhe disa të plagosur nga ana jonë. Në këtë luftë duhej patjetër që të ishte Brigada III për me e goditë reaksionin dhe mos me e lënë të grumbullohej. Por brigada mbeti në terrenin e Pezës dhe tani është zor që të vejë, se

s'është e armatosur. Gjithë reaksiioni është kundër nesh nën kryesinë e Fiqri Dines, i cili sigurisht është i lidhur dhe me Bazin dhe patjetër me qeverinë e Mitrovicës e Mehdi Beun, se ai lufton krah më krah me gjermanët.

Goditja që mund t'i bëjmë reaksiionit në Dibër do të jetë një grusht i fortë që do t'i bëjmë reaksiionit në Shqipëri, por këtë grusht duhet ta preqatitim imtësisht.

Në Shkodër organizata s'po bën këmbë. Kishin kater muaj që drejtuesit s'kishin bërë një raport dhe s'dinin se ç'bëhej në atë terren. Po ato avaze, po ato intriga, po ata njerëz, jo hatër i mbetur, jo moskënaqësi, jo plogështi, moskujdesi etj. Veliu e ka ndërruar krejt qarkorin. Krejt është një fjalë, se prapë me po ata njerëz. Shokët thonë se puna ka marrë pak gjallëri. Shpresojmë dhe duhet. Batalioni i Shkodrës nuk shkon keq, ai ka arritur në numrin 200 dhe tani e kemi urdhëruar të shkojë nga Plava dhe Gucia të bjerë në kontakt me njësitet e Armatës II partizane jugosllave.

Nga Vlora më kanë shkruar dy herë dhe punën e tregojnë në favor tonë. «Balli» është demaskuar dhe është goditur rëndë ushtarakisht.

Në Berat vazhdon puna alla Gjinçë¹. Çështja e kompromisit ka qenë e vërtetë dhe ashtu si e kishim marrë vesh. Tani na lajmërojnë se gjermanët kanë hyrë në Berat dhe tanët janë tërhequr. Mestan Ujaniku ka ardhur në Dumre dhe kërkon të piqet me ne. Nuk e dimë se ç'ka. Mos i ka ngjarë ndonjë mosmarrëveshje me sho-

¹ I referohet punës së Gjin Markut, i cili vepron me metoda bajraktarësh dhc ishte përgjegjës kryesor për kompromisin tradhëtar të Beratit.

kët e atjeshëm, ose për çështjen e djalit të tij, i cili kishte vrarë një shok të rinisë? Do ta kenë gjykuar shokët e brigadës dhe tani ai kërkon të bisedojë me ne për ta falur. S'dimë gjë, të shohim, por s'do jetë ndonjë gjë me rëndësi.

Nga Korça lajme s'kemi marrë që më parë. Goditje me çetat e «Ballit» në Mokër dhe asgjë të re.

Të kemi dërguar nga ana e Tiranës një qarkore¹, që ja kemi dërguar gjithë qarkorëve të Partisë. Këtë këndoje me vërejtje dhe punoje ndër shokë. Ki shumë kujdes për qarkoren, se mos e lësh këtej e andej, se qarkoren e parë shokët e Beratit e kishin neglizhuar dhe e kishin marrë ballistët dhe e shtypën në trakt. Të gjitha letrat dhe qarkoret që ju vijnë, kanë karakter shumë konspirativ, prandaj ose i fshihni mirë ose i digjni.

Na shkruaj kurdoherë për gjendjen e atjeshme. Shulle, radiot, anglezëve mos ua jep, na iço përnjëherësh këtej. Hamdiu² na doli këtej dhe ky po ta sjell letrën. Ky e di ku janë fshehur radiot dhe veglat e tjera të anglezëve.

Shumë të fala

[Enver Hoxha]

Botohet për herë të parë, si pas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

¹ Është fjala për direktivat e KQ të PKSH të 3 nëntorit 1943. (Shih në këtë vëllim f. 1.).

² Pseudonimi i shokut Alqi Kondi, sekretar politik i Komitetit qarkor të Rinisë për Elbasanin. Vdiq më 24 qershor 1945.

LETËR DREJTUAR SHOKUT NAKO SPIRU MBI ORGANIZIMIN E BRIGADËS II SULMUESE

[Nëntor 1943]

I dashur Deti,

Sot bisedova me Topin dhe shoh tek ai një ndryshim shumë të madh; më bëri një raport të punës së Partisë në Elbasan dhe në rrethet që me të vërtetë më ka kënaqur. Topi po tregon mjaft aktivitet, vullnet dhe iniciativë; nga ana tjetër shoh së e ka mjaft në shpirt dhe në zemër çështjen organizative, dhe direktivat që i jepen po i zbaton mjaft mirë. Por e kam hallin gjetkë: *te brigada*. Planet po prishen përsëri përsa i përket komisarit dhe zëvendëskomisarit. Topi propozon si zëvendëskomisar brigade Alqin, mikun tënd të rinisë në Elbasan, thotë, dhe s'kam dyshim, që është një shok i mirë dhe punën organizative e bën fare mirë. Unë s'kam asnjë kundërshtim, por vetëm nga çështja e moshës së tij nuk më ngrohet zemra, është mjaft i ri për të qenë një zëvendëskomisar brigade. Sidokudo zëvendëskomisari i brigadës mua më duket se s'duhet të jetë dhe aq i ri nga mosha. Unë do të dëshiroja shumë që ky të shkonte në brigadë dhe të ishte përfaqësues i rinisë. Më jep dhe

ti një mendim. Unë po vij përsëri te propozimi që kisha bërë më parë: të vijë si komisar brigade Kila, dhe këtu e rregullojmë pastaj se kush të jetë komisar o zëvendës: Topi apo Kila. Një problem tjetër, që më preokupon dhe që duhet ta mendoni atje në Tiranë ose në Durrës, është çështja e anëtarëve të Partisë në Brigadën II. Deri tani me hesapet që bëjmi do të ketë vetëm 20 anëtarë të Partisë, dhe këta të rinj dhe vetëm nga terreni i Elbasanit. Shumë numër i paktë. Ne parashikojmë që brigada do të ketë në fillim afër katërqind vetë. Është e pamundur që 20 anëtarë të Partisë të mjaftojnë. Të marrim nga Elbasani të tjerë, le që dobësohet terreni, por janë të gjithë të rinj. Prandaj duhet të mendoni e të na çoni një numër anëtarësh partie, të paktën 15, por jo të jenë fare të rinj në punë, por të kenë haber dhe të jenë të qartë. Këta anëtarë partie të jenë nga të Tiranës dhe nga të Durrësit. I shkruani edhe Isos, të veprojë po në këtë mënyrë. Bashkë me anëtarët e Partisë që do të na çoni për Brigadën II, na çoni dhe partizanë për këtë brigadë nga ata që po rekrutoni andej, se këta që janë këtu, s'janë të gjithë për atë punë që dëshirojmë ne. Por po të kemi disa elementë nga ata që do të na çoni ju, nga ata të mirët, dhe me ata të paktë që kemi zgjedhur në Elbasan, mund të arrijmë lehtë që t'i ngremë dhe të tjerët; nga Gjin Marku asnjë përgjegje për të famshmit punëtorë të Kuçovës¹. Inglizi na çoi një letër, ku na thotë se ka lajmëruar Londrën që të gjithë anëtarët

¹ Shtabi i qarkut të Beratit kishte lajmëruar se do të dërgonte për në Brigadën II S. një numër punëtorësh të vajgurit nga Kuçova.

ë «Këshillit të lartë»¹ t'i quajë tradhëtarë dhe, nga ana tjetër, ka kërkuar në Londër që në komitetin e famshëm², që flet Konferenca e Moskës, të marrë pjesë dhe Shqipëria për çështjen e Italisë në Ballkan. Këto janë veresie.

Të fala

T a r a s

Botohet për herë të parë, si-pas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

¹ «Këshilli i lartë i Regjencës» tradhëtarë, i krijuar nga pushtuesit gjermanë në tetor 1943.

² Në Konferencën e Moskës (19-30 tetor 1943) u krijuat një Këshill konsultativ për çështjet e Italisë në të cilin bënë pjesë BRSS, SHBA, Anglia dhe Komiteti i Çlirimt Kombëtar të Francës. Ky këshill kishte për qëllim të vëzhgonte respektimin e mekanizmit të kontrollit alcat në Itali.

LETËR DREJTUAR SHOKUT NAKO SPIRU NË LIDHIJE ME KRIJIMIN E BRIGADËS II SULMUESE

[Nëntor 1943]

I dashur Deti,

Po i çoj ato qarkoret. Artikullin po e bëj nesër, se kam pasur shumë punë. Me rastin e këtyre qarkoreve u shkrova gjithë shokëve përgjegjet e letrave dhe raporteve që më kishin çuar. Sot vamë dhe te inglizi; na përrallisi. Ishte pjekur me Bazin, por ne s'na e zuri në gojë. Sot priste të vinin ata të «Ballit», por s'i ishin përgjegjur.

Kilën nise për këtu, për në brigadë. L., që kisha këtu, dhe ai do të shkojë për në brigadë si zëvendëskomisar. Prandaj më ço këtu një shoqe të rinisë, që të dijë të shtypë në maqinë, në vend të tij, shoqe dhe jo shok, se shokë të rinisë po të keni, i çoni në Brigadën II. Duhet për Brigadën II të çoni disa shokë partie nga Tiranë e nga Durrësi.

Letrën tjetër ki mirësinë ja jep Delegates.¹

Botohet për herë të parë, si-
pas origjinalit që gjendet në
Arkivin Qendror të Partisë

Shumë të fala

Taras

¹ Pseudonimi i shoqes Nexhmije Xhuglini (Hoxha).

**LETËR DREJTUAR SHOKUT NAKO SPIRU PËR
DREJTIMIN E «ZËRIT TË POPULLIT», PËR RRITJEN
E INICIATIVËS NË KUADROT E PARTISË DHE
PËR ÇËSHTJEN E ZOGUT**

[Nëntor 1943]

I dashur shoku Deti,

Letrën e mora. Me të vërtetë që dhe ju keni shumë punë aty, por edhe unë kam shumë punë këtej. Ti më duket se s'e ndan mirë punën andej dhe, sipas letrës tënde, gjithë shtypin e rregullon ti. Kjo nuk duhet të ngjasë ashtu. S'duhet që ti ta shkruash «Zerin e Popullit» që nga radha e parë deri në radhët e fundit. Kjo s'është mirë. Ty të bie të shkruash një kryeartikull, fundi dhe ndonjë tjeter, pastaj restin duhet ta shkruajnë të tjerë shokë. Ti mund t'u shënosh temat dhe t'u japësh, fundi, dhe udhëzime dhe ata të mësohen të shkruajnë vetë. Dr. nuk duhet aspak që ta lesh të mos shkruajë dhe, në rast se artikujt e tij s'kanë atë mordant-in¹ që dëshirojmë, duhet t'i japësh udhëzime. Me e udhë-

¹ Mordant (frëngj.), — që të kafshon. Këtu ka kuptim: gjallëri.

zue shoqërisht dhe me e korrektue gjithashtu, po të jetë nevoja. Pra, shokët që merren me shkrime, duhet të mësohen për të mbushur «Zërin e Popullit» dhe të mos mësohen duke pritur që t'ua pregetitë tjetri që nga fillimi deri në fund.

Një gjë tjetër, që konstatoj nga letrat e Hysenit etj., është se ata, kur duan të mbrojnë ndonjë mendim të tyren, shënojnë në parantezë, që të më bindin mua, ose të forcojnë dhe më tepër tezën e tyre: «kështu mendon edhe Deti». Kjo gjë ka të mirat, por ka edhe të ligat e saj. Këtë vërejtje ta bëj shoqërisht dhe të përpinqesh që ndër shokët e atjeshëm të mos zhduket iniciativa, si në punë ashtu dhe në mendime. Nuk duhet që shokët nëty o në mua o në ndonjë shok tjetër me detyrë si tonën të shohin shokë, pa të cilët dhe pa pyetur ata në çdo rast, nuk mund të hedhin çapin më të vogël. Jam i sigurt se ma kupton fare mirë, shoku Deti, qederin që kam kur të shkruaj këtë gjë. Dua që shokët të kenë iniciativë të vetën në çdo gjë. Kemi shumë, shumë nevojë për shokë të tillë, shokë me personalitet të formuar dhe me gjykime të drejta. Influенca jonë, me aq sa mundemi, të përpinqemi që të jetë salutaire¹.

Çështja e Zogut sa vete po bëhet më aktuale. Sigurisht e ke vënë re fjalimin e Rexhep Mitrovicës dhe elozi që i bën regjimit të Zogut. Duket tani qërtë se ku kërkon të grumbullohet reaksiuni dhe ç'kartë lot armiku. Bisedimi me Bazin do të na lejojë të marrim qëndrime të prera, por, sidoqoftë lodrën e armikut dhe të reaksiionit ne do ta demaskojmë dhe më parë se të pi-

¹ Salutaire (frëngj.) — shpëtimtare.

qemi me Bazin. Për këtë gjë po bëj një artikull tjetër për «Bashkimin»¹ mbi këtë çështje. S'do jetë aspak e tepërt që të bësh dhe ti një, dhe mund të vihen të dy, njëri në «Bashkimi» dhe tjetri në «Zëri».

Për çështjen e delegatëve për një Jugosllavi s'jam i mendimit tënd, d.m.th. për vajtjen tënde. Me të vërtetë se vajtja atje ka rëndësi, por terreni dhe puna e këtushme ka një rëndësi shumë më të madhe. Formimi i brigadave, shoku Deti, ka një rëndësi të paçmueshme edhe më shumë se vajtja e një delegati atje. Tani sapo marr vesh që Topin e kanë kapur, atëherë Hamdiu bëhet dhe ca më i vlefshëm për atje. Për brigadat jemi duke u çjerrë boll, por mjerisht shokët udhëheqës s'po e kuqtojnë rëndësinë e kësaj çështjeje. Duhej t'i shkruaja Gjin Markut një letër (që s'duhet kurrë një komunist të vijë në atë shkallë sa të marrë një letër të tillë) për të dërguar elementët e Brigadës II, por edhe ata le-re se ç'janë. Pesë kanë dezertuar rrugës. Megjithatë ne do ta ngremë në këmbë, do ta forcojmë dhe sigurisht që Brigada II do të bëhet e mirë si të gjitha të tjerat. Në 220 vetë që ka çuar Berati, vetëm njëri është anëtar partie. E merr me mend situatën. Duke e parashikuar këtë, ju kam shkruar që të nxirrni 10-15 anëtarë partie nga Tirana e Durrësi dhe t'i çoni këtu. Kjo të bëhet në një mënyrë mobilizimi politik. Këta anëtarë të mos marrin urdhër dhe të largohen vetëm, por të shkojnë në grupet e tyre dhe t'u propozojnë shokëve të grupeve të vijnë dhe ata në brigadë. Njëkohësisht

¹ Artikulli «Lodrat e nazistëve okupatorë», që u botua në «Bashkimi», Nr. 5, nëntor 1943. (Shih në këtë vëllim f. 80).

të bëjnë dhe seleksionin vetë, duke lënë në qytet një pjesë të grupit që të vazhdojë punën. Kjo të bëhet sa më parë.

Për çështjen e Beratit nuk më duket ta kemi lënë shumë pas dore, si thua ti, por shokët s'kanë ditur të punonin. Janë dy gjëra që s'duhen konfonduar. Dhe kjo rrjedh më shumë nga mospasja aspak lidhje me ne. Po të mendosh mirë, atje janë çuar shokë dhe këta o janë kapur prej policisë o kanë humbur në pellgun e Gjin Markut. Sidoqoftë jam dhe unë i atij mendimi që duhet me çue njeri atje. Isua le të shkojë, por s'duhet që Durrësi të mbetet bosh. Duhet të çoni një shok që të dijë të punojë. Në Berat, sikundër që shkruan dhe Gjini, ka shumë nevojë për një shok të rinisë, se ajo punë duhet ngritur patjetër. Interesanti¹ duhet ta kryejë këtë punë dhe punën me gra gjithashtu. Prandaj unë mendoj që Interesanti të rrijë atje dhe t'i jepni udhëzime konkrete për punë. Ajo të jetë sekretare politike e rinisë, të marrë pjesë dhe në qarkor të Partisë. Mund të rrijë atje një kohë, pastaj shohim dhe bëjmë.

Çështjen e sheqerit. Unë mendoj si ju, të shiten të 800 kuintalët dhe të hollat të venë në arkën e Partisë. Pastaj i ndërrojmë me ato që di ti. Të blehen më parë kapota dimri për brigadat, po e theksoj për brigadat, Brigadën II dhe III, këpucë dhe rroba për t'u veshur. Këto ose të rezervohen dhe të dërgojnë vetë brigadat t'i marrin, ose t'u çohen brigadave në Dajt o në Elbasan, pastaj i ndajmë. Të hollat e tjera të na i çojnë ne ose të na lajmërojnë që i kanë në dorëzim dhe mbasandaj

¹ Pseudonimi i shoqes Ramize Gjebrea.

u shkruajmë ne për me çue nga një shumë në qarqet e ndryshme. Në qoftë se keni ar në Tiranë, mos e thyeni. E pyet Hysenin nga unë për atë amanetin që i kishte dhënë S., besoj se e ka në vend të sigurt. Llogaritë të mbahen të qarta. Duhet një shok i veçantë për këto dhe i sigurt. Duhet të kenë parasysh kurdoherë që në çështje paresh emri i Partisë duhet të jetë i pastër. Theksojua mirë shokëve.

Këtu marr vesh që Topin e zunë parmbërëmë. Hollësira s'kam. Lila s'punon aspak. Çështja ushtarake është e vajtueshme këtu nga pikëpamja e komandës. Merre me mend, as korrierë s'mund të gjejmë. Me gjithë thirrjet dhe apelet që i bëjmë Lilës, as që tundet nga baza. Armiku po armatos ballistët e Krrabës, të Sopotit, të Bërzeshtës. Shokët e batalioneve kërkojnë ndihma për me marrë masa sa më parë, por asnjë batalion i këtushëm s'po lëviz, se s'ka kokë, s'ka komandë grupei. Lilës kemi 15 ditë që ja kemi caktuar këtë detyrë; ai s'bën as për një komendant kompanie. Lufta dhe puna po u nxjerr kallajin disa shokëve.

Të fala

[*Enver Hoxha*]

Botohet për herë të parë, si pas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

LETËR LIDHUR ME BASHIKËPUNIMIN E MISIONIT ANGLEZ ME KRERËT E REAKSIONIT KUNDËR LUFTËS ANTIFASHISTE TË POPULLIT SHQIPTAR

[Nëntor 1943]

I dashur shoku Frederik¹

E mora letrën tënde dhe mësova përsa më shkruaje. Kur të kthehet gjenerali², më lajmëro dhe më cakto ditën kur mund të vij aty, sepse unë mendoj që të vij aty, se s'ka ku piqemi gjetkë. Për çështjen e ushqimit të italianëve, u bë mirë që u akaparua, por pa pasur të hollat nuk mund të blihet asgjë³. Oficerët anglezë, (me

¹ Frederik Nosi, ndërlidhës i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacional-Çlirimtare me misionin ushtarak anglez.

² Deiviz.

³ Komanda e forcave aleate të Mesdheut, nëpërmjet misionit ushtarak anglez pranë Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacional-Çlirimtare, premtoi që të siguronte blerjen e ushqimeve për 15 000 ushtarë të trupave pushtuese italiane në Shqipëri që nuk u dorëzuan tek trupat fashiste gjermane pas kapitullimit të Italisë fashiste. Mirëpo Komanda aleate anglo-amerikane nuk dërgoi as të holla, as ushqime. Ish-ushtaret italianë i mbajti me ushqime dhe i strehoi deri në fund të luftës populli shqiptar.

ta mund të vinte dhe Kemp¹⁾) kanë qenë nga ana e Fiqri Dines dhe, kur mbaroi lufta, ata dolën me flamur të bardhë dhe vanë te shokët tanë. S'është e vërtetë ajo që tha gjenerali se ata kishin vajtur atje për ta ndaluar Figrinë me shokë që të godiste tanët. Fiqriu dhe të gjithë plehrat tok, bashkë me gjashtë oficerë gjermanë, ishin ata që luftuan kundër nesh. Për deklaratat e «Ballit» ne, o Frederik, jemi deri në grykë. Ne aq na bën se ç'do të bëjë gjenerali dhe «Balli», ne dimë një gjë: ata që luftojnë kundër armikut me plot mend, ata janë vëllezër me ne, të tjerët. (në rast se vazhdojnë të punojnë si tani) mund të bëjnë njëqind e një deklarata nga Londra, ne s'i hamë ato. Ballistët janë gati të bëjnë çdo deklaratë dhe, nga ana tjetër, të bëjnë tradhëti, atëherë gjenerali dhe misioni anglez duhet të mendojnë mirë pér punën që kanë bërë. Në rast se Lumo Skëndua me shokë e përdorin deklaratën që do t'i çojnë gjeneralit pér të kallajisur enët e tyre të palara dhe vazhdojnë luftën e poshtër, gjenerali ka shumë përgjegjësi përpalla nesh dhe popullit. Gjenerali, që është një ushtar, si thotë, dhe s'ka haber nga politika, s'duhet të kënaqet me deklarata që do t'u marrë ballistëve në odat e Shëngjergjit, ai duhet t'i dërgojë BBC-s lajmet e luftës së vërtetë që duhet të bënte «Balli» kundër gjermanëve, dhe jo deklarata. Por, i dashuri Frederik, gjenerali është i lirë të bëjë punën e tij dhe ne të bëjmë tonën. Dëshirojmë që gjeneralin ta kemi kurdoherë në krah,

¹ Major Pitër Kemp, kryetar i grupit të misionit ushtarak anglez pranë shtabit të kriminelëve të luftës: Fiqri Dine, Xhem Gostivari dhe Hysni Dema, vegla të pushtuesve gjermanë.

por, në rast se ai na del në rrugë kryq, ne do ta ~~yaz~~
 zhdojmë rrugën tonë të drejtë, që është luftë armikut që
 na ka okupuar dhe gjithë atyre që na pengojnë në rea-
 lizimin e qëllimeve tona. Të gjithë ata që luftojnë me
 ne dhe pa hile janë miqtë tanë, të gjithë ata që kërkojnë
 të bëjnë dallavere janë armiqtë tanë.

Shumë të fala

Enver Hoxha

*Botuar për herë të parë në
 «Dokumenta të Shtabit të
 Përgjithshëm dhe të Komanda-
 ndës së Përgjithshme të
 Ushtorisë Nacional-Çli-
 rimitare», vëllimi I,
 Tiranë 1965*

*Botohet sipas origjinalit që
 gjendet në Arkivin Qendror
 të Partisë*

LODRAT E NAZISTËVE OKUPATORE

[Nëntor 1943]

«Balli Kombëtar» po e lot hapët kartën e tradhëtisë, ai është bërë një nga zyrat e Gestapos gjermane. «Balli Kombëtar» bën punën e okupatorit; çetët e tija të tipit Hamit Matjani, Tefik Cfiri e Aziz Çami janë në dorë të gjermanëve, ashtu siç ishin në dorë të italianëve Halil Alija, Selim Kaloshi e Isa Toska. Ashtu si vepronin me kolonelët Klemente dhe me tanksat e armikut Halil Alija e Isa Toska, ashtu veprojnë edhe sot «të famshmet» çeta «nacionaliste» të «Ballit» që përmendëm më sipër. (Tani që shkruajmë këtë artikull marrim vesh se çeta e «Ballit», e udhëhequr prej Isa Manastirliut, hyri «triumfalishët» në Durrës në mes të duartrotkitjeve të ushtrisë gjermane.) Është e kotë të zgjatemi mbi këto argumenta, këto s'duan komente, «fshati që duket s'do kallauz», dhe të gjithë e kanë kuptuar se «Balli Kombëtar» do të thotë tradhëti. Tradhëtia është aq e hapët saqë ata që ngrinin zërin nëpër kafenetë e Tiranës, duke u reklamuar si njerëz të «Ballit» e duke sharë ndyrë ata që luftojnë për lirinë e atdheut, tani e mohojnë qenjen e tyre në «Ballë», e shajnë «Ballin», pretendojnë që s'kanë qenë kurrë anëtarë të tij ose kanë

dhënë dorëheqjen. Të tilla gjëra ngjasin kurdoherë përpjekja para katastrofës: vapori që mbante emrin «Balli Kombëtar» po mbytet në tradhëti dhe minjtë kanë filluar të lënë vaporin. Por me mbytjen e «Ballit Kombëtar» reaksionarët e qelbur nuk i kanë hedhur armët. Ata përpjekjanë të bashkohen gjetiu nën një emër tjeter, nën një tabelë tjeter të lustruar, se ajo e «Ballit Kombëtar» hyri në historinë e Shqipërisë, krah për krah me Mustafa Krujën, si një nga faqet më të zeza të historisë së pavarësisë kombëtare.

Momentet janë të vështira për okupatorin gjerman dhe për reaksionin shqiptar. Nazistëve gjermanë s'u mjafton me pasë vetëm disa vegla të verbëra si Tefik Cfiri, Aziz Çami o Hamit Matjani, të organizuar dhe të udhëhequr nga një oficinë e diskredituar e Gestapos që quhet «Balli Kombëtar»; atyre u duhet me organizue diçka të re, të freskët për të térhequr e gënjerë popullin, se me «Ballin Kombëtar» armiku i preu shpresat që mund të gënjejë popullin; asaj arme që përdori Bushati¹ e Dalmaco i doli kallaji. Pra, gjermanët përpjekjanë të grumbullojnë reaksionin nën tabelën e Mehdi Beut e Fuat Beut. S'ka njeri në Shqipëri që të mos e ketë kuptuar se tradhëtarët Mehdi Frashëri, Lef Nosi e C°, vegla shumë më të poshtra se i poshtri Mustafa Kruja, përpjekjanë të rregullojnë zyrën e re të Gestapos, që do të zëvendësojë «Ballin Kombëtar». Dikush mund të thotë se këta njerëz kanë humbur gjykimin, se s'ka kush të mos e ketë kuptuar se bashkëpunimi me gjermanët të çon në tradhëti dhe vendin në skllavërinë më

¹ Maliq Bushati.

të errët që ka parë historia. Jo, Mehdi Beu, Fuat Beu, Lef Nosi, Pateri¹ dhe të gjithë agjentët e tjerë të Gestapos s'janë të marrë, as matufë dhe as i ka detyruar kush me kërcënimi të pranojnë një gjë të tillë jashtë vullnetit të tyre, por Mehdi Beu, Lef Nosi dhe gjithë pazvanët e tjerë janë tradhëtarë të popullit shqiptar, dhe tradhëtia e tyre është konshiente. E shkuara e këtyre është tjetër (dhe ajo diskutohet), dhe e tashmja është tradhëti. Nga e shkuara e tyre kërkojnë të përfitojnë edhe gjermanët edhe tradhëtarët vetë si Mehdiu, Fuati e Lefi për të gënjenyer dhe përqarë. Por edhe kjo lodër nuk u ndez, populli shqiptar, i regjur në kaq halle dhe mjerime, në kaq vuajtje dhe përpjekje, e merr shpcjt erën e dallaveres që luhet. Mehdiu me Fuat Di-brën kujtuan se fjala e 6 prillit² dhe ajo pak ndihmë në të holla që i kanë dhënë dikur një delegacioni shqiptar në Paris, do të gënjejnë popullin që vuan, që vritet, që gjakoset, të hedhë armët ndër këmbët e barbarëve nazi, shkatërrimtarëve të vendit të tij dhe të botës mbarë; ata kujtuan se atdheu çlirohet me një fjalë goje dhe me njëqind tradhëti, ata kujtuan se populli dhe djalëria do t'i ndiqnin këta bukuroshë që kanë emrin Mehdi e Fuat në tradhëtinë e tyre. Se si e priten Mehdiun populli shqiptar dhe djalëria, që ai i kërcënoi me armë, e di gjithkush.

Në një situatë të tillë, okupatori dhe reaksioni ka-

¹ Pater Anton Harapi.

² Më 6 prill 1939 tradhëtarë Mehdi Frashëri mbajti sa përsy e faqe një fjalim, ku u shfaq kundër pushtimit fashist italiian në Shqipëri megjithëse ai vëtë, bashkë me Zogun e klikën e tij e kishin preqitur atë prej kohësh.

lojnë momente të këqia, se edhe kjo kartë s'u pi ujë; më kot po venë dita-ditës në sallonet e Mehdiut Lumo Skëndot, Skënder Muçot, njerëzit e Beut e të Pashës, Teki Selenicët e Aleks Mavraqët me të vetmin qëllim që të rigrumbullohen, të riorganizohen nën një flamur, nën një tabelë të re për të gënjyer popullin; më kot, se tabëla e fëlliqur e flamuri i Mehdi e Fuat Beut kanë damkën e tradhëtisë, damkën e Gestapos hitleriane.

Armiku e peshon situatën dhe përpinqet të përdorë çdo lodër për t'ja mbërritur qëllimit; ai, sikundër që s'kënaqet vetëm me veglën «Balli Kombëtar», ashtu s'kënaqet me flluskën e sapunit që quhet manevra Mehdi—Fuat; ai përdor taktykën e anarkisë, të konfuzionit, të frikës, të terrorit, të luftës së nervave. Kjo lodër është e rrezikshme, dhe mjerë ai që s'e kuption e që gjenjehet, mjerë për ata që s'janë të fortë, për ata që s'janë të vendosur, për ata që shmangen nga kjo luftë titanike që bën populli dhe që s'kanë besim as në veten e tyre, as në energjitetë e shëndosha të popullit shqiptar. Këta njerëz bien në kurthin që u ngre armiku. Por ky i fundit s'mund t'ja mbërrijë qëllimit, se populli ynë s'është në hapin e parë politik, mbi të kanë kaluar shumë valë; shumë lodra e dallavere janë lojtur në kurrizin e tij. Ai është regjur e mprehur politikisht, dhe këto momente për të janë të kalueshme, se nervat i ka të shëndosha dhe vitalitetin e tij të madh; lodrën që kërkon të luajë armiku është në gjendje ta kuptojë mirë dhe ta luftojë si duhet, pa u tronditur aspak dhe pa u çjerrë në ferrat e rrugës.

Si vepron armiku? Nga njëra anë, ai përpinqet me anën e Mehdi Beut të lidhë fijet e rrjetës së prishur, të

grumbullojë rrëth tij gjithë refugjatët e «Ballit Kombëtar» e të reaksionit shqiptar; por ai e di fare mirë se s'është mjaft me i grumbullue këta njerëz rrëth Mehdiut, Lefit, Fuatit dhe Pater Antonit, s'është mjaft me ba plane në odë, kur s'të dëgjon njeri e s'të ndjek kush në rrugën e tradhëtisë, duhet patjetër me e gënje po-pullin me hir e pahir që të ndjekë qerren e Mehdiut. Nga ana tjeter armiku dhe reaksiuni hedh në shesh çështjen e Zogut si një mollë grindjeje. Çështjen e Zogut e ngre gazeta «Atdheu», çështjen e Zogut e zë në gojë «Balli Kombëtar» me Ali Bej Këlcyrën, i cili në një fjalim publik ka thënë tekstuallish kështu: «Unë jam kundërshtar i Zogut, por komunistët do të më detyrojnë të bashkohem me të», njësoj si kur të thosh: «Nga inati i sime vjehrre do të fle me mullixhinë». Çështjen e Zogut e përkëdhel dhe e trumbeton Mehdi Beu, atë e trumbeton Mustafa Kruja dhe, mbi të gjithë, atë e lejon gjermani të propagandohet si pa gjë të keqe. Qëllimi i armikut në këtë mesështë i qartë, ai don të mbjellë anarki dhe, duke i kallur frikën popullit për ndonjë rrezik eventual, ai përpinqet ta largojë këtë nga objektivi kryesor që është lufta antifashiste, dhe ta hedhë në një luftë vëllavrasëse e përçarje politike. Në këtë punë armiku ndihmohet nga i tërë reaksiuni, që prej Mehdiut, Mithatit, Aliut dhe deri te Teki Selenica. S'e lejon për sytë e bukura të askuqt gjermani që të shtypet gazeta «Atdheu» me klishera dhe të shpërndahet edhe prej vetë ushtarëve gjermanë. Aq i bën gjermanit se dalka një gazetë me emrin «Atdheu» e që mburr Zogun e regjimin e «Legalitetit», derisa ajo gazetë s'thotë asnje fjalë kundër tij; bile nazistëve u in-

tereson shumë të dalë kjo gazetë, pa sa për çështjen e Zogut e të Shqipërisë e kanë merak vetë ata në rast se fitojnë. Ne në asnje mënyrë nuk duam të prekim këtu idetë dhe ndjenjat e atyre njerëzve që çështjen e Zogut e kanë të tyren, por që njëkohësisht luftojnë okupatorin. Këtë çështje e prekim pse e lyp detyra që kemi ndaj popullit dhe atdheut, e lyp detyra e luftës sonë çlirimtare t'i vëmë pikat mbi «i» kësaj manevre që përdor armiku dhe reaksiuni për të na përçarë. Do të ishte detyra e tyre në radhë të parë, që ata njerëz, të cilëve çështja e Zogut u interesonte më shumë, t'u vinin një kufi spekulimeve që bën armiku ose disa të shitur te armiku në emër të ideve të tyre.

S'kemi dashur dhe s'duam të hapim defterët e kohërave të vjetra, s'duam të biem në provokacionin që na ngre armiku, por nuk na lejohet nëasnje mënyrë që të lëmë pa demaskuar këtë lodër të rrezikshme që luhet në kurri të luftës sonë. Gazeta «Atdheu» (pas «Kombit» doli «Atdheu», këtu mund të përdorim fjalët e famshme me pak ndryshime: «Atdhe, sa krime po bëhen në emrin tënd!») me cinizmin më të madh, sikur Shqipëria është e liruar, sikur këtu në vendin tonë s'ka ndodhur asgjë e re, sikur gjermanët s'janë në vatrat tona dhe na vrasin, na djegin e na shkretojnë, kjo gazetë na flet për Zogun, për regjimin e «Legalitetit» dhe pretendon se luftën që ka bërë e gjakun që ka derdhur djalëria e ka bërë për mbretin Zog! Të gjitha këto i thotë si pa gjë të keqe. Të nxjerr mallin e gazetës «Besa»¹.

¹ Organ kryesor qeveritar në periudhën e sundimit të Ahmet Zogut (1931—1936).

Kundër gjermanëve as edhe një fjalë; për këtë gazetë gjermanët as kanë qenë ndonjëherë armiq, as janë tani dhe ajo as që e zë në gojë se ata janë shtruar në Shqipëri; jo, gazeta «Atdheu» është vetëm për t'i mbushur mendjen popullit se regjimi i Zogut dhe Zogu «do ta shpëtojnë Shqipérinë» (sic). Sa për luftën kundër gjermanëve, le ta bëjnë të tjerët, kësaj gazete aq i bën, kjo gazetë është për të mbledhur frytat. Mirëpo gabohet gazeta, gabon okupatori. Lëvizja nacional-çlirimtare është në luftë me këtë gazetë, në luftë me njerëzit që e hartojnë dhe e shtypin, se puna që bën kjo gazetë është në favor të armikut. Këtë e themi botërisht, pa prekur aspak ndjenjat e atyre individëve zogistë që s'kanë bërë lodrën e okupatorit. Ne nuk themi, si thonë Ali Këlcyra, Mustafa Kruja, Mehdi Beu, që do të bashkohemi me Zogun, ne kemi thënë dhc e themi se jemi me të gjithë ata që luftojnë armikun pa hile e pa dallavere, jemi me të gjithë ata që luftojnë pa hile dhe pa dallavere tradhëtarët dhe kompromisaxhijtë, por jemi kundër të gjithë atyre që lënë mënjanë luftën kundër okupatorit dhe tradhëtarëve dhe flasin tani për forma regjimi, kërkojnë t'i imponojnë ato kur armiku është ende në vatrën tonë dhe kur populli po derdh gjak për ta shporrur. Formën e regjimit do ta zgjedhë vetë populli, është e drejta e tij: askush nuk mund t'ja imponojë, as gazeta «Atdheu», as Ali Bej Këlcyra, as Mehdi Beu, as Fuat Beu.

Ne s'jemi kundër zogistëve që luftojnë okupatorin me armë, në lëvizjen tonë ka mjaft njerëz të tillë, por jemi kundër të gjithë atyre që deri dje na kanë vrarë, që deri dje kanë shitur dhe tradhëtuar atdheun dhe ta-

ni, që po mbyten një nga një vaporët e tradhëtisë, ata vetëquhen zogistë e anëtarë të partive të tjera. Duhet të ndahet shapi nga sheqeri. Në lëvizjen nacional-çlirimtare ka zogistë, mundet që këta të grumbullohen në një parti, ajo është puna e tyre. S'jemi kundër një partie zogiste, por ka parti dhe parti. Ka parti që hidhet e tëra në luftë, sakrifikon çdo gjë për luftën dhe për çlirimin e atdheut, ka edhe parti si «Balli Kombëtar» që vihet drejtpërdrejt në shërbim të armikut. Me një parti zogiste, që do të kishte një program të caktuar dhe një qëndrim politik e luftarak që i përshtatet luftës së sotme antifashiste dhe u nënshtrohet parimeve të Këshillit të Përgjithshëm Nacional-Çlirimtar, ne do të bashkëpunonim. Lufta jonë i ka letrat të hapëta: sot luftohet për çlirimin e Shqipërisë nga zgjedha e okupatorit, luftohet seriozisht e jo-me hile. Qofsh ti zogist o demokrat, socialist o komunist, po të jesh patriot i vërtetë, të gjithëve na lidh diçka e ngushtë me njëri-tjetrin: çlirimi i atdheut. Por kjo luftë s'ka dollape. Atë që të pengon në këtë qëllim të shenjtë, atë që të del përpara të të vrasë, do ta vrasësh, për tradhëtarin s'ka mëshirë, për tradhëtarin s'ka strehim në asnje parti që quhet patriote e që lufton okupatorin. Në këtë luftë e në këto momente nuk shtrohet çështja e formës së regjimit, por shtrohet çështja e çlirimtë të Shqipërisë; gjatë kësaj lufte ka vetëm një pushtet të popullit, pushteti i këshillave nacional-çlirimtare, ka vetëm një ushtri, Ushtria Nacional-Çlirimtare; luftohet për një demokraci popullore, formën e regjimit do ta zgjedhë vetë populli pas luftës. Bashkëpunojmë dhe luftojmë tok me zogistët, qoftë si individë, qoftë si parti, kur këta të

pranojnë si konditë sine qua non¹ vijën e Luftës nacionaal-çlirimtare. Individ o parti qoftë, letrat duhet t'i ketë të hapëta në popull. S'mund të ketë në lëvizjen nacional-çlirimtare një parti zogiste që përvetëson gazetën «Atdheu»; organi i një partie, që është në luftë me okupatorin, duhet të jetë një organ që të mos flasë si flet gazeta «Atdheu», por të flasë si flasin gazzetat e lëvizjes nacional-çlirimtare, në të cilat, që nga radha e parë dhe deri tek e fundit, nuk bëhet fjalë, veçse kundër okupatorit dhe armiqve të brendshëm. Të gjitha ato parti që mund të formohen dhe që luftojnë kundër okupatorit fashist e bashkëpunëtorëve të tyre do t'i konsiderojmë parti mike dhe do t'i pranojmë në Frontin Nacional-Çlirimtar. Çdo parti që bashkëpunon me okupatorët do ta luftojmë. Çdo parti që qëndron pasive do të përpinqemi ta futim në luftë kundër okupatorit fashist dhe veglave të tija. Ky është qëndrimi i lëvizjes sonë karshi çdo individi ose partie qoftë. I mbetka qejfi njërit ose tjetrit, u zemëruaka njëri ose tjetri, u hedhka njëri ose tjetri me armikun, pse ne shfaqim botërisht qëndrimin tonë të drejtë, aq i bën Luftës sonë nacional-çlirimtare. Këshilli Nacional-Çlirimtar dëshiron dhe përpinqet e do të përpinqet që të gjithë të gabuarve t'u tregojë rrugën e drejtë; mjerë ata që nuk ndërrojnë rrugë! Ne dimë një gjë dhe jemi qind për qind të bindur se populli e shikon fare mirë se ku është drejtësia, ku është sakrifika, kush derdh gjak, përsë e derdh dhe me atë bashkohet, me atë lidhet, lufton dhe fiton. Njëri e tjetri mund të bëjnë demagogji. Mehdi

¹ Sine qua non (lat.) — e domosdoshme.

Beu mund të bërtasë se «djalëria udhëhiqet prej intér-nacionalistëve dhe vagabondëve», gazeta «Atdheu» mund të qirret për regjimin e «Legalitetit», evenimen-tet ndjekin rrugën e tyre, dhe këtë rrugë e cakton gjaku i kulluar i popullit që po derdhet për një që-lim të shenjtë.

Këtë lodër kërkon të luajë armiku, dhe kjo është përgjegjja jonë e qartë. Disa njerëz s'mund ta kuptoj-në këtë lodër, sidomos ata që s'kanë bërë tjetër, veçse kanë ruajtur me xhelozinë më të madhe rehatin dhe kokën e tyre, të gjithë ata që kërkojnë t'i kalojnë pa qe-der, pa sakrifica, pa gjak, këto momente decizive që po kalon kombi ynë. Mehdi Beu flet për anarki dhe, që të mos e akuzojnë të tjerët, ai na akuzon ne të lëvizjes na-cional-çlirimtare. Ne jemi kundër anarkisë dhe anarkia që kërkon të mbjellë armiku dhe Mehdi Beu nuk do-të zërë vend, sepse nervat e popullit tonë janë të forta, sepse forca e gjykimit të tij është e madhe dhe sepse populli ynë është një popull që s'mashtrohet më. Lufta dhe vuajtjet e kanë mësuar të mposhtë çdo dredhi që i bëhet, çdo poshtërsi që kërkohet të luhet; ai është mësuar të luftojë dhe të fitojë kundër gjithë armiqve që kërkojnë ta shtypin, ta shtrydhin, që kërkojnë t'i vë-në në krye regjime shtypëse dhe klika hajdutësh e tra-dhëtarësh. I ka gënjer mendja të gjithë ata që besoj-në ndryshe; mjerë ata që s'po shohin se sa përpara është populli ynë, që s'po e kuptojnë ende se s'gënjehet kol-laj ky popull shqiptar i vitit 1943 me dëngëla dhe me fjalë bombastike që mbulojnë regjime tmerri e urie; mjerë ata që s'kanë kuptuar shpirtin e kësaj djalërie heroike dhe hovin e saj mbinjerëzor! Këta njerëz janë

prapa, këta njerëz janë të destinuar të zhduken, se nuk rrojnë me kohën.

E.

*Botuar për herë të parë në
«Bashkimi», Nr. 5,
nëntor, 1943*

*Botohet sipas tekstit të
gazetës «Bashkimi»*

22
23

LETËR DREJTUAR KOMANDËS SË BRIGADES III SULMUESE MBI GJENDJEN E KRIJUAR NË QARKUN E ELBASANIT GJATË OPERACIONIT ARMIK TË DIMRIT 1943–1944¹ DHE MBI RRETHIMIN E SHTABIT TE PËRGJITHSHËM TE UNÇSH

19 dhjetor 1943

Çështja e daljes sonë nga kjo zonë është bërë një histori e ditës. Kemi gati 20 ditë që po e pregetitim këtë dalje dhe, po të rrimë e të mendojmë pakëz se në ç'rezultate kemi arritur, do të shohim se jo vetëm që s'kemi bërë asnje çap përpara, por përkundrazi dita-ditës çdo tentativë e jona po komprometohet. Mendimi ynë është se shkaku i gjithë kësaj çështjeje është mungesa e informatave, por jo vetëm mungesa e tyre, por edhe natyra e gabuar e tyre. Deri tani asnje informatë të sigurt nuk kemi, përkundrazi që të tëra janë alarmuese

¹ Në dimrin 1943–1944 pushtuesit gjermanë me ndihmën e tradhëtarëve shqiptarë zhvilluan një operacion të madh kundër Ushtrisë Nacional-Çlirimtare. Në këtë operacion morën pjesë katër divizione hitleriane, si dhe xandarë, ballistë e zogistë, gjithsej afër 45 mijë trupa. Operacioni armik dështoi.

e disfatiste, informata të kolonës së pestë. Organizata e terrenit është e para përgjegjëse, por pas saj vjen edhe komanda e shtabit të Brigadës III. Komanda e Brigadës III kemi përshtypjen se daljen tonë s'e ka marrë seriozisht, gjithashtu dhe masat që duhen marrë për qëndrimin e saj në këtë sektor. Përsa u përket informatave për daljen tonë, të paktën ne s'kemi asnjë përgjegjë. Si e qysh janë dërguar ata vërejtës ose informatorë prej brigadës, ç'detyrë u është ngarkuar, ç'rezultate kanë sjellë dhe në ç'kohë duhet t'i sjellin? Këto sende po përgatiten dhe po zbatohen, na duket, sikur armiku nuk ekziston fare dhe pret puna. Nga ana tjetër masat që i këshilluam Hulusiut të merrte te pjesa e rrugës mbi Labinot janë lënë pas dore. Hulusiu, kur ja thamë atë mbrëmje, i quajti këto masa si të tepërtë dhe ky konsiderim shkaktoi alarmin e mbrëmshëm. *I thëksoni Hulusiut dhe shokëve të tjerë se rruga; që është prishur, duhet të mbrohet dhe jo të lihet sikundër që e lanë dhe ikën.* Informata të tilla nuk permetohen të vijnë nga anëtarë të brigadës, të cilët për dy motoçikleta, të rapportojnë 20 kamiona me ushtarë. Në po shajmë dhe kritikojmë të tjerët për informata të gabuara, por këta njerëz alarmues i kemi brenda në brigadë. *Hulusiu të mos ta marrë punën shumë lart, por ta gjykojë pak si ushtar dhe si partizan dhe t'i bëjë llogaritë mirë me partizanët që ka dhe me armiqtë që ka përpresa.*

Tani, informatat për daljen tonë janë në yendin që kanë qenë këtu e 20 ditë dhe dita-ditës ne mendojmë që dalja do të bëhet shumë e vështirë. Reaksiuni dhe armiku do të na goditin më parë se ne të kemi parë realitetin. Për këtë arësyje ikja jonë duhet të bëhet pa-

tjetër. Ose duhet të dalim nga Shkumbini ose duhet të kalojmë në Martanesh; ndërkojë Brigada III ose brigada të tjera të goditin. S'mund të pritet më me duar lidhur. Nuk dimë se ç'jeni duke bërë ju aty dhe ç'po pritni. *Duhet të studjoni mundësinë e daljes, të paktën, të një batalioni tok me ne, pa kuaj dhe pa asgjë, dhe të marrin rrugën e Shpatit andej nga kaloi A. dhe T. Por preqatitja e këtij kalimi të mos marrë ndonjë muaj kohë, sepse sa kohë humbet, është në dëmin tonë.* Aspak të mos merret parasysh se brigada shpërndahet, një batalion mbetet këtej, një andej nga Shpati dhe tjetri halia i pariorganizuar. Do të lëmë një vend, ku mund të piqen e të grumbullohen. Presim përgjegjen e sigurt dhe të shpejtë, por duhet të merrni parasysh që të kemi kohë të lajmërojmë dhe anglezët.

Për çështjen e pesë palë çorapeve na duket se Hulusiu bën si ata kalamajtë. Tani çështja e tyre është koklavitur, sepse Lila ka refuzuar t'i marrë; tani duhet rregulluar puna. Pastaj Hulusiu duhet të mendojë se edhe shokët e Brigadës II kanë ardhur të zhveshur nga aksioni dhe ata na i kërkojnë se kanë nevojë dhe janë më afër atyre çorapeve.

Ju lajmëruam dhe mbrëmë që na duhen këtu nja pesë partizanë për urdhërprurësa. Nuk mund t'i ndajmë partizanët koqe-koqe, por kështu është puna; edhe urdhërat që dërgohen, bëjnë pjesë në luftën që po bëjmë. Këtë gjë e themi që të mos ngjasë me komandën e brigadës ashtu siç ngjet me Lilën, që thotë: «Batalionin tim e keni bërë korrier». Spirua shkon të piqet me Kiun, i cili erdhi, na thonë, me batalionin e tij. Do të fjaloset me të për mundësinë e një tërheqjeje nga ana

e Martaneshit dhe për kalimin nga zonat që ka kapërcyer ai.

Të fala

Envier

*Botohet për herë të parë, si-
pas origjinalit që gjendet në
Arkivin Qendror të Partisë*

**LETËR MBI PËRGJEGJËSINË E KADRI HOXHËS
PËR GJENDJEN USHTARAKE TË KRIJUAR NË
QARKUN E ELBASANIT GJATË OPERACIONIT
ARMIK TË DIMRIT**

Dhjetor 1943

Largimi ynë dështoi për të vetmen arësyse sepse informatat që na dhatë ishin krejt të gabuara. Ju s'i kishit vënë rëndësinë e duhur ndërmarrjes dhe aksioneve që kishim ndër mend të bënim. Kjo neglizhencë ngjau nga të dy anët: si nga ana e Librazhdit, ashtu dhe nga ana e Brigadës III. Kudo informatat tuaja ishin shkaku i mossuksesit dhe i humbjeve tona. Sigurisht kjo gjë do të ngjiste, dhe kemi frikë se më pas do të jetë më katasrofale për zonën e Elbasanit. Zona e Elbasanit ushtarakisht ka qenë dhe vazhdon të jetë zero në pikëpamje komande. Kjo komandë as që ka ekzistuar, as që ekziston, mjerisht për lëvizjen tonë! Ky është realiteti. Në radhë të parë përgjegjës i kësaj gjendjeje je ti. Mundet që ti të kesh të gjitha të drejtat nga ana jote, këtë gjë do ta svarosh atje ku duhet dhe

kür të thërritesh. Nga ana ime më duket se kam dalë nga borxhi dhe nga detyra që kam pasur; sa kam mundur, kam dhënë ndihmën dhc këshillën, dhc vëçanërisht ty; tani më mbetet të jap raportin atje ku duhet për punën e këtushme dhe për njerëzit që e drejtojnë.

Më duket e tepërt të shtoj dhe të të them se puna këtu vazhdon po ajo e vjetra, bile edhe më keq, punë e vjetër, punë grupazhi, punë e sëmurë, shumë e sëmurë nga pikëpamja ushtarake. Do të dukem qesharak të të përsërit, se njëmijë herë të kam këshilluar të formosh komandën, të krijosh komandat e vendit, të kontrollosh ushtrinë dhe terrenin në pikëpamje ushtarake; asgjë s'po shoh në këtë drejtim. Ti mund të ngresh duart në qiell, ti mund të bërtasësh dhe të thuash: «Çfarë të bëj unë me një batalion prej 40 vetësh»; ti mund të thuash: «Po i bien legenit më të kotë»; por unë po të them se ti s'e bën detyrën si duhet, ose s'di ta bësh detyrën, ose detyra që të është ngarkuar s'është për ty, se është shumë e vështirë. Këtë gjë duhet ta pohosh me plot gojën, në rast se është kështu, ta pohosh pa ironi dhe pa hatër të mbetur, ose duke thënë fjalët e zakonshme: «S'më njihni mirë». Haptazi, si komunist që je, duhet të tregosh: I shmangesh detyrës apo detyra është shumë e rëndë për ty? Këtë duhet ta sqarosh për mbarrëvajtjen e punës. Kësisoj puna s'ka për të vajtur mbarrë. Të marrim mossukseset e ndërmarrjeve tona. Për këto mos e kërko fajin as te Lytua as te X o Y. Gabimi është tek ju, shokët përgjegjës. Terreni s'është yni, ky është realiteti; ti mund të thuash të kundërtën. Ka katundarë që bëjnë detyrën e kolonës së pestë

në mes të partizanëve. Fajin s'e ka Lyto Leka në rast se ne s'dimë asgjë se ç'bëhet në Polis, nëse s'kemi asnje informatë, nëse andej s'kemi asnjeri të vijë e të na thotë dy fjalë që të mos kapërcejmë lumin dhe të mos shkojmë në një vend plot me ballistë të armatosur dhe me gjermanë. Përgjegjësit jeni ju dhe do të jepni hesap. Do të jepni hesap për shokët që na u vranë kot, përtej në këtë kalim që bëri një battalion i brigadës; do të jepni hesap për komandantin e këtij batalioni, që u vra tradhëtisht prej ballistëve¹. Ju, brigadat dhe shtabi, po kërkonit një rrugëdalje në një terren si ky juaji, krejt i huaj për ne, ku katundarët s'të japid një informatë, se me katundarët as që është punuar; ti rri në Orenjë për të marrë në dorëzim pësë lecka që hedh një aeroplan anglez. Mund të ngresh supet përkëtë të vërtetë që po të them, por aq më bën, realiteti është ky.

Të këshillohen komisari i grupit, Guranjaku dhe gjithë shokët që të mos përdorin në asnje mënyrë emrin tim ose detyrën që më ka ngarkuar Partia dhe Shtabi për të mbaruar punët sipas qejfit të tyre. Është çështja e Sami Bahollit. Unë dhe Komanda e Shtabit s'kemi thënë që Samiu të bëhet intendent, por zëvendëskomandant i qarkut dhe asgjë tjetër. Është i vetmi shok që mund ta bëjë këtë detyrë dhe është një nga shokët që ka dhënë në çdo rast dhe në çdo kohë tërë ndihmën e tij me një bindje dhe me një disiplinë me të vërtetë shembullore. Shokë si Samiu s'mund të destinohen të bëhen hamallë

¹ Është fjala për shokun Muhedin Sherifi, komandant i batalionit II të Brigadës III S.

të thjeshtë, por shokë që të drejtojnë politikisht këtë krahinë, e cila ka shumë, shumë nevojë.

Të fala

[Enver Hoxha]

*Botohet për herë të parë, si-
pas origjinalit që gjendet në
Arkivin Qendror të Partisë*

**LETËR DREJTUAR SHOKUT NAKO SPIRU MBI
GJENDJEN E KRIJUAR NGA OPERACIONI
ARMIK I DIMRIT DHE MBI NEVOJËN E
FORCIMIT TË PROPAGANDËS DHE
TË SHTYPIT TË PARTISË**

[Shkurt 1944]

I dashur Deti,

Ditët po kalojnë me mërzitjen më të madhe, sepse, në pamundësi të bëjmë diçka për të dalë këtej ose për të ndihmuar lëvizjen, ne vazhdojmë një jetë monotone, presim ndonjë vijë kalimi, por më kot. Lajme katundarrësh që na vijnë, s'tregojnë tjetër përvëçse kudo përpjekje, tërheqje, organizim të reaksionit. Nuk i marrim këto lajme si «argent comptant»¹ por, prap se prapë situa-ta na duket mjافت e vështirë.

Letrën tënde e morëm si edhe dy kopjet e letrave që ke çuar.

Nga ato pak radhët e tua kuptuam situatën e krijuar aty dhe vështirësitë e punimit dhe, si po e gjykoj unë,

¹ Nuk i marrim si «argent comptant» (frëngj.) — Këtu ka kuptimin: nuk i marrim për të sigurta.

më ato pak informata që kemi, e sidomos nga të kënduarit e «Bashkimit të Kombit», që na e sjell Samiu, duhet një punë e madhe dhe e qepur mirë për të luftuar gjithë atë fushatë demagogjike që ka shpërthyer armiku, fushatë demagogjike në shkallë të gjerë, të perfeksionuar dhe të shumanshme. Demaskimin e kësaj pune s'mund ta kryejë një njeri ose dy, por duhet një grup shokësh të pjekur, që i kanë trutë në kokë dhe, të udhëzuar prej teje, t'i përvishen punës me shkrime konkrete e të lidhura dhe jo konkurs proze dhe fantazira. Vetë propaganda që bën armiku, duhet t'u japë mendjeve «shterpa» dhe që «s'qëndrojnë mbi tokë» mjaft lëndë për të demaskuar lojën e armikut. Si më duket nga disa fletë që janë hedhur në Tiranë dhe që na i dërgoi Hyseni, duhet të ketë shokë që mund të jenë në lartësinë e duhur (përjashtoj nga ana ime traktin që ka hedhur Komiteti qarkor i Tiranës me rastin e Vtitit të ri si edhe një thirrje të Gruas Antifashiste, të cilat s'më pëlqyen hiç). Pra, armës së propagandës duhet patjetër t'i japësh një impuls të veçantë; me këtë s'dua të them se duhet t'i bësh ti vetë, bile s'ta rekomandoj, se, e para, s'mund t'ja dalësh dot dhe, e dyta, duhet të mësohen dhe të tjerrët. Kam konstatuar një gjë në shokët e Tiranës, të cilëve, si po shoh, s'u mungon as vullneti, as teknika që gazetat si «Zërin» dhe «Bashkimin» të mos i nxjerrin. Ata duan t'i nxjerrin këto ose në katër faqe, ose t'i lënë dhe të mos i nxjerrin fare. Harrojnë që jemi ilegalë dhe që «Zeri i Popullit» edhe në gjysmë fletë të dalë, është një fitim i madh. Kur shoh se kanë mundësi të nxjerrin disa fletë që kemi kënduar, ata mund të nxjerrin edhe gazetat me dy faqe. Prandaj kjo të bëhet pa humbur

kohë. Mjaft artikuj të mirë janë nxjerrë në fletë, që făre kollaj mund të dilnin në gazetë.

Propaganda që bëhet për rininë nga ana jonë, më bën përshtypjen se s'është asgjë. «Kushtrimi» i fundit që këndova, më la shumë të trishtuar. Atje, është mendimi im, s'kish gjëkafshë fare dhe ato që ishin, qenë të shkruara keq, kish përsëritje, «lieu commun»¹ sa të duash dhe pa pikë entuziazmi. Patjetër duhet ndryshuar. Armiku po ndjell rininë me çdo mënyrë; ne, që kemi gjithë veprat me vete, s'dimë t'i përdorim, duhet me i vu në dukje. Rininë duhet ta interesojmë, se ndryshe do ta humbasim. S'mjafton të themi se rininë e kemi me vete, por duhet me e pasë me gjithë mend. Fletët e «Kushtrimit» dhe ajo fleta «Përgjegjemi» na pëlqeu shumë, vetëm një vërejtje t'u bësh shokëve të teknikës, që lufta jonë s'ka vetëm 4 dëshmorë: Qemalin, Vojon, Perlatin e Margarita Tutulanin. Në gjithë fletët tona vetëm këto emra duken. Këta janë me të vërtetë simbolë, por kemi dhe të tjerë, me qindra, heroikë në përpjekjet e tyre dhe në vdekjen e tyre. Në mënyrën e parë biem në gabim, sepse i japim të kuqtojë popullit sikur lëvizja jonë është shterpë në heronj, kurse në të dytën, ruhem i nga lokalizma. Përmenden vetëm luftëtarët e qyteteve dhe jo të maleve. Lufta jonë është e gjerë; heronjtë tanë janë të shumtë, duhet t'i njohë populli, t'i dijë, ta vlerësojë luftën tonë. Shumë sende të tillë të vogla, por me rëndësi, duhet t'ua përmendim shokëve. Mbi të gjitha, ti e di dhe vetë, duhet të japim

¹ «lieu commun» (frëngj.) — menjtime të përsëritura dhe pa interes.

tónin në gjithë qarqet e tjera, duhet që propaganda jo-në dhe fletët e Tiranës të shkojnë edhe në qytetet e tjerë. Por që të shkojnë, duhet të bëjmë lidhjet. Nuk zgjatëm mbi këtë pikë, se e di që është pika kryesore që duhet të të preokupojë të bësh lidhjet me Jugun: Vlorën, Gjirokastrën, Beratin, dhe nëpërmjet teje, me shokët e Korçës edhe me ne.

Duhet t'i mësosh shokët e atjeshëm të punojnë, por edhe të luftojnë policinë dhe të ruajnë kuadrot.

Reaksionit të madh dhe të organizuar mos t'i futemi si qorra. Duhet të dish t'i këshillosh shokët të punojnë parreshtur, metodikisht (mundet dhe në «ralenti»¹), por jo me i futë në zjarr, kur situata është shumë e rëndë. Ki parasysh që puna të kryhet dhe njëkohësisht kuadrot e shëndosha të ruhen, se na duhen për nesër. Nuk mund të gjejmë dhe të pjellim në çdo rast Det, Hysen, Dyl e të tjerë. Këta duhet të dinë të punojnë (këto vërejtje i bëj, se na thanë që po i kapin shokët në rrugë, si peshqit).

Përsa u përket ilegalëve, shokë dhe partizanë, duhet me u gjetë ilaqin për me i nxjerrë nga qyteti, ku jeta e tyre është në rrezik. Studjoni mundësitë, s'mund të them gjë, se s'di, por sugjeroj vetëm që, kur rreziku është iminent, mos mbani format, mos pritni që çdo partizan të vejë në repartin e vet. I çoni në Pezë, do të jetë një ndihmë për Myslimin dhe një inkurajim; i çoni në Korçë me letra njoftimi false (po të keni mundësi).

Për Myslimin mos lini asgjë për ta ndihmuar. Si

¹ Në «ralenti» (frëngj.) — «Më me ngadalë».

na shkruan ti, atje po luftohet dita-ditës, duhet që Myslimi dhe shokët të shohin se jemi kurdoherë afër tyre, në çdo moment. Duhet, pas mendimit tim, që Myslimi të ndihmohet më parë se disa brigada.

S'di ç'do të na ngatërojnë me Bazin e Canës në Mat ata të Brigadës III.

Bazin, kam përshtypjen (nuk flas me siguri, se s'di), shokët e kanë lënë në heshtje. Hyseni na thotë në letër se ai ka hedhur një trakt si përgjegje rezolucionit tonë¹, por s'dimë brendinë. Kam parë një gjë, vetëm në ato fletët tona që kam kënduar, se Bazi i Canës s'po përmendet fare. Ky është një gabim. Bazin e Canës s'duhet ta lëmë të fshihet i qetë si më parë, gjoja si «një luftëtar kundër çdo okupatori» dhe nga ana tjetër në lidhje të ngushtë me tradhëtarët. Rezolucioni duhet të ndiqet me fletë e artikuj të tjerë kundër qëndrimit ekuvok të Bazit. Bazin duhet ta nxjerrim nga strofka ku është futur dhe të bëjmë që populli të shohë fytyrën e tij të ndyrë. Atë e kemi armik, duhet t'i biem, do të kemi një armik më shumë dhe duhet të mos harrojmë se, përsa mendoj unë, me ato lajme që kemi, ai është shtylla e reaksionit në Veri, rreth tij do të gravito-hen² qelbësirat.

Bazin s'duhet ta lëmë të hiqet në popull si patriot, kurse ai s'është veçse një tradhëtar. (Për Bazin po pre-

¹ Është fjala për rezolucionin e Kryesisë së Këshillit të Përgjithshëm Nacional-Çlirimtar të 7 dhjetorit 1943 «Mbi përjashtimin e Abaz Kupit nga Këshilli i Përgjithshëm». (Shih: «Dokumenta të organeve të larta të pushtetit revolucionar nacional-çlirimtar», f. 103, Tiranë 1962).

² Grumbullohen.

gatit dhe unë një artikull, por që ta shkruaj, duhet që ti të më dërgosh patjetër informata për Bazin, punën e tij dhe propagandën që ka bërë gjatë kohës që jemi shkëputur nga dynjaja. Këto i pres.)

Lufto në shokët shkarkjen që në propagandë, si me shkrim dhe me gojë, të mos goditin vetëm reaksionin dhe të harrojnë okupatorin. Të dy t'i lidhim ngushtë, me në krye gjermanët. Aksionet kundër gjermanëve, qofshin dhe të vogla, të vihen në dukje. Për këtë pikë kanë rëndësi lidhjet me krahinat...

Lila e «miqtë» në vend që të grumbullonin shokët e shpërndarë e të riformonin batalionin në një o dy njësi, kishin proceduar duke likuiduar çdo gjë, sidomos që situata përmirësohej dhe sqarohej disi. Partizanët që ishin, në vend që t'i grumbullonin e t'i organizonin, ata i dëbuau dhe i degdisën në Brigadën III, me shënim që të vinin atje ku do të bëhej grumbullimi dhe pasi të grumbullohen, të kthehen me borin në Çermenikë. Dhe më e bukura është se likuidojnë ushtrinë dhe partizanët, kur u kemi bërë gjithë ato vërejtje brigadave për këto gabime kaq të mëdha, që venë deri në tradhëti. Ç'të bësh tjetër me ta, o Deti? Peshku është qelbur nga koka, duhet kokë e re. I godita rëndë, u fola ashpër dhe hapët, i vura përrpara përgjegjësive. Asnjë prej tyre s'bëri një fjalë ose fije autokritike. Ja kështu qëndron puna.

Ballistët bëjnë mbledhje çdo javë, Lushi¹ vete-vjen si në terren të tij. Ballistët lëvizin si në çifliquet e tyre

¹ Alush Leshanaku, komandant çete balliste në qarkun e Elbasanit.

dhe ne jemi në mëshirën e mikut që di ti. Pra shokët e këtushëm i ndava në terrene të ndryshme të Çermenikës, dy e dy. Terreni do krahë, do punë, do kohë që të vijë në vete. S'di ç'të them më.

Nga D. mora një letër, ku më kërkon informata për Haxhinë dhe kërkon të kthehet, se shokët janë halakatur, s'po i gjen dot ku janë, reaksiuni në kulm, thotë. (Në Dibër 60 gjermanë dhe në Peshkopi vetëm 15. Merre me mend panikun e këtyre shokëve!)

A mendon ndopak për ne fukarenjtë e rrethuar e që mërzia e ka kapërcyer kufinë? A ke menduar ndonjë solucion¹ daljeje për ne? Automobil, Dumre, Pezë a gjetë? Duhet të shkruash nga të katër anët, por pa zënë në gojë se jemi ne që do të dalim. Lëre të kuptojnë shokët që jemi ne (pse letrat mund të bien në duar të armikut).

Mendojmë të dalim andej nga doli A. dhe T. Ky është një plan që na tenton². Po të kesh mundësi të shpejta, i ço një letër T. dhe i trego planin tonë. Ai të të përgjegjet me hollësi për situatën e atij rrithi dhe në kanë mundësi të dërgojnë ndonjë njësit nga Grabova dhe më brenda që të na presin. Këtë gjë, në qoftë se e bëjnë, ta bëjnë shpejt, d.m.th. brenda 4 ditësh ta kesh ti përgjegjen e tyre dhe ne në fund të javës, d.m.th. nga 12-a të kemi një lajm prej teje. Sidoqoftë ti bëje këtë punë në këtë mënyrë dhe u thuaj atyre që ne mund të nisemi, prandaj të çojnë njësitin. Natyrisht ne nuk do të nisemi si qorrat, por prapë me siguri të mëdha nuk nisemi. Do të luajë ca edhe fati.

¹ Zgjidhje. Këtu: mënyrë.

² Tërheq.

Për çështjen e kursit¹ këto janë plane të zakonshme. Uroj që të bëjnë diçka që mund të përfitohet. Për mbledhjen që thua ti², ajo është e domosdoshme, por puna është se a ka mundësi.

Na dërgo lajme e mos përto, o Deti. Kujto vuajtjet, kujto ç'ke hequr dhe ç'po heqim ne.

Shokëve të fala, veçanërisht Hysenit, Delegates dhe ty. Nga shokët shumë të fala.

T a r a s

Majori³ kërkon prej teje që t'i çosh një letër nga kalamajtë e tij. Me një fjalë kërkon një përgjegje nga fëmija e tij.

(Që ta kuftosh më mirë planin që kemi për të kalluar: ne do të kalojmë nga ajo krahinë, emri i së cilës është ashtu si firmoj unë⁴. Ti je i mençur, e kuption. Prandaj njësiti nga Korça, po të hyjë pak thellë në këtë krahinë, do të jetë një ndihmë për ne.)

Botohet për herë të parë, si pas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

¹ Kursi teorik që u organizua nga KQ i PKSH me udhëheqës politikë të brigadave dhc anëtarë të komiteteve qarkore të Shqipërisë së Jugut, në Panarit më 4—20 mars 1944.

² Shoku Nako Spiru propozonte të bëhcj një mbledhje e Komitetit Qendror të PKSH. Në ato kushte ishte e pamundur një mbledhje e tillë. Plenumi i Komitetit Qendror u mblodh më 15 maj 1944.

³ Spiro Moisiu.

⁴ Shpati — krahinë nöç qarkun e Elbasanit.

2

**LETËR DREJTUAR KOMITETIT QARKOR TË
PARTISË KOMUNISTE TË SHQIPËRISË PËR
TIRANËN MBI QËNDRIMIN NDAJ ELEMENTËVE
DEZERTORE Ë TRADHËTARE TË PARTISË DHE
MBI FORCIMIN E ORGANIZATAVE TË PARTISË
NË FSHAT**

2 mars 1944

I dashur shoku Gogo,

I kemi shkruar Nakos, e letrën e atij, sigurisht, do ta lexosh dhe ti, prandaj disa çështje nuk po t'i përsëritim. Ti Gogo, do të përpinqesh që të mbash lidhje të rregullta me organizatat dhe më ne. Kur vjen korrieri, ti, pa marrë parasysh se shkruan Nakua, na shkruaj hollësisht mbi situatën e atjeshme dhe të qarqeve të tjera, por në mënyrë që dhe ne të formojmë një ide të qartë.

Mos na paraqit vetëm gjendjen politike, se na intereson që të na shkruash edhe mbi organizatën. Kini kujdes, Gogo, në fraksionistët dhe në gjithë të lëkundshmit, t'i kemi gjithmonë para kontrollit tonë. Na shkruani ku ndodhen Xhepi, Difi, Xhelali¹, ç'bëjnë etj. Këta

¹ Xhelal Staravecka, dezertor i lëvizjes nacional-çlirimtare, armik i popullit, kriminel lufte.

nuk duhet t'i harrojmë. Xhelali të vritet me çdo kusht. Nga janë dhe ata që kanë qenë të dyshimtë?

I kemi shkruar dhe Nakos në një letër të mëparshme ku i kërkojmë një kopje nga e gjithë lënda që ka dalë, gjithë numrat e revistave dhe të materialit tjeter që ka dalë. Të kemi kërkuar kaq herë «Historinë e Partisë», por nuk na jep asnje përgjegje. Presim të na shkruash.

Presim prej teje një letër mbi gjithshka që kemi shkruar, mbi gjendjen politike dhe sidomos mbi organizatën, këtë jo vetëm për Tiranën, por dhe për qarqet e tjera: mbi fraksionistët, mbi veprimet e tyre, mbi qeverinë, lëvizjet e manevrat e armikut, mbi ilegalitetin dhe mbi ushtrinë. Të kemi shkruar që të merreshe vesh me qarqet e tjera dhe të të dërgonin një raport, këtë e kemi pritur dhe e presim gjithmonë. Organizatat duan ndihmë e këtë nuk mund ta japim, në qoftë se nuk dihet gjendja e tyre.

Të gjithë ilegalët që janë aty dhe në çdo qytet, e gjithë rinia dhe të gjithë ata simpatizantë e miq që duan të dalin, të hidhen në radhët e ushtrisë. Këtë duhet ta vërë në zbatim çdo organizatë.

Të gjitha organizatat duhet të kenë nën kontrollin e tyre gjithë të përjashtuarit, grupashët, të lëkundshimit dhe gjithë armiqtë e Partisë sonë, të goditin pa mëshirë gjithë ata që, të përjashtuar ose të papërjashtuar, luftojnë Partinë tonë. Bini kokës atyre që tradhëtojnë.

Po ta përsëritim dhe një herë që ti na shkruaj paravësish nga letrat që shkruan Nakua.

Dhe një gjë tjetër duhet nga ato qarqe: (si nga Shqipëria e Mesme, si nga Shkodra etj.) t'u japin rë-

ndësinë e duhur organizatave të fshatrave, po ashtu dhe ju aty në Tiranë; mos të kufizohet puna organizative në qytete. Megjithëse është e zorshme në këto situata reaksioni, por prapë këtë duhet ta theksojmë në shokët e organizatave e për këtë të udhëzojmë dhe shokët që janë në ushtri.

Kur të marrim informata të sigurta mbi veprimet e gjithë qarqeve dhe brigadave, do t'jua dërgojmë.

Të fala shoqërore

[Enver Hoxha]

*Botohet për herë të parë, si-
pas origjinalit që gjendet në
Arkivin Qendror të Partisë*

LETËR DREJTUAR SHOKUT NAKO SPIRU MBI DALJEN E SHTABIT TË PËRGJITHSHËM TË UNÇSH NGA RRETHIMI DHE MBI KUNDERMESYJMEN E UNÇSH

[Mars 1944]

I dashur shoku Deti,

Pas kaq vuajtjesh mbërritëm në Korçë dhe muarëm kontakt me shokët. Erdhëm nga ana e Shpatit dhe vuajtëm gati 20 e ca ditë duke kaluar mik më mik gjithë zonën Shpat-Vërçë. Situatën në Çermenikë e lamë të pandryshuar, kishtë mjaft reaksion, sikurse në Shpat e Vërçë; sidoqë kishte disa çeta balliste, populli e urrente «Ballin» dhe kishte shumë simpati për ne. Kudo që vajtëm, në miq e në shokë, na kanë pritur si jo më mirë. Kur ndodheshim në Kishtë, një batalioni ynë i Korçës, i komanduar prej Riza Kodhelit, vetëm me daljen e tij në Shenepremte dhe pa hedhur asnjë pushkë, vuri në ikje gjithë forcat balliste që ishin grumbulluar në Vërçë; që prej Riza Kishtës e deri te Maliq Dushari e Musa Beu i Moglicës, të gjithë, në Elbasan e mbajtën vrapin nga frika. Vetëm ardhja e këtij batalioni bëri që të zbrazej terreni prej ballistëve. Këtë e pamë vetë me

sy, bile edhe tërheqjen e tyre të parregullt. Këtu situa-ta nuk është ashtu e vështirë si nga ajo anë. Brigada I, e cila ka luftuar mirë kudo që ka qenë, ishte thirrur me urgjencë prej shokëve nga Berati dhe Mehmet Shehun me tri batalione e çuan në Çermenikë të na merrte ne. Mehmeti kaloi Shkumbinin dhe tani është në Çerme-nikë, por ne kishim ikur nga Shpati. Pjesa tjeter e bri-gadës po vepron në Mokër dhe sa po marrim lajmin se në një përpjekje, që kanë pasur me gjermano-ballistët, kanë dalë fitues. Ja ç'na shkruajnë dhe këto i shtypni në komunikatë: «Mbas spastruam zonën e Tomorricës dhe shpartalluam fuqitë e Xhaf Balit, u hodhëm në Mo-kër. Në Shkozë dhe Këmbëthekër një pjesë e një kō-mpanie të Batalionit IV të Brigadës I u ndesh me ca ba-llistë dhe i shpartalloi. Ballistët shkuan në Sovjan dhe muarën gjermanët dhe goditën shokët në befasi. Menjëherë forca të tjera të Batalionit IV u vajtën në ndih-më dhe i shpartalluan përsëri. Në përpjekje na u vra-në dy shokë, nga ata u vra një ballist. Më 4 mars një fuqi e madhe gjermane avanconte në drejtim të Mokrës duke ardhur nga Qukësi dhe nga Pogradeci. Mbas një luftimi të shkurtër, forcat tona ishin tërhequr nga Mo-kra. Në këtë përpjekje ishin vrarë dy gjermanë dhe një ballist, nga ana jonë dy të plagosur lehtë. Në mëngjezin e datës 7, forcat tona kompletuan rrëthimin e ballistëve. Rrëthimi u bë i plotë dhe mbas dy ore luftimi u kapën rob 400 ballistë e më tepër se 70 u vranë në luftim. U kapën armë e municion i panumërt si dhe komandantët e tyre, të cilët mbasi u gjykuar, u ekze-kutuan para ballistëve dhe popullit të Mokrës. Koma-nđantët që u zunë rob, që u gjykuar dhe u ekzekutuan

ishin: Haki Blloshmi, Xhevdet Blloshmi, Bame Trebinja, Sadik Bej Trebinja, Xheladin Ago Selca, Adem Ago Velçani, Adem Kapri dhe i biri i Hasan Bej Velçanit». Si e sheh, Brigada I po lufton për mrekulli, shpirti i sakrificës, guximi i partizanëve është i madh.

Brigada IV vepron në Gorë, Opar e fushë. Ka bërë spastrime dhe s'gjen asnje rezistencë. Në një përpjekje që është bërë në Lozhan, afro 400 ballistë janë shpartalluar, nja 10 janë vrarë.

Ende s'jemi ambientuar me situatën dhe me punën, nuk dimë mjaf gjëra, pse kemi vetëm dy ditë që kemi ardhur. Kemi kënduar vetëm dy letrat e tua, por sidqoftë, me të marrë letrën, duhet të na nisësh një raport të gjerë për gjithë punën që zhvillohet aty, me hollësira. Të na raportosh aktivitetin e shokëve e, sidomos të shokëve udhëheqës, qëndrimin e tyre. Të na raportosh çështjen e rinasë dhe të na çosh çdo raport që vjen nga terrenet për Komitetin Qendror. Shokët qahen për lidhjet që s'i keni mbajtë aspak në rregull. Unë nuk di për këtë punë, por patjetër kjo gjë duhet të ndreqet dhe të stabilizohen lidhjet e rregullta me Korçën me çdo kusht. Të interesoheni sa më parë te Shulja për radion transmetuese që kanë ata. Merreni e përpinquni ta rregulloni dhe kështu të lidhemi me ju me anë të radios. Po ta bëjmë këtë, kemi bërë një gjë të madhe. Prandaj mos e lini pas dore.

Sejfullau ç'gatuan aty? Për çështjen e «Partisë Republikane Demokratike»¹ që më shkruaje në Çermenikë,

¹ Në fillim të vitit 1944 u propozua formimi i një «Partie Republikane Demokratike» me elementë të Frontit Nacional-

mua Sejfullau s'më ka fjalosur aspak, dhe unë s'jam i mendimit që ne të vëmë forcat për ta kriuar dhe të largojmë elementë nga fronti gjoja për t'i afuar. Nuk di se deri ku keni vajtur, por do të fjalos me shokët dhe do t'u shkruajmë. Sidoqoftë mos bëni gjë pa marrë lajme këtej. Dr. Nishani dhe B. nevojiten të vijnë këtej, prandaj studjoni mundësitë e daljes së tyre nga ana e Pezës dhe kërkonani këtu ndihmën e t'ju çojmë forca për me i marrë në ndonjë vend ku ta caktoni ju më të përshtatshëm.

Për shokët që vijnë nga Italia a gjetkë, nga vende të huaja, të na raportohen emrat e tyre dhe çdo informatë që mund të keni mbi ta. Të mos futen në Parti pa marrë aprovimin tonë. Asnjë që thotë se kam qenë në celulë në Itali ose në Partinë Italiane, të mos futet në Parti pa urdhërin e KQ.

Një kujdes të veçantë të keni për çështjen organizative të Partisë. Shokët t'i hapin sytë dhe t'i bëjnë katër kundër armiqve të Partisë, kundër grupashëve, të cilët patjetër po punojnë nën rrogoz. Kujdes në ta, kujdes në lidhjet e tyre të vjetra, kujdes i madh, se një mëngjez do të na bjerë ndonjë tullë në kokë. Për këtë çështje që më preokupon shumë, se kam disa gjëra që kam mësuar, do të të shkruaj më gjatë dhe më me hollësi mbasi të çlodhem disa ditë.

Na dërgoni shtypin, na dërgoni hollësira të punës

-Çlirimtar, me qëllim gjoja që të tërhiqeshin në front njerçz të «Ballit Kombëtar» që ishin kundër krerëve të tyre. Formimi i një partie të tillë u quajt një gjë krejt artificiale dhe e dëmshme për luftën çlirimtare, prandaj propozimi u hodh poshtë nga KQ i Partisë.

së këshilltarëve. Do t'ju çojmë artikuj, vetëm duhet të rregulloni me urgjencë lidhjet. Këtë letër ja jep Delegates.

Shumë të fala të bëjnë gjithë shokët dhe unë të përqafoj me mall, o ish-shoku im i mizerjes. Si vete me sëmundje? Letra që të çojmë për Dibër, Sllovë, të dërgohet me çdo kusht e me urgjencën më të madhe me anë të Peshkopisë. Të mos vonohet asnje ditë në Tiranë dhe as në Peshkopi. Kjo ka karakter urgjent, shumë urgjent.

A keni marrë vesh për Vasilin?

T a r a s

Botohet për herë të parë, si-pas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

**LETËR DREJTUAR SHOKUT NAKO SPIRU
NË LIDHJE ME PËRBALLIMIN E
VËSHTIRËSIVE TË KRIJUARA NGA
OPERACIONI ARMIK I DIMRIT**

[Mars 1944]

I dashur shoku Nako,

Morëm letrën tënde, që s'kish as datë as firmë. Më duket se jeta që bëmë në Çermenikë s'të vuri mend. Letra jote ishte aq e shkurtër dhe e errët sa s'bëhet; nga Tirana ne presim të na vijë një letër e gjatë, ku të na shkruhet me hollësi për çdo gjë, deri në lëvizjet e vogla të armikut dhe jo një letër me stil telegrafik. Tirana s'është afër sa Lavdari, që të të çojmë korrierë çdo ditë e të të kërkojmë lajme, duhet të mendosh sakrificat që bëjnë korrikerët kur sjellin letrën dhe presin të marrin përgjegjen; prandaj herë tjetër mos e përsërit atë zanat, shkruaj më gjatë, propozimet që bën, bëji më të qarta dhe përgjegju të gjitha pyetjeve që të kanë bërë shokët në letrat e para si edhe në këtë.

Letra jote e fundit gjithashtu dhe e parafundit kishin një dozë pesimizmi të madh. Me të vërtetë situata është e vështirë, shumë e vështirë, si në Tiranë ashtu

edhe në Veri të Shqipërisë, por bash në këto situata të vështira të përpinqemi të mos humbasim nordin dhe të ruhemë të bëjmë konkluzione pa marrë parasysh situatën e jashtme, e cila duhet të jetë një pikë mbështetjeje, si edhe situatën në rrethet e tjera të Shqipërisë; thua se ushtria në Veri është gati likuiduar, Brigada III ka vetëm 30 vetë, për Brigadën II ose të paktën për shtabin e saj dhe ata të paktë shokë që mund të kenë mbetur, as që na i zë fare në gojë, thua se çetët janë katandisur në numra qesharakë. S'duhet aspak të dëshpërohem, këtë gjëra ngjasin, dimri qe i egër, reaksiuni qe dhe është i madh, por mos harro që humbje në njerëz nuk kemi pasur shumë dhe ata partizanë që kanë ikur nga brigadat e batalionet, janë përsëri me ne. Dimri, uria, lodhja, zbathja i ka bërë që t'u ulet morali dhe të vijnë të strukën dhe nëpër qytete. Këta janë me ne dhe ne duhet të përpinqemi që këta njerëz jo t'i dorëzojmë, jo t'i legalizojmë, jo t'i demobilizojmë, por të përpinqemi t'i mobili zojmë rishtas, t'i bindim të shkojnë në çeta, se tanë kemi përpara beharin, kohën e ngrohtë dhe jo dimrin. Gabim i madh me rënë në pozitën e tyre dhe me i legalizue; ata që do të dorëzohen, le të dorëzohen, por ju gurin mos ua hidhni, por edhe mos ua vulosni legalizimin e tyre. Në asnjë mënyrë të mos procedohet drejt likuidimit të ushtrisë. Mund të jetë zor, por në këto momente duhet që shokët të tregojnë aftësinë e tyre organizative dhe bindëse, se është kollaj me i dorëzue, por shumë zor me i futë përsëri në luftë dhe në ushtri. Shokët të harrojnë kohërat që i nisnin partizanët me automobil, tanë duhet të dërsijnë për me i çue në Pezë. Dhe të çohen në Pezë. S'e besojmë që s'mund të dalë as miza

nga Tirana. Duhet t'i përvisheni punës për këtë gjë, se patjetër duhet të riorganizohen batalionet dhe brigadat që janë shpërndarë. Këto momente ngjasin në luftë, por ne duhet të ringjitim korrentin patjetër. Situata në Jug nuk është aspak aq e vështirë, përkundrazi. Brigadat janë në këmbë dhe sulmojnë. Brigada I rrrethon 400 ballistë në Mokër dhe vret Haki Blloshmin, Bame Trebinjën, vëllain e Hakiut dhe shumë krerë të tjerë të dorës së dytë, një pjesë tjetër e brigadës ka kaluar në Çermnikë, Brigada IV po vepron me sukses në gjithë krahi-nën e Korçës, Brigada VI është shumë e fortë, gati si Brigada I dhe Brigada V, me gjithë goditjen e madhe, me gjithë dimrin e fortë, s'pati veçse 45 të vrarë e të plagosur, efektivi i saj është akoma 800 vetë. B. shkoi dje të inagurojë Brigadën VII në Berat me komandant Gjin Markun, komisar Lilën, zëvendëskomandant Neshat Hysin dhe zëvendëskomisar Adil Çarçanin. Në Vlorë kemi në plan të organizojmë Brigadën VIII. Armiku s'i ka hedhur armët, lufta do të jetë e ashpër, por ne s'duhet të na gjejnë sulmet e armikut të paorganizuar. Mos shih vetëm anën negative, por shih dhe atë pozitive të punës, me këtë s'dua të them se s'duhet ta shohësh realitetin në fytyrë.

«Lufta e Rinisë» që keni nxjerrë, nuk na la përshtypje të mirë. Kryeartikulli s'rëndon shumë, me argomenta jo të forta dhe me stil jo të mirë. Qëndrimi politik në atë artikull kundër Zogut, jo i mirë. Kurrë ne s'kemi mbajtur një qëndrim të atillë jo me shkrim, por as me gojë. Bazit të Canës në atë artikull gati i kërkojmë mëshirë. Jo, ky qëndrim që mbahet në atë gazetë s'është i mirë. Tani po preqatitim torpilën kundër Zogut, ju në

mos shkoni dot më tej, të paktën mbani qëndrimin e caktuar. Përsa i përket traktit të Komitetit qarkor të Tiranës për 4 shkurtin mund ta shkruaje më të shkurtër dhe më prekës për masat e popullit. Jemi duke pregatitur artikuj për të përcaktuar vijën për shumë çështje, por na shkruaj ç'bëni me të famshmet gazeta «Zëri i Popullit» e «Bashkimi». A mund të dalin, në mos në atë format, në ndonjë format më të vogël? Sejfullau ç'po bën aty? Miqtë si Dr. dhe B. si qëndrojnë, a shkruajnë? Të kemi shkruar që është e nevojshme të vijnë këtej, na u përgjegj.

Për botimin e dorëheqjes së Fuat Dibrës¹ s'jemi dakkord. Ky njeri, i gjallë, s'ka mbajtur kurrë një qëndrim zyrtar kundër tradhëtarëve dhe armikut dhe as një qëndrim pro lëvizjes sonë. Dhe tani ne të reabilitojmë kufomat që s'na kanë shërbyer kur kanë qenë gjallë, pse? Prandaj të mos botohet nga ana jonë. Në trakte e në fletë s'flitni veçse për Eqrem Telhanë e Xhafer Devën dhe asnje fjalë për tradhëtarët e rinj që kanë marrë pjesë në qeveri si Bahriun, Kolën e Koço Mukën. Eqrem Telhanë s'e p... njeri, por këta kanë disi influencë në disa rrethe, prandaj u bini kokës sa më fort. Mendoni pse i ka marrë gjermani në qeveri, sepse ata dicka mund të shërbejnë për të, prandaj asnje minutë mos i lini të qetë. Asnjë konsideracion të mos ju ndalojë.

¹ Pas vdekjes së anëtarit të «Këshillit të lartë të Regjencës» Fuat Dibrës, Nako Spiru propozonte që në shtypin e lëvizjes nacional-çlirimtare të botohej dorëheqja formale e këtij kuilisingu nga «Këshilli i lartë i Regjencës», gjoja me qëllim që të tërhiqeshin në radhët e lëvizjes nacional-çlirimtare elementët që ndodheshin nën ndikimin e tij.

Për punën e grupashëve duhet të kini mendjën. Shumë herë i kemi shkruar Gogos. Delegates i kam shkruar kur kam qenë në Martanesh që poqa atje K., i cili drejtohej për Tiranë. I. K. kish qenë atje, dhe K. i kish thënë se vinte të piqej me Xharxhanezin¹ dhe si-gurisht edhe me Xhepin. Unë kam bindje se ai është pjekur; janë pjekur dhe të gjithë plehrat e tjerë që s'janë në Parti dhe që janë në Parti e që shoku Gogo s'mund t'i heqë nga detyra e përgjegjësave të celulave ose t'u bëjë vërejtje, sepse gjoja janë aktivë, «shumë aktivë». Por kur të na kërcasë bomba ndonjë ditë, do ta shohin shokët sa aktivë janë dhe sa naivë kemi qenë ne. Grupashët janë struktur në qytete, se në çeta s'mund të punojnë lirisht, atje organizojnë, atje kombinojnë, prandaj shokët të jenë zgjuar, t'i vëzhgojnë, t'i luftojnë pa mëshirë; të mos kenë për ta zemër murgeshe. Shikojeni mirë këtë punë, se atje në Tiranë armiqtë s'flenë...

Letrën që të kanë shkruar shokët më parë, këndoje me vërejtje dhe jepna përgjegje sa më parë.

Shumë të fala

Taras

E dashura shoqe Delegate,

S'dimë si vete me punë, do të të shkruaj më gjatë njëherë tjetër, se mjaft punë kemi këtej. Pas tre muajsh

¹ Pseudonimi i një farë Qani Shenaj, anëtar i frakzionit të Sadik Premtes, ballist e kriminel lufte.

mungese duhet të punojmë si derrat, se mjaft u çlodhëm. Më shkruaj dhe ti gjatë për punën e atjeshme. Shko dhe në shtëpi dhe u thuaj për mua që jam mirë.

Përqaftime

T a r a s

Lilën ta lajmëroni të vijë, se është emëruar komisar i Brigadës VII. Lilës shkruaji që me anë të Balilës¹ të marrë dhe dy çantat që i kam dhënë unë dhe i di Balila ku janë. Këto t'i sjellë Lila. Goga (Heba)² që është në Elbasan, të vijë me Lilën dhe të bjerë «Historinë e Partisë» të tërë për kursin e madh të Partisë.

— Ç'bëhet puna e radiostacionit?

Gogua, Delegatja dhe ti të na shkruani veç e veç nga një raport për punën.

T a r a s

*Botohet për herë të parë, si-
pas origjinalit që gjendet në
Arkivin Qendror të Partisë*

¹ Pseudonimi i shokut Qirjako Deçka.

² Teodor Heba.

**LETËR KUADROVE DREJTUESE TË BRIGADES I
SULMUESE MBI PREGATITJEN E KUADROVE
USHTARAKE, MBI FORCIMIN E PUNËS
POLITIKE DHE RRITJEN E FRYMËS
LUFTARAKE**

24 mars 1944

Po bëhet një kohë e gjatë që s'jemi parë dhe s'kemi pasur rast të bisedojmë...

Sukseset e korrura nga Brigada I jo vetëm që na kanë gëzuar pa masë, por na kanë forcuar bindjen se ajo brigadë dita-ditës po bëhet një repart ushtarak që do të jetë një nga armët e shëndosha të së nesërmes për realizimin e programit tonë maksimum. Jemi të bindur nga ana tjetër se keni kurdoherë parasysh që nga ajo brigadë ushtria jonë pret kuadro të shëndosha, të regjura në luftë e në përpjekje, dhe Partia jonë — shokë organizatorë dhe udhëheqës që të ngrenë në nivelin e Brigadës I repartet e tjera të Ushtrisë sonë Nacional-Çlirimtare. Duhet të keni synë dhe të jepni maksimumin në ngritjen e këtyre kuadrove që çdo ditë nevojiten si në organizatat e Partisë në ushtri ashtu dhe në ato të terrenit. Të keni kujdesin më të madh që puna organizative dhe politike, që bëhet prej Brigadës I

ndër terrenet e ndryshme ku kalon, të jetë një punë e shëndoshë dhe e durueshme, të jetë baza e shëndoshë e pushtetit tonë, ku shokët e terrenit do të kalojnë, do ta forcojnë e do ta zgjerojnë. Zhvilloni ndër shokët e brigadës dhe në gjithë popullin dashurinë për Partinë Komuniste dhe kudo e në çdo rast ta popullarizoni atë si shtyllën e Luftës nacional-çlirimtare, si të vetmen udhëheqëse të popullit drejt fitores. Të popullarizohet kudo Bashkimi Sovjetik, Ushtria e Kuqe dhe fitoret e saja të shkëlqyera, kudo të flitet për shokun tonë të madh Stalin.

Shokët e brigadës duhet t'i mësoni të durojnë në vuajtje, të mos kënaqen me sukseset e korrura të deritanishme, të ndjejnë se para tyre shtrohen detyra të mëdha dhe rruga që do të kalojnë do të jetë e vështirë, përpara do të gjejnë vështirësi, do të gjejnë luftime edhe shumë më të ashpra se ato që kanë bërë. Të ngrini në kulm në zemrat e partizanëve urrejtjen për okupatorin dhe reaksionarët, vegla të armikut gjerman, dhe lufta kundër këtyre të bëhet e ashpër dhe e paprærë.

Në lidhje me situatën e Mokrës dhe në bazë të raporteve të ndryshme që na kanë ardhur nga shokët e terrenit si dhe nga ju, duhet patjetër që t'u japim fund manevrave dhe tradhëtive të Tele Baçit¹. Tele Baçin duhet ta arrestoni, t'i bëni gjyq dhe ta pushkatoni. Gjyqi i brigadës të bëhet i hapët dhe akuzat t'i bëhen

¹ Ish-komandant i Batalionit partizan «Reshit Çollaku», zhvilloi një veprimitari sabotuese në dëm të Luftës nacional-çlirimtare. Për këtë u dënuar nga gjyqi partizan si armik i popullit.

të shëndosha prej një shoku të formuar që të vërë qartë në dukje, përpara popullit të gjitha tradhëtitë e tij, duke filluar që nga manevra përpara reaksionit, deklarata që ka bërë dhe qëndrimi i tij tradhëtar në kohën e sulmit gjerman, kur nga qëndrimi i tij na u vra një numër i madh shokësh nga Batalioni i «6 Dëshmorëve» etj. Një nga akuzat që do t'i bëni është edhe vrasja prej tij ose prej njerëzve të tij e atij ballistik që fali gjyqi i brigadës sipas dëshirës së popullit. Më parë se të ekzekutohet, të merren masat e rastit e sidomos në Batalionin «Reshit Çollaku», ku ndodhen të bijtë e tij dhe ndoshta njerëz të influencuar prej tij. Të merren masa sigurimi dhe vëzhgimi kundër miqve të Teles që ndodhen në Çezme dhe të kihet kujdes që të goditet pa mëshirë organizimi eventual i ndonjë çete kriminale prej këlyshëve të Teles. Pa humbur kohë, pas ekzekutimit të tij të emërohet komandant i Batalionit «Reshit Çollaku», Zuko Kalivaçi. Të këshilloni komisarin e atij batalioni, Misto Treskën, që të tregojë gjallëri në punë dhe të mos flerë e sidomos pas këtij gjyqi, i cili do të shkaktojë një farë lëvizjeje në Mokër. Pas ekzekutimit të tij të organizoni disa konferenca në popull e në Batalionin «Reshit Çollaku» për të demaskuar Telen dhe tradhëtitë e tij.

Shumë të fala shoqërore

[Enver Hoxha]

*Botohet për herë të parë, si-
pas origjinalit që gjendet në
Arkivin Qendror të Partisë*

UDHËZIM DREJTUAR KOMITETIT QARKOR TË
PARTISË KOMUNISTE TË SHQIPËRISË PËR
GJIROKASTRËN MBI RUAJTJEN DHE FORCIMIN
E UNITETIT TË RADHËVE TË PARTISË

2 prill 1944

SHOQES NEBAHET BAKIRI

Gjirokastër

E dashur shoqe,

Kënduam letrën tënde që na drejtoje dhe ku na vije në korrent për manifestimin në radhë të disa shokëve, të disa moskënaqësive kundër forumit udhëheqës të asaj krahine. Duhej patjetër për këtë çështje, që në pamje mund të duket e vogël, por që mund të zmadhohet në qoftë se s'marrim masa për ta shëruar, të na jepje disa hollësi. Megjithatë kujdesi yt dhe i shokëve për të ruajtur radhiët e Partisë nga çdo sëmundje grupazhi, na gjëzon dhe na jep besim se do të vini gjithë forcën tuaj për me sjellë në rrugën e mirë të gjithë ata elementë që me dashje ose pa dashje paraqiten të pakënaqur dhe që kjo moskënaqësi të zhdukët sa më parë.

Që të mundni të zhdukni moskënaqësinë që është shfaqur ndër ata shokë të paktë, duhet të kërkonи burimin e saj dhe atje të merrni mësa. Në qarkun tuaj për një kohë të gjatë familjariteti në punët e Partisë ishte mjaft i zhvilluar dhe punët e Partisë ishin bërë monopol në duart e disa shokëve që u pëlgente mjaft indipendencia në punë. Prej këtyre shokëve, që në zhvillimin e punës kanë bërë mjaft gabime dhe lëshime dhe që s'kanë mundur të njojin mirë shokët me të cilët bashkëpunonin, kanë përfituar disa elementë karrieristë dhe ambiciozë, të cilët, të përkrahur dhe të mbështetur qoftë me dashje qoftë pa dashje, kanë mundur të krijojnë rreth tyre një farë aureole dhe një rreth shokësh të rinj e pa eksperiençë dhe jetë partie, mbi të cilët ushtrojnë influencën e tyre. Njëri prej këtyre shokëve është SH.T. me ato të meta që cilësuam më lart dhe që sigurisht është shtytësi i këtyre shokëve të pakënaqur, për të cilët na bëje fjalë në raport. Një send tjetër për t'u vënë re në çështjen që na rapportoje, është se të gjithë ata shokë që shfaqin moskënaqësi, janë muslimanë. Kjo ka një rëndësi të veçantë, sidomos në qarkun e Gjirokastër. Një konstatim të tillë nuk duhet ta kuptioni se në radhët e shokëve të atjeshëm shfaqet një sëmundje në atë drejtim, por vetëm inkonshient duhet të rëndoje mbi supet e shokëve muslimanë e të krishterë antagonizmi fetar i kohërave të kaluara. Simptoma e tretë dhe më me rëndësi në shfaqjen e kësaj moskënaqësie, është se këto moskënaqësi janë shfaqur po në atë formë që u manifestuan në krahinën e Vlorës prej tradhëtarit Sadik Premte dhe shokëve të tij. Duke marrë në konsideracion këto tri së-

mundje si edhe momentin në të cilën po shfaqen, duhet të veproni me kujdesin më të madh. Shpresojmë se së-mundja është e vogël, por sado e vogël që është ne nuk duhet të na zërë gjumi. Në kthesa të tilla që kalon lufta dhe Partia, duhet të dini se do të ketë elementë që do të lëkunden dhe të tjerë që do të shkëputen e të hidhen në llumin ku i pret reaksiioni dhe, bash në këto momente ne duhet t'i kemi sytë hapët për ta ruajtur Partinë që të mos dëmtohet nga elementët antiparti. Reaksiioni dhe okupatori, i regjur në këto punë, bëjnë çmos për të na goditur dhe për të dëmtuar Partinë nga brenda. Këta përdorin njëmijë e një mënyra, jo vetëm elementët tradhëtarë si Xhepi e Xhelal Staravecka, të cilët haptazi janë bashkuar me okupatorin, por me anë të frikës e të terrorit dhe me kërcënime direkte elementeve jo shumë të vendosur, përpiken të krijojnë brenda në radhët e Partisë dhe të rinisë grupe të pakënaqurish e frikacakë, të cilët, në mos mundshin të krijojnë fraksione në radhët e Partisë, të paktën të hapin panik dhe mosbesim ndër shokët. Këto shfaqje, në qoftë se ne i shohim dhe s'i luftojmë me ashpërsinë më të madhe, mund të rezultojnë në fraksione. Vini re tentativat që bën armiku: me tradhëtarin Xhep ai kurdis «Partinë Komuniste të vërtetë», me tradhëtarin Xhelal Staravec-kën partinë «Roja e Drejtësisë», me të tjerë elementë të frikshëm «Grupin asnjanës»¹, me të tjerë si Ru-

¹ Pushtuesit gjermanë, me qëllim që të largonin popullin shqiptar nga Lufta nacional-çlirimtare, nga fundi i vitit 1943 rigrupuan reaksiionin në organizatat tradhëtare si «Partia Komuniste e vërtetë», «Roja e Drejtësisë», «Grupi asnjanës» dhe

shiti¹ i Konispolit fton për bashkim me «Ballin Kombëtar». Të gjitha këto mënyra çojnë në një vend dhe s'ynjë në një gjë, të dobësojnë Partinë tonë. Në momente të tilla shoshiten shokët dhe dalin luftëtarët e vendosur të Partisë. Prandaj kini parasysh një gjë: krahina e Gjirokastrës është shumë e gjerë, shumë e varfër, shumica e popullatës është në luftë të hapët me okupatorin, një pjesë e madhe na simpatizon dhe na ndihmon; Gjirokastra paraqitet një nga bazat e shëndosha, e cila po i jep luftëtarë të vendosur ushtrisë sonë dhe anëtarë të vlefshëm Partisë; armiku dhe reaksioni e konstaton këtë gjë dhe do të përpinqet të na e marrë nga duart. Varet nga ne që plani i tij të dështojë. Pra, çështja që na raportoni duhet shikuar, duhet t'i kapni dhe t'i këshilloni e t'i bindni shokët e pakënaqur, të forconi në ta besimin karshi Partisë, karshi Komitetit Qendror dhe forumit udhëheqës të qarkut të Gjirokastrës, të forconi dashurinë në mes elementëve dhe shokëve dhe me thirrjen e SH. në agjit-propin e Shtabit të Përgjithshëm të mos lini të shfaqet asnje moskënaqësi ose dyshim në radhët e rrethit të tij. Këta duhet t'i kuroni me kujdes, këta të mos lidhin besimin në persona, por besimi i tyre të jetë i plotë në Partinë.

Të kujdeseni veçanërisht për celulën e Policanit, ku janë shfaqur këto moskënaqësi dhe të bindni ata elementë të pafajshëm e që e duan Partinë që t'i sho-

Partia Socialdemokrate. Ato nuk luajtën asnje rol të rëndësishëm dhe u shkatërruan brenda vitit 1944.

¹ Haki Rushiti, eksponent i «Ballit Kombëtar» në qarkun e Gjirokastrës.

hin drejt punët. Të gjithë shokëve t'u shpjegoni rreziqet që do të hasim në rrugë, shokët të gjithë të armatosen për t'i luftuar këto rreziqe, shokët të shtërngojnë radhët dhe të mbrojnë Partinë deri në vdekje, ky është urdhëri i Komitetit Qendror të Partisë.

Të fala shoqërore
Për Komitetin Qendror të Partisë
Komuniste të Shqipërisë

Enver Hoxha

*Botohet për herë të parë, si-
pas origjinalit që gjendet në
Arkivin Qendror të Partisë*

**LETËR DREJTUAR SHOKUT HYSNI KAPO NË
LIDHJE ME RUAJTJEN E KUADROVE KRYESORE
POLITIKE DHE USHTARAKE**

14 prill 1944

**SHOKUT HYSNI KAPO
KOMISAR POLITIK I BRIGADES V SULMUESE**

I dashur shok,

Duke parë zhvillimin e luftës, konstatojmë se një numër i madh shokësh udhëheqës politikë dhe ushtarakë na janë vrarë në përpjekje kundër okupatorit dhe tradhëtarëve. Me zgjerimin e punës dhe të luftës dhe duke marrë parasysh jetën e re të Partisë sonë, gjithashtu edhe elementin kuadër mjaft të ulët politikisht dhe ushtarakisht, këto humbje kanë qenë të ndjeshme për ne. Të shumtata e herës dhe në terrenet e ndryshme mungesa e kuadrove udhëheqëse ka qenë shkaku i dobësimit të punës dhe i moszgjerimit të luftës. Shokët udhëheqës politikë dhe ushtarakë kanë pasur kurdoherë kujdes të jatin shembullin e vendosjes ndaj Partisë dhe me guxim kanë qenë në ballin e luftës, në vendet më të rrezikshme. Kjo u ka dhënë zemër shokëve dhe ushtari-

së, kjo ka ngritur lart emrin e Partisë sonë, por shokët kanë menduar pak për ruajtjen e kuadrove të mira, kuadro që do të ngrenë shokët e tjerë dhe do të udhëheqin punën dhe luftën. Në fillimin e mëkëmbjes së punës dhe të ushtrisë ishte dashur kjo sakrificë e dhimbshme për udhëheqësit ushtarakë dhe politikë të Partisë sonë, kjo do të duhet tani dhe kurdoherë, por shokët udhëheqës duhet të kuptojnë rolin e tyre dhe detyrën e tyre si udhëheqës, duhet të mendojnë se tok me guximin dhe vendosmërinë që do të tregojnë në punë dhe në luftë, duhet të kujdesen pak më shumë se deri tani për personin e tyre dhe për dëmin që i shkakton Partisë humbja e tyre. Roli i udhëheqësve s'është vetëm me luftue, por edhe me komandue. Është lehtë përnjë udhëheqës të vendosur të kalojë në ballin e çdo përpjekjeje dhe të vdesë trimërisht, por është zor të dish të komandosh.

Në lidhje me këtë ti posaçërisht duhet të kesh kujdesin më të madh, duhet të mendosh kurdoherë në fjalët e shokut tonë të madh Stalin «me e dhënë jetën për Partinë dhe gjakun pika-pika». Të mos mendosh ngshtë në rrethin ku të është caktuar detyra dhe në çdo moment të rrezikosh jetën ashtu si një partizan i thjeshtë. *Nuk të lejohet, veçse në momente ekstreme, kur rreziku është i madh dhe sakrifica e domosdoshme, të shkosh të rrezikohesh, nuk të lejohet më të shkosh në sulm përpara shokëve për të dhënë shembullin edhe atje ku s'duhet e ku prezenca jote s'është e nevojshme.* Vetëm kur brigada të jetë në rrezik të madh duhet të intervenosh personalisht, ndryshe nuk të lejohet të vësh veten në rrezik për gjëra që fare lehtë mund t'i rregu-

llojë një shok tjetër. Ky është një urdhër që të jepet dhe që duhet të zbatohet me përpikëri; në qoftë se veprohet ndryshe, do të jetë një mosbindje ndaj Partisë dhe Komitetit Qendror.

Jemi të bindur se e kuption rëndësinë e kësaj vërejtjeje, shkaqet që na shtynë të të shkruajmë dhe, si shok udhëheqës që je, do ta kuptosh rëndësinë e çështjes.

Më datën 5 maj 1944 është caktuar mbledhja e Komitetit Qendror, mbledhje e cila paraqitet urgjente përmes diskutue dhe me marrë vendime përpara evenimenteve që po rrrokullisen. Për këtë arësyje duhet të gjenëndesh patjetër në atë datë në qarkun e Korçës; më parë se të largohesh nga reparti, duhet të marrësh çdo masë dhe t'u japësh çdo udhëzim shokëve, që kështu mungesa jote të mos pengojë zhvillimin e luftës dhe të punës.

Të fala shoqërore
Për Komitetin Qendror të Partisë
Komuniste të Shqipërisë

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë, si pas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

**LETËR DREJTUAR SHOKUT MEHMET SHEHU NË
LIDHIJE ME RUAJTJEN E KUADROVE KRYESORE
POLITIKE DHE USHTARAKE**

14 prill 1944

**SHOKUT MEHMET SHEHU
KOMANDANT I BRIGADES I SULMUESE**

I dashur shok,

Duke parë zhvillimin e luftës, konstatojmë se një numër i madh shokësh udhëheqës politikë dhe ushtarakë na janë vrarë në përpjekje kundër okupatorit dhe tradhëtarëve. Me zgjerimin e punës dhe të luftës dhe duke marrë parasysh jetën e re të Partisë sonë, gjithashtu edhe elementin kuadër mjaft të ulët politikisht dhe ushtarakisht, këto humbje kanë qenë të ndjeshme për ne. Të shumtata e herës dhe në terrenet e ndryshme mungesa e kuadrove udhëheqëse ka qenë shkaku i dobësimit të punës dhe i moszgjerimit të luftës. Shokët udhëheqës politikë dhc ushtarakë kanë pasur kurdohërë kujdes të jatin shembullin e vendosjes ndaj Partisë dhe me guxim kanë qenë në ballin e luftës në vendet më të rrezikshme. Kjo u ka dhënë zemër shokëve dhe ushtri-

së, kjo ka ngritur lart emrin e Partisë sonë, por shokët kanë mënduar pak për ruajtjen e kuadrove të mira, kua-dro që do të ngrenë shokët e tjerë dhe do të udhëheqin punën dhe luftën. Në fillimin e mëkëmbjes së punës dhe të ushtrisë ishte dashur kjo sakrificë e dhimbshme për udhëheqësit ushtarakë dhe politikë të Partisë sonë, kjo do të duhet tani dhe kurdoherë, por shokët udhë-heqës duhet të kuptojnë rolin e tyre dhe detyrën si udhëheqës, duhet të mendojnë se tok me guximin dhe vendosmërinë që do të tregojnë në punë dhe në luftë, duhet të kujdesen pak më shumë se deri tani për personin e tyre dhe për dëmin që i shkakton Partisë humbja e tyre. Roli i udhëheqësve s'është vetëm me luftue, por edhe me komandue. Është lejtë për një shok udhë-heqës të vendosur të shkojë në vijat e para dhe të luftojë e të bjerë trimërisht, por është zor që të zëvendësohet.

Në lidhje me këtë ti posaçërisht duhet të kesh kujdesin më të madh, duhet të mendosh kurdoherë në fjalët e shokut tonë të madh Stalin «me e dhënë jetën për Partinë dhe gjakun pika-pika». Të mos mendosh ngshtë në rrethin ku të është ngarkuar detyra dhe në çdo moment të rrezikosh jetën si një partizan i thjeshtë. *Nuk të lejohet, veçse në momentet ekstreme, kur rreziku është i madh dhe sakrifica e domosdoshme, të shkosh të rrezikohesh, nuk të lejohet më të shkosh në sulm përrpara partizanëve për t'u dhënë shembullin këtyre atje ku prezenca jote s'është e domosdoshme.* Vetëm kur brigada të jetë në rrezik të madh duhet të intervenosh personalisht, ndryshe nuk të lejohet të vësh veten në rrezik për gjëra që fare lehtë mund t'i zgjidhë një shok

tjetër. Ky është një urdhër që të jepet dhe që duhet të zbatohet me përpikëri, në qoftë se veprohet ndryshe, do të jetë një mosbindje ndaj Partisë dhe ndaj Komitetit Qendror.

Jemi të bindur se e kuption rëndësinë e kësaj vërejtjeje, shkaqet që na shtynë të të shkruajmë dhe, si shok udhëheqës që je, do ta kuptosh rëndësinë e çështjes.

Të fala shoqërore
Për Komitetin Qendror të Partisë
Komuniste të Shqipërisë

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë, si pas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

**QARKORE NË LIDHJE ME VENDIMIN PËR
MBLEDHJEN E KONGRESIT I ANTIFASHIST
NACIONAL-ÇLIRIMTAR DHE ZGJEDHJET E
DELEGATËVE PËR NË KONGRES**

16 prill 1944

**GJITHË KOMITETEVE QARKORE TË PARTISE
KOMUNISTE TË SHQIPËRISË¹**

Të dashur shokë,

Përpara evenimenteve që rrokullisen me kaq shpejtësi, kur Ushtria e Kuqe heroike e udhëhequr me aq gjenialitet nga shoku ynë i adhurueshëm Stalin po i jep grushtet e vdekjes Gjermanisë hitleriane, kur ushtria e popujve të URSS-it me një sulm vendimtar dhe ngadhënjyes po marshon drejt Perëndimit, drejt zemrës së Gjermanisë, kur lëvizjet nacional-çlirimtare në gjithë Evropën po marrin një hov të madh, përpara zmadhimit dhe forcimit të Frontit dhe të Ushtrisë sonë Nacional-Çlirimtare, Partia jonë Komuniste ndodhet përballë

¹ Kjo qarkore u është drejtuar edhe seksioneve politike të brigadave të UNÇSH.

momenteve me rëndësi të madhe historike. Në çdo kthesë të luftës sonë heroike Partia jonë Komuniste, udhëheqësja e vërtetë e kësaj lufte çlirimtare, ka marrë vendime të guximshme, vendime që kanë ngjallur në zemrat e gjithë shqiptarëve dashurinë e thellë dhe respektin mië të madh për Partinë tonë kreshnike.

Partia jonë, shtylla e çelniktë e Luftës nacional-çlirimtare, ishte frysuesja dhe organizuesja e Konferencës së Pezës, ku u hodhën bazat e shëndosha të frontit, baza që u vaditën me gjakun më të kulluar të shokëve tanë trinia dhe të gjithë luftëtarëve të popullit shqiptar. Këshillat nacional-çlirimtare u krijuan në baza demokratike dhe u bënë pushteti i vërtetë popullor, që ndihmoi dhe ndihmon parreshtur Luftën nacional-çlirimtare. Lufta jonë ka arritur në një zhvillim aq të madh sa krahina të tëra kanë arritur të hidhen në kryengritje të përgjithshme; brigadat dhe batalionet tonë po forcohen dhe shumëzohen dita-ditës.

Në një situatë të këtillë paraqitet e nevojshme dhe urgjente mbledhja e Kongresit Antifashist Nacional-Çlirimtar, kongres ku të dërgohen përfaqësuesit e vërtetë të popullit në luftë kundër fashizmit. Kryesia e Këshillit Nacional-Çlirimtar në mbledhjen e saj të 15 prillit vendosi të mblidhet ky kongres me rëndësi të madhe në historinë e popullit tonë. Sikundër që e shënon dhe rezolucioni i Këshillit që po ju bashkangjitim e që do t'ju shërbejë për zgjedhjen e delegatëve, mbledhja e këtij kongresi ka një rëndësi të jashtëzakonshme. Nga ky kongres do të dalë Këshilli Antifashist Nacional-Çlirimtar dhe Komiteti Antifashist Nacional-Çlirimtar. Këshilli Antifashist Nacional-Çlirimtar dhe qeveria pro-

vizore, që do të dalin nga ky kongres, do të kenë një reperkusion të madh, si brenda ashtu dhe jashtë Shqipërisë. Këto do t'i japin një hov të madh luftës sonë dhe marrëdhënjet tona me aleatët do të forcohen.

Për këto arësyе gjithë shokët e Partisë duhet të vënë forcat e tyre që të sigurohet suksesi i plotë në këtë punë. Varet nga ne që të zgjidhen delegatë të provuar në luftë, në radhë të parë anëtarë të Partisë, simpatizantë dhe miq të luftës. Të derdhet nga ana e gjithë shokëve një aktivitet i jashtëzakonshëm si nga Partia ashtu edhe nga organizata e Rinisë Komuniste, dhe tok me këshillat nacional-çlirimtare të mobilizojnë gjithë popullin (në zonat e çliruara) dhe ky të marrë pjesë gjerësisht ndër mitingje. Të popullarizohet kongresi dhe të bëhet agitacion në shkallë të gjerë me anë mbledhjesh dhe konferencash si edhe me anë mitingjesh, ku të marrë pjesë dhe ushtria. Në këtë mënyrë populli, që do të mblidhet në mitingje për të zgjedhur delegatët, të jetë i preqatitur për këtë eveniment me kaq rëndësi. Në vendet e çliruara të popullarizohet kongresi me anë shtypi dhe afishesh, të cilat të mbulojnë muret e fshatrave e të qyteteve që mund të jenë çliruar.

Që të evitohen gabimet, duhet të këndohen me vërejtje rezolucioni dhe letrat përcjellëse nga ana e Kryesissë dhe shokët që bëjnë pjesë në këshilla të sqarojnë ndër anëtarët e këshillave brendinë e këtij rezolucioni, që kështu të sigurohet suksesi brenda afatit të caktuar. Nga ana tjetër anëtarët e Partisë dhe gjithë organizatat duhet të ndihmojnë me sigurinë më të madhe përcjelljen e delegatëve të vendeve të ndryshme për në zonat e lira. Çdo komitet qarkor të interesohet veçanërisht për dele-

gatët e vendeve, për të cilët ju bashkangjitet letra. Ju theksohet edhe një herë rëndësia e çështjes dhe nuk lejohet asnjë shmangje ose neglizhencë për këtë punë me kaq rëndësi.

Gjithë komitetet qarkore duhet të na dërgojnë listën e anëtarëve të Partisë në terren dhe në ushtri tok me karakteristikat e tyre. Të na dërgohet gjithashtu lista e shokëve që bëjnë pjesë në komitete të Partisë dhe të rinisë tok me karakteristikat e tyre. Ata qarkorë që na i kanë dërguar këto lista të kenë kujdes që çdo muaj të na jasin shënimë për ata anëtarë të rinj që hyjnë në Parti dhe për ata që përjashtohen si edhe për ndonjë vërejtje që mund të kenë për ndonjë anëtar partie.

Të fala shoqërore
Për Komitetin Qendror të Partisë
Komuniste të Shqipërisë

Enver Hoxha

*Botuar për herë të parë
në «Dokumenta kryesore
të PPSH», vëllimi I,
Tiranë 1960*

*Botohet sipas origjinalit, që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

**LETÉR DREJTUAR SHOKUT HÝSNI KAPO
MBI ZGJEDHJEN E DELEGATÈVE NGA
BRIGADA V SULMUESE PËR NË KONGRESIN I
ANTIFASHIST NACIONAL-ÇLIRIMTAR**

17 prill 1944

I dashur shok,

Ti sigurisht, sipas rezolucionit¹, ke ide të saktë se kush është më i përshtatshëm të marrë pjesë në kongres. Ata që do të zgjidhen nga brigadat duhet të përfaqësojnë shpirtin luftarak të partizanëve, duhet të jenë me të vërtetë përfaqësuesit e ushtrisë sonë trime, të jenë me të vërtetë shprehja e vullnetit të gjithë brigadës. Një pjesë e madhe e brigadës përbëhet nga të rinj, prandaj do të ketë delegatë edhe të rinisë dhe mundësisht edhe të gruas. Duhet marrë parasysh se ata që vijnë në kongres do të zgjedhin parlamentin, por janë njëkohësisht edhe ata që mund të zgjidhen, prandaj du-

¹ Është fjala për rezolucionin e Kryesisë të Këshillit të Përgjithshëm Nacional-Çlirimtar të 15 prillit 1944 «mbi zgjedhjen e delegatëve për në Kongresin Antifashist Nacional-Çlirimtar» (Shih: «Dokumenta të organeve të larta të pushtetit revolucionar nacional-çlirimtar», f. 121, Tiranë, 1962).

hen caktuar ata, të cilët nuk do të zgjidhen në terren, por që duhet të jenë përfaqësia ose deputetë të një krahine. Është mirë që të jetë dhe ndonjë partizan.

Ti do të vish pa marrë parasysh numrin që caktohet për delegatë, ju e dini mirë se kush mund të jetë i përshtatshëm, zgjedhja do të bëhet nga ana e partizanëve, por do të veprohet në mënyrë që të dalin ata për të cilët mendoni se është më mirë që të vijnë nga brigada.

Të fala shoqërore

Tara s

VDEKJE FASHIZMIT
LIRI POPULLIT

*Botohet për herë të parë, si-
pas origjinalit që gjendet në
Arkivin Qendror të Partisë*

**LETËR DREJTUAR ZEVENDËSKOMISARËVE
TË BRIGADAVE MBI DETYRAT NË TERRENET
KU KALON BRIGADA**

17 prill 1944

I dashur shok,

Sikurse është theksuar shpesh herë, detyrat që duhet të kryejë organizata e Partisë në ushtri janë të shumta. E gjejmë të nevojshme të theksojmë një nga këto detyra.

Me mobilizimin e gjerë të popullit, e sidomos të masave fshatare, një numër i mirë shokësh dhe përgjegjësish është hedhët në radhët e ushtrisë. Me ofensivat dhe me goditjet e shpejta e të shpeshta të armikut, shumë zona janë shkelur, reaksiuni ka përfituar, propaganda e tij helmatuese, vrasjet, terrori, frikësimet, kërcënimet e barbarizmat e okupatorit dhe të tradhëtarëve e kanë tronditur deri diku popullin. Për këto shkaqe dhe për të tjera, puna organizative, politike dhe ushtarake në terren ka mbetur mbrapa, sidomos ajo organizative. Prandaj organizata e Partisë në ushtri duhet të punojë në këtë drejtim; ushtria kudo që shkon, është përgjegjëse për punën që bën në terrenin ku ajo kalon ose

qëndron. Të gjithë komisarët, zëvendëskomisarët dhe të gjithë anëtarët e Partisë kanë përgjegjësi jo më pak për këtë punë se sa për punën e tyre që do të kryejnë në ushtri.

Si gjithë sektorët e punës që ka celula, puna në terren do të jetë një sektor i veçantë. Çdo anëtar partie duhet të punojë në këtë sektor. Ai do të raportojë në celulën e tij punën që ka bërë në terren dhe celula duhet të kërkojë llogari për këtë punë. Nuk duhet të ketë arësye të kota dhe justifikime; kudo që shkon ushtria, duhet të bëhen konferenca dhe mitingje, të bëhen mbledhje grupesh edukative, celulash, aktivesh rinie, të organizohen çeta e batalione territoriale, çeta e batalione pune nga të rinj e nga gra, të funksionojnë komandat, të forcohet pushteti, me një fjalë, organizata e Partisë në ushtri ka për punën në terren po atë përgjegjësi që ka organizata e terrenit.

Në qarqe ku shkon brigada, ju merruni vesh me shokët përgjegjës të terrenit për t'u vënë më mirë në dijeni të situatës dhe për të vepruar jo indipendentë, por në marrëveshje dhe në këshillim me ta. E dini fare mirë rëndësinë që ka zgjerimi i organizatës sonë në krahina të ndryshme me fshatarë të vendosur.

Prandaj është detyra juaj kryesore: të zgjeroni dhe të forconi organizatën në ato krahina dhe në ato qarqe ku janë bazat organizative dhe organizata është në këmbë; të ngrini në këmbë dhe të krijoni në themel të shëndosha organizatën në ato qarqe ku nga reaksioni ose nga mungesa e punës sonë nuk janë hedhur bazat organizative të Partisë.

Kjo detyrë të theksohet mirë dhe qartë në të gjithë

anëtarët e Partisë për çdo sektor pune dhe veçanërisht për këtë sektor të kërkohet llogari mbi punën që do të kryhet; asnjëherë të mos mungojë kontrolli i nevojshëm. Për kryerjen e kësaj detyre përgjegjësia të bie drejtpërdrejt ty, mbasi ti i shpie organizatës fjalën e Komitetit Qendror, ti ja bën të qartë vijën politike dhe direktivat e Komitetit Qendror, ti ngjall në organizatë ndjenjën e përgjegjësisë për zbatimin e kësaj vije.

Presim kurdoherë raporte të qarta mbi situatën në përgjithësi të asaj brigade dhe gjithmonë do të jemi pranë me ndihmën dhe me udhëzimet e duhura.

Të fala shoqërore
Për Komitetin Qendror të PKSH

[Enver Hoxha]

**VDEKJE FASHIZMIT
LIRI POPULLIT**

*Botohet për herë të parë, si-
pas origjinalit që gjendet në
Arkivin Qendror të Partisë*

**LETËR DREJTUAR SEKSIONIT POLITIK TË
BRIGADES I SULMUESE MBI EDUKIMIN
DHE KALITJEN IDEOPOLITIKE TË
KOMUNISTËVE E PARTIZANËVE**

22 prill 1944

**SEKSIONIT POLITIK TË BRIGADES I SULMUESE
(Shoqes Fiqret)**

Pas punës, ndihmës dhe udhëzimeve tuaja shihet se gjendja e brigadës është përmirësuar në çdo pikëpamje, sidomos përsa i përket lartësimit të kuadrove.

Thekson në raportin tënd se besimi është i madh te partizanët ndaj shtabit të brigadës, kjo është shumë mirë dhe mjaft pozitive, por kryesisht dhe veçanërisht duhet të ngjallim te partizanët dhe te anëtarët besimin dhe dashurinë e madhe për Partinë tonë e për Komitetin Qendror, që është udhëheqja e saj e urtë dhe e drejtë. Brigada juaj qëndron lart përsa u përket moralit, entuziazmit, vendosjes, por duhet të mos harrojmë se kuadrot e saj janë shumë të ulëta, mungojnë sidomos udhëheqësit politikë. Sot ushtria jonë po zgjerohet, brigadat po shtohen dhe kemi mjaft nevojë për kuadro, si politike

ashtu dhe ushtarake. Deri tani nuk kemi kërkuar, se e kemi ditur si ka qenë gjendja e kuadrove, por këtë e tutje presim prej jush që të veproni në mënyrë që ajo brigadë të na japë kuadrot më të mira, sidomos për organikat e batalioneve. Ju e dini mjaft mirë dhe nuk e gjejmë të nevojshme t'jua theksojmë rëndësinë e madhe që ka ngritja e kuadrove. Varet nga puna juaj që të forcohet organizata në brigadë, që prej atyre partizanëve të forcuar nga mundimet, nga vuajtjet, nga uria, nga lufta, të dalin anëtarët më të mirë të Partisë sonë.

Për çështjen e kursit keni vepruar mirë me rastin e grumbullimit të brigadës; në ndarjen e temave nuk keni vepruar mirë, sepse të gjithë shokët që kanë qenë në kurs duhet të merrnin tema për të paraqitur e jo vetëm Fiqreti¹ dhe Sadiku²; Dhori³ e sidomos Atleti⁴ do të ishte mirë që të paraqitnin diçka mbi rininë dhe ndonjë temë tjeter. Shkruan për grumbullimin e brigadës përsëri, por kjo nuk mund të bëhet, duhet të humbasin të paktën 10 ditë për këtë grumbullim. Mbledhja përsëri të bëhet vetëm atëherë kur ju afron detyra ushtarake.

Në raportin tënd shihet se anëtarët e Partisë janë shtuar, ky është një sukses, vetëm duhet pasur kujdes që të rekrutohen me një kriter të shëndoshë, nuk duhet të shkohet në të dy ekstremet.

Për temat e ndryshme që bisedoni në konferanca

¹ Fiqret Sanxhaktari (Shehu)

² Sadik Bocaj

³ Dhori Panariti.

⁴ Pseudonimi i shokut Mihal Prifti.

dhe në orët e mësimit, theksoni mirë para gjithë partizanëve luftën tonë, e cila nuk do të vazhdojë vetëm derisa të shkatërrohet fashizmi, por derisa t'i japim popullit qeverinë popullore demokratike. Theksoni mirë çështjen e dashurisë në mes të partizanëve e partizaneve. Dashuria është e lirë, por të edukohen në drejtim që të ketë baza të shëndosha. Qëndrimi duhet të jetë serioz, pajtimi i plotë midis dy palëve; të theksohen se nuk është asgjë e jashtnatyrshme ose për t'u kritikuar në qoftë se shihet një atrim midis dy palëve, në çdo rast duhet të jeni vetë në gjendje t'i zgjidhni këto çështje dhe mos u influenconi nga asnjë mendim i jashtëm.

Pelivani¹ dezertoi. Këtë e kuptioni dhe ju vetë përse ndodh. Duhet edukatë e fortë, të ngjallet besimi në fitoren e fundit, të ngjallet besimi në sukseset e Partisë dhe në pathyeshmërinë e Partisë. Duhet të dalloni kur dezertojnë elementë të rinj ose partizanë të tërhequr nga të tjerë, kur dezertojnë ata që kanë qenë për 6 muaj rrësht në atë organizatë anëtarë. Vihet re se nuk është kontrolli dhe kujdesi i duhur për anëtarët dhe për ata që tregojnë shenja të këtilla. Pelivani dhe më parë ka qënë i dyshimtë dhe prandaj është faji i organizatës që ai përfundoi në këtë mënyrë. Duhet kujdes më i madh dhe ndihmë më e madhe për anëtarët, qëndrimi me kuadrot të jetë i mirë dhe shoqëror, por dhe i rreptë kur ta dojë puna. T'u jepet dora dhe përkrahja atyre që kanë nevojë e t'u tregohet vendi i duhur atyre që,

¹ Villas Arapi, një nga pjesëtarët kryesorë të fraksionit të Sadik Premtes në Vlorë. Pas dezertimit nga UNÇSH u bashkua me «Ballin Kombëtar» dhe me pushtuesit gjermanë.

me gjithë ndihmën e përkrahjen tuaj, mbajnë një qëndrim jo të mirë.

Keni nevojë për teknikë dhe për mjete, keni të drejtë, por do të rregulloheni me këto që keni, derisa të vijnë të tjerat. Akoma shaptilografi nuk ka ardhur, për këtë po interesohemi dhe ne.

Agjit-propi duhet të punojë, por ju duhet ta ndihmoni dhe ta udhëzoni, çdo gjë do të kalojë nga dora juaj. Shokët mundet të jenë të rinj dhe nuk dinë të punojnë e ju do t'i udhëzoni, por me gjithë mungesat përsëri ju keni bërë diçka.

Me italianët është një iniciativë e mirë që ka treguar shoku Todi¹, me këta duhet punuar mirë dhe vazhdimi shërbim edhe politikisht edhe në pikëpamje organizative.

Disa ditë më parë dërguam një udhëzim përsa i përket punës që duhet të bëjë organizata e Partisë në terren e prandaj për këtë nuk po e përsëritim. Jemi të sigurt se do të punoni në këtë drejtim dhe do t'u jepni një ndihmë të madhe organizatave të ndryshme të terreneve.

Të fala shoqërore
Për Komitetin Qendror

[Enver Hoxha]

Botohet për herë të parë, si pas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

¹ Todi Naço.

**LETËR DREJTUAR ZËVENDËSKOMISARËVE TË
BRIGADAVE MBI NGRITJEN IDEOLOGJIKE TË
KOMUNISTËVE NË USHTRI DHE MBI
ORGANIZIMIN E PUNËS POLITIKE ME
RASTIN E 1 MAJIT**

24 prill 1944

I dashur shok,

Po ju dërgojmë artikullin e shokut Stalin mbi «Bolshevizimin e Partisë»¹ dhe broshurën mbi «Kuadrot» të shokut Dimitrov². Më parë duhet t'i punosh ti bashkë me seksionin politik; i përtypni mirë dhe pastaj i punoni në byro e në celula. Të shumohen menjëherë, qoftë dhe me maqinë, në rast se mungon poligrafi; duhet të ketë të paktën nga një kopje çdo celulë.

Me rastin e ditës së 1 Majit duhet të bëhen konferenca të gjera ndër partizanë dhe në popull, në këto konferenca do të theksoni: rëndësinë e datës 1 Maj, si festa e punëtorëve të gjithë botës, situatën në të cilën

¹ Pjesë nga biseda e J. V. Stalinit me anëtarin e PK të Gjermanisë Hercog «Mbi perspektivat e PKGj dhe mbi bolshevizimin». J. V. Stalin, Veprat, vëll. 7, f. 38-40.

² Paragrafi i fundit i fjalës së mbylljes në Kongresin e shtatë të Internacionales Komuniste, gusht 1935. Gj. Dimitrov. Vepra të zgjedhura vëll. I, f. 473-482 (bot. rusisht).

na gjen kjo festë, fitoret e Ushtrisë së Kuqe nën udhëheqjen e shokut të madh Stalin, ku ndodhet proletariati i gjithë botës, ku ndodhet lëvizja nacional-çirimtare në botë e në Ballkan, vëllazërimi i popujve të Ballkanit, ku ndodhet e ku ka arritur lëvizja n.-çl. në Shqipëri. Konferencat mund të vazhdojnë dhe disa ditë pas datës 1 Maj, duke pasur këtë qëllim.

Vihet re se partizanë, bile dhe anëtarë partie, dezertojnë nga brigadat e kjo më tepër në raste reaksi. Kjo vjen se nuk janë të lidhur ngushtë me luftën tonë dhe me Partinë, nuk janë të sigurt në fitore dhe se e kanë humbur perspektivën. Këtu shihet mungesa e organizatës: nuk është punuar në këtë drejtim, nuk është mbajtur qëndrimi i duhur dhe i ashper, kur kanë dhënë shenja për dyshim, ose nga moskontrolli i duhur nuk janë parë fare këto shenja. Nuk bëhen rekrutimet me kriterin e duhur. Porositeni që t'u shpjegoni gjithë partizanëve nëpërmjet konferencave, grupeve edukative, që lufta e tyre nuk mbaron vetëm me shkatërrimin e fašizmit, por atëhere kur t'i japim popullit qeverinë e vërtetë popullore demokratike, lirinë e tij të plotë.

Të kemi dërguar një letër, ku shkruajmë mbi punën që duhet të bëjë organizata e Partisë në terren¹, besojmë të keni vepruar sipas asaj letre, d.m.th. *kudo që kalon brigada nëpër terrene të ndryshme ku ekziston organizata e Partisë duhet kjo të ndihmohet prej organizatës së ushtrisë* (kur nevojitet ndonjë këshillë ose udhëzim

¹ Është fjala për letrën c KQ të PKSH të datës 17 prill 1944, drejtuar zëvendëskomisarëve të brigadave. (Shih në këtë vëllim. f. 141).

nga eksperienca juaj luftarake). Në vendet ku nuk ekziston organizata si detyrë duhet të krijoni grupe edukative, celula etj. Në rast largimi duhet t'i lidhni me qarkun përkatës (më të afërt). Por këtë nuk duhet ta kuptoni në mënyrë sikur ju keni të drejtë të ndërhyjni në organizatë dhe të kontrolloni punën, do të ndërhyjni vetëm atëherë, kur ju kërkohet ndihmë nga ana e organizatës. Sa për agitacion e propagandë është detyra e çdo partizani dhe pa fjalë e çdo anëtar i Partisë.

Në lidhje me këtë detyrë që ka organizata duhet të mësohen gjithë shokët si punohet më këshillat, me komandat e me çdo punë tjetër.

Presim të na dërgoni me korrierët më të parë gjithë emrat e komisarëve dhe të zëvendëskomisarëve dhe emrat e gjithë anëtarëve të Partisë, të gjitha karakteristikat: vjetërsia në Parti, mosha, vendlindja, përgjegjësia në Parti, origjina e profesioni privat, ndonjë aftësi ose prirje e veçantë, gjithashtu dhe vërejtjet e tua mbi çdonjërin, p.sh. i vendosur, i lartësuar politikisht, mundësi zhvillimi etj.

Duhet të na dërgoni dy kopje nga revista juaj, e cila do të dalë sigurisht në rregull. Mbi këto udhëzime vini në dijeni dhe seksionin politik.

Të fala shoqërore
Për Komitetin Qendror të PKSH
[Enver Hoxha]

VDEKJE FASHIZMIT
LIRI POPULLIT

Botohet për herë të parë, si pas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

UDHËZIME MBI FUNKSIONIMIN DHE DETYRAT E ORGANIZATAAVE TË PARTISË NË USHTRINË NACIONAL-ÇLIRIMTARE

[Prill 1944]

GJITHE ZËVENDËSKOMISARËVE TË BRIGADAVE, GRUPEVE E BATALIONEVE SI DHE SEKSIONEVE POLITIKE

Partia jonë, me qëndrimin e drejtë në luftë, me punën e saj organizative e politike, ka mundur të krijojë një ushtri të rregullt. Që kjo ushtri të jetë e fortë për të përballuar çdo vështirësi, çdo reaksion dhe të mos lëkundet nga asnjë propagandë e armikut, që të pregetitet për t'u lidhur gjithmonë më ngushtë me Partinë tonë dhe që të jetë forca vendimtare për realizimin e qëllimeve tona, duhet të bëhet sa më shumë punë politike dhe organizative; duhen pasur organizata partie të forta me kuadro partie besnike, të dhëna e të afta me udhëheqë lëvizjen nacional-çlirimtare. Kështu, duke pasur organizatat të forta, do ta kemi dhe ushtrinë të fortë; kështu do të shfaqet roli udhëheqës i Partisë sonë si parti e vetme politike, që i ka treguar popullit rrugën e drejtë dhe që i prin sot me sukses në luftë.

Me zgjerimin e Luftës nacional-çlirimtare, me kri-

jimin e konditave të reja, organizatacave tona në ushtri u hapet një fushë e gjerë veprimi dhe u paraqiten detyra të reja. Organizatat në ushtri dhe anëtarët duhet të realizojnë rolin udhëheqës të Partisë, duhet të punojnë për lartësimin dhe vetëdijen politike të luftëtarëve, duhet të preqatitin një ushtri të fortë, të çelnikjtë dhe të vendosur. Në broshurën «Ushtria Nacional-Çlirimtare»¹ është paraqitur mënyra e punimit të Partisë në ushtri. Por janë bërë disa gabime nga mungesa e eksperiencës, prandaj e gjemjë të nevojshme të bëjmë disa plotësime dhe të paraqitim në mënyrë të qartë punën e Partisë në njësitë ushtarake që të mos përsëriten më gabimet dhe shokët të orientohen mirë në zbatimin e detyrave të tyre.

Kanë qenë disa moskuptime që e kanë penguar punën:

1) Nuk është kuptuar mirë roli udhëheqës që duhet të ketë Partia në ushtri.

a — Nuk është kuptuar mirë se komisarët politikë janë delegatë të Partisë, të cilët përpara popullit, dhe përpara njësisë ushtarake do të mbrojnë vijën e caktuar nga Partia jonë ndaj Luftës nacional-çlirimtare. Komisari politik bën pjesë në celulën e shtabit. Ky për të kryer plotësisht rolin e tij do të ketë përkrahjen e celulës në të cilën bën pjesë dhe me ndihmën e së cilës ai do të kryejë detyrën. Ky nuk mund të veprojë në emër të celulës ose të forumit përgjegjës pa marrë udhëzime dhe direktiva nga këto.

¹ Referat i mbajtur në Konferencën e parë të Vendit të PKSH.

b— Nuk është kuptuar roli udhëheqës që duhet të ketë celula, byroja në batalion dhe forumet e tjera udhëheqëse të Partisë në njësitë më të mëdha dhe marrëdhënja e tyre me shtabet përkatëse.

c— Nuk është kuptuar mirë qëndrimi që duhet të kenë të gjithë anëtarët e Partisë në çetë. Këta duhet të dallohen nga të gjithë luftëtarët e tjerë, duhet të jenë shembull i trimërisë dhe i vendosjes. Me trimërinë, me vendosjen dhe me diturinë e tyre do të lartësojnë moralin e luftëtarëve dhe në konditat më të vështira nuk do të lejojnë demoralizimin dhe shpërndarjen e ushtrisë. Duhet të kujdesen më parë për partizanët pastaj përveten e tyre. Duhet të jenë shembull i durimit përpara çdo vuajtjeje, përpara urisë, lodhjes, reaksionit etj. Kur partizanët janë në një gjendje të vështirë, kur janë të plagosur, anëtarët e Partisë do të jenë të parët për t'u ardhur në ndihmë. Këta duhet të kenë marrëdhënje të ngushta dhe shoqërore me partizanët. Moskujdesia, kapadaillëku, arroganca i pengojnë këto lidhje dhe e bëjnë të zorshme dashurinë e luftëtarëve për ta. Vetëm duke vepruar kështu do të fitojnë dashurinë dhe besimin e partizanëve ndaj tyre, do të dallohen nga gjithë luftëtarët e tjerë. Mbi gjithë të tjerët do të jetë komisari politik, ai do të ketë cilësitë e sipërme, për të shoku Stalin ka thënë: «Komisari është udhëheqësi moral e politik i repartit të tij, mbrojtës i parë i interesave morale e shpirtërore... Komisari duhet të jetë babai e shpirti i repartit të tij».¹

1 Shih: «Josif Visarionoviç Stalin». Biografi e shkurtër Tiranë 1945, f. 41.

2) Nuk është kuptuar rëndësia e madhe që ka kryerja e punës politike dhe organizative në ushtri.

Duhet të kemi gjithmonë parasysh dhe të ruajmë që vija ushtarake mos të dalë mbi atë të Partisë, d.m.th. anëtarët e Partisë që kanë përgjegjësi ushtarake në njësinë, nuk duhet të kryejnë vetëm atë detyrë dhe të lënë pas dore detyrat e tyre të Partisë. Ndodh shpeshherë që disa njësi ushtarake si të tilla janë shumë të mira, por neglizhojnë anën politike të punës, luftëtarët zhvillohen vetëm nga një anë, ushtarakisht. Kjo gjë do të shkaktojë që në disa situata të vështira (si mossuksese në luftë, lodhje, mungesë ushqimi) propaganda e armikut ose e shpirtvegjelvë të sjellë rezultate të këqia.

3) Nuk është kuptuar rëndësia që ka kryerja e punës me plan.

Duhet që çdo punë të kryhet me një plan të caktuar; celula, byroja (krejt brigada), do të caktojnë planin që duhet të plotësohet nga mbledhja në mbledhje ose për një kohë më të gjatë. Në krejt njësinë (në kompani, batalion ose brigadë) duhet që puna të vazhdohet harmonikisht në çdo sektor dhe në çdo pjesë të njësisë, p.sh. nuk duhet të shkojë përpara puna në rini dhe të mbetet pas dore ajo politike ose në një batalion të shkojë puna shumë përpara dhe në një tjetër jo. Po të punohet me një plan të përbashkët, (në krejt njësinë do të punohet po një temë, do të rrihen po ato çështje, do të shpjegohet po një lëndë edukative etj.), atëhere realizohet uniteti i vërtetë në njësinë ushtarake.

Nuk është punuar me një plan të afërt ose të largët. Puna me plan do të shtojë aktivitetin e anëtarëve, do të forcojë kontrollin në punë, do të sigurojë zbatimin e

përpiktë të direktivave dhe të udhëzimeve të Partisë e të forumeve përkatëse.

Përveç moskuptimeve që kanë qenë, janë bërë edhe disa gabime në punë.

Shpesh organizatat kanë qenë sektare në rekrutimin e anëtarëve. Lufta jonë, puna në situata të vështira dhe përpjekjet e vazhdueshme duhet të na kenë dhënë një kriter në rekrutimin e anëtarëve. Nuk duhet të kemi frikë të futim në Parti ata që janë me të vërtetë një garanci për ne, por nuk janë të lartësuar ose kanë disa të meta. Këta elementë do të lartësohen me punën tonë, do të përmirësohen me edukatën tonë. Organizatat tona në ushtri do të mbeten të dobëta në rast se do të mungojë puna organizative dhe nuk do të punohet në mënyrë që të rekrutohen elementë të dalë nga lufta dhe të lartësohen këta në çdo pikëpamje.

Në disa njësi ushtarake (brigada) përgjegjësa celule kanë qenë komisarët politikë të kompanive dhe kjo jo pse mungonin anëtarët e tjerë, por sepse komisari politik ishte shoku më i mirë dhe më i preqatitur. Kjo ka bërë që puna organizative të mos shkojë shumë përpara, sepse komisari politik ka shumë përgjegjësi dhe nuk mund t'i kryejë të gjitha siç duhet, gjithashtu kjo ka penguar që të ngrihen dhe të tjerë anëtarë dhe të fitojnë eksperiencë në punë. Edhe shokët e rinj, me gjithëse nuk dinë të punojnë, duhet t'i ngarkojmë me përgjegjësi dhe t'i udhëzojmë si të punojnë.

Janë bërë dhe disa lëshime, të cilat me sqarimet që do të japim dhe me një aktivitet më të madh të shokëve, nuk do të përsëriten më. Të tillë janë sidomos mbledhja jo në rregull e celulave, moslartësimi i duhur

i anëtarëve të Partisë, mungesa e kontrollit në kryerjen e detyrës etj.

Që të shkojë përpara puna organizative dhe ushtarake duhet celulat e shtabeve të dinë detyrat e tyre dhë marrëdhënjet që kanë me shtabet përkatëse.

Celula e shtabit. — Në celulën e shtabit bëjnë pjesë: komandanti, zëvendëskomandanti, komisari, zëvendëskomisari, intendenti, përgjegjësi i agjit-propit, oficeri operativ, përgjegjësi i sanitetit, oficeri i informative, por kjo nuk duhet të kuptohet në mënyrë të prerë. Nuk futen në celulë intendentë ose të tjerë në qoftë se nuk janë në atë lartësi për të qenë anëtarë të celulës së shtabit, p.sh. kur janë anëtarë të futur rishtas në Parti ose edhe kur janë të vjetër, por nuk janë në gjendje të ndihmojnë punën e celulës së shtabit, por përkundrazi e pengojnë.

Partia ose forumi superior i Partisë direktivat, udhëzimet e Partisë etj. i zbaton nëpërmjet të celulës në shtab. Për punën e tyre në vijën ushtarake, anëtarët e shtabit janë përgjegjës para komandës ushtarake më të lartë. Por anëtarët e shtabit që janë edhe anëtarë partie për gjithë punën e tyre janë përgjegjës edhe përpara Partisë. Në qoftë se në atë njësi ka funksionarë të Partisë (delegatë të Komitetit Qendror) këta marrin pjesë në celulën e shtabit kur ta gjejnë më të nevojshme. Në këtë rast do të jetë ky që do të japë vijën e Partisë. Shokët, anëtarë të shtabit, duhet të dinë se në celulë janë vetëm anëtarë të thjeshtë. Janë përgjegjës për punën e tyre përpara celulës, janë të detyruar të jenë të gjithë të disiplinuar dhe duhet të dinë se pa pëlqimin dhe dijeninë e celulës, nuk mundet të veprojnë.

Anëtarët duhet të tregojnë karshi komandantit dhe komisarit nderimin e duhur të një ushtari të thjeshtë. Të gjitha urdhërat e komandantit dhe të komisarit shokët do t'i zbatojnë në mënyrë kategorike. Komandanti dhe komisari në celulë janë anëtarë të thjeshtë, zëvendëskomisari është anëtar i thjeshtë në njësinë. Kjo është marrëdhënja e drejtë ndërmjet shtabit dhe celulës, e kjo duhet të kuptohet mirë.

Vihet re se shumë shokë kujtojnë se shtabit nuk është e nevojshme, por kjo pikëpamje është e gabuar. Shokët anëtarë të shtabit duhet të mësohen ta shikojnë jetën e batalionit dhe të shtabit në prizmin e Partisë dhe kanë nevojë të domosdoshme për lartësimin e tyre teorik e politik.

Detyra e celulës është të interesohet që të zhvillojë iniciativën në shtab, përsa i përket çështjes së aksioneve. Është detyra e shokëve të Partisë që ta pregaftin udhëheqjen e shtabeve të jetë e zonja për luftë, të jetë shembull i guximit dhe i disiplinës. Është detyrë e celulës që të ngrejë e të forcojë autoritetin e shtabit dhe të anëtarëye të tij.

Në celulën e shtabit punohet si në çdo celulë tjetër partie dhe duhet sidomos kujdes që të ngrihen nga çdo pikëpamje anëtarët e celulës. Në celulën e shtabit çdo shok ka një sektor pune, p.sh. komisari ka përsipër zbatimin e vijës politike dhe ngritjen politike në përgjithësi, intendanti merret me çështjet e ushqimeve etj. Për zbatimin e punës në sektorin e tyre bëjnë raportin në celulë dhe japid llogari për punën e tyre. Të gjithë anëtarët e celulës duhet të bëjnë kritikën e autokritikën e punës së tyre që ka të bëjë me mbarëvajtjen e punës së

Partisë. Të gjitha propozimet rrreth punës së organizatës së Partisë në batalion kjo celulë i jep nëpërmjet byrosë së Partisë (zëvendëskomisarit të batalionit), në brigadë nëpërmjet të zëvendëskomisarit të brigadës. Në mbledhjen e celulës i caktohet puna çdonjërit dhe në mbledhjen tjetër i kërkohet llogari për punën e kryer. Përsa u përket planeve ushtarake, këto bisedohen veç prej komandës operuese. Për zbatimin e planit të caktuar jepet raporti në mbledhjen e celulës.

Shokët anëtarë të shtabit, para se të marrin ndonjë masë, duhet ta diskutojnë më parë këtë në celulë. Të gjithë anëtarët e celulës duhet të përkrahin mendimin dhe vendimin e shtabit, se ky është njëkohësisht dhe mendimi i tyre. Po të mos veprohet kështu, do të përfundojë që shtabi të mos mund të zbatojë masat e marrura, që të prishet uniteti i punës në mes të celulës dhe shtabit dhe që të mos realizohet roli udhëheqës i Partisë. Një lidhje e këtillë ndërmjet masave që merr shtabi dhe celulës është sidomos e domosdoshme kur ka elementë fraksionistë, kur janë influenca të huaja, ndaj të cilëve celula e Partisë mund të caktojë qëndrimin e duhur.

Organizata e Partisë në njësi nuk mund të bëhet tutore e shtabit. Raporti duhet të jetë i atillë që Partia të jetë me të vërtetë udhëheqëse, por kjo gjë të mos guxojë të cenojë autonominë dhe iniciativën e komandës ushtarake, por vetëm të sigurojë zbatimin e direktivave të Partisë; nga ana tjetër komanda ushtarake të ketë mbështetjen dhe ndihmën e sigurt për të gjitha çështjet te organizatat e Partisë si te faktori udhëheqës i Luftës nacional-çlirimtare.

Që të mund të realizohet roli i Partisë në çetë duhet që të ndihmohet puna e celulës, duhet të zhvillohet pa pushimjeta e Partisë, e kjo arrihet vetëm me organizimin e drejtë e të fortë të celulës komuniste.

Celula e Partisë. — Të gjithë anëtarët e Partisë në një çetë formojnë një celulë, kjo është njësia e Partisë në ushtri, një çetë — një celulë. Në qoftë se ka shumë anëtarë partie, celula mund të ndahet në grupe, por këto prapë mbeten të një celule dhe udhëheqës kanë po atë përgjegjës (grupet mund të formohen sipas toga-ve e kjo ndodh kur kompania ka një numër të madh luftëtarësh).

Puna e celulës duhet të organizohet sipas sektorëve të punës së Partisë dhe në mënyrë që për çdo sektor të caktohet një shok përgjegjës që organizon punën në atë sektor e përgjegjet para celulës për sukseset ose mos-sukseset. Nuk duhet të ketë specializim në punë, por të gjithë shokët duhet të punojnë në të gjithë sektorët e të fitojnë kështu eksperiencën e çdo pune partie. Puna e celulës duhet të organizohet gjithmonë duke patur parasysh perspektivën e zhvillimin e punës në sektorët e caktuar, duke llogaritur që puna të zhvillohet në mënyrë harmonike nga të gjithë sektorët.

Puna organizative. — Të gjithë luftëtarët do të organizohen në grupe të ndryshme. E gjithë kompania duhet të jetë një grup edukativ, por meqenëse kjo është pak e zorshme, formohen dy ose më shumë grupe të Partisë (edukative), për edukimin e të cilave caktohet një shok përgjegjës në celulë për këtë punë; në qoftë se ky nuk ka mundësi ta kryejë këtë detyrë vetëm, caktohen më shumë. Me luftëtarët më të mirë dhe me ata

që mund të bëhen më shpejt anëtarë partie punohet në mënyrë individuale, këta edukohen prej një ose më shumë shokëve të celulës, sipas mundësive dhe si të gjendet më e arësyeshme nga celula. Kur celula bën mbledhjen edukative, atëherë është mirë që të marrin pjesë edhe kandidatët e Partisë, por kjo të kuptohet mirë dhe jo të merret një numër i madh luftëtarësh në mbledhjen edukative të celulës.

Kur nuk ka celulë në kompani duhet të përpinqemi që të krijohet kjo sa më parë.

Në punën organizative çështja kryesore është që njësia të jetë krejt e organizuar. Çdo luftëtar duhet të marrë pjesë në ndonjë grup në qoftë se nuk është anëtar partie. Kur nuk ka celulë në kompani, atëherë merren ata luftëtarë që mund të bëhen më shpejt anëtarë partie dhe formohet një grup kandidatësh, çdonjërit i caktohet përgjegjësia e një sektori pune. Duhet të punohet shumë përlartësimin e tyre politik dhe teorik. Kur të jenë preqitit përanëtarë partie atëherë transformohet grupei në celulë e nuk është nevoja të krijohet një grup tjetër, sepse do të mbetet si një celulë e dytë pranë celulës kryesore.

Në punën individuale duhet të mos harrohet që të punohet me të vjetërit, me ata të cilët nuk bëjnë pjesë as në grupet e rinisë dhe as në të Partisë. Këta kërkojnë një sjellje të veçantë dhe mënyra edukimi të ndryshme. Me këta duhet të shpjegohet situata politike në mënyrë të thjeshtë, të punohen disa artikuj, ata më aktualët dhe ata që u përshtaten më shumë atyre. Me anëtarët e grupave edukative, dhe sidomos me kandidatët, duhet të zhvillohet një punë intensive politike dhe edukative,

në mënyrë që këta të lidhen sa më ngushtë me Partinë tonë, të ngjallet në ta dhe të forcohet besimi dhe dashuria ndaj Partisë. Në punën e celulës bëhet kritika dhe autokritika. Jo vetëm kritika e punës, por edhe ajo e qëndrimit dhe e jetës personale të çdo anëtari, të veticë të mira ose të të metave të tij, se vetëm kështu zhvillohet përgjegjësia e plotë e anëtarëve karshi Partisë.

Në mjaft njësi si batalione e brigada, ku ka luftëtarë të mirë e të vendosur, ka një numër fare të paktë anëtarësh partie. Këtu shihet mungesa e punës sonë organizative dhe pikëpamja sektare në rekrutimin e anëtarëve. Nuk duhet të jemi sektarë, por të jemi të guximshëm në rekrutimin e anëtarëve të rinj në Parti; nuk duhet të mendojmë se duke futur shumë në Parti do ta dobësojmë këtë. Partinë e dobësojmë nga puna jonë e paktë dhe e paorganizuar. Por nga ana tjetër nuk duhet të mendojmë se do t'i hapim dyert e Partisë nga të dy anët dhe të futim këdo. Duhet të rekrutojmë me një kriter të caktuar: të futim në Parti punëtorë, fshatarë, intelektualë të shëndoshë, të ndershëm e luftëtarë, elementë të vendosur, që e duan Partinë, që janë punëtorë dhe që kanë mundësi të shkojnë përpëra etj. Organizatat i kemi të dobëta, sepse nuk kemi rekrutuar me kriter dhe ata që i kemi futur, nuk jemi përpjekur t'i lartësojmë.

Bëhen disa përjashtime pa vend. Anëtarët për të metat, për gabimet e tyre kritikohen, u hiqet vërejtja, këshillohen dhe bëhet çmos për përmirësimin e tyre; kur janë të pandërgjegjshëm atëherë përjashtohen. Përjashtimet e shumta, dezertimet etj. tregojnë mungesën e punës sonë organizative dhe moszgjuarësi në punë.

Duhet kujdes i madh që të spastrohen radhët e

Partisë. Nuk duhet të ketë vend në celula, në ushtri për elementë fraksionistë, inaktivë, të dyshimtë dhe sidomos frikacakë. Spastrimi i radhëve e forcon Partinë.

Puna me rininë. — Në celulë caktohet një shok, i cili ka për detyrë të udhëzojë, të ndihmojë punën e rinisë, ka për detyrë të zbatojë vijën e Partisë në rini dhe për këtë është përgjegjës para celulës. Në një çetë ka vetëm një aktiv, që drejtohet prej një përgjegjësi, i cili është një i ri komunist që ka eksperiencë në punën e rinisë ose anëtar i Partisë, përgjegjës i rinisë në celulë. Përgjegjësi i aktivit, qoftë i ri komunist, qoftë anëtar i Partisë, udhëzohet prej komitetit të rinisë në batalion dhe i jep llogari komitetit për punën e tij që ka kryer. Anëtari i Partisë, përgjegjës i rinisë, raporton punën e tij që bën me rininë në celulë. Aktivi i rinisë është një-kohësisht dhe grup edukativ, por kur ka mundësi është mirë që të bëhen dy ose më shumë grupe edukative. Për edukimin e këtyre të rinjve kujdeset komiteti i rinisë në batalion dhe ndihmohet për këtë punë nga celula. Rinisë duhet t'i jepen mundësitë për t'u lartësuar, për t'u pajisur me njojuritë marksiste-leniniste etj. Rinia Komuniste në ushtri, duhet të punojë gjithashtu në prapavijat me të rinj duke organizuar bashkimin e të rinjve, çetate punës, mobilizimin e të rinjve, duke krijuar çeta të ndryshme etj. Ajo duhet të ndihmojë dhe në punë organizative, duke formuar organizatat e Rinisë Komuniste, në rast se kjo nevojë paraqitet nga organizatat e qarqeve.

Komititetet e rinivë. — E gjithë rinia komuniste që është në çetë duhet të organizohet; për këtë arësy është nevoja të krijuhen komitetet e rinisë. Këto formohen prej shokëve që kanë më shumë eksperiencë në

punën e rinisë (do të jenë në gjendje të udhëzojnë më mirë ata shokë, të cilët kanë qenë në terren anëtarë komiteti qarkor të rinisë; këta mund të jenë anëtarë të komiteteve të rinisë edhe në qoftë se kanë ndonjë përgjegjësi ushtarake: komisar dhe zëvendës; ky është një rast i rrallë). Komitetet e rinisë megjithëse do të kenë iniciativë të plotë në punën e tyre, do të udhëzohen dhe do të udhëhiqen nga forumet e Partisë e do të jepin llogari për punën para tyre. Anëtarët e komitetit kanë lidhje direkte me përgjegjësit e aktiveve dhe me edukatorët e grupeve të rinisë, të cilët i udhëzojnë në punë dhe i kërkojnë raportin e punës. Megjithëse formohen komitetet e rinisë do të jetë përsëri përgjegjësi i rinisë në byronë e Partisë. Përgjegjësi i rinisë në byronë e batalionit merr pjesë në komitetin e rinisë. Komiteti i rinisë ka lidhje dhe merr udhëzime nga zëvendëskomisari i batalionit (të kuptohet që kjo është një lidhje dhe udhëzim indirekt). Komitetet e rinisë të batalioneve udhëzohen dhe kanë lidhje direkte me komitetin e rinisë në brigadë.

Puna politike, kulturalo-arësimore. — Siç u theksua edhe më lart, nuk është punuar si duhet për lartësimin e luftëtarëve si edhe të kuadrove të Partisë. Për këtë arësysh përpjekja ka ndodhur që në situata të vështira kanë dezertuar partizanë, gjithashtu dhe anëtarë partie nuk kanë mbajtur qëndrimin e duhur. Anëtarë partie disa herë nuk kanë mbajtur qëndrim politik të drejtë. Për këto e për të tjera raste është e domosdoshme në çetë puna politike kulturalo-arësimore, e cila ka për qëllim të shtojë dijenitë e përgjithshme dhe vetëdijen politike të luftëtarëve dhe me këtë të ndërtohet uniteti i fortë moral e politik i njësisë. Nga realizimi i unitetit

politik dhe moral varet dhe aftësia e uniteti luftarak; pse njësia, pa realizimin e unitetit moral e politik, nuk do t'u përgjigjet dhe detyrave të veta në pikëpamje ushtarake. Celula, pra, duhet t'i japë rëndësi këtij sektori pune, duhet të zhvillojë një punë intensive politike — punën kulturale duhet ta zbatojë Rinia Komuniste, duke i dhënë rinisë mundësinë që të zhvillojë iniciativën e vet në këtë punë. I gjithë materiali politiko-arësimor duhet të punohet në çetë dhe, kur ky mungon, anëtarët duhet të preqatitin referate dhe këto të mbahen në konferanca të çetës.

Për këtë punë janë të domosdoshme konferencat, kurset e ndryshme dhe orët e mësimit. Në këto do të punohen tema që janë më aktuale e që u interesojnë më tepër luftëtarëve.

Puna ushtarake. — Celula duhet të nxjerrë eksperiencë nga lufta, të mësojë takтикën e luftës, të lartësojë udhëheqjen ushtarake. Me punën dhe me stërvitjet ushtarake duhet të mësohen luftëtarët që të përdorin armët e ndryshme, të përdorin të gjitha mjetet e luftës. Duhet të hiqet nga të gjithë ideja e gabuar se ne nuk kemi nevojë për ushtrime. Me anën e ushtrimeve, partizani mëson jo vetëm të zotërojë armën, por forcohet dhe disiplina e puna në çetë. Me një punë ushtarake të mirë shtohet aftësia e çetës dhe e çdo individi për luftë, preqatiten dhe lartësohen udhëheqës të rinj ushtarakë. Këtë e drejton kryesisht udhëheqja ushtarake, shtabi, ndërsa celula duhet ta ndihmojë shtabin në këtë punë. Puna politiko-arësimore e kombinuar me atë ushtarake do të na japin njësi të forta, të shëndosha e të disiplinuara, të afta për të kryer aksione luftarake e politike.

Puna në terren. — Edhe këtë celula e ka si sektor pune. Celula e Partisë duhet ta bëjë të aftë e të lartësojë të gjithë çetën në nivelin e agitatorit në bazë të vijës së Luftës nacional-çlirimtare. Që të mund të kryejë detyrat e saj në terren me sukses, celula duhet të dijë gjithë format e punës së Partisë, si punën në rini, organizimin e këshillave nacional-çlirimtare, detyrat e bashkimit të rinisë, punën me gra etj. Përsa u përket konferencave në popull e mitingjeve, shokët e dinë se e kanë kurdo-herë një detyrë që duhet ta kryejnë; për punë organizative do të punojnë vetëm atëhere kur dërgohen ose udhëzohen nga udhëheqësit e tyre. Për punën e kryer në terren celula duhet të kërkojë llogari për çdo anëtar.

Byroja. — Është udhëheqësja e Partisë në batalion. Byroja është përgjegjëse për marrëdhënjet në mes të Partisë dhe të komandës, për realizimin e rolit udhëheqës të Partisë. Byroja duhet t'i kushtojë një kujdes të veçantë forcimit të organizatave të Partisë, lartësimit të kuadrove dhe pranimit të anëtarëve të rinj në Parti. Byroja duhet të kontrollojë punën e celulave, t'u japë atyre ndihmën, udhëzimet, direktivat e të ngrejë në një shkallë të denjë përgjegjësinë e celulës përpara Partisë dhe atë të anëtarëve para celulës. Gjithashiu ajo duhet të interesohet që puna e Partisë të zhvillohet pa u prerë, të zhvillohet në mënyrë harmonike në çdo sektor. Duhet të interesohet që në punë të mos ketë pengesa, që asnje celulë të mos mbetet prapa të tjerave në punë. Byroja cakton një plan, të cilin e konkretizon celula në kompaninë e vet.

Për t'u plotësuar puna siç duhet në të gjithë sektoret, duhet t'i kushtohet një kujdes i veçantë lartësi-

mit teorik e politik të anëtarëve të Partisë. Lartësimi i kuadrove do të shtojë ritmin në punë dhe do të na sigurojë përfundime më të frytshme. Duhet të ngjallet e të zhvillohet në anëtarë ndjenja e përgjegjësisë karshi Partisë, në mënyrë që të zbatohen me vullnetin më të madh udhëzimet dhe direktivat e Partisë. Për këtë lartësim përveç broshurave e lëndëve të tjera edukative, është e domosdoshme të punohet në celulë materiali aktual i Partisë, proklamatat e Komitetit Qendror, të forumeve të tjera të Partisë, ndonjë artikull politik nga «Zeri i Popullit», nga «Bashkimi» ose nga ndonjë revistë tjetër. Ky material do të punohet patjetër, se është garancia më e mirë që udhëzimet e direktivat e Partisë të kuptohen më mirë.

Me një udhëheqje të drejtë dhe me një aktivitet më të madh të anëtarëve, do të forcohen organizatat e Partisë në ushtri, do të spastrohen nga elementët e sëmurë, do të shtohen radhët e Partisë me punëtorë, fshatarë, intelektualë të shëndoshë, të ndershëm e luftëtarë, që janë gadi t'i përballojnë gjithë vështirësitë e punës dhe të luftës, do të lartësohen kuadrot dhe kështu do të zbatohet via që ka caktuar Partia; kështu të gjitha organizatat në ushtri do të kryejnë siç duhet të gjitha detyrat që u ngarkon Partia.

[Për Komitetin Qendror të PKSH

Enver Hoxha]

*Botohet për herë të parë, si-
pas originalit që gjendet në
Arkivin Qendror të Partisë*

**RAPORT PËRPARA PLENUMIT I TË KOMITETIT
QENDROR TË PARTISË KOMUNISTE TË
SHQIPÉRISE¹**

[15 maj 1944]

Të dashur shokë,

E ndjej për detyrë që, përpara se të fillojmë punën, me respekt të madh të kujtojmë qindra e qindra shokë udhëheqës dhe anëtarë të thjeshtë të Partisë që heroikisht ranë në fushën e nderit. Për këta shokë që pa kursyer asgjë, si ushtarë të bindur dhe të disiplinuar dhe me dashurinë e madhe për Partinë dhe për popullin, luftuan deri në pikën e fundit të gjakut të tyre, përulet me respekt flamuri ynë, dhe sakrificat e gjaku i tyre të jenë simboli i virthyteve të larta që karakteri-

¹ Plenumi I i KQ të PKSH — filloi punimet më 15 maj 1944 në Helmës të Skraparit. Ai përcaktoi detyrat për çlirimin e plotë të vendit dhe perspektivat për zhvillimin e mëtejshëm të revolucionit. Ky plenum aprovoi vendimin e Kryesisë së Këshillit të Përgjithshëm Nacional-Çlirimtar për thirrjen e Kongresit I Antifashist Nacional-Çlirimtar dhe masat për formimin e Qeverisë së Përkohshme Demokratike dhe për shndërrimin e gjithë Ushtrisë Nacional-Çlirimtare në ushtri të rregullt.

zojnë anëtarët e partive të tipit Lenin-Stalin. Lavdi anëtarëve heroikë të Partisë Komuniste të Shqipërisë, që ranë në luftë, duke ngritur lart e më lart emrin e Partisë dhe flamurin e Marks-Engels-Lenin-Stalinit.

Të dashur shokë,

U bë një kohë e gjatë që s'jemi mbledhur. Që prej Konferencës së parë të Vendit plenumi i Komitetit Qendror nuk është mbledhur nga shkaku i mjaft pengesave teknike. Angazhimi i shumë shokëve të Komitetit Qendror në terrene të ndryshme, ku ishin dërguar për të ndihmuar organizatat dhe ushtrinë, lufta që po i bëhej okupatorit dhe peripetitë e saj e bënë teknikisht mjaft të zorshme këtë mbledhje. Por këto pengesa ishin edhe të kapërcyeshme kur të ndjehej nevoja urgjente e grumbullimit dhe në rast se ndodheshim përpara evenimenteve me rëndësi të veçantë, ku duhej të përcaktohej një qëndrim i ri politik dhe organizativ në mënyrën e punimit dhe në lidhje me situatat e krijuara. Vija e punimit, e përcaktuar me aq urtësi nga Konferenca e Vendit, ishte e qartë e tejshikuese dhe, përpara evenimenteve dhe zhvillimit që merrte lufta pas Konferencës së Vendit, nuk na mbetej veçse të zbatonim pikë për pikë në gjerësi dhe në thellësi vijën organizative dhe politike që na u përcaktua.

Sot u ndie e domosdoshme mbledhja e Komitetit Qendror, se evenimentet po rrokuilisen dhe kristalizohen në një formë më të përcaktuar, se lufta jonë po zhvillohet në proporcione të mëdha dhe duhen marrë vendime të prera dhe decizive. Sot, përpara Partisë so-

në dhe Komitetit Qendror të saj, shtrohen probleme jëtësore, të cilat lypin një zgjidhje të drejtë dhe të shpejtë, sepse këtej varet e ardhshmja e luftës sonë dhe e popullit shqiptar. Në këtë kthesë me rëndësi të historisë sonë, që është rezultat i ngjarjeve të jashtme dhe i përpjekjeve të Luftës nacional-çlirimtare të vendit tonë, të udhëhequr prej Partisë Komuniste të Shqipërisë, mbledhja e Komitetit Qendror dhe vendimet që do të marrim do të luajnë një rol vendimtar, do të përcaktojnë për anëtarët e vet dhe për gjithë anëtarët e Partisë vijën politike dhe organizative të veprimit, vijë që do të shpejtojë çlirimin e vendit tonë nga thonjtë e okupatorit e të tradhëtarëve dhe do t'i drejtojë shokët drejt një organizimi të pushtetit në një formë më të lartë, të përshtatshme me rrethanat e sotme. Këto janë arësyet e ngutshme dhe me rëndësi që e shtynë Byronë e Komitetit Qendror të thërresë plenumin në një mbledhje të jashtzakonshme, pa marrë parasysh pengesat teknike dhe vendin e zbrazët që do të lënë shokët e Komitetit Qendror në vendet udhëheqëse, nga ku drejtonin punën dhe luftën.

Shokë,

Në Evropë evenimentet po rrokullisen me shpejtësi të jashtzakonshme. Gjermania hitleriane, e plagosur rëndë nga goditjet e parreshtura që i ka dhënë Ushtria e Kuqe, po tronditet dhe ushtria e saj po humbet moralin dhe fryshten sulmuese. Disfatat e njëpasnjëshme që ka pësuar ushtria gjermane kanë ngjallur moskënaqësi të madhe në popullin gjerman, i cili e ka humbur besi-

min në Hitlerin dhe në fitoren. Nga ana tjetër, ekonomia e Rajhut të tretë nuk është më në gjendje të përballojë nevojat e mëdha të popullit dhe ato të ushtrisë. Popujt e robëruar, që Hitleri u përpooq t'i përdorte si mish topi, s'kanë besim në qeveritë kuislinge të tyre, dhe «pathyeshmëria» e forcave gjermane tanë është një përrallë për ta. Si një bishë e plagosur ushtria gjermane po tërhiqet në Evropë, ku taktikisht do të mundohet të bëjë qëndresën e saj të fundit për të zgjatur edhe ca kohë jetën e vet. Klikat reaksionare në gjithë Evropën, të cilave nuk u pëlqen zhdukja e fashizmit, sepse ekzistenca e tyre është e lidhur ngushtë me të, bëjnë çmos për ta ndihmuar Hitlerin; këto janë në shërbim të hapët të Gjermainisë hitleriane dhe me përpikëri zbatojnë direktivat e diktuarra prej Gestapos në dëm të popujve të tyre. Planet e Hitlerit dhe të gjithë reaksionit u shkatërruan, dhe kjo në saje të Ushtrisë së Kuqe, e cila e ka mbajtur dhe e mban në kurrizin e vet peshën më të rëndë të kësaj lufte të madhe. Ajo, me strategjinë e saj ushtarake, që ka çuditur botën dhe që s'është parë në historinë e luftërave të popujve, i dha grushtin e vdekjes maqinës më të fortë ushtarake që ka parë bota. Njëri pas tjetrit u çliruan fshatra dhe qytete të Bashkimit Sovjetik. U çlirua Ukraina Sovjetike. Në një ofensivë të rrufeshme, e cila nuk do të ndalet, veçse kur Gjermania hitleriane të rrëzohet përdhe, Ushtria e Kuqe kaloi Dniestrin, Dnieprin dhe Bugun, ajo hyri në Besarabi dhe Bukovinë, doli në kufitë e Çekoslovakisë dhe tanë po marshon drejt Rumanisë dhe Hungari-së, bastione vasale të Hitlerit në Evropë. Në frontin e Qendrës dhe të Veriut po preqatitet sulmi vendimtar

që do të çlirojë përgjithmonë tokat sovjetike. Ushtria e Kuqe jo vetëm që ka marrë përsipër barrën e rëndë të spastrojë nga tokat e veta invazorin gjerman, por edhe spastrimin e shfarosjen e fashizmit dhe të ushtrisë hitleriane nga gjithë Evropa. Stalini, në fjalimin e tij të fundit¹, tha se goditja për vdekje dhe spastrimi i hitlerianëve nga Evropa është një detyrë e rëndë, detyrë më e rëndë nga ajo që ka pasur deri tanë Ushtria e Kuqe, se bisha naziste e plagosur rëndë do të përpinqet me çdo kusht të zgjatë jetën e vet dhe të mbrohet në Evropë. Ushtria gjermane duhet të goditet nga të katër anët; Ushtria e Kuqe duhet t'ja japë grushtin nga veriu dhe nga lindja, aleatët nga perëndimi dhe nga jugu, kështu, me veprime të kombinuara, do të shpejtohet thyerja e forcave gjermane. Ushtria e Kuqe, me moralin e saj të lartë, me armatimet e perfektionuara, me dashurinë e madhe që është rrrethuar nga të gjithë popujt e URSS-it dhe e udhëhequr nga strategu më i madh i kohërave të sotme, Stalini, është bërë mjeshtre e mbaruar për detyrën e saj të rëndë, por glorioze. Krahas me sukseset ushtarake qëndrojnë edhe sukseset e mëdha politike që Bashkimi Sovjetik ka korrur në fushën ndërkombëtare. Pas Konferencës së Moskës, Konferenca e Teheranit² lidhi dhe më fort aleancën ushtarake dhe mi-

¹ Është fjala për urdhërin e Komandantit Suprem të Ushtrisë së Kuqe, J. V. Stalin, me rastin e 1 Majit 1944.

² Konferenca e Teheranit — u mbajt prej 28 nëntorit gjë më 1 dhjetor të vitit 1943 me pjesëmarrjen e kryetarëve të tri fugive të mëdha aleate: J. V. Stalinit, U. Çerçillit dhe F. Ruzveltit. Aprovoi «Deklaratën mbi veprimet e përbashkëta në luftë kundër Gjermanisë dhe mbi bashkëpunimin e tri shteteve

qësore ndërmjet URSS-it dhe anglo-amerikanëve. Kjo konferencë dënoi me vdekje hitlerizmin dhe tentativat e tija për të përqarë aleatët. Kjo konferencë përcaktoi më qartë nevojën e domosdoshme të pjesëmarrjes aktive në luftë nga ana e anglo-amerikanëve dhe ajo ishte për popujt e robëruar një inkurajim dhe mbështetje e fortë për luftën e tyre çlirimtare. Popujt e robëruar riforuan besimin në Bashkimin Sovjetik, i cili lufton për çlirimin e gjithë popujve dhe për mbrojtjen nga çdo ndërhyrje e huaj në punët e tyre të brendshme.

Aleatët marrin pjesë të dukshme në shkatërrimin e fuqive hitleriane me bombardimet, por, duke marrë parasysh fuqitë që kanë grumbulluar, nuk jepin rezultatet e pritura dhe veçanërisht ato që presin popujt e robëruar. Vetëm lufta ajrore nuk është e mjaftueshme për të shkatërruar hitlerizmin, është e domosdoshme edhe suqia që të luftojë në tokë. Në rast se anglo-amerikanët futin shpejt në luftë të gjitha ato forca që kanë grumbulluar do të jetë më i shpejtë çlirimi nga Gjermania hitleriane.

Me avancimin e Ushtrisë së Kuqe po grumbullohen forcat patriotike të vendeve të ndryshme dhe kështu po lind dhe po forcohet lufta nacional-çlirimtare e popujve të robëruar nga Gjermania. Në ballë të këtyre luftërave çlirimtare të popujve shohim kudo partitë komuniste, të cilat udhëheqin luftën e popujve të tyre.

Në Jugosllavi veçanërisht lufta ka marrë një hov

pas luftës». Gjithashtu vendosi që fronti i dytë në Evropë të hapej jo më vonë se 1 maji 1944.

të madh. Lufta këtu s'është më ajo luftë e dy vjetëve më parë në formë guerriljesh, por është një luftë frontale dhe me një ushtri të madhe dhe të regjur në përpjekje të përgjakshme. Ushtria nacional-çlirimtare e popujve të Jugosllavisë dita-ditës po shtohet dhe bëhet strumbullari i vëllazërimit të të gjithë popujve të Jugosllavisë; njëkohësisht ajo është ngritur dhe armatosur vetëm e vetëm me përpjekjet dhe me gjakun e këtyre popujve. Kjo ka detyruar tradhëtarët të zbulojnë lordin e tyre përpara popujve të Jugosllavisë dhe përparrë të gjithë popujve të botës. Çetnikët e Drazha Mihajloviçit, qeveria tradhëtare e Jugosllavisë në Londër dhe kral Pjetri¹ shfaqën qëllimet e tyre shoviniste dhe u demaskuan gënjeshrat, tradhëtitë e spekulimet që kishin për qëllim të dobësonin frontin nacional-çlirimtar dhe luftën si dhe të grabitnin pushtetin. Formimi i qeverisë provizore ishte një sukses i madh politik për luftën nacional-çlirimtare të Jugosllavisë. Ushtria jugosllave sot është në radhën e atyre ushtrive aleate që luftojnë okupatorin.

Bullgaria është një nga shtetet vasale të Hitlerit. Reaksioni bullgar i ka lidhur fatet e Bullgarisë me ato të Gjermanisë hitleriane dhe me atë ushtri që kanë formuar, ata kanë shtypur çdo lëvizje brenda në Bullgari dhe janë drejtuar edhe kundër lëvizjes naçional-çlirimtare në Jugosllavi e Greqi. Populli bullgar ka një dashuri të veçantë qysh prej kohërave të vjetra për popujt vëllezër të Bashkimit Sovjetik dhe, me gjithë

¹ Pjetër II Karagjorgjeviç, mbret i Jugosllavisë në vitet 1934—1945.

terrorin dhe shtypjen sistematike nga ana e gjermanëve, ai po hidhet në luftën nacional-çlirimtare. Deklarata e shokut Dimitrov¹ drejtuar popullit bullgar ka caktuar rrugën që duhet të ndjekë ky popull. Me afrimin e Ushtrisë së Kuqe perspektivat janë të mira për një zgjerim të luftës nacional-çlirimtare të popullit bullgar dhe për një bashkëpunim të ngushtë midis popujve luftues të Ballkanit.

Lëvizja në Greqi ka marrë proporcione të gjera politikisht, por nuk kemi atë ashpërsi të nevojshme kundër reaksionit të brendshëm. Intrigat e huaja atje kanë gjetur fushë veprimi.

Në Itali, pas çlirimit të një pjesë të saj prej anglo-amerikanëve, Badolio u mbajt në fuqi me përkrahjen e aleatëve dhe vazhdoi një politikë jopopullore. Por pas ndërmjetësimit të Bashkimit Sovjetik u dukën ndryshime në politikën e qeverisë italiane të Badolios². Roli i Partisë Komuniste Italiane u bë i dukshëm në formimin e frontit antifashist dhe në zgjerimin e qeverisë së Badolios, ku marrin pjesë përfaqësues nga gjithë partitë dhe nga PKI shoku Erkoli. Nga moskënaqësia, protestat dhe demonstratat e popullit u rrëzua mbreti Viktor

¹ Është fjala për «Programin e Frontit Patriotik» të Bullgarisë, të hartuar nga Gjergj Dimitrovi dhe të transmetuar nga radio «Kristo Botev», më 17 korrik 1942.

² Me ndërmjetësimin e Bashkimit Sovjetik, i cili në mars 1944 vendosi marrëdhënje diplomatike të drejtpërdrejta me qeverinë italiane, në prill 1944 kabineti i Badolios u riorganizua duke u futur në të edhe përfaqësuesit e gjashtë partive të koalicionit antifashist italian, midis të cilëve edhe përfaqësuesit e Partisë Komuniste Italiane.

Emanuel, shkaktar i aq fatkeqësive dhe përkrahës kryesor i regjimit fashist që robëroi popullin italian dhe popujt e tjerë. Me organizimin e ushtrisë italiane dhe me luftën e partizanëve italiane në tokat e okupuara po duket zgjerimi i luftës nacional-çlirimtare italiane dhe forcimi i pozitave të përparimdashësve në tokat e çliruarra. Në Veri të Italisë punëtoria ka marrë pjesë në përpjekje të ashpra dhe të përgjakshme kundër okupatorit gjerman dhe, megjithëse populli italian është i gjakosur prej shtypjes dhe sakrificave të një lufte të gjatë, ku e kishte hedhur fashizmi, ai ka filluar të përtërihet dhe të ringjallet.

Në Francë lëvizja partizane ka marrë një hov të ri këto kohët e fundit, sidomos në Hot-Savua. Atje shohim zgjerimin e frontit nacional-çlirimtar dhe pjesëmarrja e komunistëve në qeverinë e De Golit është një hap përpara në lëvizjen e popullit francez. Shohim që kjo qeveri të marrë qëndrime të caktuara karshi elementeve të dyshimtë dhe bashkëpunëtorëve të tradhëtarëve të Vishisë. Heqja e Zhirosë¹ nga komanda e ushtrisë dhe izolimi i tij nga skena politike dhe ushtarake është karakteristike.

Në Poloni dhe Çekoslovaki, me afrimin e Ushtri-

¹ Udhëheqës ushtarëk e politik reaksionar francez. Gjatë viteve të Luftës së dytë botërore u ka shërbyer interesave të imperializmit amerikan. Në qershor të vitit 1943 u caktua nga amerikanët president i «Komitetit të Çlirimt Nacional» të Francës. Duke qenë i komprometuar me politikën e tij reaksionare u hoq nga ky post në nentor të vitit 1943, kurse në prill të vitit 1944 u hoq edhe nga posti i komandantit të forcave të armatosura të «Komitetit të Çlirimt Nacional» të Francës.

së së Kuqe, po gjallërohet lëvizja e këtyre popujve dhe njëkohësish po krijohen qeveri të reja, të cilat përkrahen prej Bashkimit Sovjetik.

Lëvizjet nacional-çlirimtare në Evropë, të mbështetura nga Bashkimi Sovjetik, dhe krijimi i qeverive provizore, të dala nga lufta e popujve, janë një hap përrpara dhe një garanci për një të ardhme më të mirë. Këto lëvizje vërtetojnë fjalët e Mollotovit se pas kësaj lufte do të kemi një varg revolucionesh. Klasa punëtore dhe partitë komuniste në botë do të luajnë një ro-vendimtar për çlirimin e popujve dhe të kolonive.

Si paraqitet tek ne situata e brendshme aktuale? Me ardhjen e Gjermanisë në vendin tonë reaksiioni filloj të grumbullohet dhe të organizohet më mirë. Nën okupacionin italian një pjesë e reaktionit, me «Ballin Kombëtar» në krye, u përpoq të zhdukte lëvizjen tonë nacional-çlirimtare dhe të përqante popullin shqiptar e ta tërhoqë këtë nga e vetmja rrugë e shpëtimit të tij, nga rruga që i kishte caktuar Fronti Nacional-Çlirimtar, fronti i luftës së pamëshirshme kundër okupatorit. «Balli Kombëtar», me parulla false dhe pseudonacionaliste, me kompromise të hapëta me okupatorin dhe kuislingët, u mundua të grumbullojë rreth vetes të gjithë elementët e poshtër dhe t'i organizojë këta në banda hajdutësh dhe kriminelësh për të na goditur me armë. Me ardhjen e gjermaneve, «Balli Kombëtar» u bë vegla e verbër e Gestapos. Gestapoja, e regjur në këto punë dhe e pajisur me një eksperiencë të gjatë në grumbullimin dhe organizimin e reaktionit, ja filloj punës, duke shtënë në dorë të gjitha fijet e klikave reaksionare që vepronin haptazi dhe fshehurazi kundër lëvi-

zjes sonë. Rreth qeverisë kuislinge të Mehdi Beut dhe të Rexhep Mitrovicës u grumbulluan që prej «Ballit Kombëtar», duke kaluar nga «Bashkimi Kombëtar», deri te njerëzit e «Legalitetit». Gjithë taktika e tyre ishte të na asgjësonin ushtarakisht, ta shkëputnin popullin prej nesh dhe politikisht të na diskreditonin. Një fushatë e gjerë propagandistike u zhvillua nga ana e tyre me një shtyp të madh dhe të organizuar, kurse, nga ana tjetër, preqatitej imtësisht ofensiva kundër forcave tona. Lufta e tyre bëhej me parullat e njoitura antikomuniste dhe gjermanët e reaksiioni përpinqeshin ta paraqitnin në popull lëvizjen tonë si një lëvizje thjesht komuniste. Parullat e «Shqipërisë së madhe», e «Shqipërisë indipendente» ishin në rendin e ditës; feudalët si Shefqet Vërlaci, Ibrahim Biçaku, Vrionasit vunë gjithë peshën e tyre për të grumbulluar elementët e tyre dhe i vunë köta në shërbim direkt të Gestapos. Me terror, me anarki, ata u përpoqën të lëkundnin popullin dhe t'i humbisnin këtij besimin në fitore. Me çdo mjet ata u përpoqën të shpartallonin edhe grumbullimin e rinisë, duke përdorur demagogji dhe terror.

U krijuan prej okupatorit dhe «Ballit Kombëtar» organizata të ndryshme gjoja me programe politikë të caktuara, por të gjitha të lidhura ngushtë për një qëllim, për të luftuar popullin dhe lëvizjen tonë. Në këtë mënyrë ata donin të dezorientonin popullin dhe ta bënin këtë që të mos mundte dot të orientohesh e të ndiqte një rrugë të caktuar dhe të drejtë. Qëllimi i tyre ishte që ta bënin popullin të humbiste besimin te Partia Komuniste, e cila me vijën e saj të drejtë, me qëndrimin e pathyer dhe me sakrificat e mëdha që po bënte kishte

fituar besimin e mbarë Shqipërisë. U krijua «Partia Socialdemokrate» prej agjentit të Gestapos Skënder Muços, e të tjerë elementëve ballistë, me qëllim që të shkëputnin elementët përparimtarë që ndodheshin në frontin tonë dhe të tërhiqnin elementët e lëkundshëm që ende s'kishin hyrë aktivisht në luftë. Të tilla ishin organizatat «Roja e Drejtësisë», «Partia Komuniste e vërtetë», e kryesuar prej tradhëtarit Sadik Premte. Këto organizata terroristë s'ishin veçse dora ekzekutuese e Gestapos. Në luftën e ashpër që i bëhej Gjermanisë dhe reaksionit nga ana e Frontit Nacional-Çlirimtar, elementë të lëkundshëm, që vegjetonin në frontin tonë, si Bazi i Canës, treguan ftyrën e tyre të ndyrë prej reaksionari. Bazi i Canës, zogist, mori pjesë në Konferencën e Pezës dhe pranoi direktivat e caktuara prej kësaj konference. Ky element në ato momente paraqitesh antiitalian dhe kundër kuislingut Mustafa Merlikës, por aktiviteti i tij luftarak ishte zero. Ai nuk hodhi asnjë pushkë kundër okupatorit dhe tradhëtarëve dhe as që pranoi të krijonte pushtetin e këshillave në vendet ku ai kishte influencë. Qëndrimi i tij në front bëhej dita-ditës i dyshimit. Ai bënte mbledhje dhe pjekje me njerëzit e dyshimitë dhe me të gjithë ata që ishin në luftë të hapët me frontin, si krerët e Dibrës dhe të Matit. Me ardhjen e okupatorit të ri dhe me ashpërsimin e luftës sonë kundër reaksionit dhe «Ballit Kombëtar» qëndrimi i Bazit u bë më i dukshëm dhe më konkret. Në mbledhjen e Mukjes, ku ishin dërguar shokët tanë, midis të cilëve edhe doktor Dishnica, për të biseduar për herën e fundit me «Ballin Kombëtar», Bazi i Canës e tregoi

qëndrimin e tij kundër lëvizjes dhe influencës edhe shokët tanë që të bien në një gabim të madh politik, në një gabim oportunist. Që prej bisedimeve të Mukjes Bazi i Canës filloi të bjerë në marrëveshje të hapët me kuislingun Mehdi Frashëri, me «Ballin Kombëtar» dhe krijoi «Legalitetin», organizatë zogiste, ose, më mirë të themi, «vazhdimësinë e regjimit të Zogut», si thotë ai, «regjim që duhet të jetë i vetmi» në Shqipëri, pse gjoja është legal, por është zhdukur nga Shqipëria prej forcës së armëve fashiste italiane. Me krijimin e «Legalitetit» gjermanët dhe reaksiioni po krijonin një armë të re për të pérçarë popullin, për ta frikësuar këtë dhe për të grumbulluar më mirë reaksiionin që po tronditej në radhët e «Ballit» dhe të organizatave të tjera tradhëtare. «Legaliteti», i përkrahur haptazi nga kuislingu Mehdi Frashëri, i cili ruan kultin e Zogut derisa arrin të vendosë në administratë tiparet e administratës zogiste në marrëveshje të drejtpërdrejtë me okupatorin gjerman, përpinqet të grumbullojë rrëth vetes gjithë bajraktarët e malësive dhe reaksiionarët e ndryshëm për të na goditur dhe për të preqatitur ardhjen e Zogut në Shqipëri. Në shtypin e «Legalitetit» dhe të Bazit të Canës nuk bëhet asnjë fjalë për okupatorin, por gjithë lufta dhe propaganda e tyre përmblidhet në luftën kundër nesh dhe në apologjinë e Zogut e të regjimit të tij. Në Veri të Shqipërisë krerët e Dibrës mbajnë një attitude¹ të njëllojtë me të gjithë reaksiionin. Ata, nën okupacionin italian, kanë qenë vegla të tija dhe me armë kanë luftuar lëvizjen; tani, nën

¹ Attitude (frëngj.) — qëndrim.

okupacionin gjerman, ata vazhdojnë po rrugën e tradhëtisë. Me Mehdi Frashërin dhe me reaksionarët e tjerë, si Bazi i Canës dhe elementë të «Ballit», ata janë në marrëveshje të plotë për të na luftuar. Të lidhur me reaksionarët e tjerë shqiptarë të Maqedonisë, si Xhem Gostivari e të tjerë, ata përpiken të shuajnë lëvizjen tonë në ato rrethe.

Tradhetari Mustafa Merlika, i lidhur ngushtë me Marka Gjonin e Mirditës, po organizon në Veri rezistencën dhe njëkohësisht mbrojtjen e tyre. Mustafa Kruga është në marrëveshje me Bazin dhe, sigurisht, me elementët e tjerë reaksionarë. Ata do të mundohen të bëjnë një blok kundër lëvizjes sonë. Sido që reaksiioni nuk është ende i lidhur mirë në Veri, përsëri paraqitet i rrezikshëm për ne. Në Veri s'duhet të harrojmë edhe Muharrem Bajraktarin, i cili deri tani, nuk ka hyrë në luftë të hapët as kundër nesh, as edhe kundër okupatorit. Një rol të madh ka luajtur dhe do të luajë kisha katolike, e cila ka një influencë në Shkodër dhe në malësi. Kisha katolike ka mbajtur një qëndrim negativ dhe profashist në kohë të okupacionit italian, dhe qëndrimi i saj tani, nën okupacionin gjerman, është i njëllojtë kundër lëvizjes nacional-çlirimtare.

Nga të gjitha këto klika reaksionare, që paraqiten në skenën shqiptare, armiku okupator bën çmos që të përfitojë, t'i drejtojë dhe t'i hedhë ato në luftë kundër nesh, duke përfituar nga çdo kontradiktë e tyre që mund të kenë me njëri-tjetrin si dhe nga kundërshtimi kryesor që kanë kundër nesh. Gjermani okupator, që i përdori për një kohë të gjatë bandat kriminale të «Ballit» kundër nesh në formë bashibozuke, tani po i shndë-

rron këto banda në një formë gjoja të rregullt ushtarake. Qëllimet e tija janë të shumta. Nga njëra anë, ai përpinqet, së pari të ketë kurdoherë mercenarë për të përm bushur nevojat e tija këtu, duke i përdorur në vend të ushtarakëve të tij, që është i detyruar t'i heqë dhe të lerë vetëm një pakicë dhe, së dyti t'i ketë këta pér më vonë të organizuar pér me i dërgue atje ku do ndjehet nevoja, sikundër që bën me polonezët, austriakët, francezët, etj. Nga ana tjetër, me formimin e këtyre reparteve, nën maskën e një xhandarmërie ose ushtrie shqiptare, ai mban me shpresa reaksionin, i cili me qdo mjet përpinqet të ketë një forcë të organizuar pér të përballuar sulmet tona, si sot ashtu edhe nesër. Kjo xhandarmëri ose ushtri është shpresa e të gjithë reaksionarëve të ndryshëm, që prej krerëve të «Ballit Kombëtar» e deri te Bazi, dhe cilido prej tyre i, jep ç'i mundet gjermanit zot, që të fitojë favorin me e përdorë gjithsecili pér vete atë armë. Duhet të shohim se në radhët e reaksionit ka lëkundje dhe tronditje. Brenda në «Ballin Kombëtar» shohim një mosmarrëveshje në mes të krerëve, mirëpo një mosmarrëveshje që nuk i bën kurrë të harrojnë qëllimin e tyre kryesor, luftën kundër lëvizjes nacional-çlirimtare. Gjermanët, tok me reaksionarët, ndërmuarën ofensivën e madhe të dimrit kundër nesh, e cila dështoi, sepse ajo s'mundi t'ja arrinte qëllimit, qëllimit që kishte caktuar: asgjësimit të forcave tona ushtarake. Gati i gjithë reaksioni është në luftë të hapët me ne. Kudo që batalionet dhe brigadat tona po sulmojnë dhe sulmohen, ato gjejnë përpara bandat e reaksionit, të «Ballit», të Shefqet Vërlacit, të Ibrahim Biçakut, të «Legalitetit» dhe të këlyshëve të tyre. Në

këto rrrethana të jashtme dhe të brendshme lëvizja jonë ka kaluar me sukses përpara në etapa të ndryshme. Konferenca e Pezës, e cila hodhi themellet e Frontit Nacional-Çlirimtar, i dha mundësi dhe hov lëvizjes sonë të zgjerohet, si në çështjen e këshillave si organe të pushtetit, ashtu edhe në zhvillimin e luftës dhe të ushtrisë sonë. Këshillat nacional-çlirimtare u formuan si organe të vërteta të pushtetit popullor demokratik, në një pjesë të vendit ato funksionuan si duhej, kurse në disa vise të tjera ato mbeten të dobëta dhe rezultatet e dhëna prej tyre kanë qenë të pakta. Fati i këshillave ishte i lidhur dhe me sulmet e armikut dhe të reaksionit. Në vendet ku armiku mund të hynte lehtë, atje ishte shumë e zorshme që këshillat të organizoheshin dhe të funksiononin si duhej. Në Veri të Shqipërisë ato u krijuan në një pjesë të Dibrës dhe në disa vise të Shkodrës e gjetkë. Në disa vende ne nuk kemi asnë punë të organizuar, as edhe shokë që të punojnë ndër ato rrethe, atje reaksiioni është mjaft i madh dhe ka nxjerrë pengesa për realizimin e punës sonë.

Fronti Nacional-Çlirimtar e ka pasur kurdoherë rrugën të qartë dhe të përcaktuar mirë dhe, me trakte e me qëndrime të ndryshme, si dhe me konferenca, ka sqaruar popullin në situata të ndryshme, si edhe është përpjekur të grumbullojë në front të gjithë elementët e ndershëm e luftëtarë, është përpjekur të futë në luftë të gjithë ata të mënjanuarit si dhe të gjithë ata që qenë të gabuar nga reaksiioni dhe armiku, por që s'ishin përlyer me gjakun e popullit.

Në çdo kthesë të lëvizjes dhe të luftës, fronti ka ditur të mbajë qëndrime të caktuara dhe të prera.

Karshi «Ballit Kombëtar» fronti ka mbajtur një qëndrim të drejtë. Ai i ka bërë thirrje «Ballit» të hidhej në luftë kundër okupatorit, por «Balli» nuk u hodh në luftë kundër armikut, por ndoqi rrugën e tradhëtisë dhe ka hapur luftën vëllavrasëse. Fronti u bëri thirrje elementeve të gënjer që të dezertonin nga kjo organizatë tradhëtare.

Me zhvillimin e luftës dhe me zhvillimin e ushtrisë sonë u pa e nevojshme që të thërritej Këshilli¹ një mbledhje të jashtzakonshme për të zgjedhur Shtabin e Përgjithshëm, për të riorganizuar këshillat dhe për të marrë një qëndrim të prerë kundër «Ballit Kombëtar» dhe reaksionit. Mbledhja e parë, që u bë në Labinot¹, ka një rëndësi të veçantë, se ajo i dha ushtrisë sonë një udhëheqje të vetme, e cila mori përsipër drejtimin e luftës, forcimin dhe zmadhimin e ushtrisë sonë. Përveç kësaj, kjo mbledhje ka një rëndësi, se atje u muar qëndrimi i prerë karshi reaksionit, vegël e okupatorit, dhe atje u vendos dërgimi i një delegacioni që të bisedonte për herë të fundit me «Ballin». Ky ishte takimi i Mukjes. Bisedimet që u zhvilluan atje u bënë në momentin e kapitullimit të Musolinit. Në ato momente «Balli Kombëtar» kujtoi se kishte ardhur koha të merrte pushtetin dhe gati një pjesë e madhe e tij u hodh në «ilegalitet». Përveç kësaj ai ishte i tronditur nga brenda, se disa elementë, gjoja si më liberalë, ishin në kundërshtim me krerët e kësaj organizate dhe kërkonin prej tyre llogari për aktivitetin që kishin zhvilluar. Duke dashur të për-

¹ Mbledhja e Këshillit të Përgjithshëm Nacional-Çlirimtar u mbajt më 4 korrik 1943 në Labinot të Elbasanit.

'fitojë nga gjendja politike dhe nga pjekja me delegatët tanë, «Balli Kombëtar» manevroi në mënyrë që bisedimet t'i udhëhiqte ai dhe të bënte të triumfonin tezat e tija. Mukja ishte një sukses për «Ballin» dhe një humbje për ne. Bazi i Canës atje tregoi qartë tendencat e tija. Sido që s'kish bërë kurrë luftë, me rrëzimin e Musolinit lufta për të kishte mbaruar dhe përpinqej me çdo kusht të arrihej në një bashkim të sëmurë dhe pa baza, duke lënë mënjanë çdo kujtim të veprimeve të «Ballit» dhe të reaksionarëve të tjerë. «Balli» manevronte nga ana e tij për me e tërheq Bazin në anën e vet, për me e dobësue frontin dhe me e goditë më mirë. Në mbledhje nuk u biseduan fare, ose u biseduan në një mënyrë formale dhe si çështje të dorës së dytë të gjitha vendimet që ishin marrë në Mbledhjen e Labinotit, por u bisedua për një «Shqipëri etnike», u bisedua për «shpalljen e indipendencës», u bisedua për krijimin e një superorganizate dhe u vu «Balli Kombëtar», që kishte luajtur rolin më të zi, në një radhë me Frontin tonë Nacional-Çlirimtar. Në këtë mbledhje, përvèç Dr. Dishnicës, që ishte caktuar prej Byrosë së Komitetit Qendror për të mbrojtur interesat dhe vijën e Partisë, ishte dhe Mustafa Gjinishi, i cili bëri po atë gabim. Në vend që shokët tanë të përfitonin nga tronditja e «Ballit» dhe të bënин diferencimin, ky i fundit forcoi pozitat e tija organizative. «Balli Kombëtar» arriti të shuajë moskënaqësitë në radhët e tij, të dalë në popull me të famshmin trakt të firmuar nga «Komiteti për Shpëtimin e Shqipërisë» si një organizatë patriotike, që paska bërë për çlirimin e Shqipërisë aq sa ka bërë fronti ynë. Vendimet e Mukjes u hodhën tej, dhe karshi «Ballit» u muar qëndrim i prerë. Bazi i Canës

u thirr të sqarohej, ai s'erdhi. Vetëm shumë kohë më vonë, pas Konferencës së dytë të Labinotit, Bazi i Canës erdhi në kontakt me delegatët e Kryesisë së Këshillit në Shëngjergj. Ai kishte përqafuar të gjitha parullat e «Ballit». Teza e tij ishte që ne të njihnim regjimin e Zogut dhe të bashkëpunonim jo më si front, por si një parti politike nën hijen e Zogut. Përveç kësaj ai kërkonte që ne të bashkëpunonim me «Ballin Kombëtar» dhe asnje qëndrim nuk merrte karshi qeverisë kuislinge të Mehdi Beut. Bazi përpinqej të përsërise Mukjen, dhe këtë herë ne të gabonim dhe të pranonim bashkëpunimin nën regjimin e «Legalitetit». Ne i paraqitëm Bazit vendimin dhe vijën tonë të pathyeshme dhe të drejtë të frontit kundër okupatorit dhe reaksionit dhe i thamë që të linte mënjanë tani për tani çështjen e regjimit të Zogut, çështje që do të zgjidhej pas luftës; i thamë se mund të bashkëpunonim me një parti politike zogiste, e cila duhet të hynte në Frontin Nacional-Çlirimtar, të hynte në luftë kundër okupatorit dhe të spastronte radhët e saja nga elementët tradhëtarë. Bazi s'pranoiasnje nga këto propozime. Kryesia e Këshillit, me rezolucionin e vet¹, e hodhi Bazin jashtë nga Kryesia e Këshillit dhe nga Shtabi dhe e dënoi, duke e demaskuar në popull si element reaksionar në bashkëpunim të hapët me klikat reaksionare dhe me kuislingët e Tiranës.

Konferenca e dytë e Labinotit ishte një sukses përlëvizjen tonë. Atje morën pjesë një numër i madh delegatësh nga të gjitha anët e Shqipërisë, u zgjodh një Kë-

¹ Është fjalë për rezolucionin e Kryesisë së Këshillit të Përgjithshëm Nacional-Çlirimtar të datës 7 dhjetor 1943 mbi përashtimin e Abaz Kupit nga Këshilli i Përgjithshëm.

shill i madh Nacional-Çlirimtar si edhe një presidium i gjerë. Por zhvillimi i Luftës nacional-çlirimtare dhe porpcionet që mori kjo, gjendja politike e jashtme dhe rrrethanat e brendshme sot, na detyrojnë të marrim vendime më me rëndësi dhe të mbledhim një kongres për të zgjedhur Këshillin Antifashist Nacional-Çlirimtar që do të ketë atributet e një pushteti legjislativ dhe ekzekutiv, nga ku do të dalë Komiteti Antifashist me atributet e një qeverie provizore. Byroja e Komitetit Qendror mendon se është momenti më tepër se kurrë që këto çështje me rëndësi duan një zgjidhje të shpejtë. Mbledhja e kongresit dhe zgjedhja e Këshillit Antifashist si dhe formimi i qeverisë provizore do të sjellin forcimin e luftës sonë, forcimin e pushtetit brenda si edhe ndryshime në marrëdhënjet ndërkombëtare në mes lëvizjes nacional-çlirimtare dhe aleatëve. Masat e popullit, që kanë marrë pjesë aktive në luftë, do të shohin te ky pushtet qeverinë e tyre dhe, nga ana tjetër, formimi i qeverisë provizore do të jetë një grusht kundër çdo tentative të reaksionit të jashtëm dhe të brendshëm për formimin e ndonjë qeverie reaksionare, qoftë nën Zogun, qoftë ndonjë tjetër qeveri pseudodemokrate. Shtrohet, pra, përpara Komitetit Qendror kjo çështje me rëndësi për vendin tonë, për të cilën duhet të shfajqim mendimet tona dhe të marrim vendime.

Që prej Konferencës së parë të Vendit e deri tani, lufta jonë ka marrë një hov të madh, Ushtria Nacional-Çlirimtare është zmadhuar e forcuar dhe ka shkuar në etapa të ndryshme. Nga njësitet e guerrilet e mëparshme dhe nga batalionet territoriale, që ekzistonin kur u bë Konferenca e Vendit, sot kemi një ushtri të rregullt,

kemi një numër të madh brigadash dhe jemi në prakun e formimit të divizioneve. Kemi kaluar, pra, në një formë të re të ushtrisë sonë. Partia jonë ishte faktori kryesor dhe udhëheqësja e sigurtë e kësaj ushtrie. Në Konferencën e parë të Vendit është theksuar se shokët e Partisë duhet të kuptionin se sektori kryesor i punës ishte ushtria dhe që të mundej Partia të bëhej udhëheqëse e vërtetë e Luftës nacional-çlirimtare duhej të kuptionin rëndësinë e krijimit dhe të forcimit të Ushtrisë Nacional-Çlirimtare. Konferenca na caktonte si detyrë që të grumbullonim dhe të mobilizonim në radhët e ushtrisë gjithë patricët dhe luftëtarët e ndershëm, të mobilizonim katundarinë dhe të kalonim nga njësitet e vogla partizane në njësite të mëdha dhe në një Ushtri të rregullt Nacional-Çlirimtare. E kemi plotësuar deri diku vendimin që u muar në atë konferencë. Kemi kaluar nga njësitet partizane në formacione të rregulla, të cilat janë bërë tmerr për okupatorin. Anëtarët e Partisë kanë treguar guxim, vendosje e zotësi ushtarake dhe janë shquar me gisht jo vetëm nga luftëtarët që udhëhiqnin, por edhe nga populli. Ushtria dhe populli panë me të vërtetë se Partia jonë është udhëheqësja trime dhe e urtë e kësaj lufte çlirimtare. Sot, që kemi në këmbë një numër brigadash të mëdha dhe jemi duke kaluar në divizione, parashtrohet përpara Komitetit Qendror çështja e gradave. Byroja ka vendosur që kjo çështje të bisedohet imtësisht, se ka një rëndësi të veçantë për ushtrinë tonë. Me dhënjen e gradave, ushtria jonë do të marrë formë më të plotë të një ushtrie të rregullt, do të dallohen të gjithë ata luftëtarë që kanë treguar zotësi ushtarake gjatë këtyre dy vjetëve luftë dhe,

nga ana tjetër, do të forcohet edhe ca më shumë disiplina në ushtrinë tonë partizane.

Shokë,

Konferenca e parë e Vendit ka qenë për Partinë tonë një eveniment me rëndësi të madhe, se atje u përcaktuán detyra të qarta, vija politike e punimit si dhe ajo organizative. Nga kjo konferencë doli Komiteti Qendror Definitiv, që mori përsipër drejtimin e punës në bazë të direktivave të Internacionales Komuniste. Direktivat e ardhura në një kthesë me rëndësi në historinë e popullit tonë, i hapën Partisë dhe luftës horizonte të gjera veprimi dhe u bënë faktor i rëndësishëm për zhvillimin me aq sukses të punës së Partisë, për rolin e madh që do të luante kjo gjatë kësaj lufte si dhe përzgjerimin e frontit dhe për organizimin e Ushtrisë sonë Nacional-Çlirimtare. Konferenca e parë e Vendit, e bëre në momente shumë të vështira ilegaliteti, ku merrnin pjesë delegatë të zgjedhur nga të gjitha organizatat e Partisë të vendit, tregoi forcën e Partisë sonë të re, vendosmërinë e anëtarëve të saj dhe vijën politike të drëjtë. Konferenca e Vendit diti të orientojë anëtarët në momentet më të ndërlikuara dhe u dha mundësitë të kalojnë mjaft pengesa që u dolën përparrë. Në radhë të parë, Konferenca e Vendit na vuri përparrë problemin e forcimit dhe të zgjerimit të radhëve të Partisë, duke pasur kurdoherë parasysh që të mos cenohej njësia e Partisë dhe duke pasur kurdoherë sytë hapët kundër të gjithë elementeve të sëmurë dhe grupashë që përpinqeshin nga brenda të na dëmtonin. Ajo na mësoi të jemi në

luftë të ashpër dhe të paprerë me të gjithë elementët antiparti, sepse, pa një luftë të tillë dhe pa një pastrim radikal të këtyre elementeve, kurrë Partia nuk mund të shkonte përpara, kurrë nuk mund të kishte sukseset politike që ka korru dhe kurrë nuk do të mundnim të zgjeroreshim dhe të forcoheshim organizativisht. Ajo na vuri përpara problemin me rëndësi të lartësimit të kuadrove të Partisë dhe të pajisjes së tyre me një njo-huri të shëndoshë marksiste-leniniste si edhe me një eksperiencë praktike dhe ushtarake. Konferenca parashikoi me plot të drejtë nevojën e ngutshme të këtyre kuadrove, sepse na paraqiteshin përpara probleme me rëndësi si vendimi për luftë kundër okupatorit, formimi i Ushtrisë sonë Nacional-Çlirimtare. Në kohën kur bë-hej konferenca, Partia jonë po ndërmirte një punë me përgjegjësi të madhe dhe kuadri ynë i ri nuk do të mundte dot të kryente me sukses detyrat e shumta dhe të ndryshme dhe nuk do të mundte të dallonte ndryshimin midis çështjeve aktuale kryesore dhe çështjeve të vogla në situata të komplikuara, në qoftë se nuk punohej mjaft për ngritjen e nivelit politik dhe teorik të tij. Për këtë arësyje Konferenca e parë e Vendit na vuri përpara problemin me luftue energjikisht kundër paditurisë, nga e cila rrjedhin shumë gabime dhe devijime. Konferenca e Vendit, ndërmjet të tjera, konstatoi se s'ishte bërë mjaft për fshatarësinë dhe se duhej me çdo kusht të dyfishonim aktivitetin tonë për ta hedhur atë në luftë, për t'ja bërë të qartë këto direktiva të Partisë dhe për ta bërë atë faktor kryesor në këtë luftë si dhe mbështetje për Partinë tonë; në atë konferencë u theksua se s'ishte bërë mjaft për me forcuar bashkimin e po-

pullit shqiptar, për me organizue ndër fshatra dhe qytete këshillat nacional-çlirimtare, që do të ishin me të vërtetë organet e pushtetit demokratik popullor dhe të Luftës nacional-çlirimtare dhe që do të ishin, tok me Ushtrinë tonë Nacional-Çlirimtare, ato që do të shkatërronin pushtetin fashist. Konferenca na theksoi se duhej popullarizuar Bashkimi Sovjetik, Ushtria e Kuqe, aleanca në mes të aleatëve si edhe lufta heroike e popujve të robëruar. Këto ishin, në përgjithësi, direktivat që muarën delegatët e Partisë në Konferencën e Vendit dhe që i shpërndanë në gjithë organizatat për t'i zbatuar në jetë dhe në luftë.

Deri ku organizatat tona të Partisë i kanë zbatuar këto direktiva? Kurdoherë është theksuar rëndësia e çështjes organizative. Kuptimi i vërtetë i kësaj çështjeje nga ana e anëtarëve, si udhëheqës ashtu dhe anëtarë të thjeshtë, do të ishte një faktor i rëndësishëm në mbarëvajtjen e Partisë, në zgjerimin dhe forcimin e radhëve të saja dhe në zhvillimin dhe zmadhimin e luftës dhe të Ushtrisë Nacional-Çlirimtare. Organizativisht Partia jonë është bërë më e fortë dhe ka bërë hapa përpara. Ajo është pasuruar me eksperiencën e vet dhe me eksperiencën e partive të tjera komuniste. Ajo është lidhur ngushtë me masat e popullit dhe sidomos në Shqipërinë e Jugut dhe në Shqipërinë e Mesme. Para konferencës, organizata ishte hedhur në gjerësi dhe jo sa duhej në thellësi, dhe kjo u dha shokëve të kuptojnë se një punë e tillë nuk do të sillte përfitim të madh, se populli do të kishte vetëm një simpati për Partinë tonë, simpati që do të ndërrohej me fatin e ngjarjeve. Duhej që Partia jonë të kishte rrënëjë të forta në popull, të lidhej ngushtë

me të, të lidhej me shtresat fshatare dhe punëtore e të forconte influencën në këto shtresa të popullit. Në këtë drejtim punuan organizatat e Partisë, dhe kemi pasur rezultate të kënaqshme. Në radhët e Partisë sonë elementi fshatar nuk numërohet me gisht si përpara konferencës, por ai përbën një përqindje të madhe, gjithashtu edhe elementi punëtor dhe i vobektë. Shokët kuptuan rëndësinë e fshatit dhe mësuan se si hyhet në fshat, ata kuptuan se fshatarin e shtyn, më tepër se të tjerat, sistemi i skllavërisë fashiste, të hidhet në Luftën nacional-çlirimtare dhe të bashkohet e të lidhet ngushtë me Partinë tonë, mbrojtësen e interesave të tija kundër fashizmit robërues dhe shfrytëzues. Në qytete lufta ka shkuar më mirë. Numri i anëtarëve të Partisë është shtuar; puna në fshat gjithashtu është zgjeruar dhe është kuptuar më me seriozitet. Kështu i është dhënë rëndësi punës së këshillave nacional-çlirimtare dhe është kuptuar rëndësia e tyre. Zhvillimi i punës nuk ka pasur të njëtin hov në Jug e në Veri. Në Jug puna mori një zhvillim më të madh, por në Veri ajo nuk pati po këtë rritje. Megjithëse organizata e Shkodrës ka përparuar, ajo nuk është çliruar prej atyre plogështive të vjetra. Në disa vise të Shqipërisë së Veriut, kemi disa pikë mbështetjeje, po nuk kemi organizata partie, dhe shokët që kemi atje kanë mbetur të shkëputur.

Në Konferencën e parë të Vendit u konstatua se që prej formimit të Partisë organizata e Rinisë Komuniste ishte zgjeruar dhe kishte arritur të grumbullojë rreth vetes një masë të Rinisë Antifashiste; kjo konferencë vuri përpara organizatës së Rinisë Komuniste këto detyra kryesore: forcimin e saj, mobilizimin e gjerë të ri-

nisë në luftë dhe shtimin e kuadrove të Partisë me elementë të rinj. Në fillim Rinia Komuniste ishte fare pak e lidhur me fshatin dhe për këtë punë janë dërguar të rinj ndër krahina për të bërë mobilizimin e rinisë. Por organizata e rinisë ka pasur mjaft të meta dhe gabime që e kanë penguar të shkojë përpara. Është bërë specializimi në punët me rininë dhe kjo ka shkaktuar një paralelizëm me punën e Partisë dhe një farë indipendence, gjë që mund ta largojë rininë nga udhëheqja e afërt e Partisë. Nga kjo mund të lindin shkëputje, me gjithëse nuk ka asnjë simptomë. Nuk është kuptuar sa duhet roli i Rinisë Komuniste në Bashkimin e Rinisë Antifashiste. Është fshehur roli dhe ekzistenca e kësaj organizate. Kështu, organizata e Rinisë Komuniste ka humbur brenda asaj të Rinisë Antifashiste dhe ka punuar pak për të shtuar radhët e saj brenda kësaj organizate. Shokët e rinisë janë treguar sektarë në zgjerimin e kësaj organizate e sidomos me elementin fshatar. Nuk është punuar për ngritjen politike dhe teorike të rinisë, botimet kanë qenë të pakta dhe gjëja më kryesore është se është folur pak për Partinë dhe për të ndrequr gabimet janë bërë disa ndryshime në format organizative të rinisë. Janë hequr bërthamat që kishin arritur të merrnin formën e një forumi dhe që me pikëpamjet e tyre të ngushta pengonin zgjerimin dhe forcimin e radhëve të rinisë. Ky ndryshim do të ndihmojë zgjerimin dhe lartësimin e rinisë, rinia do të jetojë më afër Partisë dhe gjithë shokët e Partisë do të njojin punën e rinisë. Gjithashtu edhe në ushtri janë shpërndarë bërthamat e rinisë të batalioneve të rinisë dhe aktivet janë

vënë në lidhje me përgjegjësin e rinasë në celulë. Dë të krijojen dhe komitetet e rinasë ndër batalione dhe brigada, të cilat do të udhëheqin rininë në ushtri. Me një punë të vazhdueshme në organizatën e rinasë, me një rini luftarake, Partia jonë do të ketë mbështetje të fortë të rinia, prandaj duhet t'i vihet rëndësi kësaj çështjeje, dhe riorganizimi i Komitetit Qendror të Rinasë të merrët në diskutim nga ju.

Në radhët e ushtrisë sonë është bërë mjaft punë, dhe për me e pasë këtë të fortë dhe të pajisur me të gjitha cilësitë morale që lyp kjo luftë, duke pasur kurdoherë parasysh rolin e madh që do të luajë në të ardhmen, duhej që të krijojeshin atje organizata të Partisë. Për këtë shkak shokët më të mirë, udhëheqësit që kishin fituar deri diku një farë eksperience ushtarake, politike dhe organizative, u hodhën në rreshtat e ushtrisë dhe ju përveshën punës për krijimin dhe forcimin e ushtrisë dhe të organizatës brenda në ushtri. Ata u përpoqën të mos ishin sektarë në rekrutimin e partizanëve dhe nga lufta të mundnin të nxirrin elementët më të vendosur për Partinë. Njësitet dhe batalionet tona u mbushën me partizanë të rinj, me një shumicë të madhe katundarësh dhe këto njësitë u bënë brigada e u priten me dashuri të madhe në popull, sidomë që ky është varfëruar nga lufta dhe ekonomikisht ndodhet në një gjendje të vajtueshme. Portat e Partisë u çelën për elementët e vendosur dhe që e donin Partinë e jepnin jetën për të. U krijuan celulat në njësitë e ndryshme, u krijuan byrotë e batalioneve dhe këto u lidhën ngushtë me Komitetin Qendror të Partisë. Kështu që nga Konferanca e Vendit e deri tanë ne mund të themi se kemi një

ushtri më të fortë, më të organizuar dhe kemi një organizatë partie të shëndoshë në këtë ushtri.

Me gruan janë bërë hapa të mëdha. Është zhdukur deri diku ajo frymë sektare që shihej ndër shokët përsa i përket punimit në këtë sektor. Tani gruaja shqiptare merr pjesë aktive në luftën tonë, partizane të vendosura luftojnë me guxim në radhët e ushtrisë, dhe në terrene gruaja shqiptare jep një kontribut të madh. Organizativisht kemi bërë një hap përpala në këtë sektor, duke formuar këshillat e grave antifashiste në disa qytete e disa fshatra, por duhet mjaft punë akoma që organizata e Bashkimit të Gruas Antifashiste të qëndrojë në një radhë me organizatat e tjera që luftojnë në frontin tonë.

Por nuk duhet që këto suksese të dukshme që kemi pasur në fushën organizative të na vënë në gjumë. Duhet të shohim me imtësi të metat, gabimet dhe lëshimet që janë bërë gjatë punës dhe luftës, t'i ndreqim këto gabime dhe të mos i përsëritim. Duke i njojur mirë shokët dhe organizatat, ne mund të shkojmë përpala. Sukseset të mos na verbojnë, pse bash për këto suksese armiku po shton goditjet kundër nesh, dhe një lëshim i vogël i kushton shumë Partisë dhe luftës.

Mjaft shokë nuk kanë qenë shumë vigjilentë përruajtjen e radhëve të Partisë nga elementët e sëmurë grupashë. Me gjithë direktivat dhe vendimet e marrura në Konferencën e Vendit kundër këtyre elementëve që paraqiteshin të rrezikshëm, disa shokë neglizhuan mjaft vëzhgimin e tyre dhe këta elementë e dëmtuan mjaft punën. Në Vlorë, nga që shokët e kësaj krahine nuk muarën masat e duhura kundër tradhëtarit

Sadik Premtes, doli një farë fraksioni në atë krahinë, kundër të cilit u muarën masa dhe u ndalua me kohë. Megjithatë Sadik Premtja, i cili i shpëtoi dënimit, mundi të tërhiqte disa elementë në tradhëtinë e tij, dhe sot i shohim këta elementë në radhët e armiqve më të mëdhenj të popullit tonë dhe të Partisë. Duhet të dimë se elementi grupash, i tronditur, kur Partia është në fitime, ringjallet dhe manifestohet në format e ndryshme. Kur reaksiioni është i fortë dhe kur goditjet janë të rënda nga ana e armikut, atëherë ata bëjnë folcnë në elementët e sëmurë e të lëkundshëm që vegjetojnë në radhët e Partisë dhe përpiken të na godasin nga brenda. Këtë dimër, kur gjermani dhe reaksiioni u përpoqën të na goditnin me forcë të madhe, u dukën lëkundje në disa elementë të dobët dhe moskënaqësi e kritika nga disa të tjerë. Tradhëtarët si Xhelal Staravecka e disa të tjerë u hodhën nga ana e armikut dhe na hapën një luftë të ndyrë, luftë që shkaktoi lëkundjen e një numri të rinjsh ende të paformuar dhe jo të regjur në luftë. Këto ngjasin, se shokët nuk bëjnë shumië kujdes dhe harrojnë shpejt dëmin e madh që i sjellin Partisë këta elementë. Armiku më i madh është ai që harrohet, thotë Stalini, dhe shokët tanë s'duhet të harrojnë fjalët e mësuesit tonë të madh. Shfaqje moskënaqësie dhe sëmundje grupazhi janë dukur në Berat, Tiranë, Gjirokastër. Veçanërisht në Berat këto morën një formë të dukshme me tradhëtinë e Xhelal Staraveckës, i cili mori një prehrin e tij ata elementë tradhëtarë që dezertuan nga kjo organizatë. Në Tiranë lëkundje u shfaqën në radhët e disa të rinjve të gënjer nga propaganda e renegatëve dhe e armikut, por që nuk patën rrjedhime se-

rioze. Në Gjirokastër gjithashtu këto shfaqje moskënaqësie dhe kritika, të ardhura prej elementeve intelektualë të sëmurë, s'kanë qenë serioze, por të mjafta për të bërë që shokët të mos flenë. Duhet të kenë parasysh shokët se s'kemi aq kohë për me i bindë këta elementë të sëmurë, por duhet të marrim masa kundër tyre sa më parë. Në shumë raste shokët harrojnë rrrezikun e madh që i vjen Partisë nga elementët trockistë të njohur. Asgjë s'duhet që t'i lëkundë këta shokë në besimin karshi masave që ka marrë Partia për ta. Trockisti Zai Fundo, i kthyer nga Italia në Kosovë¹, është kurdoherë armik i betuar i Kominternit dhe i Partisë sonë. S'duhet aspak të harrojmë edhe trockistët Fallo, Zisi Andrea, Niko Kondi etj., të cilët zhvillojnë një aktivitet kundër nesh dhe janë në bashkëpunim të hapët me armikun.

Sado që organizatat tona kanë mbajtur kurdoherë qëndrime të qarta me anë të shtypit në çdo moment me rëndësi dhe kanë demaskuar okupatorin dhe shërbëtorët e tij, përsëri në shumë raste ato nuk kanë ditur të mbajnë qëndrime të prera dhe të zbatojnë imtësisht direktivat që u janë dhënë. Bazi i Canës e «Legaliteti» nuk janë demaskuar si duhet. Shokët janë kënaqur të riprodrohjnë një rezolucion të Këshillit², por nuk i kanë rënë problemit në kokë dhe ta demaskojnë Bazin dhe punën

¹ Pas kapitullimit të Italisë fashiste Zai Fundo u dërgua nga Inteligens Servisi në Kosovë për të përçarë lëvizjen nacional-çlirimtare. Në shtator 1944 u kap së bashku me misionet ushtarake angleze pranë forcave reaksionare dhe u dënuar nga gjyqi partizan.

² Rezolucionin c 7 dhjetorit 1943 të Kryesisë së Këshillit të Përgjithshëm Nacional-Çlirimtar.

që bën ai në mënyrë që të mos mundë dot të gënjejë popullin me demagogjinë dhe qëndrimin e tij në mal.

Monopolizimi i punës vazhdon të shihet e të manifestohet jo vetëm ndër shokë që punojnë në organizatat e terrenit, por edhe në ato të ushtrisë. Shumë shokë bëjnë njëkohësisht punën e komisarit, të zëvendëskomisarit dhe të komandantit. Në terren gjithashtu nuk u lihet iniciativë shokëve të rinj. Kjo ka rrjedhime të këqia se ndalon çdo iniciativë të shokëve, ndalon përparimin e tyre dhe pengon mbarëvajtjen e punës, qoftë edhe sikur ky monopolizim të bëhet pa tendenca.

Nga dobësimi i lidhjes së fortë më celulat, shumë herë, në momente reaksioni, komitetet qarkore kanë qenë të shkëputura me celulat dhe në pamundësi t'i udhëzojnë dhe t'i ndihmojnë tamam në momentet më të vështira. Në disa krahina shokët kanë lënë fare terrenin dhe janë larguar që të gjithë, pa marrë parasysh se lënja e terrenit në dorë të armikut shkakton një humbje të madhe për ne. Një gjë e tillë ka ngjarë në Vlorë. Komiteti qarkor i Vlorës ka humbur çdo lidhje me qytetin brenda. Megjithëse reaksioni atje ishte i madh dhe duheshin shpëtuar kuadrot nga goditjet e rënda të armikut, përsëri duheshin lënë disa anëtarë partie që të vazhdinin punën. Duhet, pra, të merren masa për ndreqjen e këtij gabimi sa më shpejt dhë të evitohet përsëritja.

Shokët e Gjirokastrës kanë bërë disa gabime organizative, të cilat duhet të mos përsëriteren herë tjetër. Këto kanë edhe një karakter politik, se janë të lidhura me çështjen e minoritetit grek. Lejuan formimin e disa institucioneve krejt të ndryshme nga ato të frontit. Kjo zhshkaktohet nga që shokët s'e kanë të qartë çështjen e

nacionaliteteve, çështje shumë delikate e që mund të na shkaktojë shumë dëm në qoftë se nuk jemi të kujdesur. Gabime të tjera kanë bërë në interpretimin e Rregullorës së Këshillit të Përgjithshëm, dhe rezultatet kanë qenë në mbrojtjen e agallarëve dhe në dëm të bujqve, duke ndihmuar marrjen e së tretës prej këtyre elementeve që s'bën pjesë as në frontin tonë, por mbanin shumë herë një qëndrim armiqësor kundër nesh. Një gabim tjetër i madh dhe i dëmshëm për Partinë e përlëvizjen është marrja e së tretës prej bujqve të Dishniciës gjoja në ndihmë të frontit. Me këtë gjë ata përpëra bujqve s'bën tjetër, veçse po atë punë që bënte edhe agai.

Dekonspirimi na ka shkaktuar mjaft dëme. Me kapitullimin e Italisë shumë shokë, duke mos i peshuar aq mirë situatat, kujtuan se mbaroi lufta dhe filluan të punojnë e të veprojnë haptazi. Shokët e rinj dhe të panjohur prej armikut u zbuluan. Kjo shkaktoi goditje të rënda në kurri të organizatave.

Për ngritjen e kuadrove kujdesi nuk ka qenë i mjaftueshëm, bile është lënë mangut. Kuadrot duhet t'i ngrinim dhe të kujdeseshim për to në një mënyrë të veçantë, se me kuadro bëhet çdo gjë. Shokëve nuk u është dhënë aq sa duhet ndihma të njihnin teorinë marksiste-leniniste me anën e një organi të Komitetit Qendror, i cili na ishte vënë si detyrë nga ana e konferencës për ta nxjerrë dhe që ne ende nuk po e nxjerrim. Për t'i ngritur këto kuadro duhesin bërë konferenca dhe kurse të ndryshme, duhet t'u vinim në dorë literaturën marksiste-leniniste dhe sidomos «Historinë e Partisë Komuniste (bolshcvike) të URSS-it». Përkthimi

i historisë dhe riprodhimi i saj na ishte vënë si një detyrë kryesore nga ana e konferencës. Deri tani ne nuk kemi shtypur veçse dy kapituj. Ky është një lëshim që nuk na falet. Na ishte vënë si detyrë gjithashtu të bënim një kurs të lartë dhe ky të organizohej prej shokëve të Komitetit Qendror. Ky kurs ende nuk është bërë.

Një gabim tjetër, që shihet në shokët e Partisë në ushtri, është mospërfillja aq sa duhet e punës organizative në radhët e partizanëve. Çdo gjë i është kushtuar luftës me armë dhe pak interesim tregohet për ngritjen e kuadrove politikisht. Kjo është lënë në fatin e vet. Kuadrot më të shumtat e herës s'janë të zonjat të mbajnë një konferencë ose të zgjidhin ndonjë çështje që u del përpara. Disa komisarë politikë as që janë në korrent të direktivave dhe të qëndrimeve politike karshi rrymave të ndryshme që paraqiten. Kjo rrjedh se nuk bëjnë një jetë intensive të Partisë dhe nuk kanë arritur të kuptojnë se celula është shkolla e vërtetë e komunistit. Në ushtri, ku duhet të kemi kuadro të forta, se atje shokët mbruhen në luftë e në përpjekje, ende shohim mungesa dhe lëshime. Në radhët e ushtrisë janë rekrutuar anëtarë partie, por në vend që këta të edukohen është lartësohen, ata janë lënë pas dore. Përsa u përket disiplinës dhe respektit karshi udhëheqësve ushtarakë në detyrë ato janë të dobëta, dhe kjo rrjedh se janë kuptuar keq disiplina dhe respekti partizan. Disa nga repartet tona nuk kanë fituar ende fryshtën ofensive, por shumë herë ato vazhdojnë të bëjnë një luftë mbrojtjeje dhe, në rastet kur ato janë në luftë me armikun dhe e thyejnë këtë, nuk e vazhdojnë sulmin deri në shfarosjen e armikut. Disa herë në ushtri shihet në disa

raste tendenca me shkue majtas dhe me ra në gabime politike. Kudo që shkohet nuk flitet veçse për Partinë, dhe disa shokë përgjegjës në ushtri e përdorin emrin e Partisë në vend të Frontit Nacional-Çlirimtar. Këtyre shokëve u duket sikur i sjellin fitim çështjes duke vepruar në këtë mënyrë, por kjo e dëmton luftën dhe frikëson ata elementë që nuk kanë simpati të veçantë për komunizmin, por që duan të luftojnë okupatorin dhe mund të bashkohen me frontin. Partia duhet të popullarizohet shumë, por të qëndrojmë kurdoherë brenda kuadrit të Luftës nacional-çlirimtare. Duhet me u vënë kujdes të veçantë njerëzve që e duan luftën, dhe ata elementë të pabindur dhe të lëkundshëm me i bindë me një durim të mjaftueshëm, duke u munduar t'i bëjmë aleatë, se është më mirë me pasë një aleat të lëku ndshëm se sa një armik. Për këtë shkak duhet të jemi të zgjuar dhe të kemi kujdes në parullat tonë, se lufta s'ka mbaruar.

Shokët në përgjithësi, qoftë në terren, qoftë në ushtri, çështjen e dashurisë së lirë e kanë keqkuptuar dhe shumë herë kanë gabuar. Dashurinë e lirë e kanë kuptuar ngurt dhe kanë marrë vendime disa herë të hidhura. Kjo çështje, aq delikate, duhet t'u bëhet e qartë të gjithë shokëve, sidomos shokëve të rinisë. Të mos lejohen shfaqje të imoralitetit, por të mos biem në pozitat e murgut për të shtypur çdo ndjenjë të pastër, çdo sentiment në të rinjtë.

Shokët e Partisë duhet, nga ana tjetër, të kenë kujdes në sjelljet e tyre, ata duhet tëjenë shembull për të tjerët si në jetën personale ashtu edhe në luftë.

Kritika dhe autokritika ende nuk zhvillohen ashtu

si duhet të ngjasë në një parti komuniste të vërtetë, kjo tregon papjekurinë e shokëve. Ka shokë që ndruhen të hapin zemrën, të pohojnë dhe të njojin gabimet, të korrighohen, dhe kjo i shtyn në gabime më të mëdha e që dëmtojnë rëndë Partinë.

Në organizatat e terrenit si edhe në ushtri shihet një burokratizëm i tepruar, i cili jo vetëm që frenon punën, por e bën këtë të dobësohet, kuadrove ua pret hovin e punës dhe i shtyn në dembellëk e në një punë rutine.

Në punën me këshillat nacional-çlirimtare shokët shumë herë kanë gabuar, duke zgjedhur elementë të papërshtatshëm në këto këshilla dhe ka raste që kanë sjellë këtu edhe elementë antipopullorë. Dësa herë puna bëhej formale dhe, duke mos ditur të silleshin me elementët që merrnin pjesë në këto këshilla, ata u imponoheshin nga lart, duke vënë përpara autoritetin e Partise. Shumë herë shokët nuk kanë kuptuar rolin e madh të këshillave dhe punën e tyre si organe të pushtetit demokratik, por i kanë përdorur këto vetëm për nevojat e ngutshme të ushtrisë.

Nga pikëpamja organizative para Komitetit Qendror paraqiten dy probleme, të cilat duhet të zgjidhen. Doktor Dishnica ka bërë gabimin e Mukjes, i cili i ka kushtuar mjaft Partisë dhe i ka dhënë një armë në dorë ar- mikut dhe ballistëve për me e luftue Partinë si shkaktare të prishjes së vendimeve të Mukjes. Për këtë gjë Byroja e Komitetit Qendror ka përjashtuar Doktorin nga Byroja dhe e paraqet çështjen përpara Komitetit Qendror¹.

¹ Plenumi vendosi përjashtimin e Ymer Dishnicës nga Komiteti Qendror i PKSH.

Gjin Marku ka bërë gjithashtu një gabim të madh, që e ka dëmtuar shumë prestigjin e Partisë; ky është kompromisi me gjermanët pas kapitullimit të Italisë. Një gabim themeltar të tillë nuk do të guxonte ta bënte as një anëtar i thjeshtë i Partisë dhe jo një udhëheqës, anëtar i Komitetit Qendror. Byroja kundër Gjinit s'ka marrë ende ndonjë masë, prandaj e paraqet çështjen para Komitetit Qendror dhe ky të marrë masat¹.

Shokë,

Duhet të gjithë ta kemi kuptuar rëndësinë e përgjegjësisë së punës që na është ngarkuar dhe nuk na lejohet më të bëjmë lëshime dhe gabime që dëmtojnë Partinë dhe luftën tonë. Duhet ne veçanërisht të bëjmë kujdes, se nga ne pret gjithë organizata, ne duhet të jemi shembull i mirë për anëtarët e Partisë dhe për gjithë popullin. Përpara nesh kemi luftime të reja dhe na duhet të marrim qëndrime që do tëjenë vendimtare; për këtë shkak ne duhet të jemi të preqatitur, të kemi Partinë më të fortë se kurrë, me kuadro të shëndosha dhe të edukuara si ushtarakisht dhe politikisht, që të mundim kësosoj të përballojmë çdo situatë që do të kri-johet. Para nesh paraqiten perspektiva të rëndësishme, për të cilat ne duhet të kemi parashikuar masat dhe qëndrimin tonë, së paku nën vija të përgjithshme. Përpara ofensivës dhe avancimit të Ushtrisë së Kuqe drejt Rumanisë dhe vendeve të tjera të Ballkanit, ne duhet

¹ Plenumi vendosi përjashtimin e Gjin Markut nga Komiteti Qendror i PKSH.

të forcohemë si ushtarakisht dhe politikisht, dhe Partia jonë të grumbullojë rreth vetes gjithë popullin punëtor dhe fshatar, se me avancimin e Ushtrisë së Kuqe proletariati i gjithë Evropës, dhe i Ballkanit veçanërisht, në një kohë të afërme do të luajë një rol vendimtar. Partia Komuniste, udhëheqësja dhe pararoja e çelnikëtë e popullit në këtë luftë, do të ketë ndihmën më të madhe nga Bashkimi Sovjetik. Paraqitet eventualisht edhe mundësia e një zbarkimi aleat në Ballkan. Ky zbarkim duhet të na gjecjë të fortë dhe të organizuar, që kështu të mos lejojmë që në një mënyrë ose tjetër, këta të ngatérrohen në punët tona të brendshme, dhe t'i bëjmë të respektojnë Kartën e Atlantikut dhe vendimet e marrura në Konferencat e Moskës e të Teheranit. Të mos harrojmë se në Angli dhe në Amerikë ekzistojnë reaksionarë, të cilët përpinqen të fitojnë luftën, duke pasur së më pak dëme. Këta elementë, të cilëve u intereson zhdukja e fashizmit, se ky kërcënon ekzistencën e tyre, janë në luftë me Gjermaninë, por nuk i shohin me sy të mirë lëvizjet nacional-çlirimtare në Evropë, se njëkohësisht me zmadhimin e këtyre lëvizjeve, zvogëlohet posibiliteti i shfrytëzimit të popujve nga ana e tyre. Në një vend si Inglitera dhe Amerika, ku kapitali është i zhvilluar, nuk mund të jetë zhdukur influenca e tij, i cili i ka rrënjet mjaft të forta, si në rrethet qeveritare të këtyre vendeve ashtu edhe në ato ushtarake. Ngjet, pra, që këto shtresa reaksionare do të përpinqen të përkrahin dhe të gjejnë elementë për t'i përdorur si një kundërbalancim për forcat tona nacional-çlirimtare. Këto tendenca mund t'i shohim në oficerët e misionit britanik në Shqipëri. Këta s'mungojnë të bisedojnë me elemen-

të reaksionarë dhe t'i përkrahin këta, t'i reabilitojnë në sy të popullit, të dërgojnë misione tëk elementët tradhëtarë si Bazi i Canës e krerët e Dibrës me të vetmin qëllim që t'i ngrenë përpara popullit për t'i përdorur më vonë. Këta oficerë bëjnë mjaft për të mos popullarizuar sa duhet lëvizjen tonë, dhe qëllimi kryesor i tyre është të kërkojnë të ndërhyjnë në punët tona organizative. Për këtë shkak ne duhet të kemi kujdesin më të madh dhe në asnjë mënyrë të mos lejojmë që këta të përzihen në çështjet tona organizative dhe të mos 'u japim asnjë informatë me karakter ushtarak e organizativ që mund të dëmtojë Partinë dhe Ushtrinë Nacional-Çlirimtare.

Duhet të kemi parasysh edhe një tërheqje eventuale të gjermanëve nga Shqipëria, dhe kjo gjë të mos na gjejë në befasi dhe të papregatitur. Duhet t'i pregatitë shokët në këtë drejtim dhe, nga ana tjetër, të zhdukim atë mentalitet që ndjehet në shumë shokë e partizanë se me ikjen e gjermanëve ne i kemi mbaruar gjithë punët dhe presim këtë mbarim për të lëshuar armët e për të shkuar në shtëpi. Duhet t'ua bëjmë të qartë shokëve dhe ushtrisë se armët nuk do t'i lëshojmë kurrrë, por do t'i mbajmë në dorë, derisa vendi ynë dhe populli shqiptar të ketë fituar liritë e plota dhe derisa të mos mbetet këmbë armiku në vendin tonë.

Duke përfituar nga eksperienca e së kaluarës, vëçanërisht që prej Konferencës së parë të Vendit, duke mësuar nga gabimet tona, ne duhet të ecim përpara me hapa gjigante drejt bolshevizmit të Partisë dhe ta shohim kthjelltë përfundimin e luftës dhe të ardhmen tonë. Garancia më e madhe për fitoren tonë është unite-

ti i Partisë. Kemi detyra karshi Partisë, karshi popullit tonë, duhet që këto detyra t'i kryejmë dhe të gjitha do t'i kryejmë, po t'i përvishemi punës me vendosje, duke mos kursyer as jetën tonë.

*Botohet për herë të parë, si-
pas origjinalit që gjendet në
Arkivin Qendror të Partisë*

R A P O R T
NË KONGRESIN I ANTIFASHIST
NACIONAL-ÇLIRIMTAR¹

24 maj 1944

**ZHVILLIMI I LUFTËS NACIONAL-ÇLIRIMTARE TE
POPULLIT SHQIPTAR NË LIDIJE ME NGJARJET
NDËRKOMBËTARE**

Populli shqiptar, i shtypur ekonomikisht dhe politikisht, i shfrytëzuar deri në palcë prej regjimit politor të Zogut, u gjend i izoluar politikisht nga bota e jashtme dhe i dezorientuar, kur ushtritë fashiste italiane sulmuan vendin tonë më 7 prill të vitit 1939.

Xhelati i popullit shqiptar, Ahmet Zogu, që urrehet nga mbarë populli ynë, sepse, i ardhur në fuqi me forcë kundër vullnetit të popullit, gjatë sundimit të tij

¹ Kongresi I Antifashist Nacional-Çlirimtar zhvilloi punimet nga 24—28 maj 1944 në qytetin e çliruar të Përmetit. Ai zgjodhi Këshillin Antifashist Nacional-Çlirimtar si trupin më të lartë legjislativ dhe ekzekutiv që do të përfaqësonte sovranitetin e popullit shqiptar, si brenda dhe jashtë vendit, aprovoi Komitetin Antifashist me atributet e qeverisë së përkohshme popullore me President shokun Enver Hoxha. Kongresi hodhi themellet e shtetit të ri shqiptar të demokracisë popullore dhe vendo-

ka përdorur terrorin më të zi. Ai dhe regjimi antipullor i tij kishin shkaktuar ditët më të zesa të urisë e të varfërisë, kishin shtypur çdo frymë përparimi dhe liri demokratike, kishin lidhur fatin e vendit tonë në të gjitha pikëpamjet me Italinë e Musolini, dhe në ushtrinë shqiptare e në shtatmadhorinë e saj ishin agjentët e Italisë fashiste që sundonin dhe drejtonin. Kështu, zbarkimi i italianëve në Shqipëri e gjeti popullin tonë në një gjendje të mjeruar ekonomike, shpirtërore dhe ushtarake dhe që ai s'mundi dot të përballonte invadimin dhe kapitullimin e turpshëm që sistematikisht kishin preqatitur Zogu dhe qeveritarët e tij të shitur nëpërmjet të një zinxhiri tradhëtie.

Shqipëria hynte në një robëri të rëndë, në një robëri që s'e kishte parë kurrë gjatë ekzistencës së vet dhe që do t'i kushtonte kaq gjak, lot dhe vuajtje.

Me gjithë revoltimin e ditëve të para të prillit, me gjithë demonstratat dhe tentativat për luftë, me gjithë rezistencën e patriotëve në Durrës dhe Vlorë, ne nuk mundëm të mbanim atë vrull të rezistencës të popullit, sepse armiku, i armatosur deri në dhëmbë, kolona e pestë e tij, e preqatitur prej agjentëve fashistë italianë dhe shqiptarë të shitur, demagogjia e tyre, rihapja e disa

si t'i ndalohej Zogut kthimi në Shqipëri, të mos njihej asnjë qeveri tjetër që mund të formohej brenda ose jashtë Shqipërisë, kundër vullnetit të lirë të popullit, të anuloheshin të gjitha marrëveshjet politike dhe ekonomike që kishte lidhur qeveria e Zogut me shtetet e huaja, të vazhdohej lufta kundër pushtuesve gjermanë dhe tradhëtarëve shqiptarë deri në shkatërrimin e tyre të plotë dhe vendosjen e pushtetit të demokracisë popullore në të gjithë vendin.

punëve me karakter ushtarak dhe zgjerimi i marrëdhënjeve tregtare me Italinë, influencuan për neutralizimin në një farë shkalle të rezistencës sonë. Populli shqiptar nuk kishte preqatitjen e duhur politike; megjithëse ai është urrente për vdekje okupatorin italian, nuk e njihte mirë fashizmin dhe konsekuençat e këtij regjimi barbar, sepse mungonte një parti përparimdashëse në Shqipëri, e cila të mund të krijonte me kohë një front antifashist. Kështu që në kohët e para një pjesë nga populli u mashtrua deri diku prej fashizmit, por neutralizimi i rezistencës sonë nuk vazhdoi një kohë të gjatë, se u ringjall ndërgjegjja e kombit të shtypur dhe populli shqiptar e kuptoi thellë katastrofën ku ishte futur atdheu, konkretizoi urrejtjen dhe mërinë kundër okupatorit. Ai pa dhe kuptoi qëllimet robëruese dhe imperialiste të fashizmit dhe me greva e demonstrata zgjeroi rezistencën e tij heroike, rezistencë e një populli të vogël që preferonte më mirë të zhdukej se të rronte në gjunjë. Mori hov rezistenca kundër okupatorit, kundër pseudonacionalistëve tradhëtarë që priten me krahë hapur ushtritë italiane dhe kundër atyre që gjoja qëndronin në mërgim gjatë regjimit të Zogut dhe që në marrëveshje të plotë me njerëzit e Romës fashiste u kthyen në atdhe për të vazhduar tradhëtitë e tyre. Okupatori italian solli në fuqi tradhëtarët e ndyrë Shefqet Vërlacin, Mustafa Krujën, Maliq Bushatin, Eqrem Libohovën etj. dhe me ndihmën e këtyre fillooi të zbatojë planin e tij të errët për zhdukjen e popullit shqiptar, për shkombëtarizimin e tij, për ta përdorur këtë si mish topi në luftërat e tij skllavëruese në kurriz të popujve të tjera liridashës. Tradhëtarët u përpoqën të

bashkonin rrëth tyre nacionalistët dhe t'i bënин pjesë integrante të tradhëtisë së tyre dhe të kompromisit. Shumë reaksionarë u bashkuan me ta dhe i ndihmuani në intrigat dhe në masat e tyre terroriste kundër popullit. Ata luftuan me tërbim të gjithë patriotët, të gjithë ata që ishin kundër okupatorit; pa mëshirë vranë, varën, burgosën dhe internuan me qindra njerëz, sulmuan dhe dogjën katunde të tëra. Por lëvizja e popullit shqiptar nuk u shua. Okupatori dhe kuislingët jo vetëm që nuk ishin në gjendje të zhdukninurrejtjen e popullit kundër okupatorit, por ata s'mundën me e luftue lëvizjen nacional-çlirimtare që po forcohej. Fashizmi e kuptoi mirë rrezikun e kësaj lëvizjeje dhe mendoi ta shtypet që në hapat e para me çdo mjet.

Përpjekjet e tyre për të përçarë popullin, për të tërhequr nationalistët e ndershëm në pozitat e tyre, s'patën suksesin që shpresonin, se në momentet më të vështira të historisë sonë një organizatë doli nga gjiri i popullit të vuajtur: Kjo ishte Partia Komuniste e Shqipërisë, e cila vuri në shërbim të atdheut dhe të popullit jetën e anëtarëve të saj dhe çdo gjë që kishte të sajën. Ajo u bë organizuesja dhe udhëheqësja e vërtetë e popullit tonë në kryengritjen me armë kundër okupatorit dhe reaksionit më të tërbuar. Ajo ka qëndruar kurdoherë e papërkultur në ballin e luftës, kurdoherë ajo është përpjekur me bashkue të gjithë nationalistët e ndershëm dhe patriotët në një front të përbashkët kundër invazorit. Ajo u bë iniciatorja dhe organizoi në Pezë në shtator të vitit 1942 një konferencë të gjërë, ku u hondhën bazat e lëvizjes dhe të këshillave nacional-çlirimtare, organe të kësaj lufte dhe të pushtetit demokratik.

Partia Komuniste e Shqipërisë ngriti lart e më lart flamurin e Luftës nacional-çlirimtare dhe sot ajo bashkë me popullin e vet qëndron e patundur.

Konferenca e Pezës ishte një hap përpara drejt bashkimit dhe formimit të frontit, dhe kjo u dha mundësi të gjithë atyre që e duan Luftën nacional-çlirimtare të marrin pjesë aktive në të.

Filluan të krijohen njësitet e para partizane, të cilat treguan se, me gjithë skllavërinë e rëndë, me gjithë terrorin që s'ishte parë kurrë, populli ynë është i pamposhtur dhe i papërkulur dhe gati të bëjë sakrifica më të mëdha për çlirimin e tij. Njësitet, të vogla në fillim, gati pa armë e pa municione, por të pajisura me ndjenjën e lirisë dhe me një shpirt luftarak të patreguar, u zmadhuan, u forcuan, u armatosën në luftë dhe në përpjekje me okupatorin. Ato treguan se nuk mund të zhduken qoftë dhe prej forcave aq të egra dhe të armatosura, siç ishin ato të okupatorit, të cilat ishin drejtuar si bisha për të shuar lëvizjen partizane në vendin tonë. Me krimjin e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacional-Çlirimtare këto njësite kaluan në batalione e në brigada dhe sot formojnë ushtrinë tonë të rregullt, ushtrinë trime të popullit shqiptar. Ushtria jonë Nacional-Çlirimtare, e përbërë prej djemve më të denjë të këtij vendi, tok me gjithë popullin shqiptar, kanë marrë përsipër të luftojnë deri në fund okupatorin dhe t'i japin popullit lirinë e dëshiruar. Me luftime të ashpra e të paprera u spastruan krahina dhe zona të tëra nga thonjtë e armikut dhe të shërbëtorëve të tij, tradhëtarëve dhe atje është vendosur pushteti ynë demokratik. Gati gjithë Shqipëria Jugore gjëzon këtë liri e këtë pushtet,

gjithashtu dhe një pjesë e Shqipërisë së Mesme. Ushtria jonë tregoi se ishte në gjendje jo vetëm t'i jepte grushte të forta okupatorit, por edhe të zgjidhë probleme më të rënda. Ushtria jonë i dha një impuls të madh luftës është shumë krahina hovi i kryengritjes përfshiu gjithë shtresat e popullit.

Këshillat nacional-çlirimtare u krijuan në çdo vend të çliruar, gjysmë të çliruar dhe në ato të okupuara. Kjo gjë na tregon se ato u bënë bërthama e re e pushtetit popullor, pushtetit që zëvendësonte pushtetin e vjetër, i cili u vu i téri në shërbim të okupatorit. Këshillat nacional-çlirimtare i dhanë një ndihmë të madhe zhvillimit të luftës dhe të njësive ushtarake në fillim me mobilizimin e popullit, me ndihmë, me ushqime dhe me shërbime të ndryshme me karakter politik dhe ushtarak, por në kohën e krijimit të Ushtrisë Nacional-Çlirimtare dhe pas Konferencës së dytë të Labinotit ato shndërrohen në pushtetin e vetëm dhe të drejtë popullor. Përveç organizimit të rrjetës së gjerë të këshillave, të cilat u krijuan në çdo fshat, në çdo komunë, krahina ose qytete, dhe ndihmë njësive dhe Ushtrisë Nacional-Çlirimtare, përpara këshillave shtroheshin detyra të tjera të shumta. Këshilli Nacional-Çlirimtar i Përgjithshëm dhe Kryesia e tij, që u zgjodh prej Konferencës së dytë të Labinotit, përveç detyrës së centralizimit dhe forcimit të këshillave, u vunë përpara problemit për riorganizimin e jetës shoqërore në vendet e çliruara dhe përmes ngjallë ndjenjën e solidaritetit në mes të popullit që të përballohej mjerimi ekonomik i shkaktuar nga kjo luftë e përgjakshme. Kryesia kryen me sukses mobilizimin e popullit rrëth frontit dhe me vijën politike të

drejtë dhe të pathyeshme ajo ka kapërcyer çdo pengesë, ka mposhtur propagandën e reaksionit e të okupatorit dhe ka dalë fituese. Krahas me sukseset e lëvizjes nacional-çlirimtare armiku ka shtuar goditjet e tija. Me ardhjen e gjermanëve në vendin tonë reaksioni u grumbullua dhe u organizua më mirë. Gestapoja gjermane, e pajisur me një eksperencë të gjerë përsa u përket organizimit dhe grumbullimit të reaksionit, shtiu në dorën e vet të gjitha fijet që e vinin në lëvizje këtë dhe të gjithë tradhëtarët dhe klikat reaksionare, që haptazi ose fshehu-razi ishin kundër lëvizjes nacional-çlirimtare. Rreth kuislingut Mehdi Frashëri dhe qeverisë tradhëtarë të Tiranës u grumbulluan që prej «Ballit Kombëtar», që prej ish-«Bashkimit Kombëtar» e deri te «Legaliteti» me qëllim që të na asgjësonin ushtarakisht dhe ta shkë-putnin frontin nga populli dhe nga rruga e vetme e shpëtimit që kishte caktuar, nga rruga e luftës. Një demagogji e madhe u përdor prej tyre, parullat e njoitura për ta paraqitur frontin tonë të gjerë si një lëvizje thjesht komuniste, parullat e «Shqipërisë së madhe», e «Shqipërisë etnike» ishin në rendin e ditës. «Balli Kombëtar», që i vuri gjithë bandat e tija kriminale në duart e hitlerianëve, e hoqi maskën dhe haptazi mori pjesë në qeverinë kuislinge; feudalët tradhëtarë, si Shefqet Vërlaci, Ibrahim Biçaku, Vrionasit etj., vunë gjithë peshën e tyre për të grumbulluar elementë reaksionarë dhe i vunë këta në shërbim të Gestapos.

Me terror, me demagogji, me anarki, u përpoqën ta lëkundnin popullin dhe ta bënин këtë të humbiste besimin në fitore. U krijuan prej okupatorit dhe «Ballit Kombëtar» organizata të ndryshme, gjoja me programe

politike të caktuara, si «Partia Socialdemokrate», «Röja e Drejtësisë», «Bashkimi Kombëtar» etj. Por këto u treguan që ishin organizata terroriste në dorën e Gestapo-s gjakatare.

Në luftën e ashpër që i bëhej Gjermanisë dhe reaksionarëve, shërbëtorë të saj, u shoshtën radhët e frontit tonë nga elementët e dyshimtë dhe të lëkundshëm, dhe lufta i detyroi të tregonin fytyrën e tyre prej kompromisaxhiu dhe tradhëtari. Bazi i Canës ishte njëri prej tyre. Ky mori pjesë në Konferencën e Pezës dhe pranoi direktivat e asaj konference, por aktiviteti i tij luftarak ishte zero. Ai s'hidhte asnje pushkë kundër okupatorit dhe jo vetëm që s'pranoi të krijonte pushtetin e këshillave në vendet ku ai kishte influencë, por ai pengoi formimin e tyre. Qëndrimi i tij në front bëhej dita-ditës i dyshimtë, se ai bënte pjekje dhe lidhje me gjithë organizatat e krerët reaksionarë, që ishin të lidhur me armikun. Në mbledhjen e Mukjes, ku ishte dërguar dhe ai si delegat i Këshillit Nacional-Çlirimtar, u duk qëndrimi i tij kundër Frontit Nacional-Çlirimtar. Ai përqafoi të gjitha parullat e «Ballit» dhe të reaksionit, ai krijoj organizatën zogiste të «Legalitetit» ose, si thotë shtypi i tij, ku s'bëhet asnje fjalë kundër okupatorit, «vazhdimesinë e regjimit të Zogut, i cili duhet të jetë i vetmi në Shqipëri, se është regjim i dalë nga vullneti i popullit dhe është zhdukur nga Shqipëria prej forcës së armëve italiane». Kjo organizatë tradhëtare me Bazin e Canës në krye përkrahët haptazi prej kuislingut Mehdi Frashëri dhe qeverisë së tij dhe është në marrëveshje të drejtpërdrejtë me okupatorin gjerman.

Bazi i Canës u hodh jashtë Këshillit të Përgjith-

'shëm dhe Shtabit të Përgjithshëm, dhe «Legaliteti» zë atë vend që ka dhe «Balli Kombëtar», në radhët e tradhëtisë hyn edhe Bazi i Canës, i cili bën pjekje me komandantin e forcave gjermane në Shqipëri, gjeneralin Shmoll, dhe lidh me të marrëveshje miqësore dhe mos-sulmimi, qëndron në një radhë me tradhëtarët e Tiranës.

Me formimin e «Legalitetit», gjermanët dhe reaksioni krijonin një armë të re për të pérçarë popullin, përtatë frikësuar këtë me ardhjen e Zogut përsëri në Shqipëri dhe përtë rigrumbulluar më mirë reaksionin që ta hidhën në luftë kundër Ushtrisë sonë Nacional-Çlirimtare.

Me të gjitha këto klika reaksionare, që paraqiten në skenën shqiptare, armiku okupator bashkëpunon, bën çmos që të përfitojë prej tyre, t'i drejtojë në luftë kundër nesh, duke përfituar nga çdo kontradiktë e tyre që mund të kenë me njëri-tjetrin si dhe nga kundërshtimi kryesor që kanë kundër Luftës nacional-çlirimtare. Gjermani okupator, që i përdori për një kohë bandat kriminale të «Ballit» në formë bashibozuke, tani po i shndërron këto banda gjoja në formë të rregullt ushtarake. Qëllimet e tija janë të shumta. Nga njëra anë, ai përpinqet të ketë kurdoherë mercenarë përtë përbushur nevojat e tija këtu në Shqipëri, duke i përdorur në vend të ushtarëve të tij, të cilët është i detyruar t'i tërheqë, duke lënë vetëm një pakicë, dhe, e dyta, me i pasë këta përtë vonë të organizuar përtë me i dërgue atje ku ndjehet nevoja, sikundër që bën me polonezët, austriakët, francezët etj. Nga ana tjetër, me formimin e këtyre reparteve nën maskën e një xhandarmërie ose ushtrie shqiptare ai mban me shpresë reaksionarët, të cilët me çdo mjet përpinqen të kenë një forcë të organizuar përt

të përballuar sulmet tona si sot ashtu dhe nesër. Kjo xhandarmëri dhe ushtri, e organizuar nën bajonetat gjermane dhe e rekrutuar me forcë, është shpresa e gjithë reaksionarëve, që prej krerëve të «Ballit» e deri te zogistët, dhe cilido prej tyre i jep çdo gjë okupatorit gjerman për të mundur ta përdorë gjithsecili për interesat e veta këtë grumbullim njerëzish pa shpirt dhe pa asnjë ideal.

Reaksionarët shqiptarë, që prej krerëve të «Ballit Kombëtar», zogistëve dhe kuislingëve, nën patronazhin e Gjermainisë hitleriane përpinqen të bëjnë një blok të vetëm me reaksionarët tradhëtarë të vendeve fqinje e të largëta për të shtypur lëvizjen e popullit tonë. Aq larg shkon tradhëtia e «Ballit Kombëtar», e zogistëve dhe e kuislingëve, sa të vihen në shërbimin e një shtabi reaksionar grek. Ata që cirren duke na sharë ne të lëvizjes nacional-çlirimtare dhe duke na akuzuar si të shitur, paturpësish shesin interesat e atdheut në klikat reaksionare të Ralit¹ të Greqisë dhe të Nediçit e Mihajloviçit të Jugosllavisë. Dokumenti i tradhëtisë së Lumo Skëndos², i kapur prej nesh, u ve damkën këtyre të

¹ Kryetar qeverie kuislinge në Greqi në kohën e pushtimit gjerman.

² Dokument i Komitetit Qendror të «Ballit Kombëtar» të nënshkruar nga Mithat Frashëri në maj 1944, me anën e të cilit bëheshin përpjekje për të krijuar një koalicion të reaksionit greko-shqiptar. «Balli Kombëtar» pranonte që forcat e armatosura shqiptare të viheshin nën komandën e përgjithshme të Greqisë. Forcat e bashkuara të këtyre vendeve do të përdorështin për të shtypur lëvizjet nacional-çlirimtare në Shqipëri e në Greqi. Përpjekjet e «Ballit» dështuan përballë forcës së luftës revolucionare të popullit shqiptar.

poshtërve që për ambiciet e tyre shqelmojnë interesat e larta të atdheut dhe të popullit. Këta njerëz, që tërë jetën kanë shfrytëzuar popullin tonë të mjeruar, përpiken të korrin sukseset e kaq gjaku të derdhur për liri dhe pavarësi.

Gjatë okupacionit gjerman kemi bërë luftime të ashpra dhe të përgjakshme; përpara Ushtrisë sonë Nacional-Çlirimtare u vunë detyra të rënda. Ofensivat e armikut kishin për qëllim okupimin e zonave të çliruara dhe asgjësimin e ushtrisë sonë. Gjatë këtyre luftimeve dhe gjatë ofensivës së madhe dimërore kemi pasur humbje, kemi pasur vuajtje dhe mundime të mëdha, në të cilat bijtë e popullit tonë, të plagosur, pa bukë, të zhveshur, në borë e në furtuna, por me moralin kurdoherë të lartë, kanë treguar trimëri të padëgjuara, me të cilat do të mburren me shekuj brezat e ardhshëm të popullit tonë. Megjithëse armiku ishte shumë superior në numër dhe në mjete teknike, ai nuk mundi të asgjësonë ushtrinë tonë dhe pësoi humbje të rënda. Ushtria jonë trime s'i la një minutë rehat armikun dhe bandat e reaksionit. Ajo i goditi kudo me ashpërsi, ajo sulmoi kolonat e armikut, kazermat, grumbullimet. Në rrugë e në çdo shteg gjëmonte pushka e partizanëve, dhe këta u bënë tmerri i okupatorit. Me qindra e qindra djem të Shqipërisë rannë në fushën e nderit dhe lufta jonë e përgjakshme ka çuditur gjithë botën përparimitare dhe ka fituar simpatinë më të madhe.

Le të nderojmë gjithë bijtë e lavdishëm të popullit tonë, të cilët dhanë jetën e tyre shumë të vlefshme për një të ardhme më të mirë dhe më të lumtur për popullin shqiptar.

Është dashur të derdhim shumë gjak të vlefshëm të popullit, është dashur që bijtë më të mirë të japid jetën e tyre në këtë luftë kundër një armiku jo të barabartë, që kështu të spastronim rrugën për pozitën e Shqipërisë para opinionit botëror. Ndofta kurrë, asnje populli të vogël nuk i ka kushtuar kaq shtrenjtë që të arrijë të bindë opinionin e përbotshëm se gjaku i derdhur në Shqipëri është gjaku i tij dhe jo i atyre tradhëtarëve të poshtër që paturpësisht nga hotelet e Tiranës ose jashtë kërkojnë ta përvetësojnë.

Ne na kanë sharë e po na shajnë me një plan të njëllojtë. Okupatori, kukslingët, tradhëtarët Mehdi Frashëri, Lumo Skëndo, Ali Këlcyeza, «Balli Kombëtar», Bazi i Canës, «Legaliteti» etj. etj., kanë folur dhe flasin se lufta jonë është thjesht komuniste; kanë folur për bolshevizimin e vendit etj. etj. Këto sharje e gënjeshtra të poshtra kanë dalë nga kuzhina e dr. Gëbelsit¹ dhe përdoren nga i gjithë reaksiioni botëror që lufton krah për krah me okupatorin. Por pak janë ata që u besojnë këtyre gënjeshtave dhe aq më pak u beson populli shqiptar, i cili nëpërmjet kësaj lufte të madhe është bindur se komunistët janë bijtë më besnikë të vet, gjithmonë të gatshëm për të bërë sakrificat më të mëdha për lirinë e tij.

Që prej Konferencës së Pezës e të Labinotit janë bërë ndryshime të mëdha jo vetëm në vendin tonë, por dhe në krejt botën. Fitorja e Ushtrisë së Kuqe të lavdëshme dhe shkatërrimi i armatave hitleriane krijuan konditat për fitoren e aleatëve: Anglisë dhe Amerikës në

¹ Drejtues i propagandës naziste gjatë kohës së regjimit hitlerian.

Afrikë, u krijuan konditat për zbarkimin e aleatëve në Siqeli dhe në Itali dhe për kapitullimin e ortakut kryesor të Hitlerit, Italisë fashiste. Sot, në saje të fitores së Ushtrisë së Kuqe, e cila me strategjinë e saj ushtarake ka habitur botën, u prishën planet e Hitlerit. Me një ofensivë të madhe, e cila nuk do të ndalet, veçse kur Gjermania hitleriane do të thyhet plotësisht, Ushtria e Kuqe, mbasi çlirroi qytete të panumërtë, hyri në Besarabi dhe Bukovinë, ajo doli në kufi të Çekoslovakisë dhe tanë po marshon ngadhnjimtare drejt Rumanisë dhe Hungarisë, kala vasale të Hitlerit në Evropë. Maqina ushtarake e Hitlerit gjendet përpara katastrofës dhe nuk është e largët fitorja mbi këtë armik të madh të njerëzimit. Satelitët po tronditen dhe marrëveshja midis aleatëve dhe Bashkimit Sovjetik po bëhet kurdoherë më e fortë. Këtë e dëshmojnë konferencat në Moskë dhe në Teheran.

Me avancimin e Ushtrisë së Kuqe po grumbullohen forcat patriotike të vendeve të ndryshme dhe, kështu, po lind e po forcohet lufta nacional-çlirimtare e popujve të robëruar. Ata po vëllazërohen njeri me tjetrin për t'i dalë mbanë sa më shpejt dhe fitimtarë kësaj lufte të përba-shkët kundër të njëjtë armik. Fqinjët tanë jugosllavë bëjnë një luftë heroike. Rumania, Hungaria, Bullgaria, vasalët e Hitlerit, po tronditen; popujt e këtyre vendeve, me gjithë terrorin e madh që ka shpërthyer armiku dhe kuisingjet e tyre, po forcojnë luftën nacional-çlirimtare.

Të gjithë këta faktorë kanë një rëndësi të madhe për Luftën tonë nacional-çlirimtare, se po shton besimi në fitore dhe në çlirimin e zonave të tëra të okupuara nga fashizmi dhe tradhëtarët; këtë e provojnë mijëra partizanë të rinj që grumbullohen e shtoj-

në dita-ditës radhët e Ushtrisë Nacional-Çlirimtare,

Në lidhje me evenimentet e jashtme që po rroku-lisen dita-ditës, me zgjerimin e forcimin e Frontit Nacional-Çlirimtar në Shqipëri, me spastrimin e çlirimin e zonave të tëra nga okupatori e tradhëtarët dhe në lidhje me problemet e mëdha e të ndryshme që shtrohen përpara popullit tonë paraqitet e nevojshme dhe urgjente të marrim masat që me kohë për zhvillimin e mëtej-shëm të luftës me sukses. Është e nevojshme që populli ynë, i cili ka vuajtur dhe ka derdhur kaq gjak, t'i sigurojë vetes një sistem shtetëror të atillë, i cili të japë lirinë e vërtetë dhe demokracinë për gjithë shtresat sho-qërore. E tillë është situata e sotme.

Kongresit të sotëm, të dalë nga vullneti sovran i popullit dhe që përfaqëson gjithë shtresat e shoqërisë sonë, i bie barra e rëndë, por glorioze, të marrë të gjitha masat e duhura, i ngarkohet të krijojë organe të tilla popullore, politike, legjislativë si dhe ekzekutive, të cilat do të dalin nga ky kongres dhe do të janë në gjendje të kapërcejnë çdo pengesë që do t'u dalë përpara, do të përfaqësojnë ashtu siç duhet popullin shqiptar, si brenda ashtu dhe jashtë Shqipërisë, dhe do të janë të afta të ndalojnë çdo tentativë, të bërë nga çdo anë qoftë dhe që do të ketë për qëllim mosrealizimin e dëshirave, për të cilat populli ynë po lufton dhe po derdh kaq gjak në këtë luftë të madhe çlirimtare.

Përfaqësuesve të popullit që përbëjnë këtë kongres historik u bie barra e shenjtë të zgjedhin Këshilli Antifashist Nacional-Çlirimtar, i cili do të jetë trupi më i madh legjislativ dhe ekzekutiv nga do të dalë Komiteti Antifashist Nacional-Çlirimtar, organ ekzeku-

tiv në formën e një qeverie provizore, e cila do të jetë e aftë për të drejtuar gjithë punët dhe të veprojë si një qeveri e drejtë dhe me të vërtetë popullore.

Kjo që po bëjmë ne sot është një nga ngjarjet më të mëdha të popullit shqiptar. Për të parën herë populli dërgon përfaqësuesit e vet që ai i ka zgjedhur lirisht e që ka besim në ta. Është, nga ana tjetër, një ngjarje e madhe në marrëdhënjet me vendet e jashtme, në marrëdhënjet me aleatët tanë, se nëpërmjet të kësaj përfaqësie populli ynë do të shfaqë dëshirën dhe vendimet e tija. Lufta jonë e rëndë për liri dhe pavarësi ka bërë që populli shqiptar të fitojë të drejtën të vetë-vendosë mbi fatin e tij, dhe kjo e drejtë qëndron në harmoni të plotë me Kartën e Atlantikut. Ne kemi bindjen e plotë se aleatët tanë nuk do ta shohin shtrembër këtë hap historik të popullit shqiptar, përkundrazi, ata do t'i japid ndihmën morale dhe materiale popullit tonë nëpërmjet të përfaqësisë së zgjedhur me vullnetin sovran të popullit.

Tani disa fjalë për Ushtrinë tonë Nacional-Çlirimtare të lavdishme. Krijimi i Ushtrisë sonë Nacional-Çlirimtare në kondita kaq të vështira në një periudhë lufte të tmerrshme është një shembull i rrallë në histori. Nga njësitet e vogla, pa armë ose me disa armë të vjetra, arritëm të krijojmë një ushtri të tërë, të armatosur dhe të disiplinuar dhe që është bërë tmerr për okupatorin e për tradhëtarët. Në përpjekje dhe luftëra të përgjakshme njësitet tona ushtarake rrëmbyen nga armiku armët dhe municionin e nevojshëm. Misionet ushtarake aleate që janë pranë nesh na kanë ndihmuar deri diku me armë e municion dhe për këto i falenderojmë e u

jemi mirënlohës, por ndihma që është dhënë s'ka qenë kurrë e mjaftë. Me proporcione që ka marrë lufta jona dhe me zgjerimin e Ushtrisë sonë Nacional-Çlirimtare kjo ndihmë është relativisht e vogël. Aleatët duhet të na ndihmojnë më shumë për t'i dalë mbanë me sukses kësaj lufte të përbashkët.

Në të tilla kondita krijimi i ushtrisë sonë ka qenë një punë e rëndë; ne s'kemi pasur akademi dhe shkolla ushtarake, nuk kemi pasur kuadro oficerësh, por nga lufta dhe rreshtat e ushtrisë sonë katundarë, punëtorë, studentë, intelektualë etj., bij të denjë të popullit tonë, dolën dhe udhëheqin me guxim e trimëri ushtrinë tonë heroike. Me të tillë udhëheqës mund të jetë krenar i gjithë populli shqiptar.

Me krijimin e ushtrisë sonë të rregullt paraqitet e nevojshme dhënya e gradave në ushtrinë tonë, dhe Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacional-Çlirimtare kërkon nga përfaqësia e lartë popullore aprovimin nga ana e saj për dhënjen e gradave në ushtri.

Organizimi i ushtrisë sonë akoma nuk është mbaruar. Kemi në këmbë brigada e batalione të panumërtë, jemi duke krijuar divizionë, do të krijohen dhe korparmata. Krijimi i ushtrisë sonë deri tanë ka qenë mbi baza vullnëtare, por tanë që populli shqiptar do të ketë organin e vet ekzekutiv, detyra e Komitetit Nacional-Çlirimtar do të jetë të japë dekretin për detyrën e përgjithshme ushtaraKE dhe njëkohësisht të ketë të drejtë të hyjë në ushtrinë tonë kushdo që të dëshirojë jashtë moshës së caktuar.

Në lidhje me Konferencën e tre aleatëve në Moskë, Komiteti Antifashist Nacional-Çlirimtar duhet të kërkojë nga aleatët që edhe Shqipëria, një nga viki-

mat më të para të fashizmit, të marrë pjesë krahas me aleatët dhe me delegatët e Jugosllavisë dhe të Greqisë në konferencën ku do të shqyrtohen dëmet e shkaktuara prej fashizmit italian në Ballkan. Vendi ynë ka pësuar dëme dhe plaçkitje të patreguara nga fashistët italianë dhe gjermanë, prandaj çështja e kthimit të pasurisë së popullit të plaçkitur nga okupatori, zbulimi dhe vërtetimi i krimave të okupatorit dhe të bashkëpunëtorëve të tij, si edhe zbulimi dhe vërtetimi i emrave të të gjithë kriminelëve të luftës në vendin tonë, janë çështje më rëndësi të madhe dhe që duhet të rregullohen sa më parë.

Jeni të gjithë në dijeni se pranë Këshillit Nacional-Çlirimtar dhe Shtabit të Përgjithshëm kanë ardhur në vitin 1943 misione ushtarake angleze me qëllim që të ndihmojnë me armë Luftën nacional-çlirimtare. Siquidër e theksova edhe më lart këto misione na kanë ndihmuar deri diku me material, por jo vetëm që duhej ta bënин këtë, por duhej që Luftën tonë nacional-çlirimtare ta këqyrnin më objektivisht nga çdo pikëpamje. Shohim me keqardhje që misione të tjera angleze ndodhen pranë armiqve të popullit shqiptar dhe të Luftës nacional-çlirimtare, si Bazi i Canës e «krerët» e Dibrës, të cilët janë lidhur ngushtë me okupatorin dhe zbatojnë urdhërat e tij. Nga ana tjetër, këto misione nuk e paraqesin në dritën e vërtetë luftën tonë dhe radio e Londrës, e Barit dhe propaganda e bërë me anë fletushkash dhe të gazetës «Mundimi»¹, që shtypet në Bari, jo vetëm që s'vënë sa duhet në dukje përpjekjet.

¹ Gazetë e përvjetorë që botahej nga anglo-amerikanët

luftimet e ashpra kundër okupatorit, sakrificat e mëdha dhe gjakun që dërdh populli dhe ushtria jonë, por më të shumtë e herës qëndrimi i tyre është ekuivok dhe dëmton Luftën nacional-çlirimtare. Ne e dimë se ekzistojnë jashtë disa rrethe reaksionare që nuk i shohin me sy të mirë lëvizjet nacional-çlirimtare, por ne dimë gjithashtu se shumica e njerëzve demokratë në vendet e aleatëve sinqerisht dëshirojnë që populli të vetëvendosë fatin e tij dhe se luftërat heroike të tyre i çmojnë dhe i simpatizojnë.

Pasi Shtabi i Përgjithshëm ka qenë dhe është në kontakt me këto misione aleate, këto gjithnjë i janë drejtuar edhe për çështje që nuk janë thjesht të natyrës ushtarake, por çështje politike, të cilat janë në kompetencën e një qeverie. Për këtë shkak Shtabi i Përgjithshëm ka kërkuar dy-tri herë prej misioneve angleze që Shtabi i Përgjithshëm aleat i Mediterranësë të pranojë një delegacion të Shtabit tonë të Përgjithshëm dhe të Këshillit Nacional-Çlirimtar, i cili të sqarojë çdo çështje që i përket luftës së përbashkët dhe të koordinojë veprimet luftarake kundër gjermanëve me ato të aleatëve. Shtabi ynë i Përgjithshëm s'ka marrë një përgjegje konkrete.

Komititetit Antifashist Nacional-Çlirimtar i bie si detyrë urgjente të kërkojë nga aleatët, që lufta jonë të njihet si duhet e të përkrahet si duhet më shumë me material luftarak dhe me çdo mjet tjetër, që pranë Shtabit tonë të ketë një përfaqësues zyrtar të akredituar nga Ko-

manda e lartë aleate dhe ky të ketë nën dipendencën e tij të gjitha misionet në Shqipëri, që asnjë mision anglez të mos qëndrojë më pranë elementëve tradhëtarë të popullit tonë dhe t'i ndihmojë këta me material lufte ose sende të tjera. Komiteti Antifashist i Çlirimtës njihet si një organ i pushtetit, i dalë nga vullneti i popullit shqiptar, dhe populli shqiptar, që lufton heroikisht, të qëndrojë në një shkallë me popujt e tjerë përparimdashës dhe të ketë të drejtat që gjëzojnë këta popuj.

Për të gjitha këto kuptohet se sa e nevojshme dhe me rëndësi është formimi i një qeverie provizore, e cilë do të mund të rregullojë shumicën e këtyre çështjeve dhe të dalë jashtë si i vetmi përfaqësues legjitim dhe juridik i popullit shqiptar.

Me krijimin e Komitetit kërkojmë që pranë Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacional-Çlirimtare të vijnë edhe misione ushtarake amerikane dhe përfaqësuesit e Bashkimit Sovjetik, të këtij shteti të madh, flamurtar i luftës çlirimtare dhe mbrojtës i gjithë popujve të robëruar.

Lufta heroike e popullit tonë dhe sukseset e shkëlqyera të saj kanë ngjallur në krejt botën përparimtare simpati të mëdha; konditat janë arritur që populli ynë të realizojë dëshirat e tija për një Shqipëri të lirë dhe demokratike.

*Botuar për herë të parë
në broshurën «Kongresi I
Antifashist Nacional-Çli-
rimtar», 1944*

*Botohet sipas tekstit të bro-
shurës «Kongresi I Antifashist
Nacional-Çlirimtar»*

**URDHËR DITE DREJTUAR USHTRISE
NACIONAL-ÇLIRIMTARE ME RASTIN E FORMIMIT
TË KOMITETIT ANTIFASHIST NACIONAL-
-ÇLIRIMTAR**

28 maj 1944

URDHËR DITE

**SHOKË PARTIZANË E UDHEHEQËS USHTARAKË DHE
POLITIKË TË USHTRISE SONË NACIONAL-ÇLIRIMTARE!**

Dita e sotme, që i dha popullit shqiptar Komitetin Antifashist Nacional-Çlirimtar, është ditë e shenjtë për popullin dhe ushtrinë tonë heroike, se sot me shpalljen e Komitetit po del edhe dekretimi i parë i oficerëve tanë trima.

Në përpjekje të përgjakshme me shkelësin e vendit tonë dhe me tradhëtarët lindi dhe u forcua ushtria jonë, lindën udhëheqësit e kësaj ushtrie trime, të cilët sot drejtojnë ushtrinë e popullit shqiptar me aq guxim e zgjuarësi sa kanë çuditur botën. Nga gjiri i popullit të vuajtur dhe të lidhur ngushtë me popullin, punëtorë, katundarë dhe intelektualë të ndershëm dolën dhe me një vullnet të pathyeshëm e me një bindje të plotë në fitore, u shquan në luftime të ashpra dhe u treguan të

aftë të udhëheqin ushtrinë tonë. Komandantët dhe komisarët politikë kanë dhënë prova të një zotësie të shquar dhe kanë thyer e mundur oficerët italianë e gjermanë të pajisur me njohuri të mëdha ushtarake; edhe sot ata qëndrojnë të patundur e fitimtarë në luftën kundër okupatorit gjerman.

OFICERË TË USHTRISË NACIONAL-ÇLIRIMTARE!

Udhëheqja në ushtrinë tonë është me rëndësi të madhe dhe e shumanshme. Ajo duhet të jetë ushtarake e politike dhe, për të qenë e përsosur, duhet që kuadrot tona të pajisen me njohuritë e nevojshme teorike. Detyra e Shtabit të Përgjithshëm është krijimi i shkollave, ku oficerët tanë popullorë të pajisen me taktilët e luftës dhe të jenë të zotët të përballojnë taktilën ushtarake të armikut e të mos e lënë kurrë armikun të na imponojë taktilën e tij. Ne duhet të jemi kurdoherë në ofensivë, gjithnjë në ofensivë dhe, kur armiku sulmon, ne të dimë t'i shkatërrojmë planet e tija, ta godasim nga të gjitha anët, t'i presim lidhjet dhe t'i hyjmë thellë në prapavijat, t'i presim furnizimet, t'i shkatërrojmë shtabet e tija dhe të çlirojmë qytetet e okupuara. Ju e kuptoni fare mirë rëndësinë e stërvitjes dhe të mësimit ushtarak, i cili do t'ju shërbejë që të kryeni barrën e rëndë që ju është ngarkuar, të kryeni luftën me sukses.

Në momentet më të vështira të luftës sonë, Shtabi i Përgjithshëm krijoj një kurs të lartë oficerësh ushtarakë e politikë, ku shumë prej jush morën pjesë. Më vonë, do të krijohen edhe të tjera, dhe oficerët tanë do

t'i shtojnë eksperiencës së tyre të madhe, të fituar në luftë, edhe njohuritë teorike të artit ushtarak.

Dhënja e gradave do t'i japë Ushtrisë sonë Nacio-nal-Çlirimtare formën e një ushtrie më të rregullt. Gradimi juaj do t'i japë një hov të ri luftës, do të forcojë disiplinën dhe shpirtin luftarak në radhët e ushtrisë sonë.

SHOKË PARTIZANË, KOMANDANTË E KOMISARË POLITIKË!

Ju jeni garancia e madhe që lufta jonë të shkojë përpara dhe në rrugën e fitoreve të lavdishme. Armët që keni në dorë t'i përdorni më së miri kundër okupatorit dhe tradhëtarëve dhe të mos i lëshoni derisa populli ynë të ketë fituar lirinë dhe gjithë të drejtat e tija. Armiku është përpjekur dhe përpinqet të na shmangë nga lufta jonë e drejtë kundër okupatorit, duke na hedhur në një luftë vëllavrasëse; por ne nuk duhet të harrojmë kurrë se armiku më kryesor është okupatori gjerman dhe se këtij duhet t'i bëjmë luftën më të ashpër, luftën më të ashpër zaptuesit dhe të gjithë tradhëtarëve që bëjnë lodrën e tij. Lufta jonë e përgjakshme, e lidhur ngushtë me atë të aleatëve tanë të mëdhenj: Bashkimit Sovjetik, Anglisë dhe Amerikës si dhe të popujve të robëruar, është garancia e vetme e çlirimt tonë.

Populli ynë i mjeruar, që lëngon nën thundrën e okupatorit gjakpirës gjerman, kërkon prej nesh shpëtimin, prandaj me atë guxim e heroizëm, me atë shpirt sakrfice e vetëmohimi, me atë disiplinë shëmbullore që na ka dalluar, të hidhemi përpara në luftë

për të çliruar sa më shpejt popullin tonë të dashur.

Ju jeni garancia dhe shpresa për popullin tonë, që bashkë me të do të vazhdoni luftën gjer në fitore.

Rroftë Këshilli Antifashist Nacional-Çlirimtar !

Rroftë Komiteti Antifashist Nacional-Çlirimtar !

Rroftë Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacional-Çlirimtare dhe njësive partizane !

Rroftë aleanca antifashiste me në krye popujt e fuqishëm të Anglisë — Bashkimit Sovjetik — Amerikës !

Rroftë populli shqiptar !

Rroftë Ushtria Nacional-Çlirimtare !

VDEKJE FASHIZMIT — LIRI POPULLIT

Komandanti i Përgjithshëm i
Ushtrisë Nacional-Çlirimtare Shqiptare
Gjeneral-Kolonel

Enver Hoxha

Botuar për herë të parë në
«Dokumenta të Shtabit të
Përgjithshëm dhe të Koma-
ndës së Përgjithshme të
Ushtrisë Nacional-Çli-
rimtare», vëllimi I,
Tiranë, 1965

Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë

**URDHËR DITE DREJTUAR USHTRISË NACIONAL-
ÇLIRIMTARE SHQIPTARE PËR SHPARTALLIMIN
E OPERACIONIT ARMIK TË QERSHORIT¹**

14 qershor 1944

URDHËR DITE

Ushtrisë Nacional-Çlirimtare Shqiptare

PARTIZANË, PARTIZANE, KOMANDANTE,
ZEVENDËSKOMANDANTE, KOMISARË DHE
ZEVENDËSKOMISARË !

Në këto momente decizive, kur e gjithë bota përparimtare është çuar me armë në dorë dhe po godet me ashpërsinë më të madhe bishën naziste, barra e rëndë dhe e shenjtë e çlirimit të popullit tonë dhe të atdheut rëndon mbi supet tuaja. Këtë detyrë të shenjtë, që ju

1 Operacioni armik i qershorit kundër Ushtrisë Nacional-Çlirimtare filloi më 28 maj dhe vazhdoi gjëri në fund të qershorit 1944. Në këtë operacion morën pjesë katër divizione e gjysmë gjermane në bashkëpunim me xandarë, ballistë e zo-

ka ngarkuar populli shqiptar dhe historia, ju po e përmbushni me vetëmohimin më të madh dhe me sakrifica të përgjakshme. Epopeja e shkëlqyer e popullit tonë po shkruhet me gjakun tuaj të kulluar, me gjakun e bijve më të ndershëm e më trima të tokës sonë.

Ju, që s'duruat shkelësit e vatrave tona, ju, që s'duruat që emri i Shqipërisë, nderi e zakonet e saja të mireshin nëpër këmbë, jeni shprehja më e gjallë e vullnetit të pathyer të një populli heroik që kurrë s'ka pranuar robërinë, që për shekuj me radhë ka derdhur gjak për liri e pavarësi. Në qytete dhe fshatra, në gërxhe e male, me bukë e pa bukë, me armë e pa armë, por me një vullnet të hekurt e me besim të madh në fitore ju luftuat me armiq të egër, të motorizuar dhe të armatosur deri në dhëmbë. Asgjë s'ju trembi, asgjë s'ju lëkundi, se mbajtët shtrenjtë në zemrat tuaja vuajtjet dhe mjerimet e popullit tonë fatkeq, i cili kërkonte shpëtimin. Historia do të shkruajë me shkronja të arta luftën tuaj legjendare kundër fashistëve italianni e gjermanë dhe shërbëtorëve të tyre, bijve bastardë të popullit tonë.

Në përlleshje të armatosur u armatosët, në luftime të ashpra dhe të paprera krijuat ushtrinë tonë heroike, e cila është bërë tmerri i okupatorit gjerman dhe i kuisingëve.

gistë, gjithsejt përmbi 50 mijë trupa. Kundërmësymja e menjëherëshe e Ushtrisë Nacional-Çlirimtare ua prishi krejt planet forcave armike. Operacioni përfundoi me disfatë për pushtuesit gjermanë dhe reaksionin.

Gjermanët hitlerianë, kuislingët, tradhëtarët e «Ballit Kombëtar», të «Legalitetit», etj., të gjithë të bashkuar lëshuan kundër ushtrisë sonë ofensivën e madhe të dimrit, me qëllim që të na zhduknin dhe të shuanin rezistencën e popullit tonë, por ushtria jonë doli fitimtare dhe më e fortë se kurrë. Ajo u dha grushte të rënda okupatorit dhe tradhëtarëve dhe shkatërrroi planet e tij. Ushtria jonë ngjalli besimin e madh dhe dashurinë e pafund të popullit shqiptar ndaj ushtrisë së saj dhe ai pa tek ajo mburojën e çelniktë të jetës dhe të fateve të tija. Pas ofensivës dimërore ne sulmuam kudo, dhe armiku, i tmerruar nga kjo forcë e madhe, të cilën kishte bindje se do ta asgjëson, u struk në qytet dhe, i plagosur rëndë, për pesë muaj rresht u përpoq të grumbullojë trupat mercenare dhe tradhëtarë të kuislingeve, të cilët, të shoqëruar me trupa të freskëta të tija të sjellur apostafat nga frontet e tjerë të Evropës, i hodhi në një ofensivë të dytë kundër ushtrisë sonë.

PARTIZANË DHE PARTIZANE, KOMANDANTË DHE KOMISARË POLITIKË!

Në borë e në furtunë përballuat ofensivën e madhe të dimrit dhe dualët fitimtarë, flamuri ynë valoi i pathyer, tanë më tepër se kurrë ju po e mbytni në gjak ofensivën e dytë të armikut. Kjo është shpresa e fundit e armikut dhe e tradhëtarëve, kjo është një faqe tjetër e shkëlqyer e armëve tona. Mbi bishën e tërbuar naziste dhe mbi tradhëtarët e poshtër nga të katër anët po sulmojnë partizanët tanë trima. Me qindra gjermanë po

lyejnë me gjakun e tyre të ndyrë çdo pëllëmbë tokë, ku shkelin e kalojnë, dhe më çdo grykë e më çdo rripë, pushka e partizanëve po godet pa mëshirë shkelësit e vendit tonë dhe mbron tokat e çiruara ngá kthe-trat e tyre.

PARTIZANË DHE PARTIZANE !

Goditni pa mëshirë shtabet dhe forcat e gjalla të armikut, shkatërroni prapavijat e tyre dhe i ndaloni furnizimet, shkatërroni komunikacionet dhe urat, digjni kazermat dhe depot e tyre dhe i ndiqni këmba-këmbës deri në shfarosjen e tyre të plotë! Mos i leni asnje minutë të pushojnë e të rigrumbullohen, sulmi juaj i rrufeshëm duhet të ndalet brenda në qytete, të cilat t'i çlironi një herë e përgjithmonë!

Nga dështimi i ofensivës së dytë të armikut dhe nga kundërofensiva jonë e rreptë varet shpejtimi i çlirimt të popullit tonë.

Armiku gjerman po kalon momente të këqia. Ai është plagosur rëndë dhe ofensiva e madhe sovjetike, që ka shpërthyer në të gjithë frontin e Lindjes, zbarkimi i aleatëve në Francë, e kanë vënë Gjermaninë në pozita të vështira, të cilat do të jenë fatale për të.

Flamurtarë të idesë së madhe të çlirimt, mbrojtës të lirisë dhe të të drejtave të popullit tonë që lëngon, përpara në ofensivë për të shfarosur armikun gjerman dhe kuislingët e tradhëtarët! Në luftën tonë heroike do të hasim akoma pengesa, do të zhvillojmë ende luftime të ashpra me bishën e plagosur, por ne do t'i kapërzcej-

më të gjitha dhe do të fitojmë, se bëjmë një luftë të drejtë për çlirimin e popullit tonë.

VDEKJE FASHIZMIT — LIRI POPULLIT

Komandanti i Përgjithshëm i
Ushtrisë Nacional-Çlirimtare Shqiptare
Gjeneral-Kolonel

Enver Hoxha

*Botuar për herë të parë në
«Dokumenta të Shtabit të
Përgjithshëm dhe të Koma-
ndës së Përgjithshme të
Ushtrisë Nacional-Çli-
rimtare», vëllimi I,
Tiranë, 1965*

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

**QARKORE PËR POPULLARIZIMIN E VENDIMEVE
TË KONGRESIT I ANTIFASHIST NACIONAL—
—ÇLIRIMTAR TË PËRMETIT**

15 qershor 1944

**GJITHË KOMITETEVE QARKORE TË PARTISË
ZËVENDËSKOMISARËVE
SEKSIONEVE POLITIKE**

Të dashur shokë,

Në momentet kur Ushtria e Kuqe heroike ka shpërthyer ofensivën e madhe kundër okupatorit gjerman dhe ka çliruar Ukrainën, Besarabinë dhe Bukovinën, kur ajo po marshon mbi Hungarinë, Rumaninë dhe Çekoslovakianë, duke i dhënë grushte vdekjeje armatave hitleriane, të cilat si bisha të plagosura po tërhiqen të thyera në kështjellën e Evropës për të bërë rezistencën e fundit, kur përpala Ushtrisë së Kuqe vihen detyra të rënda dhe të reja për të çliruar gjithë popujt e shtypur të Evropës dhe për të shfarosur murtajën hitleriane, në Evropë krijuhen kondita të reja. Në saje të këtyre fitoreve të shkëlqyera të Ushtrisë së Kuqe, të udhëhequr nga strategu më i madh i kohërave të sotme, shoku Stalin, u krijuan konditat për aktivizimin e ofensivës aleate në Itali, për zhvillimin e madh të luftërave të popujve të robëruar dhe më në fund, për zbarkimin

me sukses të aleatëve në Francë, zbarkim që është rezultat i kaq preqatitjeve dhe i Konferencës së Teheranit.

Krahas me zhvillimin e luftërave kundër okupatorit, po forcohet kudo pushteti demokratik i popullit e po merr forma konkrete, të cilat ndihmojnë zhvillimin e luftës me sukses, ndihmojnë grumbullimin e forcave të gjalla të çdo populli dhe forcojnë pozitat kombëtare dhe ndërkombëtare të këtyre popujve, pozita të bazuara në themele të shëndosha popullore dhe në parime demokratike. Në çdo vend të Evropës dhe veçanërisht në Jugosllavi, Francë, Çekoslovaki etj. u formuan komitete antifashiste, të cilat kanë të gjitha atributet e qeverive provizore. Këto komitete kurorëzuan luftërat e përgjakshme të këtyre popujve kundër hitlerianëve dhe klikave reaksionare të lidhura ngushtë me okupatorin e që përpinqeshin me çdo kusht të dobësonin luftërat nacional-çlirimtare dhe të pengonin zhvillimin përparimtar dhe vullnetin e popujve. Në vende të tjera si në Itali, Bullgari etj. shohim pjesëmarrjen aktive të popullit në luftë dhe krijimin e forcimin e frontit antifashist, i cili po marshon drejt konkretizimit të formave demokratike të shtetit, që do të eliminojnë në luftë e në përpjekje të gjitha mbeturinat fashiste dhe reaksionare që pengojnë zhvillimin e drejtë të luftës popullore.

* * *

Në vendin tonë, me zgjerimin dhe forcimin e frontit, me zmadhimin e Ushtrisë sonë Nacional-Çlirimtare dhe me çelnikosjen e saj gjatë kësaj lufte të përgjakshme që po bën populli ynë, përpëra Komitetit Qendror të Partisë u shtruan probleme me shumë rëndësi jetike

për popullin shqiptar dhe për zhvillimin e mëtejshëm me sukses të Luftës nacional-çlirimtare. Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë, në mbledhjen e tij të jashtzakonshme¹, mbasi shqyrtoi situatën, e pa të domosdoshme dhe urgjente mbledhjen e Kongresit I Antifashist, ku do të merreshin vendime me rëndësi historike. Për këtë gjë, dakord me Këshillin e Përgjithshëm Nacional-Çlirimtar, në qytetin e lirë të Përmetit u mblo-dhën në kongres të gjithë delegatët e popullit nga çdo anë e Shqipërisë dhe të zgjedhur në mënyrën më demokratike me anë mitingjesh të gjera dhe me vota të hapëta.

Kongresi I Antifashist hapi seancat e tij në mes të një entuziazmi të papërshkrueshëm të popullit dhe të ushtrisë dhe atje u muarën vendime me rëndësi përfatim e atdheut dhe të popullit tonë. Kongresi I Antifashist i dha Shqipërisë Këshillin e Përgjithshëm Nacional-Çlirimtar me të gjitha atributet e pushtetit legjislativ dhe ekzekutiv nga doli organi ekzekutiv dhe urdhërdhënës Komiteti Antifashist Nacional-Çlirimtar me të gjitha atributet e një qeverie provizore.

1. — Kongresi i Përmetit, me rëndësi të madhe historike, shprehu vullnetin dhe dëshirën e zjarrtë të popullit tonë përfshirë vazhduar luftën kundër okupatorit dhe tradhëtarëve më me ashpersi, deri në fitoren e plotë të armëve tonë mbi hitlerizmin, përfshirimin e plotë të atdheut nga gjakpirësit reaksionarë, vegla të okupatorit, dhe përfitoren e të gjitha tē drejtave të popullit shqiptar.

2. — Kongresi shfaqi besimin e plotë tek aleatët e

¹ Është fjala përf Plenumin I të KQ të PKSH që u mbajt në 15 maj 1944 në fshatin Helmës të Skraparit.

mëdhenj: Bashkimi Sovjetik, Anglia dhe Amerika dhe se tok me ta dhe me gjithë popujt e robëruar populli shqiptar do të vazhdojë luftën deri në fund për shpëtimin e njerëzimit nga murtaja naziste.

3. — Kongresi shfaqi bindjen dhe besimin e plotë se populli shqiptar, pjesëtar i blokut të madh antifashist, i mbështetur në deklaratat e Kartës së Atlantikut, të Konferencës së Moskës dhe të Teheranit, do të gjëzojë të gjitha të drejtat që i garantojnë këto vendime historike dhe se do të qëndrojë në një radhë me të gjithë popujt përparimtarë të botës.

4. — Kongresi me entuziazëm të madh brohoriti për Partinë Komuniste të Shqipërisë, udhëheqësen e ndritur të popullit shqiptar kundër okupatorit dhe tradhëtarëve.

5. — Kongresi brohoriti në mënyrë të papërshkrueshme Ushtrinë tonë heroike Nacional-Çlirimtare, ushtrinë e popullit shqiptar për luftën e saj të drejtë, të parerë dhe fitimtare, për aktet e saja heroike, që kanë çuditur botën dhe që kanë ngritur lart emrin Shqipëri, duke i siguruar një vend të shkëlqyer në radhën e popujve përparimtarë.

6. — Kongresi shfaqi vullnetin dhe dëshirën e popullit shqiptar për bashkimin e vëllazërimin e gjithë popullit në Frontin Nacional-Çlirimtar dhe pjesëmarrjen e të gjithë patriotëve të ndershëm në radhët e Frontit dhe të Ushtrisë Nacional-Çlirimtare.

* * *

Këto evenimente me rëndësi të jashtzakonshme për popullin tonë duhet t'i popullarizoni në shkallë të gjerë,

gjithashtu dhe vendimet e marrura në këtë kongres t'ja bëni të ditura popullit duke ja bërë të qarta dhe të kup-tueshme. Duhet të shumëzoni në një numër të madh materialin që ju dërgohet përsa i përket kongresit dhe ky material të punohet me kujdes në të gjitha celulat, byrotë e batalioneve dhe në aktivet si dhe në komitetet e rinisë. Nga punimi i mirë i këtij materiali dhe kuptimi i drejtë i tij varen efekti dhe rezultati që do të kemi. Nuk lejohen gabime në interpretimin e keq të vendimeve, të brendisë së tyre si edhe të noménklaturës. Do të jetë një gabim në qoftë se veprohet ndryshe dhe do të na shkaktohen dëme. Për këtë arësy po ju jepim disa sqarime suplementare.

1. — Kongresi I. Antifashist, i dalë nga lufta, ku morën pjesë me qindra delegatë nga ushtria, nga organizatat e ndryshme dhe me tendencë politike antifashiste, që grumbullohen në Frontin Nacional-Çlirimtar, të zgjedhur prej popullit në mënyrë demokratike, përfaqëson vullnetin sovran të popullit shqiptar. Kongresi krijoj organet politike, legjislativë dhe ekzekutive, të cilat përfaqësojnë popullin shqiptar, si brenda ashtu dhe jashtë vendit.

2. — Kongresi zgjodhi Këshillin e Përgjithshëm, si trup kryesor legjislativ dhe ekzekutiv, që përfaqëson sovranitetin e popullit dhe të shtetit shqiptar. Kjo formë e pushtetit është e re dhe u përshtatet konditave të krijuara nga lufta. Këshilli i Përgjithshëm i përbledh të dy pushtetet dhe është Këshilli që krijon organin ekzekutiv, Komitetin Nacional-Çlirimtar, i cili është përgjegjës për punët e veta përpara Këshillit dhe anëtarët që e përbëjnë mund të jenë ose jo anëtarë të Këshillit.

3. — Meqenëse Këshilli nuk ka mundësi të qëndrojë i téri i grumbulluar, se s'e lejojnë konditat e luftës, ai zgjedh presidiumin e vet dhe ky është i veshur me të gjitha atributet e Këshillit të Përgjithshëm Nac.-Çl.

4. — Vendimet e marrura nga Këshilli Nac.-Çl. ose nga Kryesia janë ligje, të cilat vihen në zbatim prej organit ekzekutiv.

Të gjitha vendimet e marrura nga Këshilli Nacional-Çlirimtar duhet t'i studjoni me vërejtje të madhe, t'i kuptoni dhe nuk lejohen interpretime të gabuara. Këto vendime, mbasi të punohen mirë, t'ua bëni të kuptueshme gjithë këshillave, gjithë anëtarëve të tyre dhe të lehtësohet puna e këtyre jo duke ua imponuar, por duke ua mësuar me durimin më të madh, duke pasur kurdoherë kujdesin që këshillat të përfaqësojnë me të vërtetë pushtetin e popullit.

Deklarata dhe thirrja nga ana e kongresit duhet të bjerë në çdo dorë, deri në këndin më të humbur të Shqipërisë, dhe njëkohësisht duhet të popullarizohet kongresi, duke vënë në dukje rëndësinë e tij dhe momentin në të cilin u mblodh, si dhe veprën e tij historike.

Të popullarizohet në shkallë të gjerë Këshilli Nac.-Çl., përfaqësues i sovranitetit të popullit, dhe Komiteti Nacional-Çlirimtar.

Ju vihet nga ana tjeter si detyrë kryesore:

1) Të popullarizohet në shkallë të gjerë Partia jonë, udhëheqësja e kësaj lufte çlirimtare, organizuesja e ndritur dhe e papërkulur e luftës së armatosur kundër okupatorit si dhe mbrojtësja e interesave të popullit që punon.

2) Të popullarizohet në çdo anë Bashkimi Sovjetik

dhe shoku Stalin. Por popullarizimi të mos mjaftohet vetëm duke thënë se është e vëtmja forcë që theu armatat e Hitlerit etj., por se Bashkimi Sovjetik është udhëheqësi i masave punonjëse dhe që u dha këtyre kollektivitetin e lirë vëllazëror të njerëzve të lirë, një shoqëri të lulëzuar dhe jetë të begatshme. Vetëm rendi socialist mundi të krijojë atë forcë të pathyeshme që është Ushtria e Kuqe, e aftë për me përballue të gjitha vështirësitë. Sot asnjë vend, asnjë lëvizje a parti nuk mund të mos mbajë parasysh ekzistencën e Bashkimit Sovjetik si faktor vendimtar dhe të pakontestueshmë në zhvillimin e shoqërisë së sotme. Në këtë drejtim duhet ta popullarizoni Bashkimin Sovjetik dhe udhëheqësin gjenial, Stalinin, pavarësisht nga propaganda që do të bëjnë klikat e ndryshme reaksionare të vendit tonë...

4) Të popullarizohet lufta e popujve të robëruar, të popullarizohet vëllazërimi i popujve ballkanikë dhe t'i bëhet luftë propagandës shoviniste që kërkon të armiqësojë popullin tonë me popujt fqinjë.

Të fala shoqërore
Për Komitetin Qendror të PKSH

Enver Hoxha

VDEKJE FASHIZMIT LIRI POPULLIT

*Botuar për herë të parë
në «Dokumenta kryesore
të PPSH», vëllimi I,
Tiranë, 1960*

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

**QARKORE DREJTUAR KOMISARËVE
DHE ZËVENDËSKOMISARËVE TË UNÇSHI MBI
FORCIMIN E PUNËS POLITIKE-EDUKATIVE
NË USHTRINË NACIONAL-ÇLIRIMTARE**

16 qershor 1944

**KOMISARËVE DHE ZËVENDËSKOMISARËVE TË
USHTRISË NACIONAL-ÇLIRIMTARE**

Të dashur shokë,

Me zhvillimin e luftës u zhvillua dhe ushtria jonë, duke shumëzuar radhët e saja me partizanë të rinj dhe me udhëheqës ushtarakë dhe politikë. Kjo ushtri është e vendosur për luftë, se është e përbërë nga djemtë e popullit që kanë ndjerë thellë shtypjen e okupatorit dhe të tradhëtarëve, se në pjesën më të madhe është e përbërë prej katundarëve të varfër, që me shekuj kanë vuajtur njëmijë e një të zeza e që tani, me okupacionin, ekzistenca dhejeta e tyre është bërë skëterrë. Këta djem të popullit panë se lufta që u bëhej okupatorit dhe tradhëtarëve ishte e vëtmja rrugë shpëtimi dhe përkëtë arësyte ata ju përgjegjën thirrjes sonë, rrokën armët për të na ndjekur në rrugën e drejtë që na ka cak-

tuar Partia. Por nuk mjafton vullneti i mirë për luftë për t'i bërë të gjitha këto masa luftëtare konshiente për barrën e rëndë dhe të shumanshme, duhet që këto masa të edukohen politikisht dhe ushtarakisht, të dinë përse luftojnë dhe si të luftojnë, të njohin mirë armikun, forcat e tija, qëllimet dhe metodat që përdor dhe të zoterojnë vijën e luftës dhe taktikën luftarake tonën.

Eshtë një fakt i pakontestuar se ushtria jonë eshtë zmadhuar, por ky zhvillim në numër nuk ka shkuar paralelisht me zhvillimin politik dhe ushtarak të partizanëve, të komandantëve dhe të komisarëve, dhe ushtria jonë, sado që ka hyrë në rrugën e një ushtrie të tipit të ri, prapë eshtë shumë larg synimit të dëshiruar dhe që e lypin rrethanat e sotme dhe konditat që do të kri-johen nesër. Ushtria jonë Nac.-Çl. nuk paraqitet ende si një blok kompakt me të gjitha cilësítë që lypsen dhe këtej duhet të nxjerrim një konkluzion, i cili duhet të na bëjë të mendohemi shumë që ushtrinë ta kemi të gjithë nën kontrollin tonë dhe të mos na ngjasë që një pjesë e saj eventualisht të shkëputet ose me mbarimin e luftës të shthuret, me që s'e ka kuptuar si duhet rolin e vet të madh.

Për këtë gjendje në ushtri përgjegjës kryesorë jeni ju, shokë komisarë politikë dhe zëvendëskomisarë, ju që përfaqësoni Partinë në ushtri, ju që çoni në masat luftuese fjalën, vijën, udhëzimet, vullnetin e çelniktë, disiplinën konshiente, idetë përparimtare të pararojës dhe udhëheqjes së ndritur të proletariatit dhe të popullit që punon. Për këtë shkak përgjegjësia juaj eshtë e madhe përpara Partisë dhe nga ju varet formimi i ndërgjegjës politike në partizanët e ushtrisë sonë.

Puna politike dhe organizative që ju është ngarkuar, nuk është zbatuar si duhet; kjo ka pasur të meta, lëshime dhe gabime, të cilat kanë shkaktuar moslartësimin e kuadrove dhe të partizanëve. E meta kryesore e shumë prej jush ka qenë shablonizmi në punën tuaj d.m.th. se të gjitha udhëzimet dhe direktivat që ju janë dhënë, i keni kupluar cekët dhe jeni përpjekur t'i zbatoni kallëp, pa i prekur e pa i bërë gjakun dhe mishin tuaj, kështu që të dinit t'i zbatonit në situata të ndryshme, duke ua përshtatur vendit dhe rrëthanave dhe duke hedhur larg globalizmin. Jeni përqëndruar në çështje të përgjithshme pa ja përshtatur realitetit dhe kjo gjë ju ka mbajtur larg këtij realiteti dhe konkretizimit të punës që keni zhvilluar. Keni hedhur farën, por s'keni ditur të kujdeseni për bimën që lindi, e cila kërkon shumë kujdes e përpjekje për t'u rritur dhe zhvilluar. Kjo mënyrë pune ka shkaktuar që ju të mos njihni mirë njerëzit e reparteve tuaja, mos t'i njihni aftësitë e të metat e gjithsecilit për të mundur t'i zhdukni këto të meta dhe të zhvilloni kualitetet e tyre. Shumë njerëz në ushtri vijnë nga qytetet, të mësuar me një mënyrë pune tjetër, dhe një herë, në ushtri mund të dezorientohen, se në ushtri shumë gjëra janë ndryshe, kështu, ju që jeni të kualifikuar t'i drejtoni këta elementë, të cilët mund të bëhen udhëheqës të mirë, por mund të bëhen edhe të pavlefshëm në rast se mungon kujdesi juaj.

Përveç asaj s'merrni përgjegjësi politike dhe ushtarake cse fare pak. Janë neglizhuar konferencat ndër partizanët dhe udhëheqësit dhe nuk zbatohen plane pune nga ana juaj. Puna juaj është shumë herë një punë e rastit, pa u menduar pak se nga puna juaj e rregullt

varet forcimi i ushtrisë dhe influenca e Partisë në të.

Puna juaj në ushtri është pasqyra e Partisë, dhe partizanët shohin në ju udhëheqësin e ndritur të masave. Kur ju s'tregoni kujdesin e duhur për njerëzit, për ngrijjen e tyre, kur nuk i zgjidhni problemet si duhet, kur nuk jepni shembullin e guximit e të heroizmit, emri i Partisë errësohet, influenca e saj në masat dobësohet dhe mosbesimi në udhëheqjen fillon të hedhë rrënje. Shumë prej jush e harrojnë detyrën e tyre të shumanshmë, si politike ashtu dhe ushtarake, dhe nganjëherë interesohen mjaft për njérën dhe neglizhojnë tjetrën ose interesohen për të dyja në mënyrë të përciptë.

Puna që do të bëni në reparte ndihmon organizatën e Partisë në ushtri; e forcon atë, në qoftë se puna zhvillohet si duhet dhe e dobëson atë, në qoftë se ajo nuk shkon progresivisht. Organizata e Partisë në ushtri është pasqyra e punës së anëtarëve që punojnë në këtë sektor dhe, për fat të keq, organizata nuk është rritur aq tepër dhe të zotërojë në shumë anë punën që paraqitet. Ajo nuk mund ta zotërojë situatën, në rast se nuk forcohet me elementë të rinj, të shëndoshë, të vendosur, të cilët të lartësohen dhe të edukohen. Që të mund të kryeni me sukses barrën që ju ka ngarkuar Partia, duhet të ndryshohet stili dhe metoda e punës, kjo të marrë një impuls të ri; të mësoni që t'u hyni më thellë problemeve dhe t'i zgjidhni përnjëherësh, duke pasur kurdoherë parasysh direktivat. Të dini të gjeni dhe të njihni gabimet, t'i ndreqni këto dhe të mësoni prej tyre. Prej kuadrove të Partisë, sidomos prej atyre që punojnë në ushtri, kërkohet që të futen në punë me më shumë perspektiva dhe guxim, të futen në masa dhe pa ndrojtje të rekru-

tojnë anëtarë të rinj të Partisë, sidomos nga shtresat e varfëra fshatare.

Të keni kujdes të zbatoni drejt vijën e Partisë në ushtri, të mobilizoni masat katundare rrëth ushtrisë sonë dhe këto të bëhen një faktor kryesor i luftës, këtë masë ta edukoni dhe këtej të dalin komandantë, anëtarë partie të zot, luftëtarë të vendosur për luftën dhe për Partinë. Duhet të kuptohet mirë roli i fshatarësisë në zëtë Luftë nac.-çl., të dini që t'i afroheni fshatarësisë dhe veçanërisht në lidhje me luftën; të dini të kuptoni dëshirat e tyre dhe t'i zgjidhni më së miri dhe me drejtësi problemet që u interesojnë më tepër.

Ushtria jonë të ruajë kurdoherë karakterin popullor, si ushtri e vërtetë e popullit, dhe në lidhje me këtë, sjelljet e saj në popull duhet të jenë shembullore. Të mos lejohet në asnjë mënyrë keqpërdorimi dhe mënyra brutale që ndonjë mund të bëjë në popull, luftoni rebelizmin dhe shfaqjet anarkiste dhe dënoni me ashpërsi të gjithë ata që tentojnë t'i japid ushtrisë sonë ngjyrën e një ushtrie të parregullt, antipopullore. Ushtria jonë të jetë shembulli i drejtësisë për të pafajshmit dhe të gabuarit dhe e pamëshirshme për armiqtë e popullit. Ushtria duhet të jetë konshiente për rolin e saj sot edhe nesër, dhe çdo partizan duhet të dijë dhe të ketë kuptuar se armët, që me gjak ja kemi marrë armikut, ne edhe populli nuk do t'i lëshojmë nga duart deri në fitoren e plotë. Kudo që të shkoni në masat e gjera fshatare të bëni konferanca, të regjistroni dëmet e bëra nga lufta, të mbani veçanërisht në shënim, dhe t'i vini në dukje, të gjithë kriminelët e luftës.

Të popullarizoni Partinë tonë në shkallë të gjerë,

si udhëheqëse të luftës, të popullit, mbrojtësen e interesave të popullit që punon. Të popullarizoni blokun antifashist dhe të dini të popullarizoni Bashkimin Sovjetik jo vetëm si fuqi që po dërmon hitlerizmin, por më konkretisht, duke vënë në dukje nga ka rrjedhur ajo fuqi e madhe, rendi socialist, që ka lartësuar masat punonjëse, u ka dhënë lirinë, ka vëllazëruar popujt dhe ka krijuar kondita për krijimin e Ushtrisë së Kuqe heroike, ushtri e dalë nga gjiri i popullit, e pajisur me të gjitha virtytet morale që vetëm socializmi mund t'i japë, njerëzimit. Në këtë drejtim të bëhet popullarizimi.

Shokë komisarë e zëvendëskomisarë, detyra juaj është një detyrë e lartë dhe nga kryerja e saj si duhet varet suksesi i solëm dhe i nesërm. Ju dhe gjithë shokët e tjerë të Partisë në ushtri keni barrën ta bëni ushtrinë tonë të denjë e të fortë për realizimin e qëllimeve të larta që ju ka ngarkuar Partia dhe ju duhet të dini, si u ka hije komisarëve politikë dhe zëvendëskomisarëve, të ngrini lart emrin e Partisë dhe të mos preket autoriteti i saj.

VDEKJE FASHIZMIT — LIRI POPULLIT

Të fala shoqërore
Për Komitetin Qendror të Partisë
Komuniste të Shqipërisë

Enver Hoxha

*Botuar për herë të parë
në «Dokumenta kryesore
të PPSH», vëllimi I,
Tiranë, 1960*

*Botohet sipas kopjes që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

**LETËR ME ANËN E SË CILËS U HIQET VËREJTJA
KADRI HOXHËS DHE GJIN MARKUT PËR LIDHJET
E DOBËTA ME KOMITETIN QENDROR DHE PËR
DOBËSI TË THEKSUARA NË BRIGADËN
VII SULMUESE**

17 qershor 1944

Morëm raportin tuaj (në qoftë se mund ta quajmë raport atë letër të shkruajtur me aq shpejtësi dhe ku s'kishte asgjë konkrete). Ju kemi shkruar shumë herë për rëndësinë e mbajtjes në korrent të Shtabit të Përgjithshëm për çdo gjë që ngjet në brigadë ose në terrenin ku ajo vepron. Akoma s'e keni bërë tuajën këtë këshillë. Pastaj duhet të keni pak kujdes kur shkruani raportin, mos me na e çue në dy-tri fletë të një bloku të vogël, që po ta shtrydhësh brendinë e tij, nuk nxjerr gjëkafshë. Nuk duhet kurrë të procedoni në atë mënyrë, duke shkruar një gjë të shpejtë dhe duke shënuar që raporti vjen pas, etj. etj. Raporti duhet të vijë shpejt dhe komplet, qoftë ose jo e mbledhur e gjithë brigada, keni bërë ose jo lidhjet me të o me Brigadën XII. Shtabi i Përgjithshëm nuk mund të ndalojë punën, sepse ju s'keni bërë lidhjen me Brigadën XII dhe të mos mësojë shpejt zhvillimin e luftimeve, lëvizjen e armikut, drejti-

min që kishin marrë kolonat armike, forcat e tija, humbjet e tyre dhe tonat, qëndrimet e partizanëve, të komandantëve dhe të komisarëve, qëndrimin e popullit dhe gjendjen e reparteve, nga çdo pikëpamje. Këtë gjë jo vetëm që duhet ta bëni menjëherë pasi mbarojnë luftimet, po edhe gjatë luftimeve, që të dijë Shtabi të marrë masa eventuale në lidhje me këto veprime. Pastaj, në rast se mungon lidhja me ndonjë batalion, kur ai të jetë kthyer, ju e plotësoni raportin. Duhet të kuptoni se raporti nuk bëhet për raport, por sepse ai ka rëndësi të madhe, dhe ata që e presin e presin të nxjerrin diçka për të vepruar; prandaj duhet të bëni patjetër e shpejt raportin komplet dhe jo vetëm të luftimeve, por mbi të gjitha çfarë shënova më lart.

Brigada juaj të lëvizë menjëherë sipas urdhërit që ka marrë, duke marrë në konsideracion dhe udhëzimet e mëpastajme që u janë dhënë me letra të tjera gjatë ofensivës.

Po ju theksoj edhe një herë, sido që e dini vetë, ju duhet të bëni jetën e batalioneve, që të shohin këto udhëheqësit e tyre, dhe të interesoheni direkt për ngrijtjen e partizanëve dhë të shokëve duke caktuar një plan veprimi e jo një punë të rastit. Interesimi juaj i gjallë dhejeta që do të bëni me repartet dhe partizanët, do të zhdukin shumë moskënaqësi që kanë lindur në brigadën tuaj dhe që do të na shkaktojnë dëme të pandreqshme...

Përsa i përket çështjes së masave që duhet të merrin kundër të arratisurve nga brigada, duhet që vendimet të jenë shumë të matura dhe të drejta. Është gabim dhe s'duhet në asnjë mënyrë të digjen shtëpitë e të arratisurve partizanë dhe ca më pak vrasja e prindërve

të tyre. Të tilla masa s'janë të lejuara, jo që të merren, por as edhe të mendohet çështja në këtë mënyrë. Vetëm ndonjë shtëpi të ndonjë tradhëtarë të dëgjuar, bashkë-punëtor i okupatorëve mund ta djegim, por jo tjetër; këtë gjë e kemi biseduar shumë herë, më duket. Duhet të kuqojmë pse bëhen dezertimet. Këto rrjedhin se partizanët e rekrutuar, ose s'e dinë rëndësinë e ushtrisë dhe të luftës ose kur janë në reparte nuk punohet sa duhet me ta dhe nuk e kanë të qartë pse luftojnë. Kështu që më parë se të mendojmë të marrim masa të tilla kundër atyre partizanëve që kanë një jetë prej dy-tre muaj në brigadë, duhet të mendojmë shumë seriozisht për edukimin e tyre. Kundër ndonjë partizani të vjetër që dezerton, mund të marrim masa vetëm kundër tij, por jo kundër familjes së tij. Ndaj partizanëve të rinj, që dezertojnë, vendimet kundër tyre duhet përsëri të jenë të matura. Dezertimin nuk duhet ta zhdukim me terror, se s'është i përshtatshëm për ushtrinë tonë.

Për çështjen e shtabit të Batalionit I duhet të vepronni me kujdes, më parë se të bëhen ndryshime. Ai shtab paraqitet i pakënaqur prej shtabit të brigadës dhe veçanërisht prej Gjinit. Me Gjinin jam fjalosur veçanërisht për këtë gjë. Për këtë shkak ju duhet të interesoheni për këtë shtab, për këta shokë, t'i ndihmoni konkretisht dhe në rast se s'nxirren rezultate të mira, atëherë veproni duke shkarkuar nga funksionet atë që s'mund ta kryejë dot barrën që i është ngarkuar. Vetëm shohim një gjë, që na ka hequr vërejtjen dhe që duhet t'ju bëjë të mendoni dhe ju, se s'është vetëm Batalioni I, që pretendon se shtabi i brigadës nuk bën jetën e batalioneve e të partizanëve, por edhe Batalioni II ka po atë

qarje. Këtë gjë po jua them për dijeni, dhe në rast se paraqitet kësisoj, duhet të bëni që kjo moskënaqësi të zhduket.

Gjinin veçanërisht e këshillojmë që në vendime të jetë më i shpejtë dhe në diskusione të ruhet e të mos futet në hollësi të mëdha, gjë që shkakton të mos i jepet rëndësia e duhur thelbit të problemit. S'duhet që degët të na ndalojnë të shohim madhësinë e pyllit. Nga ana tjetër të jetë gjakftohtë në vendime.

Besoj se këto këshilla shoqërore do t'u ndihmojnë për t'u zhvilluar puna më mirë dhe brigada të shkojë përpara në të gjitha fushat e veprimit.

Të fala shoqërore

[*Enver Hoxha*]

VDEKJE FASHIZMIT

LIRI POPULLIT

Botohet për herë të parë, si-pas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

**LETËR DREJTUAR SHOKUT RAMIZ ALIA MBI
KRIJIMIN E KOMITETEVE TË RINISË DHE
FORCIMIN E GJENDJES NË BRIGADËN VII
SULMUESE**

17 qershor 1944

**SHOKUT RAMIZ ALIA,
PËRGJEGJËS I RINISË NË SEKSIONIN POLITIK
TË BRIGADES VII SULMUESE**

I dashur shok,

Kemi marrë të dy raportet e tua që na ke drejtar. Këto dy raporte na gjëzojnë për arësyen e qartësisë së tyre, gjë që është pasqyra e punës tënde në brigadë dhe, nga ana tjetër, na vënë në korrent për zhvillimin e mbarë dhe me themel të punës së rinisë në atë repart. Që prej letrës së parë të datës 23.IV.1944 dhe deri te ajo e fundit shohim një organizim dhe një rritje të rinisë ndër batalionet e brigadës, që na lë të shpresojmë për një përparim në këtë drejtim. Për t'ja mbërritur këtij rezultati duhet treguar patjetër kujdes i veçantë me të rinjtë dhe jo vetëm nga ti, por me anën tënde të interesohen gjithë anëtarët e Partisë që të punojnë me këtë sektor me rëndësi.

qarje. Këtë gjë po jua them për dijeni, dhe në rast se paraqitet kësisoj, duhet të bëni që kjo moskënaqësi të zhduket.

Gjinin veçanërisht e këshillojmë që në vendime të jetë më i shpejtë dhe në diskusione të ruhet e të mos futet në hollësi të mëdha, gjë që shkakton të mos i jepet rëndësia e duhur thelbit të problemit. S'duhet që degët të na ndalojnë të shohim madhësinë e pyllit. Nga ana tjetër të jetë gjakftohtë në vendime.

Besoj se këto këshilla shoqërore do t'u ndihmojnë për t'u zhvilluar puna më mirë dhe brigada të shkojë përpara në të gjitha fushat e veprimit.

Të fala shoqërore

[*Enver Hoxha*]

VDEKJE FASHIZMIT
LIRI POPULLIT

*Botohet për herë të parë, si-
pas origjinalit që gjendet në
Arkivin Qendror të Partisë*

**LETËR DREJTUAR SHOKUT RAMIZ ALIA MBI
KRIJIMIN E KOMITETEVE TË RINISË DHE
FORCIMIN E GJENDJES NË BRIGADËN VII
SULMUESE**

17 qershor 1944

**SHOKUT RAMIZ ALIA,
PËRGJEGJËS I RINISË NË SEKSIONIN POLITIK
TË BRIGADES VII SULMUESE**

I dashur shok,

Kemi marrë të dy raportet e tua që na ke drejtuar. Këto dy raporte na gjëzojnë për arësyte të qartësisë së tyre, gjë që është pasqyra e punës tënde në brigadë dhe, nga ana tjetër, na vënë në korrent për zhvillimin e mbarë dhe me themel të punës së rinisë në atë repart. Që prej letrës së parë të datës 23.IV.1944 dhe deri te ajo e fundit shohim një organizim dhe një rritje të rinisë ndër batalionet e brigadës, që na lë të shpresojmë për një përparim në këtë drejtim. Për t'ja mbërritur këtij rezultati duhet treguar patjetër kujdes i veçantë me të rinxjtë dhe jo vetëm nga ti, por me anën tënde të interesohen gjithë anëtarët e Partisë që të punojnë me këtë sektor me rëndësi.

Për çështjen e komitetit të rinisë që duhet të krijojnë në çdo batalion e për të cilin ju ka shkruar ose do t'ju shkruajë Komiteti Qendror i Rinisë, ju duhet të filloni menjëherë me i krijue këto forume, me qëllim që e tërë rinia, që ndodhet në një batalion, të udhëzohet më mirë, duke qenë e organizuar. Këto komitete formohen prej shokëve që kanë një eksperiencë në punën e rinisë. Këtu mund të hyjnë ata shokë që kanë bërë pjesë në komitetet e rinisë në qytete dhe mund të janë anëtarë të komiteteve të rinisë edhe sikur në batalion të kenë një përgjegjësi ushtarake ose politike. Si kurdoherë komitetet e rinisë do të udhëhiqen prej forumeve të Partisë në repart, prej të cilëve do të ndihmohen dhe para tyre do të jepin llogari, por si kurdoherë ata do të kenë iniciativë të plotë në punën e tyre. Këto komitete që do të krijohen do të kenë lidhje direkte me përgjegjësit e aktiveve dhe me edukatorët e grupeve të rinisë, të cilët i udhëzojnë në punë dhe u kërkojnë raportin e punës. Përgjegjës të rinisë në byro duhet të ketë kurdoherë, me gjithë formimin e komitetit të rinisë, dhe ky përgjegjës në byro merr pjesë në komitetin e rinisë të batalionit. Komitetet e rinisë të batalioneve të një brigadë kanë lidhje direkte dhe udhëzohen prej komitetit të rinisë së brigadës, por në një mënyrë indirekte çdo komitet i batalionit merr udhëzime dhe nga zëvendëskomisari i atij batalioni.

Përsa i përket punës së përgjithshme në brigadë, ti duhet që të kujdesesh aq sa kujdese edhe për punën e rinisë dhe sikundër që ndihmon në zhvillimin e punës në sektorin e rinisë, duhet të ndihmosh edhe në sektoret e tjerë të punës. Herë tjetër në raportin tënd duam

të shohim më mirë rezultate në këtë drejtim. E shohim interesimin tënd të veçantë për punën që zhvillohet në brigadë; vetëm duhet të kesh kurdoherë parasysh që shikimet tuaja të drejta, të mos mbeten vetëm konstatime, por në mbledhjet e ndryshme të byrove, të celulave ose të shtabeve, të përpinqesh që me arësyetime dhe me bindje të imponosh rrugën dhe zgjidhjen e drejtë për çdo problem. Konstatimet janë shumë të mira, por do të jenë të dobishme, kur çdo çështjeje t'i jepet shpejt zgjidhja e drejtë.

Për ndryshimin e gjithë shtabit të Batalionit I, atje duhet të punoni pak me kujdes. Nga raportet e ndryshme që na kanë ardhur, kemi konstatuar se në atë batalion ka pasur dhe duhet të ketë edhe moskënaqësi kundër shtabit të brigadës e sidomos kundër Gjin Markut. Këto moskënaqësi, sido që mund të jenë edhe pa arësy, por prapseprapë diçka duhet të ketë; shtabi i brigadës nuk ka qenë në lartësinë e duhur dhe nuk është kujdesur sa duhet për atë batalion e sidomos përshtabin ku paraqiteshin këto moskënaqësi. Po ta shihni të arësyeshme mund të bëni ndryshime duke shkarkuar komandantin e atij batalioni, por edhe këtu duhet të punoni me kujdes, pa u influencuar nga mendimet e njërit e të tjegrit. Para së gjithash duhet t'i jepet ndihma atij batalioni dhe atij shtabi, gjë që u ka munguar, dhe pastaj, duke parë rezultatet, duhet të bëni ndryshime. Në rast se bëhet ndryshimi i komandantit për të cilin, po e theksoj edhe një herë, duhet të rishikohet me kujdes çështja, atij duhet me i ngarkue një detyrë tjeterë me përgjegjësi të përshtatshme për të dhe që mund ta kryejë.

Përsa i përket Gjinit dhe çështjeve që na parashtron, ai nuk ka të drejtë. Në asnjë mënyrë të mos merren masat që propozon ai kundër dezertorëve, shtepive të tyre si dhe prindërve të tyre. Një mënyrë si ajo që përkrah Gjini, s'është aspak me vend dhe e përshtatshme. Edhe kundër atyre që dezertojnë nga radhët e ushtrisë duhet të marrim vendime të matura mirë, se ka dezertorë e dezertorë. Në radhë të parë dezertimi shkaktohet sepse ata që mobilizohen nuk e kanë kuptue mirë rëndësinë e luftës ose nuk është punuar sa duhet me ta kur ata janë inkuadruar në radhët e ushtrisë. Nuk mund të merren masa kundër një partizani që ka dy muaj në ushtri, që s'ka dëgjuar asnjë konferencë ose s'ka parë asnjë kujdes nga ana e udhëheqësve dhe që gjen rastin dhe ikën në shtëpi, edhe aq më pak kundër prindërve të tij. Merren masa drakoniane kundër një partizani të vjetër që dezerton, dhe vetëm kundër tij dhe jo kundër prindërve ose shtëpisë së tij. Djegjet e shtepive duhet të kufizohen shumë dhe të mos merret kjo masë, përvçëse në rastet ekstreme kundër një tradhëtarit. Përsa i përket Gjinit duhet me e këshillue që t'i gjykojë çështjet më me gjakftohtësi dhe më realisht dhe më me pak këmbëngulje, e sidomos kur nuk ka arësy. Kjo është një barrë për të gjithë ju, sepse Gjini duhet të korrektohet nga kjo e metë. Gjini dhe gjithë të tjerët, më parë se të marrin masa të tillë kundër dezertimeve, duhet të bëjnë jetën e brigadës, të ndihmojnë ngritjen e partizanëve dhe mbasandaj do të shohin se dezertimet do të pakësohen.

U ruani nga mendimet dhe vendimet e pamatura dhe mos lejoni në asnjë mënyrë që të zhvillohet opor-

tunizmi në radhët e udhëheqësve. Kundër padrejtësisë duhet të mos hezitoqi për të vepruar me ashpërsinë e duhur. Përsa i përket shokut *** , duhet të tregoni kujdesin më të madh dhe të ndalohen veprimet e tija arbitrale dhe jo të drejta. Të përpinqeni më parë me zhdukë nga ai ambicien dhe fodullëkun dhe të bëni që të përmirësojë sjelljen e tij me partizanët; kjo është gjë kryesore. T'ja bëni të kuplueshme se sjellje të tilla kundër partizanëve nuk janë të lejueshme në ushtrinë tonë, ku respekti i partizanit ndaj udhëheqësit duhet të ketë burimin jo në kërcënimet dhe sharjet, por në sjelljet e mira dhe zotësinë e udhëheqësit.

Vendimet e marrura pa vend dhe arbitrarisht shkaktojnë patjetër komplikacione dhe në rast se nuk merren masa, atëhere rrëshqitet në gabime të tjera...

Kjo ka qenë arësyjeja kryesore që Shtabi i Përgjithshëm ka dhënë urdhër që brigada të kalojë nga sektori i Beratit, ku shumë elementë që kanë mundësi të ndreqen e të korrektohen, po rrëshqasin dita-ditës në intrigat e vjetra të vendit. Nga ana tjetër, shkaku kryesor i lëvizjes së brigadës në sektorë të tjerë ka qenë për me i dhënë fryshtën sulmuese kësaj brigade, e cila do të ketë rastin të bashkëpunojë me të tjetra njësive dhe në terrene të ndryshme nga ai i qarkut të Beratit. Prandaj ju duhet të bëni që të shpejtohet lëvizja e brigadës.

Një e metë tjetër e Gjin Markut është vonesa e raporteve për Shtabin e Përgjithshëm. Kjo gjë ka shkaktuar shumë gabime nga ana e tij. Prandaj ju duhet ta këshilloni që të shkruajë shpejt dhe ta mësoni se si bëhet një raport dhe ç'duhet të vihet në raport, du-

ke lënë mënjanë frazat e gjata boshe e duke shkruar konkretisht.

Mos harro se të gjitha këto duhet të bëhen me mënyra bindëse dhe me durim të madh, duke u vë në shumë herë në sulm, derisa të metat e shokëve të zhduken.

Edhe një herë të theksoj, dhe kam bindjen se do të punosh në këtë drejtim, mos u limito vetëm në konstatime të çështjeve, por interesohu direkt në këto çështje, mendohu mirë e me gjakftohtësi dhe merr vendime të drejta dhe përpiku t'ua bësh shokëve të kuptueshme, si edhe të pranueshme.

Shumë të fala
Për Komitetin Qendror të Partisë

Enver Hoxha

VDEKJE FASHIZMIT
LIRI POPULLIT

Botohet për herë të parë, si pas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

PËRVJETORI I TRETË I LUFTËS HEROIKE TË URSS-it

22 qershor 1941 – 22 qershor 1944¹

22 qershor 1944

Tre vjet më parë si sot Hitleri paturpësisht çori traktatin që kishte me URSS-in² dhe në befasi sulmoi tokat sovjetike, duke filluar, kështu, ndërmarrjen më të çmendur, e cila do të bëhej fatale për Gjermaninë hitleriane. Hitleri, i dehur nga fitoret mbi popujt e Evropës, të cilët i shtiu lehtë nën zgjedhë, duke i plac-kitur deri në palcë, dhe duke u armatosur deri në dhëmbë, sulmoi Bashkimin Sovjetik, duke kujtuar se rezistenca e këtyre popujve do të ishte e dobët, se atje do të shthurej fuqia e Sovjetëve, ashtu si ngjau me demokratitë borgjeze të Perëndimit, dhe kolona e pestë do të zhvillonte punën shkatërrimtare nga brenda.

¹ Material për organizimin e bisedave me rastin e përvjetorit të tretë të Luftës së madhe patriotike të Bashkimit Sovjetik.

² Traktati sovjeto-gjerman mbi mossulmimin, u nënshkrua më 23 gusht 1939 në Moskë me një afat prej 10 vjetësh. Më 22 qershor 1941 Gjermania hitleriane e shkeli këtë traktat duke sulmuar pabesishet BRSS.

Tre vjet me radhë bota e tërë i kishte sytë nga Lindja, ku zhvilloheshin beteja të përgjakshme dhe nga përfundimi i të cilave varej shpëtimi i popujve të botës. Te Ushtria e Kuqe, pjella e punëtcrëve dhe e bujqve sovjetikë, të udhëhequr nga Partia Komuniste (bolshevikë) e URSS-it dhe nga Stalini i madh, ishin varur shpresat e botës përparimtare e punonjëse, ishte varur shpëtimi i qytetërimit mbarë, i kërcënuar nga regjimi fashist gjerman dhe italian, regjim i terrorit mesjetar. Tre vjet heroizma të papërshkrueshme të popujve socialistë, flamurtarë të luftës clirimtare.

Me gjithë përparimin gjerman në tokat sovjetike, me gjithë terrorin që mbillnin kudo që shkonin hunët e motorizuar të kohërave të sotme, fuqia e madhe sovjetike, si një kolos graniti, qëndroi e pathyer dhe dita-ditës godiste si një varë e rëndë ushtrinë hitleriane, e cila ngjyente me gjakun e ushtarëve më të zgjedhur të saj çdo pëllëmbë tokë ku shkelte. Çdo ditë ushtria gjermane po cfilitej, çdo ditë Ushtria e Kuqe po forcohej, po armatosej, po çelnikosej përfatim e mirë të njerëzimit.

Shumëkush u habit prej zhvillimit në këtë mënyrë të kësaj lufte; këta elementë bënin pjesë në atë grumbull njerëzish që ishin fryrë e ngopur prej propagandës antisovjetike, të bërrë nga klikat reaksionare të Evropës dhe nga fashizmi italo-gjerman. Këto klika reaksionare, që mëkëmbën fashizmin, të cilin e bënë forcën më të egër përfshirë të shtypur lëvizjet përparimtare dhe revolucionare në vendet e ndryshme të Evropës dhe përta përdorur kundër shtetit socialist, e paraqitnin në vija të zeza përparimin kolosal që bëhej në URSS në çdo lëmë të aktivitetit njerëzor. Përpara përparimit dhe for-

cimit të Sovjetëve këto klika përdorën si arnië organizimin e luftës dhe të fashizmit dhe paraqitjen e atdheut socialist si një skëterrë. Realiteti ishte krejt ndryshe, dhe lufta e sotme vuri në dukje metodat dhe qëllimet e shpifjeve të reaksionit e të fashizmit si dhe realitetin, brendinë, qëllimet dhe forcën e shtetit socialist.

Kjo forcë e madhe sovjetike, e cila përballoi dhe theu maqinën më të fortë ushtarake që ka parë bota, lindi dhe triumfoi në oshëtimën e Luftës së parë botërore, triumfoi, sepse nën udhëheqjen e bolshevikëve masat popullore të Rusej së vjetër, të munduar, të shfrytëzuar nga regjimi carist dhe imperialist, u çliruan e ndërtuan një shoqëri të lulëzuar, ku njeriu nuk shfrytëzon njerinë, ku njeriu për njerinë nuk është ujk po vëlla, dhe ku një popull nuk shtyp më një popull tjetër, por rron në harmoni të plotë me të.

Vetëm regjimi socialist u dha këtyre popujve fuqinë përparimtare, aftësinë e gjallë dhe vullnetin e çelniktë për të kaluar drejt një qytetërimi të ri. Këtu qëndron madhështia e sistemit sovjetik, këtu qëndron rëndësia e pavdekshme e veprës së madhe të Leninit dhe të Stalinit. Këtej lindi forca e madhe e Bashkimit Sovjetik, i cili shpëtoi botën nga katastrofa.

Hordhitë e tmerrit hitlerian u thyen, sepse gjetën përpara Ushtrinë e Kuqe, një ushtri e dalë nga gjiri i popujve sovjetikë, që ishte lidhur me djersë e me gjak me popullin e vet, një ushtri që dinte përsë luftonte dhe se ç'mbronte, një ushtri që hidhej në zjarr e në flakë, duke pasur në zemër e në gojë prijësin e madh të saj, Stalinin, mjeshterin e pavdekshëm të lumturisë së kaq popujve që kërcënoheshin për vdekje nga Hitleri.

Hordhitë e tmerrit hitlerian u thyen, sepse gjetën përpara popujt sovjetikë, të bashkuar si një trup rrëth Partisë heroike Bolshevikë, rrëth Stalinit, rrëth ushtrisë së saj, gjetën këta popuj jo të përçarë si në Perëndim, me grindje kombëtare dhe me intrigë kundër njëri-tjetrit, por konshientë të rrezikut që kërcënonte jetën e tyre e pasurinë e tyre morale dhe materiale. Këta popuj vunë çdo gjë në shërbim të frontit dhe të Ushtrisë së Kuqe. Që nga pionierët dhe gjer te pleqtë urdhëri i ditës i Stalinit «Çdo gjë për frontin dhe për ushtrinë» u bë gjaku dhe mishi i tyre dhe urdhërin e prijësit të tyre ata e zbatuan, duke dalë ngadhnjimtarë në të gjitha frontet, duke shumëzuar prodhimin e tyre, duke e përmirësuar dhe perfeksionuar. Me qindra fabrika të reja u ngritën, të tjera u shtuan dhe perfeksionuan prodhimin e tyre; popujt e mbarë URSS-it, si një trup i madh e i palodhur, me një vitalitet dhe energji të jasht-zakonshme përkrahën ushtrinë e tyre heroike, e pajisën me armët më moderne, ata dhanë kontributin e pashoq në triumfin e çështjes së madhe të çlirimtë.

Bashkimi i madh Sovjetik, me gjithë fuqitë e tija, goditi pa mëshirë ata që kishin marrë përsipër skllavërimin e botës. Nga fitorja në fitore, nga ofensiva në ofensivë, Ushtria e Kuqe theu armata të tëra hitleriane dhe, në këtë përvjetor të tretë të kësaj lufte vigane, flamuri i Sovjetëve, flamuri i Leninit dhe i Stalinit të madh valon ngadhnjimtar mbi Karpatet, në Ukrainë, në Besarabi, në Bukovinë, në një pjesë të madhe të çliruar të Bjellorusisë. Ushtria e Kuqe lavdiplate kudo pritet ashtu si i ka hije, si shpëtimtare dhe garante e li-

risë së popujve të shtypur. Fjala e Mollotovit¹, që shpreh vullnetin e gjithë popujve të URSS-it, drejtuar popullit rumun, të cilin e thërret të hidhet në luftë kundër invazorit gjerman dhe i garanton këtij indipendencën dhe lirinë, është garanci për gjithë popujt e robëruar, është garanci se nuk do të guxojë kush të shkelë lirinë dhe të drcjtat e popujve dhe se këta popuj, sa më të vegjël të jenë, aq më të madhe do ta kenë përkrahjen nga atdheu i socializmit. Flamuri i madh i Leninit dhe i Stalinit, i mbajtur lart dhe i papërkulur prej punçtorëve, bujqve dhe intelektualëve sovjetikë, po kalon murin «Manerheim»² për t'i çuar dritën e shpëtimit popullit finlandez. Ushtria e Kuqe, me strategjinë e saj që ka çuditur botën, po ndjek bishën e plagosur hitleriane, që tërhiqet në Evropë për të bërë mbrojtjen e saj të fundit. Përvjetori i tretë është përvjetori i fitores, përvjetori që do të sjellë shkatërrimin e plotë të fashizmit.

Popujt e gjithë botës i kanë sytë nga Lindja, sepse Bashkimi Sovjetik është bërë strumbullari rrëth të cilit zhvillohet historia e shoqërisë së tashme dhe sepse lufta që bën Bashkimi Sovjetik jep garancinë e madhe se kjo luftë do të drejtohet nga interesi i çlirimt kombëtar dhe jo i disa qarqeve reaksionare. Popujt e gjithë Evropës, që po luftojnë fashizmin, shohin te Bashkimi Sovjetik dhe te Ushtria e Kuqe ndihmëtaren më të madhe,

¹ Deklarata e V. Mollotovit, komisar i popullit për Punët e Jashtme të BRSS, më 2 prill 1944 në lidhje me qëndrimin e qeverisë sovjctike ndaj Rumanisë.

² Është fjala për vijën «Manerheim» që u ndërtua nga reaksionarët finlandezë në vitet 1929—1939 në kufirin sovjeto-finlandez, e cila konsiderohej nga fashistët si e pakapërcyeshme.

se në saje të fitoreve të Ushtrisë së Kuqe, që solli dobësimin e rezervave hitleriane të shpërndara në Evropë, luftërat nacional-çlirimtare në Evropë muarën një hov të madh. Në këtë ditë të përvjetorit popujt e robëruar, e veçanërisht populli ynë heroik, që ka derdhur gjak për liri, përshëndet Ushtrinë e Kuqe heroike dhe prijësin e madh të saj, Mareshalin Stalin, dhe i siguron ata se do ta vazhdojë luftën deri në fitoren e plotë mbi nazizmin. Sot, në këtë ditë përvjetori, Bashkimi Sovjetik, që është krenaria e gjithë popujve liridashës, me fitoret e tija i sjell dobi botës mbarë. Imperialistët gjermanë, që tre vjet më parë si sot sulmuan pabesisht atdheun sovjetik, shpresën e njerëzisë së vuajtur, i ka pushtuar frika e vdekjes. Kjo ditë të na nxitë për fitore të reja për popullin tonë. Këto fitore do të jenë shprehje e mirënjohjes sonë karshi atij vendi që është aq i madh, sa në të kurrë nuk perëndon dielli, dhe aq i fuqishëm, sa në të nuk ka për t'u errësuar kurrë drita leniniste-staliniane!

Enver Hoxha

*Botohet sipas kopjes
së shaptilografuar që gjendet
në Arkivin Qendror të Partisë*

**LETËR KUADROVE DREJTUESE POLITIKE TË
DIVIZIONIT I TË UNÇSH LIDHUR ME NGURIMIN
NË ZBATIMIN E URDHËRIT TË SHTABIT TË
PËRGJITHSHËM PËR KALIMIN E DIVIZIONIT NË
VERI DHE ME FORCIMIN E PUSHTETIT TË
KËSHILLAVE NACIONAL—ÇLIRIMTARE**

1 korrik 1944

Kemi marrë letrat tuaja si edhe të shokëve të tjerrë të divizionit. Në shtabin e atij divizioni janë shfaqur lëkundje dhe pretekste jo të mira e të shëndosha përmoskalimin në Veri, të cilat nuk duhej të ngjisnin¹. Pretendohej, sikundër që shkruani ju, se ata të shtabit të divizionit nuk mund të niseshin dhe dëshironin të merrnin medoemos një forcë tjetër.

Në radhë të parë të gjithë ju duhet të kuptoni mirë një gjë, pa të cilën nuk mund të shkojmë përpëra, dhe kjo është: *me zbatue pa diskutim urdhërat që dalin nga Shtabi i Përgjithshëm ose Komiteti Qendror, dhe askush nuk lejohet të luajë me to ose t'i azhurnojë*. Sugjerimi cse kërkesa përmarrjen e Brigadës XII dhe lënjen e Brigadës IV dhe andej vendimi i moskalimit në Veri janë vendime në kundërshtim me urdhërin e dhënë nga

¹ Këto lëkundje u shfaqën te Dali Ndreu e Tuk Jakova, komandant e komisar të Divizionit I në këtë kohë.

Shtabi i Përgjithshëm dhe, pra, të rrezikshme dhe të dëmshme. Të dëmshme sepse shtabi i divizionit, duke hasur pengesa rrugës e duke qëlluar dhe shpërndarja e trupave si ajo e Brigadës IV, ka pasur frikë të marrë përgjegjësi për të vazhduar rrugën sipas urdhërit të dhënë dhe, pra, vuri në diskutim e nën kondita kalimin e divizionit në Veri. E rrezikshme sepse në rast se diskutohen urdhërat e dhëna para se të zbatohen, dhe shkelen, atëhere vaj ushtria jonë, Shtabi i Përgjithshëm dhe Partia!

Askujt nuk i lejohej të vepronte në këtë mënyrë, por me ashpërsinë më të madhe duhej të ruhej autoriteti i Shtabit të Përgjithshëm e i Partisë, pa lejuar oportunitazma në zbatimin e urdhërave, s'duhej të hezitonit asnjë minutë për të zbatuar urdhërin e Shtabit për kalimin e Shkumbinit. Gjithë shokët e dinin fare mirë se në planin e përgjithshëm që ishte bërë, çdo brigade i ishte caktuar vendi i posaçëm dhe detyra me rëndësi për ta përbushur, dhe nuk mund të prishej ky plan meqë shtabi i divizionit e gjeti të arësyeshme dhe e gjykoj si pas prizmit të vet. Nga ana tjetër, ofensivën që gjetët përpara, e gjetën të gjitha brigadat dhe ushtria jonë, dhe në këto rrethana ishte gabim të mendohej ashtu si bëtë ju dhe të vendosej si bëri shtabi i divizionit. Brigada XII, të cilës i vutë gishtin, kush mund t'ju siguronte se ishte disponibël të vihej në dispozicion të divizionit, qoftë edhe ndonjë brigadë tjetër? Por edhe sikur të ishte disponibël juve mund t'ju lejohej të shtonit edhe disatë afatin për të grumbulluar forcat e Brigadës IV dhe të vazhdonit rrugën, por jo të kondiciononit urdhërin dhe letrën e dytë që ju shkruajta.

Gabimi i madh, nga i cili duhet të ruhem, ku bien shpesh komandantët e brigadave dhe tanjai i divizionit, është se e shohin punën e luftën nën prizmin e reparteve që komandojnë dhe jo në përgjithësi. Me të vërtetë divizioni ka një detyrë të rëndë që duhet ta kryejë me ata njerëz që ka, por nuk mund të harrojmë se punën të tërë nuk do ta kryejë ai. Brigadat e tjera kanë dhe ato detyra me po aq rëndësi. Në planin e përgjithshëm detyra që i caktohet divisionit nuk mund të pengojë detyrat që u caktohen reparteve të tjera. Pra vetëm Shtabi i Përgjithshëmi mund të ndalojë një urdhër dhe askush tjetër, sepse në rast se të gjitha brigadat vepronin dhe merrnin vendime si ai që kishit marrë ju, atëhere s'do të kemi veçscë një anarki në komandë.

Për këtë gjë duhet të bëni një autokritikë të shëndoshë.

Mos kujtoni se e meta që është parë në ndonjë brigadë, përsa i përket shpirtit të repartit të ekzagjeruar në një mënyrë sa të arrihet deri në nënveftësimin e reparteve të tjera, paraqitet vetëm tek një brigadë, jo. Kjo sëmundje shihet të manifestohet kudo dhe duhet të na preokupojë, se është e dëmishme. Duhet patjetër që udhëheqësit të mendojnë për lartësimin e reparteve të tyre për t'i bërë këto reparte të shquhen, por jo të zhvillohet ndër ta dhe deri tek partizanët një egoizëm i tillë sa që të harrojnë se ekziston një ushtri e tërë, e cila ka nevojë për kuadro e për çdo ndihmë tjetër e që priten prej punës që zhvillohet në reparte. Këtë e them se shohim të zhvillohet një tendencë e tillë që çdo brigadë punon dhe mendon (për aq sa punon dhe mendon) vetëm për vete dhe, kur i kërkohet ndonjë kuadër ose disa

partizanë për të forcuar një repart tjetër, as që i jep, por refuzon kategorikisht, bille shkon edhe më tej, s'përfill as urdhërin e Shtabit. Nga kjo sëmundje rrjedhin dhe të tjera gabime si ai i shikimit ngushtë të luftës dhe të punës. Udhëheqësit, qoftë ushtarakë, por sidomos politikë, të cilët duhet të janë më përpara, mendojnë vetëm për të ngritur kuadro për t'i mbajtur në repartin e tyre dhe u vjen zor me mendue se duhet patjetër të punojnë edhe për repartet e tjera. Në lidhje me këtë duhet t'u theksohet shokëve të Partisë në ushtri, e sidomos udhëheqësve, se duhet të punojnë në mënyrë intensive për lartësimin e kuadrove dhe furnizimin e reparateve të tjera me kuadro politike dhe ushtarake. Lartësimi i kuadrove të mos mbetet një gjë formale dhe e thatë, një gjë e pranuar, e diskutuar, e arësyeshme e stërarësyeshme dhe pa asnë rezultat. Shokët duhet të punojnë në mënyrë që çdo udhëheqës politik ose ushtarak, deri te njësia më e vogël, të ketë zëvendësin e tij. Mos kërkojmë që këta zëvendës të fitojnë një eksperiençë të madhe pastaj t'u japim një përgjegjësi, se në këtë mënyrë nuk do të dalim kurrë nga ky preokupacion i kuadrove që po bëhet dita-ditës një problem shumë i vështirë. Njerëzve të astë, të vendosur, t'u jepet punë me përgjegjësi, të ndihmohen. Në luftë dhe në jetë ata do të fitojnë atë eksperiencë që kërkojmë ne. Duhet të mendojnë shokët se gjithë elementët e terrenit janë thi-thur prej ushtrisë dhe dita-ditës ajo punë po ngjet. Terrenet janë bërë krunde; fillohet një farë organizimi, përnjëherësh udhëheqësit, qoftë edhe me fare pak eksperiencë, i përfshijnë repartet e tjera që formohen. Shokët që janë në ushtri duhet të mendojnë se jo vetëm

që duhet të furnizojnë repartet e tjera, por duhet të furnizojnë edhe terrenet. Në qoftë se ata nuk e shtrojnë në këtë mënyrë problemin, do të jemi vetëvetiu të shtërguar të tërheqim elementët e astë për organizim për t'i dërguar në terrene të ndryshme që të ngrenë punën, e cila është në dekadencë. Po të kemi terrenin të dobët patjetër do të jemi të dobët. Përveç kësaj, shokët e ushtrisë e nënvleftësojnë punën e terrenit, duke mos u preokupuar fare për të dhe arrijnë derisa ta përbuzin. Ky shikim është i ngushtë dhe i dëmshëm. Brigada shkon, bën si automat disa konferanca, krijon disa këshilla dhe kujton se e ka kryer detyrën. Në rast se shokët e Partisë që janë në ushtri nuk e marrin më seriozisht çështjen organizative në ushtri, ndihmën që duhet t'u japid organizatave të terrenit, të cilat kanë nevojë pa masë për ta, sepse gjithë kuadrot e mira gjenden atje, atëhere nuk do të mundim dot të zgjidhim problemet e sotme dhe ato që do të na paraqiten nesër.

Është formuar në disa mentaliteti i gabuar dhe i dëmshëm se çdo gjë i lejohet partizanit ose komandanit, se ai lufton, dhe ai kujton se mund të bëjë dhe padrejtësira. Një arrogancë po fillon të fryjë në ushtrinë tonë, gjë që e largon nga populli. Për këtë po lëshojmë një qarkore, e cila të punohet, dhe këtej e tutje do të merren me të vërtetë masa drakoniane, të cilat të shërbijnë si shembull për të tjerët. Në lidhje me këtë duhet të mendojmë edhe për nesër. Në një ushtri të atillë, që s'e ha fort disiplinën dhe ku zhvillohet një arrogancë dhe një egoizëm i tepruar, ka shumë padrejtësi dhe shumë lëkundje. Në rast se nuk e edukojmë ushtrinë tonë me parime të shëndosha, nesër, kur të çlirojmë qytete,

këta njerëz s'ka se ç'i përmban dhe vetëvetiu e padashur do të krijohet një anarki në radhët e ushtrisë, një ftohtë-sirë në popull dhe një shkëputje e paevitueshmë nga radhët e saj e një pjese të ushtrisë. Patjetër ndjehet nevoja e krijimit në çdo brigadë të ndonjë reparti, i cili të stërvitet për ruajtjen e disiplinës dhe organizimin e qetësisë e të rregullit në qytete. Kjo punë u përket komandave të vendit, por patjetër është e nevojshme që edhe ushtria të ketë nga këto reparte për ta ndihmuar komandën e vendit. Këtë gjë jemi duke e studjuar.

Referatet e ndryshme që janë mbajtur në aktivin e Brigadës I janë të mira në përgjithësi, dhe një punë e tillë duhet të vazhdohet edhe në brigadat e tjera, por shokët duhet të kenë kujdes që, sa thuhen në ato referate dhe ç'konstatohen, të mos mbeten «lettre morte»¹, se pastaj është vetëm pedantizëm. Kur flitet për këshillat duhet të bëhen sqarime më të gjera, duke vënë në dukje formën e re të organizimit ose, më mirë të themi, konkretizimin e punës së këshillave me formimin e qeverisë provizore. Roli i këshillave mbetet kurdoherë kryesori, se ato janë pushteti popullor dhe demokratik dhe jo si thuhet në referat, se këshillat do të krijojnë pushtetin. Por roli i këshillave duhet të kuptohet mirë dhe s'është aq i thjeshtë. Me krijimin e komitetit ato bëhen organet e pushtetit. Këto përfaqësojnë vullnetin e popullit dhe këto janë bazat e shëndosha nga do të dalë gjithë aparati. Deri tani këshillat kanë qenë organe që kryenin në praktikë pak gjëra, por me rëndësi, si

¹ «Lettre morte» (frëngj.) — letër e vdekur, gjë që mbetet në letër e nuk zbatohet.

mbledhjen e ndihmave për ushtrinë etj. Tani ato do të kryejnë detyra të tjera. Pikësëpari ato do të kryejnë edhe funksionet e gjyqeve, natyrisht duke u bazuar në disa ligje, të cilat jemi duke i studjuar në Komitet dhe do t'i aprovojmë në Kryesinë e Këshillit për t'i vënë në aplikim. Nga këshillat, të cilat janë organet e pushtetit, do të varen administrativisht edhe komandat e vendit, që përveç detyrave të tjera, do të kenë dhe atë të organizimit të rrjetës informative si edhe krijimin e rojeve partizane. Këshilli Nacional-Çlirimtar do të jetë pushteti, por bri tij do të krijojen dhe aparatet të veçanta të çdo sektori pune si ai i arësimit, i botores, i shëndetësisë etj. Këto aparatet do të varen drejtpërdrejt nga ministritë përkatëse, nga ku do të marrin urdhëra dhe direktyva, por në çdo qark do të krijohet një këshill administrativ i qarkut, ku do të marrin pjesë të gjithë kryetarët e këtyre seksioneve pune, natyrisht nën kryesinë e kryetarit të këshillit të qarkut. Në këtë këshill administrativ, i veçantë nga këshilli nacional-çlirimtar i qarkut, do të rrihen të gjitha problemet e qarkut, do të kontrollohet puna etj. Këshilli nacional-çlirimtar do të jetë ai, që do t'i krijojë këto aparatet, që nga i fshatit deri te i qarkut. Për shembull të marrim seksionin e kulturës e të propagandës. Këshilli i qarkut ose i katundit duhet të marrë iniciativë për të zgjedhur njerëz të frontit, njerëz të besuar dhe të përshtatshëm për këtë sektor dhe të krijojë një redaksi të veçantë për nxjerrjen e një bulletini, ose të një gazete, për krijimin e një grupei ose këshilli initiator për organizimin e një grupei teatral, muzikor etj. Njëkohësisht një njeri përgjegjës, i dërguar posaçërisht nga Ministria e Kulturës Popullore, shkon

në atë qark dhe, i ndihmuar nga këshilli, jep udhëzime, forcon organizimin e kësaj pune dhe ndihmon në zhvillimin e tyre në shoqëri të veçanta. Pasi të jenë mëkëmbur këto, që lypin ndihmën e këshillave (dhe të Partisë sonë në radhë të parë) të gjitha lidhen me Ministrinë e Kulturës Popullore, e cila krijon aparatin e vet në qark dhe përgjegjësi i këtij aparati në atë qark merr pjesë në këshillin administrativ që thamë më lart. Kësisoj për të gjitha ministritë.

Në këtë drejtim pra duhet të punojnë anëtarët e Partisë ndër terrene si edhe këshillat nacional-çlirimtare.

Përsa i përket arësimit, ata duhet t'u bëjnë thirrje gjithë arësimtarëve që janë në front, natyrisht pa i hequr ata që janë në ushtri dhe të domosdoshëm atje, si edhe të tjerëve që s'janë në front dhe të çelen shkollat në gjithë zonat e lira. Njëkohësisht Ministria e Arësimit do të dërgojë dhe ajo njerëzit e saj që të japid udhëzime dhe ta organizojnë e ta lidhin më mirë rrjetën. Në rast se mungojnë mësues, atëhere kjo detyrë t'u ngarkohet të rinjve që dinë të shkruajnë dhc të këndoja; njëkohësisht t'u jepen dhe disa udhëzime.

Përsa i përket kulturës popullore dhe agitacionit e propagandës duhet që shokët e Partisë, nëpërmjet këshillave, të bëjnë organizimin e shtypit, të krijojnë klubet, të krijojnë bërtthama teatrale, të cilat të preqatitin shfaqje me tema të kontrolluara prej këshillave dhe natyrisht prej shokëve tanë, derisa të krijojen shoqëritë teatrale, muzikore etj. Përsa u përket gjyqeve do t'ju dërgojmë hollësi më vonë, tani për tani gjyqet e vogla të vazhdojnë të bëhen si më parë prej këshillave dhe, në rast se është çështje ushtarake, prej gjyqit ushtarak.

Shokët do të marrin udhëzime më komplete përsa i përket zhvillimit të punës në sektorë të tjerë, si për shëmbull në ekonomi, në çështjen e rindërtimit. Por duke pritur këto udhëzime ju, që të gjithë, duhet të mbani statistikat e katundeve e të shtëpive të djegura, të popullatës së masakruar si edhe emrat e kriminelëve të luftës, dhe këto lista të na i dërgoni edhe neve këtu.

Dr. Petron duhet ta dërgoni sa më parë, se të plagosurve të këtushëm u kanë zënë plagët krimba. Edhe ju atje keni të plagosur, por duhet të përpinqeni të gjeni një doktor tjetër operator. Të vimë te çështja që thamë më lart: mos kërkonit të përvetësoni çdo gjë që gjeni të hazërtë, si çështja e Shaqos që kërkonit. S'gjetet dot një Shaqo në 4000 vetat që keni aty, por kërkonit të na merrni dhe këta të paktë që kemi këtu.

Këtej patëm disa alerta¹ të reja, por pa konsekuenca. Forcat gjermane që operonin në Kurvelesh u tërroqën në Greqi. Lajme s'kemi as nga Brigada VI as nga Brigada XII që vepronin në sektorin e Kurveleshit. Luftimet janë bërë të përgjakshme, tanët kanë qëndruar heroikisht. Po ju vemë disa komunikata. Kur të kemi lajme më të gjata, do t'jua çojmë.

Shumë të fala gjithë shokëve

[Enver Hoxha]

Botohet për herë të parë, si pas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

¹ Alarme.

PËRGJEGJE NOTËS SË GJENERALIT UILLSON, KOMANDANT I SHTABIT ALEAT TË MESDHEUT

12 korrik 1944

SHTABIT ALEAT TË MEDITERRANEË

Me anën e oficerit anglez të ndërlidhjes që ndodhet pranë nesh na u njoftua sa vijon:

«Gjenerali Uillson nuk toleron që partizanët shqiptarë të ndërhyjnë në qëllimet e tija strategjike me anën e luftës civile dhe se lëvizja nacional-çlirimtare nuk mund të kontrollojë gjithë Shqipërinë dhe t'u bëjë ballë gjermanëve pa ndihmën e aleatëve. Oficeri britanik i ndërlidhjes shtoi gjithashtu nga ana e Shtabit të Mesdheut se lëvizja jonë është ftuar të dërgojë delegatët e saj në Itali¹ për të biseduar mbi koordinimin e veprimeve dhe mbi evitimin e luftës civile. Gojarisht oficeri i ndërlidhjes na njoftoi se, në rast se atakohej Abaz Kupi

¹ Biscedimet ndërmjet delegacionit të Komandës së Përgjithshme të Ushtorisë Nacional-Çlirimtare Shqiptare dhe të Shtabit të forcave anglo-amerikane të Mesdheut u zhvilluan në Bari (Itali) në gusht të vitit 1944. Në këto bisedime u hodhën poshtë të gjitha orvatjet që bëri komanda anglo-amerikane për

prej forcave tona, lëvizjes nacional-çlirimtare i pritej çdo ndihmë nga ana e aleatëve».

Për të sqaruar këtë çështje kemi nderin t'ju paraqesim sa vijon: Grindje të brendshme në Shqipëri dhe ca më pak luftë civile nuk ka. *Ka vetëm një grindje dhe një luftë: luftë kundër okupatorit në radhë të parë dhe kundër veglave të tija tradhëtarë.* Lëvizja jonë u rrit dhe u forcua në luftë kundër okupatorit, dhe rrëth kësaj lëvizjeje janë grumbulluar gjithë rrymat politike antifashiste dhe populli ynë që lufton. Në Shqipëri nuk ka grupe ose parti politike jashtë Frontit Nacional-Çlirimtar që të luftojnë okupatorin. Si «Balli Kombëtar», si «Legaliteti» me Abaz Kupin në krye, si bandat e Shefqet Vërlacit dhe «krerët» e Dibrës janë në bashkëpunim direkt me komandën ushtarake gjermane në Shqipëri dhe mbështetja kryesore e qeverisë kuislinge të Tiranës. Këto organizata dhe këta njerëz bëjnë pjesë integrante në tradhëtinë e kuislingëve dhe po luftojnë krah për krah me gjermanët kundër lëvizjes nacional-çlirimtare në Shqipëri dhe, pra, kundër aleatëve. Qëndrimi ynë karshi këtyre njerëzve dhe organizatave është, pra, më se i drejtë dhe lufta jonë është një luftë kundër okupatorit dhe aspak një luftë civile.

Në saje të luftës së ashpër dhe të paprерë që i kemi bërë dhe po i bëjmë okupatorit, lëvizja jonë ka çliruar krahina të tëra dhe ajo kontrollon krejt Shqipërinë e

ta detyruar Ushterinë Nacional-Çlirimtare Shqiptare të ndërpiste veprimet e veta kundër forcave tradhëtarë të «Legalitetit» dhe u kundërshtua çdo ndërhyrje në punët e brendshme të Luftës nacional-çlirimtare të popullit shqiptar.

Jugut, ndërsa në Veri të Shqipërisë, ku ka pasur dhe ka kurdoherë batalione partizane që luftojnë, tani forcat tona po çlironjnë nga thonjtë e okupatorit dhe të tradhëtarëve të gjitha ato zona që presin me krahë hapur ushtrinë e tyre çlirimtare. Me zgjerimin e luftës sonë në gjithë Shqipërinë, me mobilizimin e mbarë popullit, me goditjen e qendrave vitale dhe të komunikacioneve të armikut, si në Jug ashtu edhe në Veri të Shqipërisë, ne kemi bindjen se nuk pengojmë qëllimet e strategjisë aleate, por i ndihmojmë për së tepërmë dhe më së miri. Nga ana tjetër, e dimë mirë se pa ndihmën e aleatëve, pa luftën që po bëjnë aleatët e mëdhenj kundër Gjermanisë naziste, lëvizja jonë nacional-çlirimtare nuk mund të ishte aq e fortë. Lufta jonë është pjesë e pandarë e luftës së madhe antifashiste në gjithë botën dhe alleanca e popullit tonë me blokun anglo-sovjeto-amerikan dhe me gjithë lëvizjet nacional-çlirimtare në botë është një konditë vitale për ne.

Pozitat e aleatëve nuk paraqiten kurrë më të forta se sot në Shqipëri. Planet strategjike të aleatëve nuk kanë pasur kurrë një terren kaq të favorshëm për t'u zbatuar sa sot në vendin tonë. Prandaj e quajmë për detyrë përpara popullit tonë dhe përpara aleatëve t'i bëjmë të njohur gjeneral Uillsonit dhe Shtabit aleat të Mediterranë se informatat që kanë marrë mbi situatën e këtushme janë pa themel dhe jo të drejta. Për të sqaruar çdo çështje dhe për ta vënë në korrent më mirë Shtabin e Mesdheut, si dhe për të biseduar me hollësi koordinimin e veprimeve tona me ato të aleatëve, kemi kërkuar disa herë që të dërgonim delegatët tanë në Itali për t'u marrë vesh për një bashkëpunim më të organi-

zuar kundër okupatorit gjerman. Kërkesat tona kanë qenë pa asnjë rezultat. Kërkojmë përsëri dhe e quajmë të domosdoshëm dërgimin e delegatëve tanë pranë atij Shtabi, dhe shpresojmë se kësaj here Shtabi i Mesdheut nuk do të na e refuzojë kërkesën tonë.

E çmojmë si duhet ndihmën e aleatëve me material lufte¹ etj. dhe e quajmë të domosdoshme për luftën tonë. Nuk besojmë që, për të penguar këtë luftë të drejtë që po bëjmë, të na priten ndihmat me armë, për arësye se ne luftojmë gjermanët dhe Bazin e Canës, që është një tradhëtar dhe që bashkëpunon me gjermanët e me kuislingët e Tiranës. Përkundrazi, kemi bindjen se Shtabi i Mediterranës do ta shqyrtojë çështjen më mirë dhe në interesin e kauzës sonë të përbashkët, ndihmat që do të na jepen do të janë të shpejta, të shpeshta dhe kurdoherë më të shumta...

VDEKJE FASHIZMIT — LIRI POPULLIT

Komandanti i Përgjithshëm i Ushtrisë
Nacional-Çlirimtare Shqiptare
Gjeneral-Kolonel

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë, si pas originalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

¹ Ndihamë materialec e anglo-amerikanëve për Ushtrinë Nacional-Çlirimtare Shqiptare ishte krejt e pamjaftueshme dhe e parëndësishme. Ndihmën më të madhe ata ua dhanë forcave reaksionare të «Ballit Kombëtar» dhe të «Legalitetit».

**LETËR DREJTUAR ZËVENDËSKOMISARIT TË
BRIGADËS VIII SULMUESE MBI EDUKIMIN
IDEOPOLITIK TË KUADROVE DHE MBI
FORCIMIN E ROLIT TË ORGANIZATAVE
BAZË TË PARTISË NË BRIGADË**

18 korrik 1944

ZËVENDËSKOMISARIT TË BRIGADËS VIII SULMUESE

I dashur shok,

Morëm raportin tuaj me datë 6.VII.1944. Nga raporti juaj kemi një pasqyrë mjaft të qartë për gjendjen e brigadës në përgjithësi, por duhet që për drejtuesit politikë dhe ushtarakë të asaj brigade të kemi sqarime më të gjera dhe sa të jctë e mundur objektive. Përshtypja jonë, e formuar prej raporteve tuaja, është se shokët e Partisë dhe drejtuesit janë mjaft të ulët, të paeksperiençë, janë kuadro të reja e që s'kanë bërë një jetë të dendur partie. Duke e njojur këtë situatë duhet të vini tërë forcën tuaj për t'i lartësuar këto kuadro, por dëshira të mos mbetet vetëm një dëshirë. Një situatë të tillë mund dhe duhet ta zhdukni me një punë të parreshtur dhe sistematike, duke organizuar kurse edu-

kative dhe teorike të dendura, duke organizuar konferanca të shpeshta me tema të prej shokëve më të lartësuar dhe herë pas here me organizues nga një aktiv të brigadës. Në këto tema të rrihen problemet aktuale më me rëndësi për punën politike, organizative, për Partinë, për ushtrinë etj. Mbledhjet e celulave të mos bëhen mbledhje banale dhe pa kurrfarë interes. Ato të bëhen të gjalla dhe atje të rrihen problemet me seriozitetin më të madh. Mbledhja e celulës të mos bëhet si një punë angari, por anëtarët ta presin këtë mbledhje me padurim për të rrahur problemet me rëndësi të ditës dhe jo për të shkuar kohën me kritika njërit e tjetrit. Këtë e them se në këto mbledhje, më të shumtë e herës, në vend që të diskutohen probleme serioze që vë momenti përpara organizatës sonë, në vend që të kërkohet rezultati i punës që çdo anëtar i celulës duhet të ketë kryer, në vend që të diskutohen dhe të zbatohen në luftë dhe në jetë direktivat e Komitetit Qendror, shokët merren me gjëra aq të vogla, sa që harrohet puna më me rëndësi. Veçanërisht ti duhet të kesh synë në çdo celulë, të kontrollosh si punohet, të kesh kujdes për edukimin dhe lartësimin e kuadrove dhe të drejtosh e të udhëzosh punën e Partisë në tërë brigadën. Kurrë mos të kënaqesh duke thënë se e kryen mirë punën e Partisë ndonjë sckretar celule, batalioni ose kompanie dhe të neglizhosh kontrollin dhe ndihmën tënde, sado mirë që të shkojë puna. Për mbarëvajtjen e Partisë në brigadë je përgjegjës kryesor përpara Komitetit Qendror, dhe ne kemi bindjen se këtë punë me kaq përgjegjësi do ta kryesh për të mirën e Partisë.

Përsa u përket transferimeve ose pushimeve që ke-

ni bërë në udhëheqësit politikë keni vepruar gabim. Askush s'ka të drejtë për të shkarkuar ose graduuar e degraduar komisarët e zëvendëskomisarët, përvèç Komitetit Qendror të Partisë. Për këto kuadro politike ashtabi i brigadës dhe as gjyqi i brigadës nuk mund të vendosë, përvèçse Partia. Mundet, në raste ekstreme dhe kur lidhjet me Komitetin Qendror të janë të prera e çështja të jetë urgjente, një vendim të tillë ta marrë zëvendëskomisari i brigadës dhe asnjeri tjetër. Prandaj të gjitha ndryshimet që keni bërë në kuadrot politike të janë provizore dhe kërkojmë prej jush të na informoni me shpejtësi dhe imtësisht arësyet përsë bëhen këto ndryshime, veç e veç për çdo element. Në lidhje me këtë duhet të përsëritni vërejtjet për çdo anëtar partie. Në listën që keni 'dërguar s'ka asnje vërejtje konkrete. Mundet që s'i njihnit mirë më parë, por tani ndryshon puna, se brigada ka një jetë më të gjatë...

Të fala shoqërore

Enver Hoxha

VDEKJE FASHIZMIT
LIRI POPULLIT

*Botohet për herë të parë, si-
pas originalit që gjendet në
Arkivin Qendror të Partisë*

NGA KONGRESI I PËRMETIT NË ÇLIRIMIN E PLOTË TË SHQIPERISË

Korrik 1944

Pas tre vjet lufte kundër dy okupatorëve të egër dhe të pamëshirshëm, që kérkonin me çdo mënyrë të na zhduknin si popull, si edhe kundër tradhëtarëve të shumtë që u shitën sunduesve çdo gjë dhe i ndihmuani këta me çdo mjet në veprat e tyre, populli ynë ngjiti njëren pas tjetrës etapat historike të luftës së tij të përgjakshme dhe të organizimit të pushtetit. Populli ynë i vogël, kurdoherë i munduar, i shtypur dhe i shfrytëzuar prej çdo regjimi, kérkonte të shkundej një herë e përgjithmonë nga gjithë këto mjerime, kérkonte një rrugëdalje nga qorrsoqaqet, ku e kishin futur politikanët aventurierë dhe shfrytëzuesit e çdo lloji, kérkonte fushë lufte për të dërmuar sunduesit e tij dhe për të ndërtuar pushtetin e vet popullor, i cili do të ishte i vërtmi pushtet që do të realizonte ëndrrën e tij të lirisë politike e sociale.

Popujt e vegjël, sidon që ishin të paarmatosur me njete lufte, në këtë luftë të përgjithshme antifashiste dhanë provën se ishin në gjendje të përballonin sulmet e hunëve modernë dhe të dilnin fitues, sepse ata ishin

të frysmezuar me idealin e lirisë, të drejtësisë dhe sepse mbroheshin kundër klikave të egra e të pashpirt, që kërkonin t'i skllavëronin. Kjo gjë ngjau dhe për popullin shqiptar. Ky u çua në këmbë kundër fashizmit, kundër tradhëtarëve, kundër robërisë, u hodh me mish e me shpirt në rrugën e luftës, ku ai e dinte se do të gjakosej, do të vritej, do të digjej, por do të fitonte çdo gjë, do të siguronte një të ardhme të lumtur dhe një liri të plotë. Drejt kësaj rruge të lavdishme populli ynë kaloi gradualisht, sepse rruga ishte me ferra, të cilat duhej të spastroheshin. Ferra më e madhe ishte okupatori me aparatin e tij të tmerrshëm shtypës, i cili kishte mundur të mbillte idenë se s'kish fuqi që ta thyente, ishin tradhëtarët që përpinqeshin të ndalonin çdo grumbullim për rezistencë, që mbillnin disfatzimin, përcarjen dhe, më në fund, vëllavrasjen. Një pengesë e madhe ishte dhe ideja që ushqenin disa mendjemykur se nuk do të realizohej dot forca e madhe dhe e gjallë që buçiste te populli ynë, ajo forcë që do të bënte mrekullira, që do të qëndronte heroikisht kundër okupatorëve dhe tradhëtarëve të çdo lloji. Vetëm se kësaj force i mungonte organizimi, i mungonin udhëheqësit e vërtetë të tij, udhëheqës jo të fabrikuar dhe fals, por të dalë nga gjiri i saj, nga vuajtjet, nga mjerimi dhe nga lufta. Vetëm të tillë udhëheqës dinin e kuptionin ndjenjat, hallet dhe aspiratat e popullit të tyre dhe nuk luannin me fatin e tij dhe gjakun e vyer të popullit, që vadiste malet e qytetet e Shqipërisë, nuk e shnderonin dhe nuk e shitnin me kompromise dhe tradhëti, se atyre u dhimbej populli, sepse populli dhe udhëheqësit ishin një, se populli ishte vetë ai që udhëhiqte.

Mrekullia për ata që s'e besonin ngjau, por kjo nuk ra nga qiejt, u bë me gjak e me djersë, me vuajtje e mundime.

Historia do të shkruajë epopenë legjendare të popullit tonë në luftën antifashiste, heroizmat e pashoqë të partizanëve shqiptarë, të luftëtarëve të katundeve dhe të qyteteve, të ushtrisë së prapavijave, rolin e madh e të pavdekshëm të Partisë Komuniste të Shqipërisë. Kurrë në historinë e popullit tonë nuk ishte parë një luftë e tillë, ku të merrnin pjesë pa përjashtim që prej të vegjëlve gjer te mëmat tona plaka, kurrë s'ishte parë që gjithë energjitetë e këtij populli të vogël, duke shqelmuar çdo paragjykim dhe zakon prapanik, të drejtohen në një luftë të ashpër për liri dhe pavarësi. Këtij hovi të madh kryengritës, këtij vullneti të çelniktë të popullit tonë, s'i dualën dot përpara dhe ta thyenin as italianët, as gjermanët dhe as tradhëtarët. Me armë në dorë populli shqiptar mësoi të luftojë kundër një armiku me tradita ushtarake shekullore, me armë në dorë ai fitoi të drejtat e tija, ai mësoi të krijojë dhe të organizojë ushtrinë e rregullt dhe pushtetin e tij.

Konferenca e Pezës ishte baza dhe hapi i parë drejt bashkimit dhe organizimit, drejt grumbullimit të luftëtarëve në njësi të rregullta, drejt hedhjes së bazave të pushtetit popullor demokratik të këshillave. Pas shumë luftërash e përpjekjesh kundër okupatorit italian, kundër tradhëtarëve të «Ballit Kombëtar» dhe kuislingëve të ndryshëm, lufta jonë arriti gjer në Konferencën e Labinotit, e cila forcoi pushtetin dhe e centralizoi atë. Në korrik 1943, në Labinot u krijua Shtabi i Përgjithshëm dhe Ushtria e rregullt Nacional-Çlirim-

tare, që u bë tmerri i okupatorit dhe i tradhëtarëve dhe mbrojtësja e të drejtave të popullit dhe të tokave të cliruara.

Okupatori gjerman, me shkeljen e vendit tonë, nuk gjeti përpara një popull të hutuar, të organizuar, nuk i gjeti luftëtarët të izoluar, të pasprovuar në luftë dhe pa një disiplinë të hekurt dhe të vetëdijshme, por gjeti një popull të organizuar rreth këshillave nacional-çlirimtare dhe ushtrisë. Okupatori e ndjeu se qëndrimi i tij në vendin tonë nuk do të ishte i rehatshëm, dhe përkëtë arësy ai, tok me kuislingët, me «Ballin», me «Legalitetin» dhe me gjithë plehrat e tjera të vendit tonë organizoi ofensivë pas ofensive kundër Ushtrisë Nacional-Çlirimtare dhe popullit shqiptar. Përpara terrorist gjerman dhe atij të reaksionarëve, populli shqiptar dhe Ushtria Nacional-Çlirimtare treguan heroizma të papërshkrueshme. Populli i gjithë krahinave me armë në dorë, tok me Ushtrinë Nacional-Çlirimtare, mbrojti çdo pëllëmbë tokë, çdo kasolle. Në këtë fazë të re të luftës sonë u mblodh Kongresi Antifashist Nacional-Çlirimtar, që u mbajt në Përmet më 24 Maj 1944. Ky kongres është kurorëzimi i luftës sonë të madhe dhe shprehja e vullnetit dhe e dëshirave të një populli të tërë që lufton, është realizimi i dëshirave të mijëra bijve të popullit, që sakrifikuani jetën e tyre që populli shqiptar të mbërrrijë në këtë ditë, të marrë frenat e lëvizjes në dorë dhe të vetëqeveriset.

Në zjarrin e luftës populli shqiptar dërgoi në këtë kongres historik delegatët e vet më të besuar dhe të sprovuar në luftë për besnikërinë e tyre karshi tij. Për të parën herë në vendin tonë populli ynë, që tradhëtarët

reaksionarë s'c kishin konsideruar kurrë si një faktor, por që e cilësonin si prapanik dhe të denjë të milej e të shfrytëzohej, bëri zgjedhje me udhë demokratike. Një muaj zona të lira të tëra zienin nga mitingjet e popullit, i cili zgjidhte delegatët, në një kohë kur Ushtria Nacional-Çlirimtare sulmonte barbarët nazistë dhe tradhëtarët. Delegatë të shumtë erdhën dhe nga zonat e okupuara si përsaqësues të popullit heroik të atyre viseve që nën terrorin më të zi kanë mbajtur lart flamurin e luftës.

Kongresi i Përmetit ishte bashkimi i gjallë i popullit dhe i ushtrisë, ishte bashkim i plotë njerëzish dhe bindjesh politike të ndryshme, ishte vëllazërimi i të gjitha besimeve që ekzistojnë në vendin tonë, të bashkuar të tërë në Frontin Nacional-Çlirimtar. Komunistë, republikanë demokratë, klerikë patriotë etj. vëllazërohezin në këtë kongres me rëndësi, të gjithë të fryshtuan nga një ideal i madh — çlirimi i atdheut — të lidhur ngushtë njëri me tjetrin me gjakun e tyre të përbashkët të dërdhur pa kursyer në luftën antifashiste kundër okupatorit dhe tradhëtarëve për shpëtimin e vendit, të nderit e të zakoneve shqiptare dhe për vendosjen e pushtetit demokratik të popullit.

Rëndësia e Kongresit Antifashist Nacional-Çlirimtar të Përmetit qëndron në punimet dhe vendimet e tij, në fryshtën që ndihej në atë kongres, në rrethanat e jashtme dhe të brendshme në të cilat u zhvillua dhe në reperkusionet që pati dhe do të ketë në dobi të luftës, si brenda ashtu dhe jashtë Shqipërisë.

Me veprimet e tija historike ky kongres konsolidoi Frontin Nacional-Çlirimtar, i hapi perspektiva të gjera luftës dhe i dha pushtetit një formë konkrete dhe të

re, të përshtatshme me rrethanat e luftës dhe në baza demokratike përparimtare. Kongresi zgjodhi Këshillin Antifashist Nacional-Çlirimtar dhe këtij i dha të gjitha atributet e pushtetit legjislativ dhe ekzekutiv, dhe Këshilli i Përgjithshëm, i veshur me këto pushtete dhe që përfaqëson vullnetin dhe sovranitetin e popullit shqiptar, emëroi organin e vet ekzekutiv dhe urdhërdhënës, Komitetin Antifashist Nacional-Çlirimtar. Vendimeve të mësipërme me një rëndësi historike, kongresi u shtoi vendime të tjera me po aq rëndësi politike dhe jetike për vendin tonë dhe që shprehnin dëshirat e mbarë popullit shqiptar. Vendimi kryesor është vazhdimi i luftës më me rreptësi kundër okupatorit dhe tradhëtarëve të grumbulluar në organizata të ndryshme si ajo e «Ballit Kombëtar», e «Legalitetit», e «Partisë Socialdemokrate» etj. Ky vendim, i marrë unanimisht dhe me duartrokitje të paprera, tregon se populli ynë e ka kuptuar se shpëtimi i tij varet vetëm nga lufta e rreptë dhe e paprerë që duhet të bëjë kundër armiqve të tij. Në lidhje me këtë vendim kryesor dhe të drejtë të kongresit ju bë thirrje gjithë popullit të marrë pjesë aktive në luftë, ju bë thirrje gjithë atyre elementeve të gabuar, por të ndershëm, të dezertojnë sa më parë nga radhët e organizatave tradhëtare dhe të këpusin zinxhirët, me të cilët i kanë lidhur tradhëtarët, të bashkohen me ushtrinë dhe me Frontin Nacional-Çlirimtar. Kjo tregon, nga ana tjetër, kujdesin e madh dhe vijën e drejtë që ka fronti ynë për të zgjeruar luftën, për të futur në luftë të gjithë ata që deri tanë, të gënjer ose nga frika, qëndronin spektatorë në këtë luftë vendimtare që bën populli ynë.

Vendim tjetër me rëndësi është shfaqja e besnikërisë ndaj aleancës së madhe me aleatët e mëdhenj dhe me popujt e tjerë të robëruar që luftojnë okupatorin. Asnjë re e zezë nuk mund të ekzistojë në vijën politike të drejtë të frontit tonë, asnjë tronditje, me gjithë terrorin dhe demagogjinë që ka përdorur armiku. Besimi në fitoren ishte i plotë, dhe për t'ja mbërritur kësaj gjëje u theksua bashkëpunimi i ngushtë jo vetëm me aleatët e mëdhenj, por me gjithë popujt e robëruar e sidomos me popujt fqinjë jugosllavë dhe grek. Me këta popuj, të cilët heroikisht po luftojnë të njëtin okupator, asgjë s'na ndan. Kundër reaksionarëve tradhëtarë që përpiken të hedhin popullin tonë në gjakderdhje me popujt fqinjë, kundër politikës së tyre shoviniste në favor të gjermanëve, Kongresi i Përmetit vuri në dukje se vetëm me një vëllazërim dhe bashkëpunim të ngushtë ndërmjet nesh dhe këtyre popujve ne do të arrijmë të mposhtim armikun e përbashkët dhe të zgjidhim me mënyrën vëllazërore mosmarrëveshjet që mund të ekzistojnë, të shkaktuara nga lodra e Versajës dhe e reaksionarëve imperialistë. Kjo vijë politike, e qartë dhe në harmoni të plotë me vijën politike të gjithë blokut antifashist, duhet të jetë vija e vetme dhe rruga e shpëtimit, që duhet të ndjekin jo vetëm kosovarët dhe çamërit, por gjithë popujt në Evropë, që Traktati i Versajës i kishte bërë lesh e li.

Kongresi që përfaqësonte vullnetin e popullit tonë vendosi me një zë ndalimin e hyrjes së Zogut në Shqipëri, i cili kishte ardhur me forcë në vendin tonë, kundër vullnetit të popullit dhe që me regjimin e tij antipopullor kishte mbjellë terrorin më të zi, kishte shfrytëzuar

popullin dhe kishte preqatitur ardhjen e fashizmit, duke shitur vendin për interesat e tija personale dhe të klikave të tija hajdute. Ky vendim me kaq rëndësi, që mori kongresi, ishte ngjallja e shpresave të mëdha të popullit tonë, i cili e ndjen veten të fortë tani më tepër se kurdoherë për të përballuar çdo manevër nga ana e elementeve tradhëtarë, si Bazi i Canës e Mehdi Frashëri, që kërkojnë të kthejnë të kaluarën.

Kongresi vendosi të mos njihet asnjë qeveri tjeter që mund të formohet brenda ose jashtë Shqipërisë kundër vullnetit të popullit shqiptar, të cilin e përfaqëson vetëm Këshilli dhe Komiteti Antifashist Nacional-Çlirimtar. Ky vendim ua preu hovin klikave reaksionare të brendshme dhe të jashtme, që kurdoherë kanë luajtur me fatin e popullit tonë dhe e kanë përdorur këtë si vegël për të sjellë në fuqi qeveri antipopullore dhe avventurierë. Vdiqën tani e tutje kombinacionet që bëheshin prapa perdes, qofshin ndër skena shqiptare, qofshin ndër rrethe ndërkombëtare. Sot populli është zot, sot ai vetëvendos, dhe kundër vullnetit të tij asgjë nuk mund të bëhet. Këtë ja garantoi gjaku që ka derdhur, këtë ja garantojnë armët që ka në dorë. Kongresi i madh i Përmetit është një nga evenimentet më me rëndësi të historisë së popullit tonë. Ai u mbajt kur armata e Ushtrisë së Kuqe po goditnin për vdekje Gjermaninë naziste dhe po marshonin triumfalish në Evropë, kur aleatët e mëdhenj po preqatitnën zbarkimin në Francë, kur në vendin tonë Lufta nacional-çlirimtare kishte marrë një hov të madh dhe përpara frontit tonë viheshin probleme me rëndësi. Me vendimet e tija mori masat për të sigruar zhvillimin me sukses të luftës, organi-

zimin e pushtetit të popullit dhe zgjidhjen e problemeve me rëndësi që na paraqiten, si popull që lufton dhe që don të rrojë i lirë dhe indipendent.

Me krijimin e Komitetit Antifashist me të gjitha atributet e një qeverie provizore, marrëdhënjet tona me shtetet aleate do të forcohen. Komiteti do të mbrojë të drejtat e popullit tonë dhe do të kërkojë që edhe populli shqiptar, si dhe gjithë popujt e tjerë që luftojnë okupatorin, të ketë dhe ai delegatët e vet zyrtarë kudo që bisedohen çështjet që i përkasin vendit tonë. Komiteti do të parashtrojë pranë qeverive aleate të gjitha dëshirat dhe vendimet e popullit shqiptar dhe do të bëjë që populli ynë heroik të ketë vendin e tij të merituar me gjakun që ka derdhur në radhën e parë të anëtarëve të blokut antifashist. Në çështjen e brendshme ai do ta organizojë pushtetin e shëndoshë të popullit, duke spastruar gjithë mbeturinat fashiste dhe metodat e vjetra që janë përdorur për të shfrytëzuar popullin tonë, dhe do të sjellë kudo në fuqi popullin, i cili ta ndjejë për herë të parë në historinë e tij se ai vetëqeveriset. Komiteti do të marrë gjithë masat për organizimin e jetës publike dhe për rindërtimin e atdheut të djegur prej okupatorit dhe kuislingëve, do të marrë masat për të mëkëmbur industrië tona dhe për t'i zhvilluar ato. Me të tjera fjalë, në luftë e sipër dhe me luftë do të organizohet Shqipëria e re, Shqipëria demokratike e popullit, Shqipëria pa okupatorë dhe tradhëtarë, Shqipëria, ku të gjithë të gjëzojnë të drejtat që u jep shoqëria dhe të gjithë të respektojnë të drejtat që ka shoqëria mbi ta.

Kongresi i Përmetit hodhi bazat e shëndosha të drejtësisë së popullit, të sovranitetit të tij, të cilat s'ka

kush i shtyp, s'ka kush i shkel, por përkundrazi do të respektohen dhe do të mbrohen jo vetëm prej atyre që kanë derdhur gjak, por prej gjithë popujve përparimdashës, sepse ato hapin rrugën për ndërtimin e një shoqërie të re përparimtare.

Enver Hoxha

*Botuar për herë të parë në
«Bashkimi» numër special,
korrik 1944*

*Botohet sipas tekstit të
gazetës «Bashkimi»*

DALLAVERAXHINJTË E VJETËR DHE ARMIQTË E POPULLIT PO LIDHIN MIQËSI TË REJA

Korrik 1944

Kjo luftë e përgjakshme, që i kushtoi botës kaq viktima, vuajtje dhe mjerime, zbuloi para popullit të gjithë armiqtë e tij, që haptazi ose fshehurazi bënин njëmijë e një poshtërsi mbi kurrizin e tij. Prapa perdes thuren sot, si kurdoherë, intriga dhe plane të errëta, sipas zakoneve të vjetra. Populli shqiptar ka qenë viktimë e këtyre lodrave të dallaveraxhinjve e të aventurierëve, që i kanë pirë gjakun dhe e kanë futur në njëmijë kallëpe të poshtra, të cilat i kanë kushtuar shtrenjtë.

Politikanët aventurierë po grumbullohen që të krijojnë miqësi të reja dhe të rrezikshme për popullin dhe të kombinojnë aleanca, që s'janë gjë tjetër vecse tradhëti të reja. Këta politikanë të falimentuar gjithë përpjekjet e tyre i kanë drejtuar kundër popullit dhe kundër lëvizjes së tij nacional-çlirimtare. Për të gjithë këta njerëz ka pushuar çdo grindje dhe mosmarrëveshje ose «armiqësi» që ekzistonte në mes tyre. Këto «armiqësi» kishin për qëllim të gënjenin popullin dhe shkaktoheshin nga egoizmi se kush e kush prej tyre t'ja hypte popullit mbi kurriz më mirë. Ata janë grindur me njëri-tjetrin, sepse

interesat e tyre personale, për ambicjet e tyre të ndyra, harruan çdo grindje që i ndante dhe gjithë forcën e tyre e drejtuan kundër popullit, i cili po u shpëtonte për gjithnjë nga duart. Metodat e tyre të vjetra dhe bajate vazhdojnë t'i vënë në zbatim. Ata flasin fjalë të mëdha për indipendencë, për vetëqeverim, por nën bajonetat gjermane, ata bërtasin për lirinë e popullit dhe për luftën e tij, por, në vend që të rrëmbej pushkët dhe të delnin e të luftonin me popullin dhe në pallë të popullit, ata, tok me italianët dhe me gjermanët, shkojnë në luftë kundër popullit dhe vrashin, presin dhe djegin fshatrat shqiptare. Ata, për të gënjer popullin dho për të fshehur tradhëtinë e tyre, tregojnë me gisht «rrezikun komunist», kundër të cilit ata bashkohen me çdo armik të vendit tonë. Realiteti është krejt ndryshe dhe populli ynë e ka kuptuar ç'është komunizmi dhe cilët janë komunistët shqiptarë, ai i sheh haptazi qëllimet e përpjekjet e tyre vigane. Por puna s'është atje. Këta reaksionarë të poshtër kanë frikë nga populli që s'u beson më as pallavrave të tyre dhe as metodave të poshtra që përdorin. Për t'i fshehur popullit qëllimet e tyre tradhëtare ata hiqen si miq të anglezëve dhe të lidhur me ta. Bazi i Canës, i lidhur ngushtë me gjermanët, me kuëslingët dhe me «Ballin Kombëtar», përpinqet të duket si kundër gjermanëve, duke qëndruar në mal dhe mik me anglezët. Lumo Skëndua dhe Ali Këlcyra me shokë pëshpërisin andej-këtej se e kanë rregulluar punën me anglezët, të cilët janë me ta dhe se anglezët lozin një politikë të madhe dhe që është në kundërshtim me lëvizjen nacional-çlirimtare dhe me komunizmin, se ata s'janë me lëvizjet përparimtare, por me reaksionarët e

tipit të Ali Bej Këlcyrës. Përmbi të gjithë, kuislingu Mehdi Frashëri, vegël e ndyrë e gjermanëve, përpinqet me çdo kusht të bëjë pajtimin e reaksionarëve, zogistëve, pseudointelektualëve e të gjithë armiqve të popullit, se e sheh që rreziku i tyre është i madh dhe vjen prej popullit. Të gjitha këto i bëjnë me qëllim që të dobësojnë besimin e popullit në fitore e në aleancën e blokut të madh antifashist dhe që të mbajnë gjallë në popull metodat dhe intrigat e kohërave të vjetra.

Tendenca e tyre është që populli t'i besojë këta, se janë politikanë të regjur, dhe t'i besojë Gjermanisë. Në këtë mënyrë ata përpiken të ndalojnë bashkimin e forcave antihitleriane, përpiken të dobësojnë çështjen e përgjithshme, aleancën, luftën dhe bashkimin e vëllazërimin e popullit shqiptar.

Këta njerëz na akuzojnë për tradhëti, na akuzojnë të shitur tek njëri e tek tjetri, por më kot. Populli ynë nuk i beson këto poshtërsi, sepse e sheh haptazi rrugën tonë të drejtë, që është e tija, dhe tradhëtinë e atyre. Dokumenti me rëndësi i tradhëtisë së «Ballit», zogistëve dhe kuislingëve, që përpiken të lidhin miqësi të reja me reaksionarët e vendeve fqinje, vë në dukje qëllimet dhe fytyrën e vërtetë të këtyre armiqve të popullit. Dokumenti në fjalë, që është kapur prej forcave tona në momentin kur po i dërgohej tradhëtarit Dhimitër Fallo në Greqi me anë të dy oficerëve kuislingë dhe kopja e të cilët është shpërndarë në popull, vë në dukje lidhjen e ngushtë ndërmjet Gjermanisë, «Ballit Kombëtar», zogistëve, Bazit të Canës dhe reaksionarëve të Kosovës, të cilët kanë dërguar delegatët e tyre për të lidhur miqësi dhe aleanca me reaksionarët grekë, si Ralis dhe

Zerva¹. Këto lidhje me reaksionin e huaj bëhen nën patronazhin e Gjermanisë dhe kundër popullit shqiptar. Tradhëtarët si Lumo Skëndua na akuzojnë se kemi shitur çdo gjë tek i huaji, se kemi sakrifikuar Kosovën dhe Çamërinë! Dokumentat e faktet provojnë të kundërtën. Janë ata që bëjnë demagogji dhe tradhëti, ata pranojnë të vënë nën komandën e ushtrisë reaksionare greke ushtrinë shqiptare. Të gjitha këto nuk mund ta gënjejnë popullin dhe ta largojnë nga lufta. Më kot po përpiken Lumo Skëndua dhe Ali Këlcyrë me shokë të hiqen si patriotë, ata s'janë veçse tradhëtarë; më kot Bazi i Canës përpitet të fshehë tradhëtinë e tij, duke qëndruar në mal dhe duke qenë i lidhur me anglezët. Historia e Dražha Mihajloviçit nuk do të përsëritet; ne nuk do të lejojmë që të përsëritet. Më kot Abaz Ermenët e ndryshëm mbajnjë fjalime në kinema të ndryshme të qyteteve nën përkrahjen e Gestapos, duke sharë Luftën nacional-çlirimtare; më kot sharlatani renegat i Gjormit Sadik Premtja, agjent i Gestapos, lëshon prej burgjeve të Vlorës njerëzit e popullit të munduar, që t'i gënjejë, duke u folur si «komunist i vërtetë nacional». Më kot tradhëtarët si Bahri Omari, Kolë Tromara e Koço Muka me shokë rënkojnë andej e këtej se u bënë ministra të Gestapos për të shpëtuar diçka nga thonjtë e Xhafer Devës². Më kot shkojnë delegatët e tyre në Greqi, te Mihajloviçi e te Nediçi e gjetkë për të lidhur traktate në

¹ Oficer fashist grek, shovinist i tërbuar, një nga krerët kryesorë të reaksionit në Greqi gjatë Luftës së dytë botërore, vegël e imperialistëve anglezë.

² Ministër i brendshëm në qeverinë kuslinge të Rexhep Mitrovicës (tetor 1943 — qershori 1944).

dëm të popullit tonë. Të gjitha këto poshtërsi do të marrin fund për së shpejti nën grushtin e shëndoshë të popullit shqiptar dhe të Ushtrisë së tij Nacional-Çlirimtare.

Me qindra delegatë të popullit shqiptar, që u dërguan në Kongresin e madh Antifashist të Përmetit, shprehën urrejtjen e thellë për këta tradhëtarë të lidhur me okupatorin dhe vullnetin e patundur të një populli të tërë që do të luftojë gjer në vdekje okupatorin dhe hyzmeqarët e tij dallaveraxhinj politikanë. Kongresi damkosi me vulën e tradhëtisë edhe politikën e tyre shoviniste kundër shteteve fqinje, që ka për qëllim ta kthejë luftën kundër okupatorit në një kanal tjeter.

Gjermanët, të goditur nga të katër anët dhe të plagosur rëndë, duke parë se lëvizja jonë po merr proporcione të gjera dhe se pozita e tyre në Ballkan po bëhet dita-ditës më e zorshme, bashkë me kuislingët e Tiranës, ballistët dhe larot e «Legalitetit», shpërthyen në Jug të Shqipërisë një ofensivë të tërbuar për të shkatërruar ushtrinë tonë. Tri divizione gjermane¹, të freskëta dhe të stërvitura në luftën partizane, dhe shumë mercenarë, të «Ballit» dhe të Bazit, të Hysni Demës² dhe të Ali Këlçyrës, dhe xhandarët e Mehdi Frashërit, që si bisha dogjën fshatra dhe vranë foshnjat e pafajshme, kujtuan se do të goditnin rëndë ushtrinë tonë. Por për fatin e mirë të atdheut ata gjetën përpara zjarrin e partizanëve dhe me qindra gjermanë dhe tradhëtarë paguan

¹ Më vonë u vërtetua se në operacionin e qershorit kundër Ushtrisë Nacional-Çlirimtare Shqiptare morën pjesë katër divizione e gjysmë gjermane.

² Komandant i përgjithshëm i xhandarmërisë kuislinge në kohën e pushtimit gjerman.

me jetën e tyre çdo hap që bënë në tokat e çliruara. Ushtria jonë, e fortë dhe e organizuar, ajo ushtri që u çelnikos pas kaq luftimesh dhe që i përballoi dhe doli fitimtare nga ofensiva e dimrit, diti të manevrojë, të luftojë heroikisht dhe të prishë planet e armikut. Ushtria jonë ishte në çdo shteg, në çdo grykë, në çdo rrugë, dhe gjermanët e tradhëtarët e paguan shtrenjtë ofensivën e tyre të dytë. Me qindra e me qindra gjermanë paguan barbarizmat që i bënë popullit.

Operacionet e mëdha të kombinuara të blokut antifashist në Lindje, në Perëndim dhe në frontet e ndryshme nacional-çlirimtare, po e shtërngojnë në një hallkë të hekurt padronin e tradhëtarëve tanë dhe po e detyrojnë të marrë masa radikale dhe të shpejta për divizionet e tija në Ballkan. Brigadat dhe divizionet tona do ta bëjnë si gjithnjë detyrën e tyre, do t'u japin mësimin e merituar dhe të fundit okupatorit dhe gjithë plehrave reaksionare që i shkaktuan popullit dhe atdheut kaq mjerime.

Drejtësia e madhe po afrohet dhe bashkë me të çlirim i popullit shqiptar.

*Botuar për herë të parë në
«Bashkimi» numër special,
korrik 1944*

*Botohet sipas tekstit të
gazetës «Bashkimi»*

**LETËR DREJTUAR KOMITETIT QARKOR TË
PARTISË KOMUNISTE TË SHQIPËRISË PËR
KORÇËN NË LIDHJE ME RISHIKIMIN DHE
REDAKTIMIN E REZOLUCIONIT TË AKTIVIT
TË PARTISË TË ATIJ QARKU**

1 gusht 1944

KOMITETIT QARKOR TË KORÇËS

Të dashur shokë,

Morëm rezolucionin e aktivit të Partisë për qarkun tuaj, gjithashtu edhe raportin e të deleguarit tonë që asistoi në atë aktiv. Kemi bindjen se ai entuziazëm dhe ai interesim e gjallëri që u shfaqën në atë aktiv do të komunikohen në tërë organizatën e Korçës, në mënyrë që puna e Partisë të marrë një hov të ri dhe të kontribuojë në forcimin e Partisë dhe të luftës.

Përsa i përket rezolucionit mendojmë se duhet ta rishikoni edhe një herë para se ta shtypni dhe ta punoni në organizatë; në ripunimin e tij të merrni në konsideracion disa vërejtje që po shënojmë më poshtë, të cilat do t'ju shërbejnë për kompletimin e tij.

Kur të formuloni një rezolucion duhet të keni para-

sysh që atje një anëtar partie të shohë qartazi vijën politike të përgjithshme, direktivat e reja, gabimet, detyrat, dhe ai t'i shërbejë si një udhëheqës në situatat e krijuara, t'i hapë njëkohësisht horizonte perspektivash të reja. Duke njojur vijën e Partisë një anëtar ka nevojë të sqa-rohet mbi aktualitetin dhe të udhëzohet në situatat e ndërlikuara që krijohen. Për këtë arësye konkluzionet e dala nga studimi që i është bërë çdo çështjeje në mble-dhjen e aktivit duhet të shënohen konkretisht dhe jo në një mënyrë sempliste dhe me terma të përgjithshme, të cilat e bëjnë rezolucionin tuaj të fundit t'u përngjasë si motër e vëlla rezolucioneve të mëparshme. Në përpilimin e rezolucionit përpinquni të lini mënjanë formulat e thata dhe klische. Mos harroni, gjithashtu, me pasë një plan për rezolucionin përsa i përket rreshtimit të fakteve dhe të situatës, ashtu si keni bërë përsa u përket gabimeve dhe detyrave. Situatën e jashtme duhet ta paraqitni më në rregull në pikëpamje rreshtimi dhe jo p.sh. të flisni për luftën e Bashkimit Sovjetik, në krye, në fund e kudo. Përveç asaj jemi të mendimit që përsa i përket Bashkimit Sovjetik me shkrue më konkretisht, se s'është mjaft me folë me terma të përgjithshme si: «ai i jep grushte vdekjeje bishës naziste» etj. Duhet të vihet në dukje se cilët janë faktorët e ndryshëm të rritjes dhe forcimit të Ushtrisë së Kuqe, ç'i shtyu popujt e Bashkimit Sovjetik të luftojnë në këtë mënyrë, të qëndrojnë kaq lart ushtarakisht dhe politikisht, të jenë të bashkuar si një trup etj. Këto janë rezultatet e sistemit socialist, ky është rezultati i veprës së madhe të Leninit dhe Stalinit, vepra e Partisë heroike Bolshevikë të URSS-it. Duke vënë në dukje forcën e madhe të

Sovjetëve, strategjinë e Stalinit dhe të Ushtrisë së Kuqe, që ka çuditur botën, dhe sukseset e ofensivës së mëdhe, e cila s'ka për t'u ndalur veçse me zhdukjen e fashizmit, duhet të theksoni qëndrimin e drejtë dhe ndihmën konkrete që Bashkimi Sovjetik u jep popujve të robëruar. Shkatërrimi i armatave gjermane nga ana e Ushtrisë së Kuqe është ndihma më e madhe që u jepet këtyre popujve, që lehtëson luftën e tyre, që i ndihmon në forcimin e ushtrive të tyre nacional-çlirimtare dhe në vendosjen e pushtetit demokratik të popullit. Kudo që kalon Ushtria e Kuqe garanton indipendencën e atij populli që ishte i robëruar nga nazizmi, respekton dhe u jep ndihmën më të madhe morale dhe materiale pushteteve të popujve, të ngritur dhe të dalë nga luftërat nacional-çlirimtare; fjalimi i shokut Mollotov drejtar popullit rumun, përkrahja që u jepet komiteteve nacional-çlirimtare të Polonisë, Çekoslovakisë, janë prova të gjalla dhe garanci e madhe për popujt e shtypur si dhe shuplakë e rëndë për propagandën armike, e cila e akuzon politikën e Sovjetëve si imperialiste.

Nga ana tjetër s'është mjaft aq sa flitni për lëvizjet nacional-çlirimtare të popujve të robëruar. Duhet të theksoni, por jo me fraza të gjata, drejtimin që kanë marrë këto lëvizje dhe në ç'mënyra po zhvillohen. Zhvillimi i tyre nuk është i njëllojtë kudo, por qëllimi i tyre është i njëjtë: zhdukja e fashizmit dhe e shërbëtorëve të tyre, duke krijuar një front të gjerë dhe përparimtar, i cili të luftojë për vendosjen e demokracisë popullore...

Përsa i përket situatës së brendshme s'është nevoja me fillue që në kohërat e vjetra e me tregue gjëra që i di çdo anëtar partie. Këtij të fundit i intereson ak-

tualiteti dhe kërkon të kuptojë lodrën e armikut dhe të tradhëtarëve, kërkon të shohë qartë lodrën e tyre. Për këtë arësyen duhet ta sqaroni dhe t'i theksoni se armiku është gjermani dhe shokët të mos bien në gabime, të shohin vetëm reaksionin në njëren anë dhe Partinë tonë nga ana tjetër, duke harruar armikun gjerman, duke harruar masat e gjera që janë në Frontin Nacional-Çlirimtar, dhe ato që do të vijnë më vonë. Të theksohen tradhëtia e Bazit dhe e «Legalitetit» dhe përpjekjet e reaksionit shqiptar jashtë, të përkrahur nga reaksiuni i huaj, të cilët, në bashkëpunim të ngushtë me njëri-tjetrin përpilen të përsëritin ato që kanë ngjarë në shtetet e tjera të robëruara.

Duhet të vini më në dukje Kongresin e Përmjetit, zgjedhjet demokratike të kongresistëve dhe pjesëmarrjen e gruas në votime, rezultatet e arritura dhe rëndësinë e Komitetit si organ ekzekutiv.

Të theksoni më qartë rëndësinë e ushtrisë sonë, përbërjen e saj dhe fryshtën popullore, që karakterizon atë që nga partizani i thjeshtë dhe deri te oficerët e lartë.

S'mjafton me thënë se duhet ta ruajmë Partinë nga elementët e sëmurë dhe grupashë, por duhet të konkretizoni shkurtimisht rrezikun që i vjen Partisë e veçanërisht organizatës suaj nga grupimi i elementeve të Niko Xoxit¹ e ku mund të mbështeten ata elementë të hedhur jashtë Partisë mbi të cilët s'keni mundur të mbani kontrollin e duhur.

¹ Trockist, u përjashtua nga grupi komunist i Korçës në vitin 1934; zhvilloi një veprimtari të theksuar përqarëse në radhët e lëvizjes komuniste në Shqipëri.

Këta elementë të hedhur jashtë Partisë duhet me i mbajtë në lidhje dhe mos me i lënë të hidhen në prehrin e armiqve të Partisë. Prandaj e shkundni organizatën dhe mos harroni fjalët e Stalinit që thotë se «armiku më i madh është ai që harrohet».

Mos harroni të theksoni në rezolucionin tuaj gabimet që shfaqen në organizimin e Partisë në ushtri, të cilat duhet t'i vini në dukje.

Në detyrat duhet të shtoni dhe popullarizimin e Ushtrisë sonë Nacional-Çlirimtare.

Rishikimin dhe shtypjen e rezolucionit duhet ta bëni sa më shpejt dhe ai të punohet me kujdes në gjithë organizatën e qarkut tuaj; eksperienca juaj t'u shërbejë gjithë shokëve të organizatës së Korçës, e cila ka nevojë të madhe.

Të fala shoqërore

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë, si pas originalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

QARKORE NË LIDHJE ME ORGANIZIMIN E SEKSIONEVE TË EKONOMISË PRANË KËSHI- LLAVE NACIONAL-ÇLIRIMTARE DHE ME ZGJIDHJEN E ÇËSHTJEVE EKONOMIKE TË KOHES SË LUFTËS

3 gusht 1944

KOMITETEVE QARKORE TË PARTISË

Të dashur shokë,

Po ju dërgojmë disa thirrje që u bëjnë teknikëve të ndryshëm shokët Medar Shtylla dhe Spiro Koleka. Këto thirrje i shumëzoni dhe i hidhni në vende ku ka teknikë të tillë, i ngjitni edhe në mure. Letrat personale që ju vëmë brenda, për disa teknikë, i shqyrtoni vetë dhe të gjithë atyre që qëndrojnë pak a shumë mirë ua dorëzoni dhe i ndihmoni të dalin në mal në qoftë se paraqiten. Ju dërgojmë dhe një kopje të disa qarkoreve dhe udhëzimeve nga Dikasteri i Ekonomisë¹. Ky

¹ Më 25 korrik 1944 Dikasteri i Ekonomisë i Komitetit Antifashist Nacional-Çlirimtar lëshoi dy qarkore mbi rimëkëmbjen e ekonomisë kombëtare (Shih: «Dokumenta të organeve të larta të pushtetit revolucionar nacional-çlirimtar», 174—180, Tiranë 1962.)

material u drejtohet këshillave të qarkut, por ju duhet ta shumëzoni dhe ta punoni në këshillin e qarkut me anën e shokëve që bëjnë pjesë atje. Më vonë do t'ju vëmë më me hollësi në dijeni se në ç'mënyrë do të funksionojnë seksionet e ndryshme në gjirin e këshillit. Por tani, me rastin që ju dërgojmë këtë material, duhet që në këshillin e qarkut, rrëth të cilit do të ngrihen seksione, të caktohet një përgjegjës për ekonominë dhe ky të krijojë pranë këshillit një aparat të vogël, i cili do të ndihmojë për zbatimin e këtyre udhëzimeve që po ju japim. Materiali që çohet prej Dikasterit të Ekonomisë duhet të dërgohet në çdo këshill krahine, komuneje e fshati, ku të punohet dhe, ajo që është më me rëndësi, të vihet në zbatim. Lypset, pra, që çdo anëtar partie të ketë në kokë çdo gjë që shkruhet atje dhe të dijë t'i zbatojë të gjitha ato që përmban programi i ekonomisë për kohën e luftës. Me rastin e punimit dhe vënjes në zbatim të këtyre udhëzimeve, sidomos shokët që punojnë në terren, duhet të rishikojnë qarkoret e ndryshme të dhëna për organizimin e këshillave dhe të komandave të vendit, të cilat duhet të forcohen për të qenë në gjendje të zbatojnë këto udhëzime.

**Për Komitetin Qendror të
Partisë Komuniste të Shqipërisë**

V a l b o n a

**VDEKJE FASHIZMIT
LIRI POPULLIT**

*Botohet për herë të parë, si-
pas origjinalit që gjendet në
Arkivin Qendror të Partisë*

**LETËR DREJTUAR ZËVENDËSKOMISARIT TË
BRIGADËS II SULMUESE NË LIDHJE ME FOR-
CIMIN E PUNËS IDEOPOLITIKE TË ORGANIZA-
TAVE TË PARTISË DHE FORCIMIN E
PUSHTETIT POLITIK DHE USHTARAK**

4 gusht 1944

ZËVENDËSKOMISARIT TË BRIGADËS II S.

I dashur shok,

Morëm raportin tënd mbi gjendjen e Brigadës II. Na gëzon kur shohim se atje në atë repart punohet me gjallëri për të forcuar organizatën e Partisë, e cila do të jetë shtylla e brigadës. Nuk duhet të harroni asnë minutë, dhe për këtë të gjithë anëtarët e Partisë nuk duhet t'i zërë gjumi, se pa një organizatë të fortë, pa kuadro të ngritura në radhën e udhëheqësve të vërtetë, që të kenë kuptuar rëndësinë e momentit dhe detyrat e tyre, nuk mund të shkojë puna mbarë dhe ushtria jonë nuk do të jetë në gjendje të kryejë detyrën e madhe që ka në kurrit. Për këtë gjë nuk duhet t'ju kënaqin sukseset, por këto duhet të janë për ju stimulantë për të arritur në rezultate më të mëdha. Përveç mbledhjeve

të rregullta të celulave dhe të byrove, ku të rrihen probleme dhe jo me u marrë me çikërrima, përveç konferencave në reparte të ndryshme të brigadës, duhet që të organizoni herë pas here dhe nga një aktiv të brigadës, ku të punohen referate të prej shokëve më të ngritur politikisht dhe ushtarakisht; të caktohet një plan pune i njëllojtë për gjithë brigadën dhe të zbatohet në një kohë. Një mënyrë punimi e tillë shërben për ngritjen e barabartë të nivelit politik dhe ushtarak të gjithë brigadës. Organizoni konferenca herë pas here me komisarët dhe zëvendëskomisarët për t'i sqaruar për situatat e ndryshme që krijohen si dhe të punoni direktivat dhe udhëzimet që ju dërgohen. Të preqatitni konferenca për anëtarët e Partisë dhe për gjithë brigadën mbi tema të ndryshme. Mund t'ju jap disa tema, të cilat i preqatitni dhe nga koha në kohë, mbasi t'i keni punuar, i zhvilloni përpara brigadës.

I. — Mbi luftërat:

a) Lufta e parë botërore.

b) Lufta botërore. Mbi luftërat e drejta dhe të pashdrejta. Lufta e dytë botërore ndahet në dy perioda: para sulmit mbi Sovjetët dhe pas sulmit.

II. — Mbi imperializmin. (Kërkonin librin e Leninit)¹.

III. — Fashizmi italian dhe gjerman (në Gjermani, krizat, socialdemokracia, socialshovinistët, roli i tyre, ardhja në fuqi e fashizmit, preqatitja e luftës etj.).

IV. — Bashkimi Sovjetik dhe socializmi.

¹ Është fjala për veprën e V. I. Leninit: «Imperializmi, si faza më e lartë e kapitalizmit».

V. — Roli i Bashkimit Sovjetik në këtë luftë.
(Bashkimi Sovjetik dhe aleatët).

VI. — Zhvillimi i luftërave nacional-çlirimtare.

VII. — Kongresi i Përmetit dhe rëndësia e tij.

VIII. — Roli i Partisë Komuniste të Shqipërisë në këtë luftë.

IX. — Ngritja e ushtrisë sonë dhe shkallët e zhvilimit të saj. E të tjera tema si këto.

Me një fjalë nuk duhet në asnjë mënyrë të ngadalësohet ritmi i punës, por duhet të shkoni me një tempo të gjallë në punë. Çdo ditë duhet të regjistroni përparrime në brigadë dhe të mos lejoni që të zerë vend plogështia.

* * *

Për çështjen organizative që na pyetni se ku duhet të bëjë pjesë zëvendëskomandanti i brigadës që njëkohësisht është edhe komendant batalioni, ju duhet të veproni kësisoj: Kjo është një anomali dhe rrjedh nga mungesa e kuadrove. Zëvendëskomandanti duhet të bëjë pjesë patjetër në celulën e shtabit, se atje merren vendime me rëndësi, por nga ana tjetër duhet të marrë pjesë edhe në celulën e batalionit, se ai është komendant batalioni. Kjo çështje pra, derisa të zgjidhet çështja e kuadrit, duhet të zgjidhet në këtë mënyrë. Ai duhet të vejë në të dy celulat. Gjithashtu edhe zëvendëskomandanti i batalionit, që është njëkohësisht komendant kompanie.

* * *

Për R. Th. ne gëzohemi që ai po përmirësohet, ju duhet të ndihmoni që ky shok punëtor të ngrihet dhe

të japë një kontribut më të madh në punë. Duhet të zhdukni prej tij idenë se i kanë pasë ngrënë hakën, kjo s'është e vërtetë. Ai është e dyta herë (një herë kur ka qenë në batalionin e Devollit dhe një herë në brigadë), që po tregon mefshtësi në punë. Në Vithkuq një mot përpara kam fjalosur vetë me të dhe ai më ka përsëritur po këtë këngë për shokët e batalionit të Devollit. Por sidoqoftë mund të përmirësohet. Ju mos u shpejtoni t'i jepni një përgjegjësi si komisar batalioni, shiheni akoma në punë, të japë prova të tjera dhe bindëse në se gjallëria e tij që tregon tani nuk është momentane, por e vazhdueshme. Pa përqmuar rendimentin e shokëve veproni si ai doktori i mirë që s'ngutet në diagnozën e të sëmurit dhe rekuperimin e forcave prej tij.

* * *

Mos mungoni kudo që shkoni të ndihmoni organizatat e terrenit, të cilat kanë shumë nevojë. Forconi pushtetin tonë të këshillave si edhe organizimin e pushtetit ushtarak të prapavijave. Kur të kemi pushtetin të fortë dhe prapavijat të organizuara mirë edhe ushtria jonë do të jetë e fortë dhe barra e saj do të leh-tësohet shumë.

Të fala shoqërore

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë si pas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

FJALIM NË KONGRESIN E PARË TË RINISË ANTIFASHISTE SHQIPTARE¹

8 gusht 1944

Shokë dhe shoqe të Rinisë Antifashiste Shqiptare!

Ju përshëndes nga zemra në emër të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë dhe në emër të Komitetit Antifashist Nacional-Çlirimtar.

Kur hordhitë e Musolinit u vërsulën mbi tokat tonë për të na skllavëruar dhe për të na zhdukur si popull, përtë na përdorur si mish topi për interesat e tyre imperialiste, rinia e vendit tonë, ajo rini që nën regjimin mesjetar dhe grabitës të Zogut nuk ishte përkulur kurrë, u bë shkëndija e parë që i dha zjarr luftës sonë çlirimtare. Në ditët e para të robërisë ju kemi parë të ndjenit dhe të mendonit si njerëz të pjekur, si njerëz që u dhimbej atdheu dhe liria, si njerëz që parashikonit një përleshje të përgjakshme, ku do të luhej fati

¹ Kongresi i parë i Rinisë Antifashiste Shqiptare zhvilloi punimet nga 8—17 gusht 1944 në fshatin Helmës të Skraparit. Në kongres merrnin pjcsë 285 delegatë që përfaqësonin rininë e zonave të çliruara dhe të paçliruara dhe të të gjitha reparteve të Ushtrisë Nacional-Çlirimtare. Në kongres përfaqësohej gjithashtu edhe lëvizja e pionierëve të Shqipërisë.

juaj, fati i popullit tonë, fati i gjithë njerëzimit, i kërcënuar nga fashizmi gjerman e italian. Ju kemi parë me fytyra të vrëjtura, por me zemrat lart, të armatosur me vullnetin e çelniktë dhe me një guxim të patreguar të hidheni nga punëtoritë, nga parmendat, nga bankat e shkollës, në demonstratat e para të qyteteve. Ju kemi parë të vërsulen i mbi mitralozat e armikut dhe të tradhëtarëve me një guxim të patregueshëm, të gjakoseni, të vriteni, të kaloni mbi kufomat e shokëve tuaj, por të shkonit gjithmonë përpara për mbrojtjen e popullit e të atdheut.

Rinia e vendit tonë, krenaria e popullit, shqiptar, u hodh me mish e me shpirt në luftën e përgjakshme, ajo dha dëshmorët e parë heroikë dhe tregoi që në fllimin e robërisë se, me gjithë terrorin e tmerrshëm fashist dhe pa pasur ende armët në dorë, ajo ishte e vendosur të luftonte, ajo dinte përse luftonte dhe se në hovin e saj ngadhnjimtar s'kish fuqi që ta ndalonte. Kur Partia Komuniste e Shqipërisë lëshoi zërin e kushtimit për të shpëtuar atdheun tonë të dashur nga kthetrat e fashizmit, rinia shqiptare që e para që ju përgjegj thirrjes së saj, që u hodh e para në luftë, mbushi njësitët guerrile të qyteteve dhe të maleve, të përbëra nga bijtë më të zgjedhur të popullit tonë, mbushi batalionet partizane, të cilat u zmadhuan në brigada e divizione e që sot përbëjnë Ushtrinë tonë të rregullt N.-Çl.

Shokë të rinj dhe shoqe të reja!

Kjo ishte një barrë e rëndë për supet tuaja të njoema, por ju ditët që në këtë luftë të vështirë, mbinjerë-

zore dhe të pabarabartë, në momentet më të vështira të kombit tonë, të tregoni se jeni bij të denjë të këtij populli heroik, që ka luftuar shekuj me radhë për liri dhe indipendencë. Ju keni treguar në luftëra të përgjakshme shembuj të panumërt heroizmi, flijimi dhe vetëmohimi, dhe për këtë keni fituar zemrat e popullit shqiptar, admirimin e botës mbarë.

Okupatorët italianë dhe gjermanë me gjithë bashkëpunëtorët e tyre, tradhëtarët e vendit, s'u gabuan në vendimet e tyre gjakësore për të luftuar Rininë Antifashiste Shqiptare me çdo mjet e me çdo kusht, sepse ata parashikonin forcën e gjallë dhe të papërkulshme të kësaj rinnie, e cila do t'i godiste pa mëshirë dhe pa kursim. Prej tyre u përdorën metodat më barbare, demagogjia dhe terrori, përkëdhelia dhe mashtrimi, korruptimi i perfeksionuar i regjimit fashist, por të gjitha vanë bosh. Rinia Antifashiste trime e vendit tonë i shqelmoi planet e tyre djallëzore. Të rinjtë tanë u internuan, u burgosën, u torturuan, u pushkatuan, u vunë në litar, por nuk u përkulen. Ju jeni dëshmitarët e torturave të padëgjuara as në mesjetë, jeni shembull i vendosjes përrapa masave çnjerëzore dhe njëkohësisht shembulli i gjallë i sakrificës, gjë që ka ngjallur entuziazmin dhe admirimin e popullit tonë. Torturat, vuajtjet dhe gjaku i derdhur e çelnikosën rininë tonë, e bashkuani si një trup rrëth Frontit N.-Çl., rrëth Ushtrisë N.-Çl. Tradhëtarët Mustafa Merlika dhe këlyshët e tij, kuislingu Mehdi Frashëri dhe xhelatët e tjerë, «Balli Kombëtar» i Mithat Frashërit, i Ali Këlçyrës, «Legaliteti» i Bazit të Canës dhe i Zogut, të shitur kokë e këmbë te okupatori dhe armiqtë e betuar të rinisë sonë, morën mësimin e

merituar nga ajo rini, të cilën ata kërkonin ta bënин vëglën e tyre për të shtypur popullin shqiptar, për ta hedhur në vëllavrasje me vëllezërit e tyre që luftonin në radhët e Ushtrisë N.-Çl., për ta bërë mjet të verbër për të sjellë në Shqipëri regjimet e vjetra, barbare dhe shtypëse.

Por jo, as italianët, as gjermanët, as kuislingët, as tradhëtarët e «Ballit Kombëtar» dhe të «Legalitetit» nuk mundën ta futnin rininë shqiptare në kallëpet e tyre të poshtra, ta helmatisnin me metodat e tyre fashiste e shoviniste, ta çonin në rrugën e shkatërrimit të të gjitha principeve të shoqërisë përparimtare. Rinia jonë u tha atyre, mjaft! Ajo e zgjodhi përnjëherësh rrugën e lavdishme të denjë për të, dha gjatë kësaj rruge të vështirë dhe të përgjakshme heronjtë e rinisë shqiptare, të rënë në fushën e nderit, të cilët u bënë pishtarë të luftës çlirimtare. Armiku dhe tradhëtarët i kanë quajtur veprat tuaja vepra kalamajsh, veprime të papjekura. Por rinia jonë tregoi po aq pjekuri në lëmin politik dhe shoqëror, sa dhe trimëri në fushën e luftës, dhe armiqtë le të lehin, ju jeni ata që po ndërtoni Shqipërinë e re. Populli shqiptar është krenar për rininë e vet, populli shqiptar me respekt përulet përpara kujtimit të heronjve të rinisë.

Dhe njeriu bën pyetjen: Ku ishte gjithë ky dinamizëm, gjithë kjo gjallëri, ç'e shtyu rininë tonë në këto kohëra të vështira të hidhet në luftë dhe të luftojë me tërbim, pa marrë parasysh vështirësitë, pa marrë parasysh vuajtjet, mundimet, sakrificat? Rininë e shtynë vuajtjet dhe mundimet, e shtyuurrejtja e madhe që ushqente për okupatorët fashistë italianë dhe gjermanë, armiqtë më të mëdhenj të saj, e shtyu dashuria e pama-

së për vendin dhe për popullin e saj të mjeruar, e shtyu dashuria për vendin e socializmit, pararojën e fuqive të popujve përparimtarë. Rinia mori armët për të fituar të drejtën e saj në shoqërinë shqiptare, për të siguruar një të nesërme më të mirë e më të lumtur, që s'e ka pasur kurrë në të kaluarën. Këta kanë qenë faktorët që e kanë bërë rininë tonë të luftojë dhe të ecë përpara dhe gjithmonë përpara, kryelartë. Rezultati i kësaj lufte heroike të rinisë është ky, që sot në tokat e çliruara mbërrimë të mbledhim Kongresin e parë Antifashist të Rinisë Shqiptare. Për të ardhur në rezultatet që kemi mbërritur: të krijojmë një ushtri të fortë të popullit, të krijojmë Komitetin Antifashist, të organizojmë kongresin, si atë të Përmetit dhe këtë të Rinisë Antifashiste Shqiptare, na është dashur të derdhim shumë gjak të vlefshëm të popullit tonë, na është dashur të bëjmë shumë sakrifica.

Kongresi i sotëm i rinisë ka një rëndësi të madhe për brezin tonë të ri, se është vepra që doli nga dora juaj, e bërë me djersën e me gjakun tuaj, ky është manifestimi i forcave të rinisë shqiptare, kjo është pasqyra e forcave tuaja. Ky kongres do të forcojë dhe ca më shumë bashkimin e gjithë të rinjve dhe të rejave shqiptare në luftën kundër fashizmit dhe tradhëtarëve. Ky kongres duhet të jetë simboli i vëllazërimit për një çështje të shenjtë dhe të përbashkët të të gjithë rinisë, padallim tendence politike dhe krahine. Ky kongres duhet të jetë shprehja e bashkimit të rinisë me popullin tonë që lufton, duhet të jetë shprehja e besnikërisë suaj ndaj luftës, ndaj Frontit N.-Çl., ndaj ushtrisë dhe Komitetit Antifashist.

Para nesh, o shokë tanë të rinj, qëndrojnë akoma detyra të mëdha dhe të rënda, të cilat duhet t'i kryejmë dhe do t'i kryejmë. Armiqtë tanë janë të shumitë, janë ende në këmbë, Gjermania naziste vazhdon të mbahet me shpirt në dhëmbë dhe në momentin e vdekjes ajo po mbjell terrorin më të zi në vendin tonë, e ndihmuar në këtë punë barbare prej shërbëtorëve të saj shqiptarë. Por lufta jonë shkon kurdoherë përpara, drejt, dhe tregon qartazi fitoren tonë finale dhe të aleatëve tanë të mëdhenj, Bashkimit Sovjetik, Anglisë dhe Amerikës. Armata e Kuqe heroike në këto ditët e fundit po i jep grushte të tmerrshme Gjermanisë naziste. Ngadhnjimtare ajo po marshon drejt zemrës së Rumanisë, Varshavës, drejt Berlinit. Në çdo vend ku kalon Ushtria e Kuqe, ajo u jep lirinë popujve të robëruar nga Hitleri. Fjala e Komisarit për Punët e Jashtme të BRSS, Mollotov, drejtar popullit rumun, të cilit i garanton het indipendenca, përkrahja e madhe që i bëhet qeverisë nacional-çlirimtare të Polonisë nga ana e Sovjetëve, janë një garanci e madhe për popujt e robëruar, të cilët s'ka se kush i pengon në realizimin e aspiratave dhe në vendosjen për fatin e tyre. Triumfet e shkëlqyera, veprat e strategut gjenial, Mareshalit Stalin, e tronditën nga themellet regjimin nazist, ku ujqërit po grihen me njëri-tjetrin, përpara katastrofës së madhe. Armatat lavdiplate të Stalinit po ndjeatin këmba-këmbës hordhitë e Hitlerit, që kishin shkuar të skllavërojnë vendin e madh të lumturisë dhe të gjëzimit, vendin ku rinia ka posibilitetet më të mëdha për t'u zhvilluar. Aleatët anglo-amerikanë, me zbarkimin e tyre në Evropë, po tronditin pozitat e Hitlerit

në Perëndim dhe po i vënë përpëra ushtritë e Romelit.

Qentë fashistë, që u vërsulën të skllavëronin botën, i bënë hesapet pa rininë antifashiste të Bashkimit Sovjetik, të udhëhequr prej Komsomolit heroik leninist, pa rininë antifashiste të popujve të Anglisë dhe të Amerikës, pa rininë e gjithë popujve të robëruar. Sot gjende mi drejt rrugës së triumfit, sot perspektiva e fitores sonë është e qartë.

Po tamam në këtë kohë nuk duhet të na dehin sukseset tona, tamam në këtë kohë duhet t'i kemi sytë, hapët dhe të shtërngojmë radhët, se tamam në këtë kohë po i paraqiten gjithnjë më tepër armiq të brendshëm brezit tonë të ri. Armiqtë e brendshëm, duke parë ditët e tyre të numëruara, bashkohen më ngushtë me okupatorin për të ngulur thikën në shpinën e luftës sonë fitimtare. Mos harroni asnjë minutë se kemi të bëjmë me një armik të regjur dhe të rafinuar dhe që është gati të përfitojë nga çdo lëshim i vogël yni, nga çdo moskujdesi nga ana jonë, nga çdo veprimitari e pamatur. Dallaveret që kërkojnë të luajnë në kurri zyrtar të popullit tonë okupatori dhe tradhëtarët janë të njoitura prej jush. Ata përpiken me njëmijë mënyra që rininë tonë ta shkëpusin nga lufta, ta zhdukin si faktor të rëndësishëm të jetës sonë shoqërore, ta shtien në vëllavrasje. Por ju të rinj, ju që me prova dhe me gjak e keni kallëzuar rolin e madh që po luani në këtë luftë vendimtare dhe rolin e madh që do të luani nesër në Shqipërinë e re të popullit, juve ju bie barra që t'ua prishni planet këtyre njerëzve të poshtër që kërkojnë ta çojnë popullin tonë në skëterrë. Plagët që na ka shkaktuar regjimi i kaluar dhe regjimi i sotëm, që na ka skllavëruar, janë ende të

hapura, dhe unë jam i bindur se asnë prej jush nuk do të dëshirojë të kthehet më koha e vjetër. Brezi i ri i vendit tonë është i vendosur dhe për këtë po derdh gjak që t'i sigurojë vetes një të ardhme të lumtur, dhe me armët që ka në dorë nuk do të lejë kurrë që fryshtet e mbjella prej tij e të vaditura me gjakun e kulluar të bijve më të mirë të vendit tonë t'i hanë të tjerët, t'i korrin tradhëtarët dhe aventurierët. Po të ngjiste e kundërta, ne nuk do të ishim të denjë për gjakun e shenjtë që çshtë derdhur.

Shokë dhe shoqe të rinisë!

Unë kam bindjen e plotë se ju, delegatët e të gjithë Rinisë Antifashiste Shqiptare, të mbledhur në këtë kongres, kur shokët tuaj dhe e tërë Ushtria N.-Çl., që prej Mirdite e deri në skajet e Shqipërisë së Jugut, ndodhen në përleshje të përgjakshme me gjermanët dhe tradhëtarët, do të punoni, do t'i rrizni problemet që ju parashtrohen me aq seriozitet sa keni treguar vendosmëri dhe trimëri në fushën e luftës; unë jam i bindur se ju, pas këtij kongresi, do të punoni me forca më të mëdha për të shpejtuar fitoren e madhe kundër zaptuesit, se do të çoni fjalën tuaj përparintare në radhët e ushtrisë sonë heroike, në prapavijat dhe në territorin e okupuar; unë jam i bindur se ju, luftëtarët e brigadave tona legjendare, se ju, luftëtarët heroikë të viseve të okupuar, se ju, luftëtarët e palodhur të zonave të çliruara, do të dhjetëfishoni energjitet tuaja dhe do të goditni pa mëshirë hordhitë e gjermanit okupator dhe të tradhëtarëve, do të mbroni dhe do të forconi pushtetin tonë

demokratik, do të jeni shembull organizimi dhe discipline; jam i bindur se dora juaj do të godasë pa mëshirë, pa u dredhur, tradhëtarët.

Unë dëshiroj prej jush që ky kongres me rëndësi të madhe të japë rezultate të mëdha, të japë ato rezultate që pret populli ynë, që pret rinia jonë, të japë rezultatet që lyp aleanca jonë e madhe me aleatët e mëdhenj Bashkimin Sovjetik, Anglinë, Amerikën dhe me gjithë popujt e robëruar për të shtypur dhe për të zhdukur nga faqja e dheut armikun më të madh të populit tonë dhe të njerëzimit: nazizmin gjerman.

Rroftë Rinia Antifashiste trime Shqiptare!

Rroftë Kongresi i parë i Rinisë Antifashiste :Shqiptare!

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

QARKORE NË LIDIJE ME DISA NDRYSHIME NË FORMAT ORGANIZATIVE TË PARTISË NË USHTRINË NACIONAL-ÇLIRIMTARE

17 gusht 1944

GJITHË KOMITETEVE QARKORE TË PARTISË
KOMISARËVE TË DIVIZIONIT I DHE II SULMUES
GJITHË ZËVENDËSKOMISARËVE TË BRIGADAVE
DHE TË BATALIONEVE

Me zmadhimin e Ushtrisë sonë Nacional-Çlirimtare dhe me krijimin e reparteve të mëdha si divizione dhe korparmata shihen të nevojshme disa ndryshime në format organizative të Partisë në ushtri si edhe krijimi i disa forumeve të tjera, të cilat do të ndihmojnë në zhvillimin e plotë dhe në forcimin e Partisë në reparte të ndryshme.

Me marrjen e kësaj qarkoreje përnjëherësh drejtuesit e Partisë në ushtri ta vënë në aplikim, duke ua bërë të qartë gjithë anëtarëve të Partisë, gjithashtu gjithë komitetet qarkore të Partisë t'i punojnë këto direktiva në çdo celulë.

Këto ndryshime konsistojnë në krijimin e komiteve të Partisë në brigada e divizione si edhe në kriji-

min dhe organizimin e seksioneve politike në divizionë dhe në brigada. Për Rininë Komuniste, në krijimin e komiteteve të rinisë në batalione dhe në brigada.

I. — *Komiteti i Partisë në brigadë.* Komiteti në brigadë formohet kur shihet se puna e Partisë nuk shkon mirë dhe zëvendëskomisari nuk është në gjendje të përballojë dot detyrën që i është ngarkuar dhe ka nevojë që të këshillohet. Mund të mos krijohet në rast se puna organizative e Partisë në brigadë shkon mirë dhe kur anëtarët e Partisë janë të ngritur. Në rastin e parë ky komitet formohet prej 3-7 vetash dhe zgjidhet prej aktivit të brigadës, të mbledhur në një konferencë ku marrin pjesë të gjithë drejtuesit politikë dhe ushtarakë (në këtë rast kur janë anëtarë partie). Në komitet zgjidhen shokët më të mirë, si komisari i brigadës, komisarë dhe zëvendëskomisarë të batalioneve. Zëvendëskomisari i brigadës merr pjesë në këtë komitet dhe është sekretari i komitetit. Në rast se në brigadë ka sektion politik, atëhere merr pjesë dhe përgjegjësi i sektionit politik. Komiteti i brigadës nuk ka pushtet, sikundër kanë komitetet e tjera të Partisë (komiteti qarkor ose komiteti i rajonit), por është vetëm një komitet këshillues dhe udhëzues. Zëvendëskomisari i brigadës, që është njëkohësisht dhe sekretari i komitetit, mban lidhje me byrotë e batalioneve, merr raportet nga ata dhe flet mbi raportet në përgjithësi në komitet, por jo të raportojë. Zëvendëskomisari i brigadës mban gjithash tu lidhje me Komitetin Qendror dhe është direkt përgjegjës për punën e Partisë në brigadë. Anëtarët e komitetit të brigadës nuk kanë sektorë pune të ndarë, por shkojnë nëpër batalione dhe ndihmojnë udhëheqë-

sit politikë e ushtarakë dhe gjithë anëtarët e Partisë, duke i këshilluar. Mbledhjet e këtij komiteti s'janë të zakonshme dhe në një kohë të caktuar. Komiteti mblidhet kur shihet e nevojshme dhe e mundshme. Komiteti, sidoqoftë, është mirë të mblidhet në 15-20 ditë një herë. Pas çdo mbledhjeje komiteti duhet të nxjerrë konkluzione nga diskutimet e mbledhjes dhe në formë udhëzimesh t'i japë në organizatë. Në mungesë të ndonjë udhëzimi ose direktive të re, komiteti duhet të lëshojë pas çdo mbledhjeje ndonjë sqarim politik për organizatën. Anëtarët e komitetit në përgjithësi nuk mund të shkojnë nga një batalion në tjetrin, se s'mund të lënë mangut detyrat e caktuara që kanë, por kjo s'përjashton të drejtën të shkojnë ndër batalione të ndryshme po të gjejnë rastin. Kurse zëvendëskomisari i brigadës mund të shkojë kudo.

II. — *Komiteti i Partisë në divizion.* Komiteti i divizonit formohet prej zëvendëskomisarëve të çdo brigadë, prej komisarit të divizonit, prej përgjegjësit të seksionit politik të divizonit. Më të shumtën e herës sekretari i këtij komiteti është komisari politik i divizonit, por s'përjashtohet që të jetë dhe një zëvendëskomisar i brigadës, që bën pjesë në atë komitet. Në çdo rast sekretari i komitetit duhet të jetë shoku më i mirë. Përgjegjësi i seksionit politik nuk mund të jetë sekretari i komitetit. Funksioni i këtij komiteti është po ai i brigadës, por pushteti i tij është më i madh dhe më i rëndësishëm, se formohet prej shokësh të caktuar, që kanë një përgjegjësi të madhe. Anëtarët e këtij komiteti i japin raporte sekretarit të komitetit, por japin raporte dhe mbajnë edhe lidhje drejt me Komitetin

Qendror. Çdo direktivë që vjen nga Komiteti Qendror diskutohet prej tyre dhe gjendet mënyra se si ta zbatojnë më mirë në organizatë. Mbledhjet e këtij komiteti të bëhen po në atë mënyrë dhe po me atë kriter si ato të brigadave. Pas çdo mbledhjeje komiteti i divizionit, sikundër ai i brigadës, duhet të lëshojë për organizatën qoftë një udhëzim politik, qoftë një direktivë pune, e të tjera.

Në asnjë nga këto komitete nuk merr pjesë përgjegjësi i rinisë në brigadë ose anëtari i seksionit politik, për rininë në divizion. Përgjegjësi i rinisë në brigadë mban lidhje me zëvendëskomisarin e brigadës dhe me Komitetin Qendror të Rinisë.

III. — *Seksioni politik i brigadës.* Këtu nuk do të flasim për rëndësinë e seksionit, e cila ju është shpje-guar nga një direktivë e mëparshme, por për disa ndryshime që bëhen në të. Seksioni politik duhet të ketë vetëm tre vetë, të cilët duhet të punojnë në këta sektorë:

- 1) sektori organizativ; 2) sektori politiko-ushtarak;
- 3) sektori i rinisë.

Seksioni politik në mbledhjen e tij bisedon për çdo punë në përgjithësi, por mbledhja e tij nuk duhet të ketë karakterin e një mbledhjeje celule me rend dite, me situatë politike etj., por atje duhet të rrihen problemet organizative të Partisë, dobësitë dhe mbarëvajtja e ushtrisë dhe e rinisë. Në mbledhjet e tyre merr pjesë dhe zëvendëskomisari i brigadës. Anëtarët e seksionit politik s'japin kurrë direktiva, por ndihmojnë me këshilla. Raportet e anëtarëve të seksionit politik i merr përgjegjësi i seksionit, që është ai i sektorit organizativ. Ky i fundit ka lidhje vetëm me Komitetin Qendror.

Seksioni politik duhet të interesohet shumë për punët në terren.

IV. — *Seksioni politik i divisionit.* Me krijimin e sektionit politik të divisionit suprimohen të gjitha sektionet politike të brigadave që përfshihen në divizion. Në këtë seksion ka pesë shokë, tre prej të cilëve kanë sektorë pune të caktuar njësoj si ata të sektionit të brigadës dhe dy të tjerët s'kanë sektorë pune të caktuar. Këta bëjnë po ato mbledhje dhe po me atë karakter që bëjnë sektionet e brigadave, dhe raportet i merr kurdoherë përgjegjësi i sektorit organizativ, i cili ka vetëm lidhje me Komitetin Qendror. Përgjegjësi i sektionit politik të divisionit (organizativi) është njëkohësisht dhe anëtar i komitetit të divisionit, por ky atje është më tepër dëgjues dhe këshillues; ky nuk raporton dhe nuk jep direktiva, por mban kurdoherë lidhje me Komitetin Qendror si përgjegjës i sektionit politik. Komisari i divisionit dhe sekretari i komitetit të divisionit mund të venë në mbledhjet e sektionit politik të divisionit, kur ky bën mbledhjet nëpër repartet e tija, dhe e kanë për detyrë të venë. Mund të venë gjithashtu edhe anëtarët e komitetit të divisionit, kur t'uа permetojë koha. Seksioni politik bën edhe mbledhje ku nuk merr pjesë asnjë nga këta, dhe këto mbledhje bëhen kur bisedohet për komitetin, për shokë të ndryshëm, etj. me këtë karakter.

Përgjegjësi i sektionit politik (organizativi) i divisionit është për çështje organizative të Partisë, e sidomos për forcimin dhe shtimin e radhëve të Partisë, përgjegjës përpara Komitetit Qendror. Ky, përvëç punës që bën me zëvendëskomisarët e brigadave dhe të

batalioneve, në mënyrë që puna të shkojë përpara dhe mbarë, ka të drejtë të marrë edhe vetë iniciativa në këtë drejtim, por për çdo gjë që bën, si mbledhjet me shokët, me udhëheqësit, me partizanët, ai duhet të vërë në korrent sekretarin e komitetit të divizonit si edhe zëvendëskomisarin e repartit ku ka vepruar. Anëtarët e seksionit politik të divizonit respektohen prej udhëheqësve të divizonit, prej komisarit, prej zëvendëskomisarëve të brigadave dhe njihen prej tyre si delegatë të Komitetit Qendror. Përpara komandave të divizonit e të brigadave gjithashtu duhet të fitojnë respektin me anë të punës dhe të këshillave të drejta, e sidomos të pyeten kurdoherë për çështje që kanë lidhje me anëtarë të Partisë, si punë gjyqesh etj. Kurrë këta s'mund të abuzojnë me funksionin e tyre. Në celulat e në byrotë, kur shkojnë, këta s'kanë të drejtë të thonë se janë delegatë të Komitetit Qendror, por anëtarë të seksionit politik. Këta kanë të drejtë të shkojnë kudo, si në organizatat e Partisë, si në shtabet, dhe kudo në punët e ushtrisë, të formacionit ku bëjnë pjesë, qoftë në divizion, qoftë në brigadë.

Funksioni i anëtarëve të seksionit politik, qoftë të brigadave, qoftë të divizioneve, duhet të kuptohet drejt dhe të mos bihet në gabime që janë shënuar shumë herë në praktikë. Anëtarët e seksionit politik nuk kanë të drejtë të japid urdhëra dhe direktiva, ata janë këshillues dhe me këshillat e tyre bindëse ata ndihmojnë anëtarët e Partisë, udhëheqësit politikë dhe ushtarakë; ndihmojnë në kuptimin e drejtë dhe në zbatimin e plotë të direktivave të Partisë; ata mbrojnë vijën e Partisë dhe ndihmojnë forcimin dhe shumëzimin e radhëve të saj.

Shënim. Komisari i korpusit ka të drejtë të vejë në të gjitha organizatat e Partisë të repartit të vet dhe të japë ndihmën e plotë dhe eksperiencën e tij të madhe. Komisari politik i brigadës, përveç detyrave të veta, ka të drejtë dhe duhet të ndihmojë punën e Partisë në repartin e vet dhe në terren.

V. — *Komiteti i Rinisë Komuniste në batalion dhe në brigadë.* Në çdo kompani batalioni ka një aktiv të Rinisë Komuniste, ku marrin pjesë vetëm ata të rinj që meritojnë këtë emër; të tjerët janë rini antifashiste, por jo të organizuar në një organizatë të Rinisë Antifashiste¹. Prej sekretarëve të aktiveve të kompanive formohet komiteti i rinisë në batalion. Këta mund të janë ose jo anëtarë partie. Përgjegjësi i rinisë në batalion, i cili merr pjesë në byronë e batalionit, bëhet sekretari i komitetit të rinisë. Sekretari i komitetit të rinisë ka lidhje me zëvendëskomisarin e batalionit si edhe me komitetin qarkor të rinisë në terrenin ku ndodhet. Në rast se ky batalion është inkadruar në brigadë, atëherë sekretari i komitetit të rinisë, përveç lidhjes që ka me zëvendëskomisarin, ka lidhje dhe me përgjegjësin e rinisë në brigadë. Të gjithë sekretarët e komiteve të batalioneve formojnë komitetin e rinisë së brigadës. Sekretari i këtij është përgjegjësi i rinisë në brigadë dhc duhet të bëjë jetë partie ose në celulën e shtabit të brigadës, në rast se është i lartësuar dhe nuk pengon punën e shtabit, ose në një celulë afér shtabit, si në atë

¹ Gjatë kohës së luftës, në Ushtrinë Nacional-Çlirimtare kishte vetëm organizata të Rinisë Komuniste në kompani, ndërsa organizata të Rinisë Antifashiste, si në terren, nuk kishte.

të korrierëve. Ky mban lidhje me zëvendëskomisarin e brigadës dhe me Komitetin Qendror të Rinisë. Në rast se brigada është e inkadruar në divizion, atëherë ky vazhdon të mbajë lidhje me anëtarin e seksionit politik të divizionit për rininë. Anëtari i seksionit politik të divizionit për rininë mban lidhje drejtpërdrejt me Komitetin Qendror të Rinisë Komuniste.

Sekretari i komitetit të rinisë në batalion, i cili bën pjesë në byronë e batalionit, duhet të bëjë jetë partie në një celulë: në rast se është i lartësuar, në mënyrë që të mos pengohet puna e celulës së shtabit të batalionit ai bën pjesë në këtë celulë. Në rast të kundërt, ai duhet të bëjë pjesë në një celulë të formacioneve që janë pranë shtabit, si celula e armëve të rënda ose e korrierëve.

* * *

Shtojcë. Në kompani ku ka celula partie nuk duhet të ketë grupe edukative të Partisë. E gjithë kompania duhet të jetë një grup edukativ. Në kompani ka vetëm kurse kandidatësh partie.

Enver Hoxha

VDEKJE FASHIZMIT
LIRI POPULLIT

*Botuar për herë të parë
në «Dokumenta kryesore
të PPSH», vëllimi I,
Tiranë, 1960*

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

FJALA NË MBLEDIJEN E KOMITETIT QENDROR TË RINISË KOMUNISTE SHQIPTARE¹

21 gusht 1944

Komiteti Qendror i Partisë ju ka sjellë në një nga forumet më me rëndësi të rinisë, dhe këtë e keni meritoruar. Por duhet me mësue gjithnjë, sepse sado që të dimë, dimë gjithmonë pak. Detyra është me shumë rëndësi dhe me përgjegjësi përpëra Partisë, rinisë e gjithë popullit. Ju jeni drejtuesit e gjithë rinisë shqiptare, qoftë asaj komuniste, qoftë asaj antifashiste. Roli juaj është i shumanshëm. Nuk duhet me i pa gjërat nën prizëm të ngushtë, por duhet me i pa më gjerë; çikërrimat nuk janë më pér ju. Duhet me futë në shpirtin e Rinisë Komuniste dhe të Rinisë Antifashiste organizimin e shëndoshë dhe me u ndejtë gjithmonë mbi kokë pér t'i këshilluar, pér t'i ndihmuar dhe pér t'i drejtar. Do tū jeni udhëheqës tē mirë, kur do tē drejtoni mirë.

Shoku Nako tha se Rinia Komuniste ka qenë fak-

¹ Mbledhja e Komitetit Qendror të Rinisë Komuniste të Shqipërisë që u mbajt në Helmës më 21 gusht 1944 shqyrtoi problemet e forcimit organizativ të «Rinisë Komuniste të Shqipërisë» dhe tē rritjes së rolit udhëheqës tē saj në «Bashkimin e Rinisë Antifashiste Shqiptare».

tor me rëndësi i lëvizjes sonë, por ajo mund të bënte akoma më tepër. Faji qëndron në atë që s'kishim eksperiencë dhe faji kryesor qëndron tek drejtuesit, të cilët nuk e kanë kuptuar mirë rolin e tyre drejtues. Megjithëse anëtarët e Komitetit Qendror të Rinisë kanë qenë të paktë dhe sektori i punës ka qenë mjaft i gjerë, prapë mund të bëhej më tepër, duke mbajtur lidhje dhe duke dhënë udhëzime jo vetëm me anë qarkoresh, por duke shkuar qarqeve të ndryshme dhe duke ndihmuar nga afër. Të mblidhej më shpesh Komiteti Qendror i Rinisë dhe pasi të shkëmbëhej eksperienca shokët të ndaheshin përsëri në qarqe. Komiteti Qendror i Rinisë ka punuar dhe do të punojë, sidomos tani me organizimin e ri.

Është e vërtetë se organizatat e Partisë s'e kanë ndihmuar sa duhet rininë. Por rinia ndjen dashuri për Partinë, megjithatë, shpesh nga pikëpamja sentimentale. Kur anëtarët e Partisë do të interesohen më tepër për rininë, atëherë kjo do ta dojë më tepër Partinë tonë. Pra, duhet lidhur rinia me anëtarin e Partisë, ashtu edhe anëtar i Partisë me rininë. Shokët që punojnë me rininë t'ua bëjnë të ditur mirë anëtarëve të Partisë vijën me rininë. Duhet që eksperienca e Partisë të kalojë në rini, në mënyrë që ajo ta njohë akoma më mirë Partinë. Është detyrë kryesore që të ngjallim një dashuri me themel në rininë ndaj Partisë. Duhet që organizata e Rinisë Komuniste të jetë e fortë, e shëndoshë, e zonja të drejtojë gjithë Rininë Antifashiste Shqiptare dhe të marrë pjesë në të gjitha lëmet e veprimtarisë sonë. Organizata e Rinisë Komuniste duhet të jetë shtyllë në ushtri, në pushtet e kudo. Por kjo nuk arri-

het vetëvetiu, duhet djersë e punë e vazhdueshme. Organizata e Rinisë Komuniste duhet të punojë si në terren ashtu dhe në ushtri. Terrenet tona janë dobësuar dhe kjo rrjedh nga që shokët që shkuan në ushtri i harruan fare terrenet prej nga ata kanë dalë. Po nuk patëm të forta organizatat e Partisë të terrenit, këshillat nacional-çlirimitare, komandat e vendit etj. nuk mund të kemi as ushtrinë të fortë. Po nuk që organizata e rinisë e fortë, nuk mund të kemi këshilla, komanda të vendit etj. të forta; s'mund të kemi pushtet të shëndo-shë, dhe pa këtë do të jemi të dobët. Duhet me i vënë rëndësi punës së shokëve të ushtrisë në terren. Ushtria duhet të jetë fabrikë e kuadrove për terrenin. Duhet me e ruejtë si sytë e ballit organizatën e rinisë. Jo të gjithë i kanë dhënë rëndësinë e duhur konspiracionit dhe informacionit. Nga këto mungesa kemi pasur shumë humbje. Duhet një disiplinë e fortë; s'duhet të influencojë në dobësimin e disiplinës shoqëria që kemi me njërin ose tjetrin. Me u ruejtë nga grupashët, sepse ata paraqiten në forma të ndryshme. Me i ngritë kuadrot nëpërmjet kursesh dhe punës praktike. T'i ngremë ata deri në nivelin tonë. Por s'mjafton me kaq, duhet të dimë me i përdorë mirë kuadrot tona.

Organizatën e Rinisë Komuniste duhet me e hedhë në punë dhe në luftë, duhet që rinia të ndihmojë pa masë pushtetin. Pushtet e ushtri — duhet të jetë sot motoja e Rinisë Komuniste.

Botohet për herë të parë, sipas procesverbalit të mbledhjes që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

**LETËR KUADROVE DREJTUESE POLITIKE TË
KORPARMATËS I MBI KRIJIMIN E KORPARMATËS
I TË UNÇSH MBI ORGANIZIMIN E PUSHTETIT
TË KËSHILLAVE NACIONAL-ÇLIRIMTARE NË
SHQIPËRINË E VERIUT DHE MBI
KONSPIRACIONIN**

[Gusht 1944]

Sikundër që ju kemi lajmëruar me anë radiogramesh, të dy divisionet dhe gjithë repartet territoriale që gjenden në veri të Shkumbinit grumbullohen nën një komandë, në atë të Korpusit I. Formimi i korpusit, përveç rëndësisë së madhe ushtarake që ka, se koordinon më mirë dhe me sukses veprimet e reparteve të ndryshme, komandimi i të cilave bëhet i pamundur drejtpërdrejt nga ana e Shtabit të Përgjithshëm, ka edhe rëndësi të madhe politike. Këtë rëndësi duhet ta vini në dukje me anë traktesh e konferencash të bëra në një shkallë të gjerë. Me krijimin e korpusit edhe detyrat tuaja e të të gjithëve bëhen më të mëdha dhe imperative. Me krijimin e korpusit duhet të rishikohet me imtësi dhe me kujdesin më të madh organizimi ushtarak i gjithë reparteve, gjithashtu dhe organizimi politik e sidomos organizimi i Partisë në këto reparte.

I. — Ushtarakisht duhet të riorganizohen batalio-

net territoriale në baza të shëndosha, të rishikohen kuadrot e tyre ushtarake dhe politike, të organizohen komandat e qarkut dhe ato të vendit, të cilat të kenë në krye njerëz të vendosur dhe të popullit dhe të kryejnë detyrat që u ngarkohen. Këto komanda të mos janë formale si kanë qenë deri tanë. Të forcohet ushtria jonë, të organizohet rrjeta informative, të organizohet jeta ushtarake në repartet tona, të ruhet konspiracioni dhe të zhduken metodat e këqia që deri tanë janë përdorur në radhët e ushtrisë dhe që bëjnë të konsiderohen çështjet e ushtrisë si një punë shokësh, ku të gjithë duhet të dinë çdo gjë, ku të gjithë të pyeten edhe pa qenë nevoja, ku të mos marrë vesh i pari të dytin dhe të tërë të japid urdhëra e të vepojnë pas kokës.

II. — Organizimi i pushtetit është në rend të ditës. Çdo gjë për ngritjen e pushtetit dhe për forcimin e tij. Gjithë anëtarët e Partisë në ushtri, në ternen, Rinia Komuniste, Bashkimi i Rinisë Antifashiste, të tërë duhet të kontribuojnë me të gjitha forcat në ngritjen e pushtetit tonë. S'mjafton me shkue në një vend dhe me krijue këshillin dhe me ikë, por me organizue sektionet e ndryshme në këshillë, me udhëzue këto sektionë se si duhet të organizojnë punën, me ndihmues në krijimin e skuadrave të punës, me ndihmues rindërtimin, me ndihmues hapjen e shkolave, organizimin e gjyqeve popullore, organizimin e kulturës, të propagandës, zhvillimin kultural të popullit, me luftue analfabetizmin, me krijue grupet teatrale, muzikore, me krijue shtypin në çdo krahi në, me organizue shtëpitë e rinisë, me krijue, me

një fjalë, një pushtet të ri e të shëndoshë, me krijuar një jetë të re, ku i tërë populli të marrë pjesë me interesim të madh në jetën shoqërore, ku populli të shohë se ky është regjimi i tij dhe i vetmi. Të mos jemi sektarë në punë, dua të them të mos shohim vetëm një anë të punës, por atë ta shohim në tërësinë e saj dhe kjo, të na bëjë konshientë të barrës së madhe që kemi në kurriz. Kryerja e kësaj barre varet nga ne, drejtuesit, varet nga përdorimi që do t'u bëjmë ne energjive të shëndosha që kemi në dispozicion. Vetëm duhet të arrijmë të fusim në shpirtin e shokëve sidomos, dhe mbasandaj të njerëzve të frontit, bindjen se vetëm me punë të paprerë dhe të matur do të arrijmë në rezultate të dëshiruara. Anëtarët e Partisë duhet të dinë mirë se puna e tyre nuk mbaron në mbledhjen e celulës, por atje fillon për të mbaruar në të mësuarit shkrim e këndim dhe katundarit më të humbur. Lufta e anëtarëve të Partisë për të forcuar ushtrinë, për të forcuar pushtetin, për të forcuar prapavijat është një luftë vigane dhe s'ka kush ta kryejë përviq nesh, ne jemi dinamoja, të gjithë të tjerët janë ndihmësat. Dhe kur dinamoja s'punon, atëherë s'mund të ecë maqina. Në këtë luftë të shumanshme, me pushkë e me kokë, me shpirt sakifice dhe me shpirt organizatori, me djersë e me mundime, do të dallohen anëtarët e Partisë, do të skartohen të plogëtit e të frikshmit, do të spastrohen sabotatorët. Në këtë punë ndërtimtare do të njihen udhëheqësit e mirë, organizatorët e shëndoshë.

Për punët e pushtetit do t'ju vijnë direktiva të vëçanta, të cilat të studjohen me rrënje, të kuptohen më

së miri dhe të mos merren «a la légère»¹, se atëhore mjerë ne. Duhet të shkunden anëtarët e Partisë në të gjitha repartet, në terren e kudo, duhet të shkundet rinia, duhet të shkundet gjithë populli, dhe një frymë e re e punës të përshkojë këdo, të gjithë të elektrizohen dhe të hidhen në punë, se vetëm kësisoj do të fitojmë.

III. — Për çështjen e Partisë po ju vë një qarkore² këtu brenda, ku do të shihni disa ndryshime organizative të reja, të përshtatshme me zgjerimin e punës në ushtri dhe me krijimin e reparteve më të mëdha. Këto direktiva i punoni ndër të gjithë, ua bëni të kuptueshme të gjithë udhëheqësve dhe i zbatoni menjëherë.

* * *

Jemi në korrent të propozimeve që keni bërë për ndryshim kuadrosh në repartet e ndryshme, si ushtarakë ashtu edhe politike. Bashkangjitur po ju dërgojmë disa aprovime. Në një nga ato telegramë më akuzonit sikur kam qenë i shtyrë nga zemërimi që u përgjegja duke thënë se «në telegramet tuaja ka konfuzion». Unë e di që ju e keni thënë pa të keqe, por edhe unë ju siguroj se s'ka as më të voglën gjaknxeftësi nga ana ime. Por një gjë është, dhe këtë duhet ta njihni, dhe kjo do t'u bindë po t'u hedhësh një sy telegrameve

¹ «a la légère» (frëngj.) — në mënyrë të sipërfaqshme.

² Është fjalë për qarkoren e KQ të PKSH të 17 gushtit 1944. (Shih në këtë vëllim f. 317—324).

tua ja, se telegramet s'janë shkruar me kujdes. Ne s'mund ta marrim me mend që ju flitni për P.P. e për P.L., ndryshime këto që janë bërë e aprovar para dy muajsh. Por për këtë u kuptuam...

* * *

Për çështjen e konspiracionit duhet të bëni shumë kujdes dhe veçanërisht ju. Ju e përdorni telefonin e radion si pa gjë të keqe, dhe kjo do të na shkaktojë ndonjë aksident ndonjëherë. Na lajmëron Brigada VI se pa kurrfarë konspiracioni u flitni në telefon, duke u thënë: «Na mori malli, ç'u bëtë, ju presim» e të tjera sende të tilla. Këto gjëra jo vetëm që janë të rrezikshme, se armiku i dëgjon dhe të pret rrugën e të jep një dru të mirë, por s'janë dhe serioze nga shtabi i një divizioni. Gjithashtu dhe herë të tjera e keni përdorur telefonin me ne, jo në një mënyrë serioze, ku haptazi na kini lajmëruar pozicionet tua ja (kjo që në fillim). Këto vërejtje që po ju bëj janë me rëndësi dhe mos t'u vijnë të hidhura, se armiku ka një rrjetë informative aq të fortë, sa s'mund të kini ide. Sikur t'u them që gjermanët dinin më parë se unë numrin e brigadës së re që formuam dhe vendin ku do të inagurohej, ju nuk do ta besoni. Por realiteti është ky. Kemi zënë dokumenta gjermane me rëndësi, nga të cilat del se jo vetëm që dinin se ku ndodhen brigadat tonë, por edhe hollësira të tjera që habitesh. Këto ngjasin vetëm nga pakujdesia jonë, dhe në rast se vazhdojmë kësisoj, do të na shkatërrrohet ushtria. Ju bëj një telegram «shumë konspirativ» për formimin e korpusit, i merr vesh të

gjitha Smithi. Kemi arësyet tonë që shkruajmë kështu dhe ju duhet t'i këndoni dhe të bëni ca më tepër kujdes për këto gjëra. Këto që po ju them, i them shoqërisht dhe jam i sigurt se do t'i kuptioni arësyet që më shtynë, gjithashtu si e kuptoj dhe unë këto rrjedhin nga moskujdesia juaj.

* * *

Divisionit II duhet t'i jepni ndihmën më të madhe, si ushtarake edhe politike. Shulja është një shok i vendoşur, ju e njihni sa edhe unë, por kur shkoi kishte pak frikë se si do të mundte ta drejtonte divisionin të tërë. Kjo vjen vetëm se ai s'ka shumë besim në vete, e nënçmon veten, por në realitet ai mund të bëjë dhe do të bëjë shumë; vetëm me pak përkrahje nga ana juaj Shulja do të shkojë përpara. Sa për kuadro politike ose ushtarake, po të paraqitet nevoja, duhet që Divizioni I të ndihmojë Divisionin II. Organizoni agjit-propet dhe shtypin, këtçj mos pritni gjë. Nga materiali që do të dalë këtej do të keni nga pak kopje, duhet vetë t'i shumëzoni.

* * *

...Kongresi i rinisë nesër merr fund me sukses. Shokët e rind kanë përfituar shumë. Çdo ditë janë bërë konferenca, shfaqje. Është punuar shkurtimisht por e tërë «Historia e Partisë», është punuar edhe lëndë tjetër. Do të shihni ndryshime në të rinxjtë që ju vijnë. Natyrisht me këtë rast janë bërë edhe ndryshime ndër

kuadrot e rinisë në brigada e në divizione. Të gjitha do t'ju komunikohen.

* * *

Bisedimet në Itali¹ ishin pezulluar, se shokët kërkonin udhëzime nga ne. Anglezët kërkonin që të konsultohet Palmeri në ndarjen e armëve dhe në hartimin e planeve. Ne ju përgjegjëm se planet i bën Shtabi ynë, se armët i ndan Shtabi ynë, dhe Palmeri do të njoftohet vetëm se ku venë këto armë. Ndonjë përfundim s'kemi edhe.

* * *

Misioni Sovjetik është pritur me ovacione në Dardhë e në Vithkuq nga populli dhe nga ushtria. Ndër ne s'ka dyshim që ka qenë ditë festë e madhe. Ka lëvuar pushka dhe mitralozi si në luftë. Majori sovjetik tha: «Komanda e Lartë Sovjetike dhe unë s'mund ta imagjinonim kurrë se ç'është arritur në Shqipëri. Kjo është e papritur, se informatat që na kanë dhënë, kanë qenë të gjitha false». Perspektiva të mëdha na hapen dhe lufta jonë për së shpejti do të shohë frytet e mëdha me ardhjen e misionit sovjetik. Më tepër nuk ju them (që t'u mbetet merak).

* * *

Formuam dy brigada të reja. Brigada XIV, që u formua në Sheper me elementë të Gjirokastrës dhe

¹ Është fjala për bisedimet që u zhvilluan në gusht të vitit 1944 ndërmjet delegacionit të Komandës së Përgjithshme

Mallakastrës, ka për komandant Gjon Banushin, përvëndëskomandant Halit Kaçanollin, komisar politik Kahreman Yllin dhe zëvëndëskomisar Gafur Çuçin.

Brigada XVI, që u formua në Çorovodë me elementë gjirokastritë, beratas, lushnjarë, mallakastriotë, ka për komandant Rahman Ruçin, zëvëndëskomandant Gjon Gjonajn, komisar politik Dyl Kellezin dhe zëvëndëskomisar Negusin ose Myzafer Vinokashin.

Kemi në plan dhe formimin e disa të tjera. Duhet të na konkuroni...

Shumë të fala juve edhe gjithë shokëve

[*Enver Hoxha*]

Botohet për herë të parë, si pas originalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

të UNÇSH dhe të Shtabit të forcave anglo-amerikane të Mesdheut.

R A P O R T
**PARA MBLEDHJES SË DYTË TË KËSHILLIT
ANTIFASHIST NACIONAL-ÇLIRIMTAR TË
SIHQIPËRISË¹**

20 tetor 1944

Të dashur shokë këshilltarë,

Kanë kaluar më tepër se katër muaj që prej Kongresit të Përmetit, ku u muarën vendime me rëndësi historike për vendin dhe për popullin tonë; kanë kaluar katër muaj me evenimente që kanë ndërruar situatën ndërkombëtare si dhe atë të vendit tonë. Këto evenimente me një karakter të rëndësishëm politik dhe ushtarak kanë pasur si rrjedhim që shkaktarja e kësaj kasaphane të përgjakshme, Gjermania naziste, e thyer nga të katër anët dhe e plagosur për vdekje, po ecën me hapa të mëdha drejt honit, ku do të zhduket përgjithmonë. Parashikimet tona në Kongresin e Përmetit po realizchen dhe janë në rrugën e përfundimit.

¹ Mbledhja e dytë e Këshillit Antifashist Nacional-Çlirimtar, u mbajt në Berat më 20—22 tetor 1944. Ajo vendosi ndërrimin e Komitetit Antifashist në Qcveri Demokratike Popullore, aprovoi ligjin mbi köshillat nacional-çlirimtare dhe «Deklaratën mbi të drejtat e qytetarëve».

Gjatë punimeve të kongresit ne, me një besim të plotë dhe të patundur në fitoren e armëve tonë, asistonim në triumfet e lavdishme të Ushtrisë heroike të Kuqe, e cila po dërmonte pa mëshirë armatat hitleriane dhe, ngadhnjimtare, ajo po çlironte tokat e veta dhe po ndiqte këmba-këmbës bishën e plagosur fashiste. Këto fitore të kësaj ushtrie famëmadhe, që ka mbajtur dhe mban mbi supet e veta të çelnikta peshën më të rëndë të kësaj lufte të tmerrshme dhe që me strategjinë e saj staliniane ka habitur botën, lehtësuan zhvillimin me sukses të luftërave antifashiste në frontet e tjera. Fitoret e Ushtrisë së Kuqe, që ishin fitoret e gjithë popujve në luftë kundër fashizmit, ishin një-kohësisht ndihma më e madhe dhe më e çmueshme që mund t'u jepej këtyre popujve në përpjekjet e tyre për të dërmuar okupatorin. Këto fitore të Ushtrisë së Kuqe, të udhëhequra nga Mareshali Stalin, e detyruan Gjermaninë naziste të dobësojë frontet e tjera dhe një-kohësisht ndihmuan Kombet e Bashkuara të blokut të madh antifashist të forcohen dhe të shtojnë aktivitetin e tyre ushtarak. Gjatë këtyre katër muajve Ushtria e Kuqe arriti në portat e Varshavës, ajo çlroi Rumaninë dhe detyroi qeveritarët kuislingë të atij vendi të kapitullonin; Ushtria e Kuqe hyri në Bullgari, Hungari, Çekosllovaki e në Prusinë Lindore. Qeveria Sovjetike dhe Ushtria e Kuqe u garantuan popujve të shtypur nga nazizmi indipendencën e tyre. Njohja dhe ndihma e madhe që i është dhënë Komitetit Nacional-Çlirimtar të Polonisë, sigurimi i dhënë popullit rumun prej Mollotovit, leja e kalimit, kërkuar Komitetit Nacional-Çlirimtar të Jugosllavisë, dhe sigurimi solemn

i dhënë këtij komiteti nga ana e Sovjetëve për moscenimin e pushtetit të ngritur në atë vend me rastin e kalimit në Jugosllavi të Ushtrisë së Kuqe, janë garancia e plotë për drejtësinë e nesërme.

Aleatët e mëdhenj: Anglia dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, që me bombardimet e tyre të ast.pra e të paprera i shkaktonin Gjermanisë, si brenda ashtu edhe në tërë frontet e Perëndimit, dëme të mëdha, shpërthyen mbi Francën sulmin e pritur prej gjithë popujve në luftë, sulm që do të shpejtojë çlirimin e Evropës nga nazizmi gjerman. Që përpara hapjes së frontit të dytë dhe hovit të ushtrisë së madhe anglo-amerikane, rezistenca e hordhive hitleriane të demoralizuara në kulm ishte e dëshpëruar. Ushtria anglo-amerikane çlroi gati gjithë Francën, Belgjikën dhe një pjesë të Hollandës dhe tani ajo gjendet në portat e Gjermanisë.

Në këtë luftë të tmerrshme, ku popujt e shtypur të Evropës kanë luftuar me një heroizëm të rrallë, një vend të posaçëm zënë popujt heroikë të Jugosllavisë dhe ushtria e tyre trime nacional-çlirimtare.

Me gjithë fitoret e mëdha të blokut të madh antifashist, me gjithë përparimin e ushtrive aleate dhe luftërat heroike të popujve të robëruar, Gjermania naziste, e plagosur për vdekje, s'i lëshonte armët, ajo bënte sforcon e fundit për të mbajtur pozitat e veta. Gjatë kohës së punimeve të Kongresit të Përmetit, okupatori gjerman dhe tradhëtarët e vendit tonë, që prej kuislingëve të Tiranës, me Mehdi Frashërin në krye, me «Ballin Kombëtar» të Mithat Frashërit e të Ali Këlcyrës dhe deri te «Legaliteti», i kryesuar prej tradhëtarit dhe banditit Abaz Kupi, po preqatitnin me ethe në trup dhe

me shpresa në zemër, ofensivën e madhe të dytë kundër Ushtrisë Nacional-Çlirimtare. Reaksionarët tradhëtarë s'i kishin humbur shpresat për me ua mbërrí planeve të tyre. Çdo mosmarrëveshje ishte zhdukur ndër ta dhe rrëth bajonetave gjermane, ende të forta, ata shihnin vetëm objektivin kryesor: shkatërrimin e Frontit Nacional-Çlirimtar dhe të ushtrisë sonë. Bandat kriminele të «Ballit Kombëtar» ishin në dispozicion të pakondicionuar të gjermanëve. Ato, tok me xhandarmërinë kuislinge dhe me banditët e «Legalitetit», kishin shpërthyer në një terror të papërshkrueshëm në tokat e okupuara jo vetëm kundër njerëzve aktivë të frontit, por kundër gjithë popullit. Në qytetet tona sundonte anarkia: gra, pleq dhe kalamaj të pafajshëm pushkatoheshin me të vetmin qëllim që të shuhej rezistenca. Grabitja e pasurisë së popullit s'kishte kufi, jeta e çdo qytetari ishte në rrezik. Në Shqipërinë Jugore këta banditë po mobilizonin me forcë njerëz nga populli, i mbanin këta të myllur në kazerma, që t'i kishin gati për aktin e tyre të fundit, dhe i ushqenin me demagogjinë e tyre të ndyrë, për t'i gjenyer më mirë dhe për t'i përdorur më mirë në veprën e tyre gjakatare kundër popullit. Në Shqipërinë Veriore gjithë reaksioni ishte grumbulluar rrëth banditit Abaz Kupi, rrëth kuislingëve Fiqri Dine me shokë, rrëth tradhëtarëve të poshtër, Mustafa Krujës, Kolë Bibë Mirakës e të tjerë Gjon Markaj. Tradhëtarët e Tiranës, me Mehdi Frashërin, me famëkeqin Mithat Frashëri e të tjerë tradhëtarë, si Ali Këlcyra, po orkestronin e drejtonin këtë veprim të shëmtuar, këtë krim të madh kundër popullit tonë. Këta pseudodemokratë e pseudorepublikanë tradhëtarë po bënin kauzë të përba-

shkët me hajdutët dhe kriminelët e regjimit të Zogut, dhe Gjermania naziste, ustai i tyre, i furnizonte me armë, me pare e me ushqime hordhitë e tyre të fëlli-qura. Tri divizione gjermane dhe me mijëra mercenarë shqiptarë, të pregetit me së miri dhe të armatosur deri në dhëmbë, u vërsulën si bisha mbi ne, u vërsulën mbi tokat e çliruara dhe të vaditura me gjakun më të kulluar të bijve të vlefshëm të popullit tonë. Plani i tyre djallëzor ishte të na asgjësonin si forcë ushtarake dhe politike, të konsumonin një herë e mirë veprën e tyre barbare dhe mbi kufomat tona ata të ngrinin pushtetin e tyre të kusarëve dhe të gjakpirësve. Por ushtria jonë heroike nuk flinte, ajo ishte gati të përbollonte çdo rrezik, ajo ishte gati, si gjithmonë, të shuhej e tëra për popullin e saj të shumëvuajtur, për atdheun e saj të shtrenjtë dhe të mos linte pa u dhënë mësimin e merituar divizioneve gjermane dhe bandave të tradhëtarëve. Ushtri e popull u çuan në këmbë, gra e burra, me pushkë në dorë, pleq e kalamaj, të gjithë si një trup, të frymëzuar me një vetëmohim dhe me një heroizëm që do të mbetet legjendar, vunë gjokset e tyre për shpëtimin e atdheut, për mbrojtjen e popullit, për mbrojtjen e tokave të çliruara, për mbrojtjen e nderit e të zakoneve tona, për fitoren e lirisë dhe të drejtësisë. Ushtria jonë dha kontributin e madh të gjakut të vet për çështjen e përbashkët të aleatëve dhe hyri në përlleshje akoma më të përgjakshme me divisionet gjermane tamam në momentet kur aleatët anglo-amerikanë, zbarkuan në Francë. Dhe përlleshja e ushtrisë sonë ngadhnjimtare me egërsirat gjermane dhe tradhëtare, o shokë këshilltarë, ishte epike. Partizanët, partizanet, komandantët dhe ko-

mistarët e batalioneve tona kreshnike, e brigadave tona legjendare, e kishin kuptuar se kjo ishte një luftë për jetë ose për vdekje dhe ata s'kursyen jetën për idealin e madh. Ata, me vetëmohim të patreguar, mbrojtën çdo pëllëmbë toke dhe e vaditën me gjakun e tyre. Me qindra e me qindra gjermanë e tradhëtarë e paguan me kërmat e tyre veprën gjakatare. Në episode lufte epike, që do të këndohen brez pas brezi si legjenda nga populli ynë, ranë heroikisht si luanë në fushën e nderit shokët dhe shoqet tona trime, ata ranë me këngë në gojë për Shqipërinë e re që po ndërtohet. Në vazhdën e tyre plot lavdi kaluan po me atë guxim e vetëmohim shokët e tjerë, dhe ushtria jonë lavdiplotë doli fitimtare, ajo e theu ofensivën e dytë gjermane, ajo shpartalloi dhe zhduku forcat dhe shpresat e tradhëtarëve dhe, ngadhjnjimtare e më e fortë se kurrë, ajo marshoi drejt objektivave të saja, që i kishte caktuar Shtabi i Përgjithshëm dhe Komiteti Antifashist, ajo u hodh në një kundërofensivë të ashpër për çlirimin e plotë të Shqipërisë. Lavdi për bijtë heroikë të popullit tonë, që ranë në fushën e nderit! Nder e dafina për Ushtrinë tonë glorioze Nacional-Çlirimtare!

Fitoret tona ushtarake kundër ofensivës së dytë gjermane erdhën menjëherë pas vendimeve të rëndësishme të Kongresit të madh të Përmetit, pas formimit të Komitetit Antifashist.

Formimi i Komitetit Antifashist, pjellë e natyrshme e kaq sakrificave dhe e kaq mundimeve që kishte bërë lëvizja jonë, ishte shprehja më e gjallë e vullnetit dhe e aspiratave të popullit tonë, i cili gjatë kësaj lufte të tmerrshme diti të konsolidojë pozitat e fituara me gjak,

qofshin këto pozita ushtarake, qofshin politike dhe organizative. Komiteti Antifashist ishte si rrjedhim i natyrshëm i konkretizimit të formës së pushtetit demokratik dhe forma e nevojshme e centralizimit të punës. Njëkohësisht formimi i Komitetit ishte për opinionin ndërkombëtar aleat shprehja e ligjshme e sovranitetit të një populli, i cili duke luftuar konkretizon njëkohësisht vetëqeverimin e vet.

Formimi i Komitetit Antifashist u prit me entuziazëm të papërshkruar nga gjithë populli shqiptar. Me mijëra letra urimi dhe besnikërie kanë ardhur në Presidencën e Komitetit nga skajet më të largëta të Shqipërisë dhe këto shprehin dashurinë e madhe dhe ndjenjat e larta të popullit tonë luftëtar, shfaqin vendosjen e madhe të tij për ta vazhduar me hovin më të madh luftën çlirimtare dhe besimin e plotë në Komitetin Antifashist, që udhëheq me sukses këtë luftë. Formimi i Komitetit ra si një bombë e madhe në radhët e tradhëtarëve që bashkëpunonin ngushtë me okupatorin dhe që preqatitnin me kujdes shfarosjen tonë. Gjithashtu formimi i Komitetit ua prishi planet që kurdisnin jashtë vendit tonë reaksionarët shqiptarë, të cilët gjenin mbështetjen në disa qarqe reaksionare të jashtme. Këta njerëz ua fshihnin vëllezërve tanë në mërgim realitetin e këtushëm, luftën e rreptë tonën, dhe vëllezërit tanë të mërgimit, që janë me mish e me shpirt me këtë popull e me luftën e tij, sepse janë demokratë me shpirt e me vepra, që janë gati të jepin çdo gjë për atdheun e tyre të lindjes, ndodhen ende në errësirë dhe s'mundin të kontribuojnë sa duhet për luftën tonë.

Formimi i Komitetit i likuidoi dhe i bëri qesharake

përpjekjet e reaksionarëve shqiptarë të brendshëm dhe të jashtëm, që përpinqeshin të formonin qeverira kukulla pa asnjë bazë në popull dhe kundër vullnetit të tij, e ku të merrnin pjesë, natyrisht, të gjithë ata që dje dhe sot s'kanë bërë tjeter, veçse lodrën e armiqve të popullit.

Kongresi i Përmetit dhe formimi i Komitetit Antifashist konsoliduan frontin tonë dhe grumbulluan gati gjithë popullin rreth tyre për në luftën e shenjtë. Pusheti u konsolidua dhe vendimet e marra prej Kongresit të Përmetit u zbatuan njëri pas tjetrit prej Komitetit Antifashist dhe prej Ushtrisë Nacional-Çlirimtare.

Një nga këto vendime më me rëndësi, që ishte ashpërsimi i luftës dhe çlirimi i zonave të okupuara, u përbush. Brigadat e divizionët tona, pasi thyen ofensivën e dytë gjermane, marshuan drëjt Shqipërisë Veriore për të çliruar tokat dhe popullin tonë të atjeshëm që vuante në mjerimin më të madh nga gjermanët dhe tradhëtarët. Njëra pas tjetrës bandat e Shefqet Vërlacit e të Abaz Kupit, të Fiqri Dines dhe të Halil Alisë me shokë, bandat e Markagjonit e të Bajraktarit¹, u shkrinë si bora në ujë. Si bora në ujë u shkrinë planet e tyre që synonin të génjenin popullin, duke u përpjekur të na paraqesin në popull si njerëz që shkatërrojmë çdo gjë dhe jo si njerëz që çonim në Veri lirinë e drejtësinë. Më kot gjermanët e tradhëtarët grumbulluan forcat e tyre të demoralizuara për të ndaluar hovin tonë çlirues dhe guximtar. Ushtria jonë ngadhnjmëtare, në mes të dashurisë së madhe dhe entuziazmit të papërshkrueshëm të popullit të Veriut, çlroi qytete e krahina të

¹ Muharrem Bajraktari.

tëra. U çliruan Çermenika, Mati, Dibra, Peshkopia, Zerqani, Lura, Luma, Mirdita. Forcat tona çdo natë janë në portat e Tiranës e të Elbasanit. Forcat tona po marrshojnë drejt Malësisë së Madhe dhe drejt Shkodrës, forcat tona arritën në Has dhe tanj gjenden në Malësinë e Gjakovës, brenda në Kosovë.

Pas këtij grushti të rëndë që u dha ushtria jonë, tradhëtarët shqiptarë s'gjejnë vend ku të futen. Erdhi koha që thoshim me plot të drejtë dhe me bindje të patundur se ata për veprat e tyre kriminale, të ndjekur këmba-këmbës prej ushtrisë dhe prej popullit që kërkon hakmarrje, do të përpiken të shpëtojnë lëkurën nën bajonetat e thyera gjermane ose nën dallaveret e reaksionit të jashtëm. Por dora e drejtësisë do t'i kapë dhe fundi i tyre i trishtueshëm është iminent.

Të dashur shokë këshilltarë,

Sikundër që shihni, që prej Kongresit të Përmetit dhe deri sot Lufta jonë nacional-çlirimtare ka marrë proporcione të mëdha dhe ushtria jonë është forcuar, çelnikosur dhe zmadhuar. Me mijëra partizanë të rinj po mbushin radhët e ushtrisë sonë dhe me një vullnet të patreguar ata hidhen në vijat e para të luftës kundër gjermanit barbar. Repartet e ushtrisë sonë kanë kaluar nga fazë e mëparshme e çetave, e batalioneve dhe e brigadave. Sot ushtria jonë vepron me njësi të mëdha. Katër divizione dhe një korparmatë janë formuar: Shtabi i Përgjithshëm është duke unifikuar shtabet e brigadave të tjera që po formohen; dhe fărë shpejt do të kemi divizione dhe korparmata të tjera. Shpirti ushtarak i njësive tona është i lartë dhe disiplina e çelniktë.

Komandantët tanë dhe komisarët politikë kanë fituar një eksperiencë të madhe dhe me teknikën e tyre luftarake ata kanë çuar repartet e tyre në fitore. Ushtria jonë, mund të themi me mburrje se, me luftërat e saj të ashpra, ka fituar edhe admirimin e aleatëve tanë. Në këto përpjekje armiqjtë e ndjenë mirë forcën e ngrijtjen ushtarake të njësive tona partizane. Në një raport sekret të forcave ajrore gjermane në Shqipëri, me datë 16.8.1944, të kapur prej forcave tona, flitet kështu për Ushtrinë Nacional-Çlirimtare nga ana e armikut tonë: «Kur atakuan Dibrën, partizanët vunë në zbatim për të parën herë një sulm të stilit të madh e të organizuar më së miri kundër një vendi të mbrojtur prej trupave gjermane. Sipas një plani të përcaktuar me kohë, armiku e zaptoi Dibrën». Por gjermanët kishin parë më parë, dhe panë edhe më vonë, të tjera operacione po me atë stil dhe me atë përpikëri zbatimi. Ata i njoën partizanët dhe komandantët e vlefshëm të ushtrisë sonë, i njoën në sulmet kur çiruan Peshkopinë, Zerqanin, Pogradecin, Beratin, Gjirokastrën, Krujën, Sarandën, Delvinën, Vlorën, Fierin, ata i njoën në Kuçovë e në gjithë rrugët e Shqipërisë, ata po i njojin dita-ditës në sulmet mbi autokolonat e tyre dhe këto sulme të rrufeshme të ushtrisë sonë i kushtojnë armikut me qindra e me qindra të vrarë, të plagosur dhe robër e me qindra automjete të djegura e të qitura jashtë përdorimit. Armiku okupator u prit me pushkë kresë kur shkeli vendin tonë, ai s'u la asnjë minutë rehat të vepronë i lirë dhe tani po ndiqet këmba-këmbës në tërheqjen e tij të fundit prej ushtrisë sonë.

Populli ynë me të drejtë le të mburret për ushtri-

në e tij të pathyer. Populli ynë me të drejtë le të qëndrojë kryelartë përpëra botës aleate dhe mike.

Në përpjekjet e saja vigane ushtria jonë u armatos me armët e rrëmbyera nga armiku, duke sulmuar kolonat dhe depot e tija. Ushtria jonë u ushqye dhe u mbajt gjallë nga buka e popullit tonë, i cili, me gjithë varfërinë e tij të madhe, me gjithë mjerimin e papërshkrueshëm ekonomik, të shkaktuar nga kjo luftë e tmerrshme, e hoqi kafshatën e gojës së tij për t'ua dhënë atyre që, zbatur e zhveshur, por me një moral të lartë e të papërkulur, në shi e në dëborë, luftonin pa kursyer as jetën e tyre për një Shqipëri të lirë dhe independente. Aleatët tanë na kanë ndihmuar dhe ata me armë e me municion. Këtë ndihmë që na kanë dhënë s'jemi nga ata që e harrojmë dhe u jemi mirënjos, por ndihmat s'kanë qenë të mjaftueshme. Me qindra partizanë janë pa pushkë e pa municion, me qindra partizanë, që digjen prej dëshirës dhe zjarrit të luftës, gjenden shumë herë në pozita të luftojnë me gurë. Nga mungesa e armëve shumë vende gjenden ende në duart e armikut. Për interesat e përbashkëta të kësaj lufte të shenjtë, për t'u prerë rrugën e tërheqjes dhe për t'i asgjësuar forcat gjermane, ne kërkojmë nga aleatët tanë armë, armë, armë! Besojmë se s'ka kush të na refuzojë të drejtën të luftojmë për ta ashpërsuar dhe më tepër luftën, ne kërkojmë përsëri armë dhe municion.

Të dashur shokë këshilltarë,

Fitoret tona kanë qenë të shumta dhe të vazhduese shme në çdo lëmë veprimi, dhe kjo i detyrohet qëndrimit politik dhe ushtarak të drejtë të lëvizjes nacional-

-çlirimtare. Parimet e luftës sonë të drejtë, të konkretnuara në platformën e Pezës dhe të plotësuara në Konferencën e Labinotit e në Kongresin historik të Përmetit, janë zbatuar me përpikëri dhe me sukses. Në tri të katërtat e Shqipërisë, dhe për së shpejti në të gjithë Shqipërinë, janë formuar këshillat nacional-çlirimtare, populli merr pjesë me vullnetin e tij të plotë dhe atje ai ka gjetur shprehjen e sovranitetit të tij; në to populli ka gjetur mënyrën e qeverimit e më mirë të themi të vetëqeverimit. Ngritja e këshillave nacional-çlirimtare dhe funksionimi i tyre gjatë luftës kanë qenë një nga faktorët e triumfeve tona. Këshillat nacional-çlirimtare, me rolin e tyre si pushtet dhe me punën e tyre të palodhur politike, kanë qenë dora e djaththë e ushtrisë sonë. Veprimet e ushtrisë dhe veprimet e këshillave ishin të lidhura ngushtë, dhe nga harmonizimi i plotë i të dy pushteteve¹, nga lufta dhe nga puna e tyre e palodhur, e kryer me një dashuri të madhe për njërit-tjetrin, dolën këto rezultate të shkëlqyera. Të nderojmë dhe të brohorasim punën dhe luftën e palodhur të këshillave nacional-çlirimtare, këtyre përfaqësueseve të denja të popullit tonë.

Me krijimin e Komitetit Antifashist puna e këshillave dhe e pushtetit mori një hov të madh. Filloi centralizimi i kësaj punë, populli u grumbullua rrëth frontit dhe ushtrisë, ai fitoi besim më të madh në punën dhe në luftën e vet. Udhëzime dhe direktiva u dhanë nga ana e Komitetit për forcimin e pushtetit dhe për shumëzimin e aktivitetit në të gjitha fushat. Rezultatet

¹ Pushtetit të këshillave dhe pushtetit ushtarak.

ishin të dukshme. Në lëmin arësimor me qindra shkolla janë çelur në zonat e çliruara dhe me mijëra fëmijë kanë filluar mësimet e tyre të rregullta. Me një zell të patreguar fëmijët e vegjël dhe të pafajshëm të popullit tonë, nën mbrojtjen e armëve të Ushtrisë Nacional-Çlirimtare, po vazhdojnë, me bindje të plotë për një të ardhme të bukur e të lulëzuar të tyre, mësimet e braktisura. Po organizohen kurse arësimtarësh, nga do të dalin mësues të tipit të ri, të cilët do të shkrijnë jetën e tyre për të edukuar brezin e ri, shpresën e atdheut. Po organizohen kurse për analfabetët e po krijojen shtëpi kulture për të ngritur nivelin kultural të popullit. Në lëmin e kulturës e të propagandës po organizohen kudo konferenca dhe mitingje, po forcohet shtypi ynë, po krijojen grupe muzikale e teatrale për të edukuar dhe për të ngritur lart shpirtin e popullit tonë. Në lëmin e ekonomisë po organizohen tregjet, po jepen udhëzimet e duhura për zhvillimin me sukses të punës në këtë sektor me kaq rëndësi për vendin tonë. Çështja ekonomike është problemi më i rëndësishëm që ka preokupuar Komitetin dhe që duhet kurdoherë të na preokupojë. Populli ynë, i dëmtuar nga lufta, vuan së tepërmë ekonomikisht. Krahina të tëra kanë mungesë buke, për të mos zënë në gojë nevojat e tjera, të cilat dhe ato kanë një rëndësi të madhe. Megjithëse në luftë, ne duhet që, në mos e zgjidhshim dot krejtësisht këtë problem, të paktën të vëmë shpatullat të gjithë për ta përmirësuar këtë gjendje. Me vullnet të mirë dhe pa u lodhur të zhvillojmë punën për ngritjen e ekonomisë së vendit, ashtu si kemi vënë shpatullat për të luftuar okupatorin. Për këtë gjë nuk duhet vetëm djer-

së, por duhet të zhvillohet në mes të popullit ndjenja e solidaritetit dhe e ndihmës reciproke. Në këtë luftë, ku të gjithë po derdhin gjak për të shpëtuar atdheun, duhet dhe në lëmin e ekonomisë të ndihmojmë shoqi-shoqin. Në këto kohë ai që ndihmon shokun ka ndihmuar veten e tij, ka ndihmuar ushtrinë, ka ndihmuar atdheun. Në lëmin e shëndetësisë, me gjithë mungesën e barnave, po bëhet çmos për krijimin e ambulancave e të spitaleve, po organizohen kurse për infermierë për me sigurue shëndetin e popullit dhe të ushtrisë.

Në katër muaj jetë, Komiteti Antifashist është përpjekur që të luftohet me tërbim kundër okupatorit dhe armiqve të brendshëm, që në zonat e lira të punohet për forcimin e pushtetit, të punohet për rindërtimin e vendit, të punohet për zhvillimin kultural të popullit. Frytet e para u dhanë dhe dita-ditës po shkojmë përpara dhe do t'u tregojmë të gjithë pesimistëve se populli ynë dhe njerëzit e rinj që farkëton kjo luftë, aq sa dinë të luftojnë trimërisht për lirinë e vendit të tyre do të dinë gjithashtu të punojnë e të ndërtojnë atdheun e tyre të shenjtë.

Një nga detyrat kryesore të Komitetit Antifashist ishte të punonte e të hartonte bazat ligjore të pushtetit tonë demokratik, mbi të cilat do të qëndrojë i patundur shteti ynë i ri. Këto ligje me një rëndësi kapitale do të vihen në aprovim, do të konkretizojnë organizimin dhe funksionimin e aparatit të shtetit.

Kujdesi dhe qederi më i madh i të gjithë neve pjesëtarëve të frontit duhet të jetë që tërë kjo punë që kemi ngritur të ketë themelë të forta për t'i rezistuar

çdo rreziku. S'duhet të na kënaqin shfaqjet e përcipta, por të shohim me sy realitetin dhe atje ku puna çalon ta ndërtojmë shëndoshë. Pushteti që po ngremë s'është një pushtet i rastit, por është gjithë e ardhmja e vendit dhe e popullit tonë, që ka vuajtur tërë jetën, që po derdh gjakun e tij të vlefshëm e që po digjet për të parë paskëtaj ditë më të lumtura. Prandaj në të gjitha degët e këtij pushteti duhet të sjellim popullin në fuqi dhe ai të jetë sovrani i fateve të veta. Për me realizue më së miri këtë barrë të rëndë duhet ta kuptojmë mirë esencën e këtij pushteti, duhet ta kuptojmë ne, ta kuptojë i gjithë populli ynë. Ligjet fondamentale të këtij pushteti demokratik janë të qarta e të thjeshta, të kuptueshme dhe të realizueshme prej të gjithëve. Çdo gjë është zhveshur nga procedura e koklavitur e ligjeve të mëparshme, të formuluara apostafat kësisoj për të mbajtur larg popullin dhe njëkohësisht për t'i ngrënë të drejtat. Por s'mjafton vetëm t'i kuptojmë këto ligje, duhet edhe t'i zbatojmë me rigorozitetin më të madh dhe t'i mbrojmë me ashpërsinë më të madhe kundër kujdo goftë që do të kërkojë t'i shtrembërojë e t'i marrë nëpër këmbë. Ai që shkel këto ligje, ai që i shpërdoron, ai shkel e shpërdoron vullnetin e popullit, ai s'mund të inbetet pa u ndëshkuar në pushtetin e ri që po ndërtohet.

Deri tani këshillat nacional-çlirimtare, qofshin ato të fshatit, të nënprefekturës, qofshin ato të prefekturës, kanë kryer njëkohësisht rolin e pushtetit dhe rolin politik. Me vendimet e reja të organizimit të pushtetit, këshillat nacional-çlirimtare dhe komitetet ekzekutive janë vetëm organe të pushtetit, dhe të gjithë

ata këshilltarë që caktohen prej këshillave nacional-çlirimtare në komitetet ekzekutive janë funksionarë të shtetit. Si të tillë ata janë përgjegjës përpara këshillave nacional-çlirimtare që i kanë caktuar dhe përparrë popullit të asaj nënprefekturë ose prefekturë ku bëjnë pjesë. Këta funksionarë të shtetit të ri, të dalë nga gjiri i popullit, duhet të zbatojnë urdhërat që marrin nga Këshilli Nacional-Çlirimtar e nga qeveria, të punojnë natë e ditë me ndërgjegje të plotë e me drejtësi të madhe për atë popull që u ka dhënë besimin. Si funksionarë ata duhet të respektohen prej të gjithëve, dhe ata nga ana e tyre, me punën dhe me sjelljet e tyre, të meritojnë këtë respekt dhe dashuri. Në këtë pushtet të ri askush s'duhet të kujtojë se me ardhjen e tij në një këshill do t'i permetohet të bëjë abuzime e të këqia në kurriz të popullit, populli do të jetë aty afër, përreth tij, që do ta ndihmojë, do ta kontrollojë, do ta kritikojë dhe do ta heqë, në qoftë se ai s'punon mirë. Përkundrazi, populli do të dojë me dashuri më të madhe dhe do të mbrojë me gjithë shpirt ata që punojnë me drejtësi për popullin. T'i kemi këto principe të qarta, si ne, si populli, në rast se kemi vendosur që gjithë ky gjak që është derdhur të mos shkojë kot, dhe me këto kriterë të shëndosha t'i përvishemi punës e të derdhim djersën dhe mundin tonë.

Rreth këtij pushteti ne duhet të grumbullojmë gjithë popullin shqiptar, askush të mos mbetet jashtë frontit, por të gjitha masat e gjera të popullit të drejtohen dhe të ushqehen me politikën e drejtë të Frontit Nacional-Çlirimtar. Për ta kryer këtë punë politike të gjerë në masat e popullit është i nevojshëm krijimi më

vete i organizatës politike të Frontit Nacional-Çlirimtar¹. Për formimin e kësaj organizate politike patjetër nderi u bie ta formoni ju, shokë këshilltarë, përfaqësuesit e denjë të popullit tonë.

Një nga detyrat e tjera të rëndësishme të Komitetit Antifashist ishte të bashkonte gjithë popullin shqiptar në Frontin Nacional-Çlirimtar dhe të luftonte ashpërsisht okupatorin për të shpejtuar çlirimin e atdheut. Me besnikërinë më të madhe Komiteti Antifashist e ka ndjekur rrugën e drejtë të bashkimit dhe të vëllazërimit të të gjithë patriotëve shqiptarë, se ishte e vetmja rrugë e shpëtimit për popullin tonë. Komiteti ishte kurdoherë zgjuar për të fituar nga çdo rr Ethanë për realizimin e plotë të këtij bashkimi të energjive të shëndosha të popullit, ishte zgjuar për t'i shkëputur çdo armë okupatorit. Në këto kohët e fundit evenimentet po rrokulliseshin me shpejtësi të madhe në Evropë e në Ballkan. Trupat gjermane, që ndodheshin në Greqi, Bullgari, Jugosllavi dhe Shqipëri u blokuan prej Ushtrisë së Kuqe dhe prej ushtrive nacional-çlirimtare të popujve të Ballkanit. Ushtria jonë dhe ushtritë nacionaal-çlirimtare të popujve fqinjë nga të katër anët po i goditnin forcat armike, që me ethe po preqatitnin ritiratën e tyre. Vapori gjerman po mbytej dhe, natyrisht, minjtë që ndodheshin në të shpejtoheshin të linin vaporin.

¹ Në Mbledhjen e dytë të Këshillit Antifashist Nacional-Çlirimtar u vendos që këshillat nacionaal-çlirimtare të mbeten vetëm si organe të pushtetit popullor, ndërsa Fronti Nacional-Çlirimtar të krijonte organizatat e tija më vete, këshillat e frontit.

Bandat e tradhëtarëve shqiptarë, që kishin ngelë ende në këmbë dhe që ndihmonin padronin e tyre në vrasjet dhe djegjet e fundit, filluan të tronditen. Banditëve shqiptarë njëri pas tjetrit filluan t'u dezertojnë të besuarit e tyre. Këta po dorëzoheshin në repartet e ushtrisë sonë, dhe, duke pohuar gabimin e tyre, kush dorëzonte armët e kush kërkonte të luftonte krah për krah me partizanët. Po asistonim në diserencimin e madh të reakzionit. Komiteti Antifashist për interesin e luftës dhe të popullit dhe për t'u hequr nga duart gjermanëve armën e fundit që kishin krijuar për të shkaktuar vëllavrasjen, bëri thirrjen që dini të gjithë¹. Kjo thirrje supreme, drejtuar të gjithë atyre që ndodheshin në pozitat e armikut, u jepte mundësinë të linin radhët e okupatorit për interesin e madh të atdheut, kjo thirrje u jepte rastin të lehtësonin fajet e tyre. Komiteti Antifashist e ka për detyrë ta shpejtojë çlirimin e atdheut. Thirrja jonë e drejtë dhe me një karakter të lartë politik ishte kushtimi i fundit, drejtuar të gjithë atyre që mund t'u kish mbetur në dejt një pikë gjak vëllai, të gjithë atyre që, me gjithë ç'kishin punuar, u dhimbej një grimë atdheu. Thirrja jonë ishte prova e madhe e qëllimeve të larta që ka ndjekur kurdoherë me drejtësinë më të madhe lëvizja jonë, qëllimet e bashkimit të gjithë popullit shqiptar. Lëvizja

¹ Eshië fjala për deklaratën e 22 shtatorit 1944 të Kryesisë së Këshillit Antifashist Nacional-Çlirimtar dhe të Komandës së Përgjithshme të Ushtrisë Nacional-Çlirimtare për ata që bashkëpunonin me okupatorin. (Shih: «Dokumenta kryesore të organeve të larta të pushtetit revolucionar nacional-çlirimtar», f. 198, Tiranë 1962).

jonë, si kurdoherë edhe tani, në kulmin e forcës së saj dhe përpara fitores definitive, u lëshoi një degë të kapeshin atyre që deri dje e kishin luftuar. Një shumicë e madhe prej këtyre njerëzve të gabuar dhe gjysmë përgjegjës pranuan thirrjen dhe u dorëzuan. Këta do të përfitojnë nga rrëthanat lehtësuese që u akordon kjo thirrje përfajet e tyre, por këto faje nuk do të falen, ato do të gjykohen prej gjyqeve të popullit me drejtësinë më të madhe që karakterizon luftën dhe frontin tonë. Me drejtësinë dhe ashpërsinë më të madhe do të dënohen të gjithë ata, mbi të cilët rëndon pesha e tradhëtisë. Të gjithë këta njerëz, që deri dje kanë qenë të huaj në front, që kanë qenë në pozitat e armikut dhe në kundërshtim të hapët me lëvizjen e që sot fronti ynë i pranon dhe u jep posibilitetë të reabilitohen, i këshillojmë të zhvishen nga mentaliteti i mëparshëm i gabuar, nga pretendimet e tyre të pamertueshme, nga qëllimet e tyre me u futë në front përmes shkatërrue nga brenda. U themi këtyre njerëzve të analizojnë mirë të kaluarën e tyre dhe tani të shohin punët drejt dhe të punojnë drejt. Ata të mos harrojnë asnjë sekondë se ne s'jemi nga ata që na ze gjumi mbi dafina. Të gjithë këtyre njerëzve u themi të ndërrojnë rrugë dhe metodë, në rast se u pëlqen që populli dhe pushteti i tij të mos marrin masa kundër tyre.

Të gjithë ata të tjerët, që me plot ndërgjegje i kanë vënë gjoksin veprës tradhëtare, po ikin të tmerruar përpara hakmarrjes dhe drejtësisë së popullit, se ata e dinë se gjaku i mijëra dëshmoriëve tanë nuk mund të bëhet ujë, gjaku i kaq prindërve dhe motrave tona të vrara dhe të therura barbarisht në fshatra e në qy-

tete nuk mund të harrohet, qindra e qindra fshatra të bëra shkrumb e hi kërkojnë hakmarrje, pasuria e popullit tonë, e djegur dhe e vjedhur, duhet vënë në vend. Mbi tradhëtarët e poshtër do të bjerë e pamëshirshme shpata e drejtësisë. Disa nga këta njerëz kanë shpresa edhe në ndihmën e disa qarqeve reaksionare të jashtme dhe përkëdhelin çndrrën e tyre se reaksiuni i jashtëm do t'i mbrojë të shpëtojnë lëkurën, ose të luajnë dallavere deri në fund.

Tek banditi Abaz Kupi, njeriu dinak dhe i njëmijë dallavereve, njeriu i Mehdi Frashërit dhe i kuislingëve të Tiranës, bashkëpunëtori i gjermanëve, të cilët e furnizonin me ushqime, material lufte dhe veshmbathje dhe i jepnin ndihmën e Vermahtit në luftën që bënte kundër nesh, qëndrojnë oficerë aleatë, dhe qëndrimin e këtyre oficerëve atje, Abaz Kupi dhe gjithë tradhëtarët e vendit e përdorin për të gënjer popullin, duke i thënë se Inglitera është me ata dhe i ndihmon. Sigurisht, qëndrimi i oficerëve aleatë ndër ata njerëz është një dëm për luftën tonë të përbashkët. Ne nuk do të pranojmë kurrë dhe kurrë nuk do të aprovojmë qëndrimin e atyre oficerëve atje. Qëndrimi ynë është më se i drejtë, besnikëria ndaj aleatëve tanë të mëdhenj është e plotë dhe dita-ditës po forcohet. Delegatët e Shtabit tonë të Përgjithshëm, që shkuan për bisedime me Shtabin aleat të Mediterranësë në Bari, në një atmosferë të përzemërt nënshkruan marrëveshjen e parë ushtarake. Ne, me luftën tonë të drejtë dhe të paprerë, kemi kaluar çdo pengesë dhe do të fitojmë, se ne në këtë luftë jemi aleatë të pandarë me Anglinë, Bashkimin Sovjetik dhe Amerikën, se popujt e këtyre ve-

ndeve janë me ne, me gjithë përpjekjet e disa intrigantëve që i kanë kömbët të shkurtëra, janë me ata popuj që luftojnë burrërisht okupatorin, për lirinë. Faktet provojnë fjalët e mia: tani pranë Shtabit të Përgjithshëm kemi përfaqësuesit ushtarakë të Bretanjës së Madhe, e cila, me luftën e saj të paprerë po shtërngon hallkën në grykën e Gjermanisë nga ana e perëndimit. Ne kemi përfaqësuesit tanë ushtarakë pranë Shtabit Aleat të Mediterranesë. Pranë Shtabit tonë të Përgjithshëm kemi përfaqësuesit ushtarakë të vendit të madh të Sovjetëve dhe të Ushtrisë glorioze të Kuqe, së cilës bota dhe njerëzimi mbarë po i kushton hymne lavdie pér peshën e rëndë që mban në supet e saja të çelnikta dhe pér luftën e saj titanike që ka habitur botën. Kërkesa unanime e popullit tonë, e bërrë me gojën e delegatëve të tij në Kongresin e Përmetit, u përmبush. Ne i jemi mirënjohës udhëheqësit të madh të popujve sovjetikë, Mareshalit Stalin. Ne kemi pranë Shtabit tonë përfaqësuesit ushtarakë të Shtetevë të Bashkuara.

Shokë,

Kongresi i Përmetit, i mbledhur në momente të vështira, ku merrnin pjesë delegatë nga të gjitha anët e Shqipërisë së çliruar dhe të okupuar, i dha vendit tonë Këshillin Antifashist, përfaqësinë e denjë të popullit shqiptar. Në këtë kongres pér herë të parë vullneti i popullit tonë u shpreh lirisht, pér herë të parë shtresat e gjera të popullit, burra, gra, pleq e të rinj muarën pjesë në jetën politike të vendit. Kongresi i Përmetit, Këshillin Antifashist të Shqipërisë e veshi me atributet legjislativë dhe ekzekutive njëkohësisht, dhe, në bazë

të të drejtave që kishte, Kryesia e Këshillit emëroi Komitetin Antifashist, organin kryesor ekzekutiv dhe urdhërdhënës të saj. Komiteti Antifashist ka pasur të gjitha atributet e një qeverie provizore, dhe si e tillë përpara tij viheshin problemet: me drejtue popullin shqiptar në luftë, me forcue dhe ashpërsue këtë luftë kundër okupatorit dhe tradhëtarëve, me çlirue tokat e okupuara, me forcue Ushtrinë Nacional-Çlirimtare, me zgjerue dhe me forcue pushtetin e këshillave. Në këtë fazë të luftës sonë, Komiteti Antifashist, me atributet e një qeverie provizore ishte guri themeltar i konkretizimit të pushtetit populor, fryti i luftërave tona të përgjakshme. Komiteti Antifashist, organ i pushtetit ekzekutiv, i përshtatshëm në rrethanat politike të asaj kohe, çeli rrugën e një qeverie demokratike të Shqipërisë, organ i pushtetit ekzekutiv, i përshtatshëm në rrethanat politike të sotme. Dhe këto rrethana politike të sotme janë ndryshe nga ato të katër muajve më parë. Lëvizja jonë është zgjeruar pa masë, lufta jonë ka marrë proporcione të konsiderueshme. S'jemi më në kohën kur në Shqipërinë Jugore po pregeteje ofensiva e dytë gjermane dhe tradhëtarët reaksionarë ishin në gjendje ende të mobilizonin bandat e tyre me forcë për me i hudhë kundër nesh, s'jemi më në kohën kur gati gjithë Shqipëria e Mesme dhe ajo Veriore lëngonin nën thundrën e okupatorit dhe të tradhëtarëve. Sot jo vetëm që në Jug s'gjen këmbë tradhëtarë dhe mercenari me armë, por Shqipëria e Mesme dhe një pjesë e madhe e Shqipërisë Veriore u çlirua krejt, duke pritur përsë shpejti të çlirohet e tëra. Tradhëtarët e Jugut dhe të Veriut po ikin të tmerruar përpara hapit ngadhnjim-

tar të ushtrisë sonë. Bandat e tyre mercenare u likuiduan dhe sot mund të themi me plot gojën se më tepër se tri të katërtat e Shqipërisë janë të çliruara, se në më tepër se tri të katërtat e Shqipërisë këndohet hymni çlirimtar; po vendoset pushteti nacional-çlirimtar i kë-shillave, po ngrihen dhe forcohen komandat e prapavijave, po ngrihet një ushtri e madhe në këmbë për të luftuar okupatorin, për të mbrojtur popullin dhe push-tetin e tij. Ushtria jonë s'është më ajo që ka qenë në Kongresin e Përmetit, ajo është trefishuar në numër, dhe energjia, vendosja për luftë e disiplina e saj janë dhjetëfishuar. Sot kemi në këmbë një numër të madh brigadash, kemi divizione dhe korparmata, dhe ushtria jonë shkon dita-ditës përrpara për çlirimin e plotë dhe të shpejtë të qyteteve dhe të gjithë Shqipërisë. Evenimentet përjashta po rrrokullisen dhe ushtritë aleate po shkojnë përrpara e po mbyllin darën mbi Gjermaninë hitleriane. Pra, edhe motoja e luftës dhe e politikës sonë duhet të jetë gjithmonë: Përrpara! Në këto rrethana politike, shokë, rrethana krejt në favorin tonë, ne duhet të marrim vendime me rëndësi, dhe njëri nga këto vendime duhet të jetë ndërrimi i Komitetit Antifa-shist në një Qeveri Demokratike të Shqipërisë. Në horizontin e jetës sonë politike ka lindur një faktor i ri që duhet patjetër ta marrim parasysh, dhe ajo arësy, që dje na ndalonte të emëronim një qeveri, sot, që tri të katërtat e Shqipërisë janë të çliruara, sot që push-teti ynë po zgjerohet dhe forcohet, sot që ushtria jonë është zmadhuar dhe forcuar, sot që Gjermania naziste po ha grushtet e vdekjes dhe tradhëtarët e vendit, të shpartalluar, s'gjejnë vend ku të futen, sot ajo arësy

na shtyn dhe na imponon të ndërrojmë Komitetin në Qeveri Demokratike. Lëvizja jonë ka kurdoherë masën e proporcionit, ka një sens politik të provuar, ajo nuk ka dalë kurrë jashtë realitetit politik, është përpjekur të ndjekë ritmin e ngjarjeve të brendshme e të jashtme dhe është bazuar plotësisht në të drejtën dhe në nevojat politike.

Ndërrimi i Komitetit në Qeveri Demokratike lyp një ligj, dhe këtë ligj jeni ju dhe vetëm ju që do ta bëni, se ju jeni përsaqësuesit e popullit të veshur me pushtetin legjislativ dhe ekzekutiv. Ky ligj që do të bëni, pasi ta merrni në shqyrtim këtë çështje, të jeni të sigurt se do të plotësojë një nga dëshirat e zjarrta të popullit tonë, do të forcojë pushtetin tonë brenda, do të forcojë pozitat tona ndërkombëtare.

Qeveria Demokratike, që do të dalë nga kjo mbledhje historike, do t'i qëndrojë besnikë platformës politike dhe ushtarake të lëvizjes sonë. Ajo do t'u qëndrojë besnikë vendimeve të Kongresit të Përmetit, do të jetë vazhdimësia e Komitetit Antifashist. Detyrat kryesore të kësaj Qeverie Demokratike do të janë, në radhë të parë, vazhdimi i luftës kundër okupatorit dhe shërbëtorëve të tij dhe mbarimi i shpejtë i kësaj lufte, forcimi i pushtetit demokratik të këshillave, mbrojtja e të gjitha të drejtave demokratike të qytetarit si edhe e besimeve të tyre, mbrojtja e pronës private. Qeveria Demokratike, besnikë e vendimeve të Përmetit, do të ndalojë hyrjen e Zogut në Shqipëri, derisa populli të mos ketë shfaqur vullnetin e vet mbi formën e shtetit. Kjo Qeveri Demokratike, pas çlirimt të plotë të Shqipërisë dhe pasi të ketë stabilizuar gjendjen, do të pro-

cedojë në bërjen e zgjedhjeve të lira dhe më demokratike për Asamblenë Konstituente, e cila do të caktojë formën e shtetit dhe do të bëjë Statutin Themeltar të Shtetit Shqiptar.

Qeveria jonë Demokratike do të kërkojë prej aleatëve të mëdhenj, Anglisë, Amerikës, Bashkimit Sovjetik, prej Jugosllavisë dhe gjithë shteteve të tjera aleate e mike të blokut të madh antifashist njohjen e saj si e vëtmja qeveri e popullit shqiptar, e dalë nga lufta dhe nga gjiri i një populli kreshnik, që ka derdhur kaq gjak e që heroikisht djemtë e tij s'kanë kursyer as jetën e tyre për lirinë e vendit të vet dhe njëkohësisht për lirinë e gjithë popujve të shtypur nga fashizmi.

Aleatët tanë të mëdhenj, Anglia, Bashkimi Sovjetik dhe Shtetet e Bashkuara, si dhe të gjitha shtetet e tjera mike, ne kemi bindjen e plotë se do ta njohin qeverinë tonë, qeveri që shpreh vullnetin dhe që përfaqëson gjithë popullin shqiptar. Ata do të na njohin, se kanë parë me sytë e tyre sakrificat tona që kemi bërë në këtë luftë të tmerrshme dhe të pabarabartë, ata kanë parë me sytë e tyre heroizmat e këtij populli të vogël, por të papërkultur. Ata do ta njohin qeverinë tonë, se ata na njohën në luftë e në momente më të vështira, ata panë ushtrinë tonë në kondita të rënda të vërsulej me tërbim dhe vetëmohim të patreguar mbi armikun në një kohë kur aleatët tanë të mëdhenj vërsuleshin po me atë abnegacion dhe heroizëm në frontet e tjera.

Të dashur shokë këshilltarë,

Në këto momente vendimtare, të thirrur nga Kryesia e Këshillit për të marrë vendime kaq të rëndësish-

me përfat e popullit dhe të atdheut tonë të shtrenjtë, jam i bindur se, si kurdoherë, përfaqësuesit e denjë të popullit tonë do të jenë në lartësinë që lyp momenti historik. Unë, në emër të Komitetit Antifashist, ju sjell përvendetjet dhe urimet tona në kryerjen me sukses të punimeve dhe, në emër të ushtrisë sonë heroike dhe të Shtabit të Përgjithshëm, përvendet në ju përfaqësuesit e denjë të popullit tonë dhe ju sjell gjithashtu, në emër të asaj ushtrie që ju të gjithë e keni në zemër, dashurinë dhe besnikërinë e saj të parfund për popullin tonë dhe përkauzën e tij të shenjtë.

Rroftë Këshilli Antifashist Nacional-Çlirimtar i Shqipërisë!

Rroftë Ushtria Nacional-Çlirimtare heroike e Shqipërisë!

Rroftë populli shqiptar!

Rroftë Shqipëria e lirë, indipendente dhe demokratike!

Rrofshin aleatët tanë të mëdhenj: Anglia, Bashkimi Sovjetik, Amerika!

Rrofshin gjithë popujt e blokut të madh antifashist!

Botuar për herë të parë në broshurën «Mbledhja e dyte e Këshillit Antifashist Nacional-Çlirimtar», 1944

Botohet sipas tekstit të boshurës «Mbledhja e dyte e Këshillit Antifashist Nacional-Çlirimtar»

DEKLARATE
E QEVERISË DEMOKRATIKE TË SHQIPËRISË, BËRË
PËRPARA MBLEDHJES SË DYTË TË KËSHILLIT
ANTIFASHIST NACIONAL-ÇLIRIMTAR TË
SHQIPËRISË

23 tetor 1944.

Në këtë luftë të madhe antifashiste e çlirimtare, ku gjithë popujt përparimtarë, të bashkuar përpara rrezikut që kërcënonte njerëzimin, hodhën energjitet e tyre kundër barbarëve nazisto-fashistë, populli ynë heroik dha me vetëmohimin më të madh kontributin e tij për çlirimin e atdheut dhe për zhdukjen e murtajës fashiste. Populli shqiptar ndërmori me guxim luftën më të tmerrshme dhe njëkohësisht më glorioze që ka parë historia jonë dhe tregoi me vepra gjaku, që do të mbeten monumente të pasembura për brezat e ardhshëm të vendit tonë, se në dejtë e shqiptarit vlon gjaku i stërgjyshërve të tij heroikë dhe se shpirti i tij është i pajisur me virtytet e larta që karakterizojnë popullin tonë. Përpara rrebeshit të madh që kërcënonte atdheun, populli ynë, pa marrë parasysh vuajtjet, urinë, djegjet e vrasjet, u hodh përpara në rrugën e vetme të shpëtimit që do të thyente zinxhirët e tmerrshëm të robërisë, në rrugën e luftës së pamëshirshme kundër oku-

patorit dhe tradhëtarëve të vendit. Populli shqiptar, me luftën e tij kundër armiqve të egër e të fortë, të armatosur me mjetet më moderne, ngjiti njëren pas tjetrës shkallët e lavdishme që quan lart emrin e Shqipërisë dhe të shqiptarit, që e bënë atdheun tonë të respektohet prej botës mbarë dhe (me gjakun e kulluar të bijve të tij të lavdishëm) të zërë vend krah për krah me të gjithë ata popuj që ndërmuarën veprën e madhe për shpëtimin e njerëzimit.

përisë Qeverinë e parë Demokratike, e cila është organi kryesor ekzekutiv dhe urdhërdhënës dhe me anën e së cilës Këshilli Antifashist Nacional-Çlirimtar kryen funksionet e tij ekzekutive.

Qeveria Demokratike e Shqipërisë, konshiente për barrën që i është ngarkuar, do të qëndrojë besnikë e vendimeve të marra në Kongresin e Përmetit, do të jetë vazhdim i Komitetit Antifashist, do të zbatojë dhe do të mbrojë të gjitha parimet ushtarake dhe politike të lëvizjes nacional-çlirimtare në një shkallë më të gjerë.

Qeveria, e mbështetur në funksionet e saj, deklaron përparrë gjithë popullit shqiptar:

1. Qeveria Demokratike e Shqipërisë do të qëndrojë besnikë e vendimeve të marrura prej Kongresit Antifashist Nacional-Çlirimtar të Përmetit dhe Këshillit Antifashist Nacional-Çlirimtar të Shqipërisë. Kjo qeveri do të vazhdojë gjurmat e Komitetit Antifashist.

2. Kjo qeveri ka për qëllim zgjerimin dhe vazhdimin e luftës, çlirimin e shpejtë dhe të plotë të Shqipërisë dhe mbrojtjen e indipendencës së saj.

3. Qeveria Demokratike e Shqipërisë do të grumbullojë të gjitha forcat e popullit shqiptar rreth pushtetit nacional-çlirimtar dhe do të forcojë pushtetin e këshillave nacional-çlirimtare.

4. Qeveria Demokratike e Shqipërisë, pas çlirimtës së plotë të Shqipërisë dhe pasi të ketë stabilizuar gjendjen, do të procedojë në bërjen e zgjedhjeve të lira me mënyrë demokratike për Asamblënë Konstituente, e cila do të caktojë formën e shtetit dhe do të bëjë Statutin Themeltar të Shtetit Shqiptar.

5. Qeveria Demokratike e Shqipërisë do të rishi-

kojë të gjitha marrëveshjet politike, ushtarake dhe ekonomike të bëra me shtetet e huaja prej regjimit të Zogut dhe do t'i prishë të gjitha ato që janë në dëm të popullit dhe të shtetit shqiptar.

6. Qeveria Demokratike e Shqipërisë do të sigurojë dhe do të mbrojë të gjitha të drejtat qytetare të nënshtetasit.

7. Qeveria Demokratike e Shqipërisë do të përpinqet ta bëjë më të ngushtë bashkëpunimin me aleatët e mëdhenj: Bretanjën e Madhe, Bashkimin Sovjetik dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, si edhe me të gjithë pjesëtarët e tjerë të blokut antifashist.

8. Qeveria Demokratike e Shqipërisë do të kërkojë prej aleatëve të mëdhenj, Bretanjës së Madhe, Bashkimit Sovjetik e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, si edhe prej gjithë pjesëtarëve të blokut antifashist, njohjen e saj si qeveri e vetme e Shqipërisë.

Në emër të Qeverisë Demokratike të
Shqipërisë

K R Y E M I N I S T R I

dhe Komandanti i Përgjithshëm i Ushtrisë
Nacional-Çlirimtare të Shqipërisë
Gjeneral-Kolonel

Enver Hoxha

Botuar për herë të parë në broshurën «Mbledhja e dytë e Këshillit Antifashist Nacional-Çlirimtar», 1944

Botohet sipas tekstit të broshurës «Mbledhja e dytë e Këshillit Antifashist Nacional-Çlirimtar»

**URDHËR
OREJTUAR SHTABIT TË KORPARMATES I
PËR ÇLIRIMIN E TIRANËS**

30 tetor 1944

**SHUMË URGJENT
SHUMË KONSPIRATIV**

Duhet me sulmue Tiranën dhe me e marrë me çdo kusht, dhe s'duhet me pritë që gjermanët të tërhiqen. Politikisht do të jetë një sukses i madh dhe do të ketë reperkusione të mëdha, si brenda edhe jashtë. Ushtarakisht do të zëmë armë e municion dhe automjete, do të ndalojmë gjermanët të grabitin dhe të djegin. Me këtë sulm partizanët dhe udhëheqësit do të fitojnë besim dhe eksperiencë.

Aksioni mbi Tiranën do të bëhet i kombinuar. Janë në lëvizje Brigada VIII dhe X nën komandën e Asaf Dragotit dhe Qazim Kondit, drejtësim Pezë. Këto brigada do të afrohen me Divisionin I dhe vihen nën komandën e korpusit për këtë aksion.

Janë në lëvizje Brig. II dhe XX nën komandën e Beqir Ballukut, drejtësim rrugës Librazhd-Elbasan, për të goditur armikun në rrugë dhe mundësishët për të bërrë presion mbi Elbasan.

Janë në lëvizje Brig. XII dhe XI nën komandën e I.R., drejtim Peqin-Kavajë, për të goditur rrugët në atë sektor dhe, në rast nevoje, për të ndihmuar forcat që operojnë mbi Tiranë.

Dita që do të veprohet të na njoftohet më parë, që të lajmërojmë të gjitha forcat të bëjnë presion të madh nga të katër anët.

Mbi Elbasan duhet të bëhet diversion ditën e sullmit mbi Tiranë, duke atakuuar qytetin me brigadën që ndodhet në atë sektor¹ dhe, në rast se shihet e mundur marrja e këtij qyteti, të sillet me urgjencë një brigadë nga terreni i Dibrës, meqë atje gjendja është e qetë².

Pa marrë parasysh preqatitjen e këtij plani, i cili duhet të zbatohet me çdo mënyrë dhe shpejt, duhet të bëni presionin mbi Tiranën dhe, po të shihni mundësitë e marrjes, veproni pa humbur kohë. Në asnjë mënyrë gjermanët s'duhet të ikin rehat e pa luftë.

Gjeneral Hoxha

*Botuar për herë të parë në
«Dokumenta të Shtabit të
Përgjithshëm dhe të Komandan-
dës së Përgjithshme të
Ushtrisë Nacional-Çlirimtare
Shqiptare», vëllimi II,
Tiranë 1966*

*Botohet sipas telegramit, që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

¹ Në sektorin e Elbasanit vepronte Brigada XV S, e cila e çlroi qytetin më 11 nëntor 1944.

² Në atë kohë gjithë qarku i Dibrës ndodhej në duar të Ushtrisë Nacional-Çlirimtare.

FJALIM NË KONGRESIN E PARË TË BGASH¹

4 nëntor 1944

Të dashura shoqe delegate të Gruas Antifashiste Shqiptare,

Në emër të Qeverisë Demokratike të Shqipërisë e të Shtabit të Përgjithshëm përshëndes nga zemra përfaqësueset e denja të Gruas Antifashiste të vendit tonë, të mbledhura në këtë kongres historik.

Për herën e parë në historinë e popullit tonë, gruaja shqiptare, në mënyrë të shkëlqyer, merr pjesë në jetën ushtarake dhe politike të vendit dhe pjesëmarrja e saj, e guximshme aq sa edhe e shenjtë, u vulos me gjakun e heroinave që ranë në fushën e nderit krah pér krah me véllezërit e tyre pér çlirimin e Shqipërisë dhe njëkohësisht të gruas shqiptare.

Në këtë luftë të përgjakshme antifashiste dhe çlirimtare, gruaja e vendit tonë e pa rrezikun që kërcë-

¹ Kongresi i parë i Gruas Antifashiste Shqiptare zhvilloi punimet nga 4—8 nëntor 1944 në qytetin e Beratit. Në kongres muanën pjesë 311 delegate nga të gjitha krahinat e Shqipërisë dhe nga repartet e UNÇSH.

nonte atdheun dhe veten e saj; ajo, me heroizëm të pashoqe, theu zinxhirët e paragjykimeve të vjetra dhe, duke ndjekur shembullin e grave antifashiste të popujve përparimtarë, vendosi krenarisht «të vdiste më mirë në këmbë se sa të rronte në gjunjë».

Në momentet më të vështira të vendit tonë, në çastet më kritike të fillimit të kësaj lufte heroike, grua-ja e Shqipërisë, ende e paorganizuar dhe prapa nga pikëpamja politike, ndjeu në zemrën e saj një dhimbje të madhe, një dhimbje që s'dinte si ta shprachte. Ajo, e tronditur nga konvulsionet e luftës, kërkonte një rru-gëdalje, një rrugë shpëtimi. Jehona e përpjekjeve të fillimit zhvilloi në zemrën e saj instinktin e mbrojtjes, instinktin prej nëne, motre, gruaje, për djemtë, për vëllezërit dhe burrat e tyre që po luftonin me mjete të pabarabarta kundër një armiku të egër. Gruaja shqiptare nuk mund të realizonte ende perspektivat e kësaj lufte, nuk mund të realizonte ende kontributin e madh që priste atdheu prej saj, por ajo që në fillim, me mish e me shpirt, ishte me djemtë që luftonin. Ajo, në momenet e vështira që kemi kaluar, na hapi portat e shtëpisë, na hapi zemrat, na inkurajoi. Kur terrori i papërshkruar sundonte mbi Tiranë, kur çdo natë kërcisnin pushkët dhe bombat dhe binin shokët tanë tri-ma nëpër rrugë për çlirimin e Shqipërisë, nuk mund të harrojmë heroizmat e mëmave dhe të motrave tona të thjeshta, të cilat, pa marrë parasysh asgjë, na ndih-monin dhe na ruanin si sytë e ballit. Kam kurdoherë parasysh ftyrën e shkëlqyer e të thjeshtë të një në-ne plakë, shoqen tonë luftëtare të pathyer të fillimit. Simbol i gruas shqiptare, në përpjekjet e saja vigane

ajo na thoshte në momentet më kritike: «Unë s'di të flas si ju, por kam besim të madh se do të fitojmë, prandaj përpara, djemtë e mi, se dhe unë do vdes tok me ju!». Dhe kjo nënë plakë, shoqe e luftës dhe e mundimeve, s'e humbi kurrë besimin, sikundër që s'e humbën gjithë gratë antifashiste shqiptare. Sot ajo, me gjithë moshiën e saj të thyer, nga malet e Shqipërisë së Veriut, ku lufton me pushkë në dorë, më shkruan e nië thotë: «Fjalët që më thoshte Qemal Stafa dhe shokët e tij u realizuan, dhe unë jam më e fortë se kurrë»..

Gruaja Antifashiste Shqiptare e gjeti rrugën e saj, rrugën e shpëtimit që ajo kërkonte, dhe kjo ishte rruga e luftës. Ndër fshatra e ndër qytete, gjaku i kulluar i nënave dhe i motrave tona, që vaditi rrugët, ishte kushtrim i një vullneti të ri dhe i një bote të re që po ngrihej; lufta legjendare e shoqeve tona, që asgjë s'i ndalonte, por hidheshin si luanesha mbi gjermanët e tradhëtarët, ishte shprehje e një faktori të madh që po lindte në vendin tonë, faktor që manifestohet sot në këtë kongres, faktor që do të luajë në Shqipërinë e re që ndërtojmë një rol me rëndësi të dorës parë.

Gruaja Antifashiste Shqiptare i fitoi me gjak të drejtat e saja, dhe këto të drejta ja garanton pushteti i popullit që ajo, tok me vëllezërit e saj, e ngriti duke sakrifikuar çdo gjë të shenjtë që kishte, këto të drejta ja garanton ushtria e popullit të saj.

Kongresi i madh dhe historik i Gruas Antifashiste, në të cilin po asistojmë sot, do t'i japë një impuls të madh zhvillimit të gruas shqiptare, e cila për të realizuar më mirë dhe më shpejt qëllimet e saja të shenjta do të organizohet dhe do të shtërngojë radhët e

saja në organizatën e Gruas Antifashiste Shqiptare. Në këtë organizatë duhet të bëjnë pjesë gjithë gratë e Shqipërisë dhe atje këto të lartësohen, të edukohen me fryshtë e re, me fryshtë përparimtare; atje do të bëhen luftëtarë për të mbrojtur të drejtat e tyre dhe njëkohësisht të bëhen mëma të denja të vendit tonë. Përpara Gruas Antifashiste Shqiptare hapen horizonte të reja e të lulëzuara, dhe për të mbërritur në idealet e larta, për të cilat ranë luftëtaret e saja heroike, gruaja e vendit tonë, krah për krah me burrat dhe me të drejta të njëjta e të barabarta, të hidhet e tëra në luftë e në jetën politike e shoqërore të vendit tonë, se vetëm në këtë mënyrë do të shpejtojmë çlirimin e plotë të Shqipërisë, do të rindërtojmë atdheun tonë të dashur dhe gruaja shqiptare do të çojë veten e saj drejt objektivit që ajo dëshiron dhe meriton. Gruaja Antifashiste Shqiptare do të ketë të gjithë përkrahjen e qeverisë dhe të pushtetit në rrugën e saj të përparimit, ashtu sikundër edhe pushteti e qeveria do të kenë ndihmën e çmuar të Gruas Antifashiste Shqiptare.

Mëmave dhe motrave të luftëtarëve tanë, që çliruan gjithë Shqipërinë e Jugut e që tani janë mbi Tiranë e mbi Shkodër për të realizuar çlirimin e plotë të Shqipërisë, po u sjell përshtendetjen e gjithë Ushtrisë Nacional-Çlirimtare dhe u siguroj se luftëtarët tanë janë kryelartë dhe mburren me ju. Ata forcon kur shohin se nënët dhe motrat e tyre, të bashkuara si një trup, janë krahas me ta në luftën përliri dhe ju, o mëma të shokëve dhe të shoqeve tona heroike që ranë në fushën e nderit për çlirimin e popullit e të atdheut, ngrini kryet lart dhe forconi zemrat,

se gjithë populli ynë dhe popujt liridashës përunjen me respekt dhe adhurim përpara koskave dhe gjakut të shenjtë të bijve dhe të bijave tuaja të dashura, që ju i rritët dhe ja falët atdheut. Gjaku dhe koskat e shenjta të bijve dhe të vashave tuaja, që mbrujtën dhe forcuan themelat e Shqipërisë së re, janë altari i shenjtë i kombit, ku i gjithë populli ynë, i bashkuar e i organizuar, do të marrë çdo ditë e përherë forcën e shpirtit që do të na çojë përpara, drejt përparimit dhe lulëzimit, drejt idealeve, për të cilat ata ranë dëshmorë.

Lavdi për heronjtë tanë, që dhanë jetën për çlirimin e atdheut!

Rroftë Kongresi i parë i Gruas Antifashiste!

Rroftë Gruaja Antifashiste e vendit tonë!

Rroftë Bashkimi i Gruas Antifashiste Shqiptare!

Rroftë Shqipëria e lirë dhe demokratike!

Botuar për herë të parë në broshurën «Fjalim në Kongresin I të BGASH», botim i shlypshkronjës «Bashkimi»,

Tiranë 1945

Botohet sipas tekstit të broshurës «Fjalim në Kongresin I të BGASH»

**VENDIMET HISTORIKE TË MBLEDHJES SË DYTË
TË KËSHILLIT ANTIFASHIST NACIONAL—
—ÇLIRIMTAR, MBAJTUR NË QYTTETIN
E BERATIT¹**

Nëntor 1944

Me zhvillimin e ngjarjeve të fundit dhe si rezultat i luftës sonë të përgjakshme e ngadhnjimtare mbi okupatorin gjerman dhe shërbëtorët e tij, lindën faktorë të rinj që ndryshuan situatën kombëtare në vendin tonë. Lufta jonë e paprerë dhe e papërkulur solli si rezultat ngritjen e gjithë vendit nën armë, zmadhimin dhe forcimin e ushtrisë sonë, zgjerimin e tokave të lira dhe ngritjen e forcimin e pushtetit demokratik të këshillave nacional-çlirimtare. Për të arritur në këto rezultate patjetër u derdh shumë gjak, u deshën sakrifica e vuajtje, u desh durim dhe një vetëmohim i madh prej gjithë popullit shqiptar. Si çdo fillim dhe ky yni ishte i zorshëm, sepse lufta jonë kundër armiqve nuk ishte e barabartë. E filluam luftën në momente të vështira, kur kuçedra fashiste po shkonte me urë të ndezur nga fitore dhe në një kohë kur një

¹ Artikull, botuar në gazeten «Bashkimi».

pjesë nga populli, me gjithëse e urrente me tërë shpirt shkelësin, nuk ishte akoma në gjendje të kuptonte si duhej takтикën e armikut e të kolonës së pestë, sepse s'kishte një edukatë të mjaftë politike, e cila t'i ndihmonte për të parë qartas që në fillim rrjedhimet e hidhura që do të sillte regjimi fashist. Kish mjaft nga ata që mendonin se populli ynë i vogël nuk mund t'ja dilit te dot mbanë gjithë atyre fuqive të mëdha armike dhe se shpëtimi i tij duhej lënë në duart e fatit. Ata mendonin se fati i Shqipërisë do të caktohej prej të huajve, prej atyre që do të dilnin fitimtarë, qofshin këta gjermanë ose kundërshtarë të tyre. Mosbesimi në forcat e pashtershme të masave të popullit dhe mosbesimi në fitoren e aleatëve i bënte këta njerëz të impresionoheshin nga propaganda e armikut dhe e tradhëtarëve të vendit, të cilët në një stil të gjerë e ushqenin këtë opinion. Nga ana tjetër, politikanët tradhëtarë, me intrigat dhe dallaveret e tyre të vjetra, shpresonin se do t'u ecte akoma lodra e tyre e urryer dhe politika e tyre false, mendonin dhe ishin të bindur se do ta drejtonin faktorin popull drejt qëllimeve të tyre, qëllime që ishin prapanike dhe të njëlljojta me ato të fashistëve. Mendojn se do t'u shkonte edhe këtë radhë politika e tyre «allaturka» që konsiston: të bësh politikë dhe aleancë me të gjithë ata që kanë forcën brutale në dorë dhe që e përdorin këtë forcë kundër popullit. Ata kujtonin se shpejt dhe lehtë do të mund të ndërronin këmishë. Ata rronin në botën e vjetër, në botën fashiste. Populli përti ishte bagëti që hiqej prej kapistre dhe që, i shtypur e i mbajtur në errësirë nga zgjedha, uria e torturat e regjimeve që kishin kaluar mbi të, nuk mund të luante

një rol të dorës së parë në tragjedinë e madhe që po zhvillohej.

Në gjendjen shpirtërore dhe ushtarake që ndodhej populli ynë, duhej patjetër të krijonim konditat e domosdoshme për fitoren; duhej të ngjallnim besimin në masat e gjera të popullit se ne ishim në gjendje të thoshim fjalën tonë, megjithëse të vegjël, se ne nuk ishim vetëm në këtë luftë të madhe, ku luhej fati i njerëzimit, por kishim aleatë të forti e të vendosur gjer në fund për zhdukjen e fashizmit, se populli ynë trim duhej të kuptonte dhe të merrte mësim nga e shkuara e tij dhe e gjithë popujve të tjerë, se liria e dhuruar nuk është liri, por vetëm ajo e fituar me gjak do t'i siguronte atij dhe vendit indipendencën e plotë. Për t'ja arritur këtyre qëllimeve na duhej ta edukonim popullin politikisht, na duhej të bënim përnjëherë atë punë që regjimi i kaluar e kishte luftuar, gjë që pati për rezultat dëshpërimin e madh të 7 prillit dhe pamundësinë të luftohej fashizmi me armë që në ditët e para pas pushtimit.

Lufta jonë çlirimtare e nxori popullin në krye dhe këtu e vetëm këtu qëndron arësyja e fitores. Populli ynë dha prova në këtë luftë të shenjtë se nuk ishte në dekadencë morale sikundër shpresonin tradhëtarët, por ishte një popull me shpirt përparimtar dhe progresiv, në të kishte një vitalitet të çuditshëm, në të vlonë ideja e çlirimt e përparimit. Lufta e popullit tonë eci përpara me hapa të habitshme; në momentet më të vështira të luftërave çlirimtare të popujve të tjerë të shtypur, heroizmi i popullit tonë shërbente si nxitës dhe shenjë admirimi për luftëtarët e atyre vendeve velle-

zër. Lufta jonë shkoi përpara, se lëvizja jonë ishte lëvizje masash, kishte karakter popullor dhe synonte çlirim e atdheut dhe vendosjen e pushtetit të popullit. Për këtë arësy e masat e gjera të katundarëve, të punëtorëve e të intelektualëve, gjetën në këtë lëvizje shprehjen e dëshirave dhe të aspiratave të tyre të shtypura prej regjimeve të kaluara dhe prej okupatorëve fashistë. Dhe këto masa luftëtare, që përpjekja dhe lufta e parreshtur i bëri të ndërgjegjshme, u bashkuan si një trup i vetëm për një qëllim. Çdo etapë e luftës sonë u shkrua me gjak, çdo gur i pushtetit ushtarak dhe politik u vadit me gjak, dhe ky pushtet i ri që po ngrihet në vendin tonë i ka themelet të forta, mbrohet nga gjokset e popullit, prandaj është i pavdekshëm dhe i pathyeshëm.

Pushteti demokratik i këshillave nacional-çlirimtare. që dita-ditës po merr formë konkrete, ishte konsekuençë e këtyre përpjekjeve dhe e karakterit popullor të kësaj lufte. Këshillat lindën nga lufta dhe u bënë organet e saja dhe krahas me ushtrinë ato ishin një nga faktorët më me rëndësi të zhvillimit të kësaj lufte. Këto këshilla nuk ishin aspak modeli i kryepleqësive dhe i myftarëve të regjimeve të kaluara, që emëroheshin nga prefekti ose nënprefekti, domethënë vegla të atyre që sundonin mbi popull, por ishin organë të përbëra nga përfaqësues të popullit, të zgjedhur prej tij për të mbrojtur interesat e tija. Patjetër në fillim dhe për një kohë të gjatë, kur pjesa më e madhe e zonave që sot janë të çliruara lëngonte nën thundrën e okupatorit, roli i këtyre këshillave kufizohej veçanërisht në ndihmën për zhvillimin e luftës, përfurni-

zimin e ushtrisë, për mbrojtjen e luftëtarëve; por me çlirimin e zonave dhe krahas me zhvillimin e luftës dhe me zmadhimin e forcimin e ushtrisë, këshillat, përveç detyrës kryesore që kishin dhe kanë akoma për të ndihmuar në radhë të parë luftën dhe ushtrinë, filluan të kuptojnë rolin e tyre të dorës së parë, filluan të marrin në dorë drejtimin e pushtetit. Kongresi i madh i Përmetit përforcoi dhc përcaktoi më mirë funksionin e Këshillit Antifashist Nacional-Çlirimtar të Shqipërisë dhe të këshillave nacional-çlirimtare. Këshilli Antifashist Nacional-Çlirimtar u vesh prej kongresit me funksionet legjislativë dhe ekzekutive, dhe këshillat nacional-çlirimtare të katundeve, të nënprefekturave dhe të prefekturave u bënë organet e pushtetit të ri. Kjo ishte etapa e konkretizimit të pushtetit demokratik të këshillave, rezultati i luftës së popullit, rezultati i Konferencës së Pezës e të Labinotit. Në këtë etapë të re të luftës, Këshilli Antifashist N.-Çl. i Shqipërisë emëron Komitetin Antifashist N.-Çl. si organ kryesor ekzekutiv të tij. Pas kësaj etape u çelën horizonte të gjera dhe perspektiva të reja për lëvizjen tonë. Lëvizja mori hov të madh, po zgjerohet e përforcohet. Entuziazmi në popull u shtua, sepse ai pa të kurorëzohen me sukses mundimet e tija, pa të varroset përgjithmonë pushteti i vjetër, jo i tij, që e kishte shtypur dhe i kishte pirë gjakun. Për popullin u shtuan shpresat dhe u rrit besimi se ai kishte tanë frenat e të ardhmes së tij në duart e veta dhe se çdo gjë kishte ecur në këtë drejtim e dita-ditës po perfeksionohej.

Me çlirimin e pjesës më të madhe të Shqipërisë, me zmadhimin e ushtrisë, me shpartallimin e të gjitha

bandave mercenare që ishin në shërbim të armikut dhe me forcimin e pushtetit të këshillave, paraqitej i nevojshëm ndërrimi i Komitetit Antifashist në një Qeveri Demokratike. Këtë vendim me rëndësi e mori Mbledhja e dytë e Këshillit Antifashist që u mbajt në qytetin e lirë të Beratit. Mbledhja e dytë e Këshillit Antifashist, përveç që i dha Shqipërisë Qeverinë e parë Demokratike, i dha vendit tonë edhe ligjet fondamentale të organizimit të pushtetit si dhe «Deklaratën e të drejtave të qytetarëve». Tri vendime me rëndësi kapitale, që janë një hap i madh drejt demokratizimit të vendit, tri vendime që i hapin vendit tonë perspektiva të gjera zhvillimi e pune drejt rindërtimit të tij dhe përparimit.

Qeveria Demokratike e Shqipërisë, pjellë e Luftës nacional-çlirimtare, do të kryejë shpejt dhe me sukses detyrën e saj kryesore, mbarimin e luftës, dhe do të jetë fryshtuesja dhe organizuesja e rindërtimit të vendit, e zhvillimit dhe e perfektionimit të ekonomisë shqiptare, e organizimit të mbrojtjes së shëndetit të popullit dhe e ngritjes së nivelit kultural të vendit. Qeveria Demokratike e Shqipërisë, që është shprehja e vullnetit të popullit tonë dhe që e përfaqëson këtë tërësisht, do të kërkojë me të drejtë dhe me insistim njojen e saj prej aleatëve tanë të mëdhenj dhe prej shteteve të tjera antifashiste dhe mike, si e vetmja qeveri që përfaqëson popullin, që s'u përkul kurrë përpara armiqve fashistë e nazistë, por luftoi me një heroizëm të rrallë krah për krah me të gjitha kombet e bashkuara të blokut të madh antifashist. Qeveria Demokratike e Shqipërisë, në ndërmarrjen e saj të madhe dhe në punën e saj të vështirë që i paraqitet përpara, kur vendi

ynë i djegur e i shkatërruar kërkon një punë të madhe e të parreshtur, do të ndihmohet me mish e me shpirt nga populli që ka pushtetin në dorë. Në këtë qëndron suksesi i sigurt në të ardhmen, se qeveri, pushtet e popull janë një e të bashkuar, si në luftë ash- tu edhe në paqe.

Pushteti demokratik që u ngrit është krejt i kundërt i atyre të parëve. Këtu populli është në fuqi dhe me të vërtetë sovran i fateve të tija. Me anën e këshillave, që janë organe të pushtetit, populli do të administrohet dhe do të rregullohet vetë. Regjimi i ri demokratik i rrëzoi përdhe regjimet e vjetra totalitare e fashiste, u dha fund mënyrave të punimit e të mendimit të kohërave të kaluara, i dënoi një herë e mirë demagogjité dhe gjenjeshrat, me anën e të cilave njerëzit e së kaluarës kishin sunduar dhe qeverisur. Në pushtetin e ri jo vetëm që populli merr i téri pjesë, por ka të drejtën të kontrollojë njerëzit që ka zgjedhur në pushtet, t'i kritikojë dhe t'i heqë, në rast se ata nuk punojnë ose punojnë në dëm të tij. Pushteti i ri do të luftojë dhe do të zhdukë përgjithmonë favoritizmat e vjetra, do të përbysë metodat prapanike, që kanë lejuar gjithnjë të mbushen radhët e administratës e të pushtetit me parazitë e kusarë. Populli ka parë dhë do të shohë ditaditës më mirë se në pushtet duhet të dërgojë njerëzit më të besuar të tij, njerëzit më të ndershëm, detyra e të cilëve do të jetë vetëm e vetëm si të përmirësojnë gjendjen e popullit dhe të realizojnë një jetë më të mirë për të. Me pushtetin e ri merr fund burokracia e tepruar e regjimeve të kaluara, që e mbyste dhe e shtrydhte popullin. Nën këtë pushtet edhe fshati më i largët do të admi-

nistrohet vetë prej njerëzve të dalë nga gjiri i tij. Prefekitura dhe nënprefektura, të cilat shërbenin nën regjimet e kaluara për të pasuar xhepat e satrapëve dhe për të ushqyer parazitët e të favorizuarit e ndryshëm, janë transformuar, me pushtetin e ri, në qendra me rëndësi ekonomike, politike dhe administrative. Në këshillat e këtyre qendrave nuk do të vijnë më njerëz të panjohur dhe të huaj për vendin, njerëz që nuk njohin as gjendjen, as terrenin, por do të vijnë njerëz të dërguar nga gjithë prefektura, dhe kjo do të jetë një entitet i shëndoshë dhe i aftë për të administruar prefekturën dhe për të mbrojtur çdo interes, qoftë edhe fare të vogël, të katundit më të largët. Në këtë pushtet të ri të gjithë do të punojnë, do të jepin kontributin e tyre për interesin e gjithsecilit dhe për interesin kolektiv. të dyja këto në një harmonizim e drejtësi të plotë. duke respektuar gjithsecili të drejtat që ka shoqëria mbi ta dhe shoqëria gjithashtu detyrat që ka karshi çdo individi. Në një pushtet të tillë demokratik ai që dëshiron të rrojë i lumtur, i lirë dhe me dinjitet njerëzor duhet të punojë pa u kursyer dhe me drejtësinë më të madhe.

«Deklarata e Këshillit Antifashist Nacional-Clirimtar të Shqipërisë mbi të drejtat e qytetarëve», që është një monument i madh në historinë e popullit tonë, cakton në mënyrë të qartë e solemne të drejtat e gjithsecilit në shoqerinë e re demokratike. Kurrë në vendin tonë nuk është bërë një deklaratë e tillë dhe kurrë nuk mund të ishte më e përshtatshme dhe më e zbatueshme se sot që po ngremë një shtet me të vërtetë demokratik. Në regjimin tonë të ri sigurohet prona private, dhe ky

është një grusht i fortë për tradhëtarët, që s'lanë shpifje pa bërë për të përçarë popullin tonë dhe Luftën nacional-çlirimtare. Deklarata e Këshillit siguron lirinë e fjalës e të mendimit, lirinë e mbledhjes e të besimit. Regjimet e kaluara ja kishin lidhur gojën popullit me një fashë të shëndoshë, dhe për atë që guxonë të kritikonte ose të ngrinte zërin kundër padrejtësive, ajo fashë shërbente si litar në grykë. Në kundërshtim me metodat e errëta të regjimeve të kaluara, regjimi demokratik i sotëm i lë të lirë njerëzit të flasin ose të kritikojnë, se vetëm kështu do të mund të ecim përpara. Nga kritikat dhe autokritikat, nga diskutimet dhe vërejtjet e shëndosha, do të dalë një punë e përsosur, do të gjejë gjithsecili vendin që meriton, do të dalin në dritë vlerat e paçmueshme që janë në gjirin e popullit tonë dhe do të spastrohen plehrat e mikrobet.

Deklarata e Këshillit i jep gruas të drejta të barabarta me ato të burrit, të drejtën të marrë pjesë në jetën politike e shoqërore të vendit. Kjo e drejtë që i akordohet gruasështë një e drejtë legjitime, të cilën ajo e ka fituar me gjak. Regjimet e kaluara e kishin shtypur gruan, e kishin bërë skllave të burrit dhe të paragjykimeve të vjetra, nuk i kishin dhënë asnjë mundësi zhvillimi dhe edukimi. Një gjendje e tillë e mjuaruar për gruan shqiptare, d.m.th. për gjysmën e populsisë së vendit tonë, që do të ishte një nga faktorët kryesorë të përparimit, duhej të merrte fund. Lufta jonë nacional-çlirimtare e nxori gruan në planin e parë; ajo u zgjua, shkundi pluhurin e shekuje, këputi zinxhi-rët që e lidhnin këmbë e duar dhe u hodh në këtë luftë

pa rezerva, për të dalë në dritë, për të marrë vendin e merituar, për t'i dhënë atdheut dhe popullit ndihmën dhe jetën e saj të çmuar. Gruaja Antifashiste Shqiptare në këtë pushtet demokratik, me forcat e saja të pashterura dhe me ndjenjat e saja të larta, do të bëhet një nga shtyllat e fuqishme të Shqipërisë së re.

Në deklaratën e Këshillit Antifashist theksohet se pushteti demokratik popullor, me anë të ligjeve, u siguron gjithë punonjësve të qytetit dhe të fshatit një jetë të pajtueshme me konceptzionin e ri të së drejtës shoqërore dhe me dinjitetin njerëzor. Regjimet e kaluara despotike dhe fashiste, të ngritura apostafat për të shtypur punëtorët, ishin torturuesit dhe xhelatët më të egër të kësaj pjese më të ndërgjegjshme dhc më të fortë të shoqërisë, që i kushton djersën, gjakun dhe mundimin, të kësaj shtylle të çelniktë të shoqërisë përapartimtare. Punonjësit shqiptarë të qyteteve dhe të katundeve kanë vuajtur me shekuj nën robërinë e rëndë dhe në mjerimin më të madh ekonomik e shpirtëror. Gjaku dhe djersa e tyre kanë shërbyer gjithmonë për të ushqyer xhelatët, të cilët me klikat dhe me organet e tyre të poshtra policore kërkonin t'i futnin punëtorët në radhën e kafshëve. Çdo e drejtë u ishte hequr punëtorëve. Urija dhe vdekja trokiste për ditë në dyert e tyre. Punonjësit shqiptarë të qyteteve dhe të katundeve, që u hodhën të parët në këtë luftë çlirimtare dhe derdhën pa kursim gjakun e tyre, do të jenë përsëri dhe gjithmonë të parët për të ndërtuar Shqipërinë e re, ku do të mbajnë vendin e nderit dhe të drejtat e fituara me gjak. Ata do të dinë më së miri të bashkohen dhe të organizohen rreth pushtetit të ri demokra-

tik dhe të vënë të gjitha forcat e tyre për ta bërë të pathyeshëm këtë pushtet.

Ndërmjet të tjerave, deklarata e Këshillit Antifashist thotë se, për të mbrojtur pushtetin demokratik, do të ndiqen të gjithë ata që merren me veprimitari fashiste ose profashiste dhe do të ndalohet çdo organizatë që do të tentojë të zhvillojë një veprimitari të tillë. Këtë pikë me rëndësi duhet që i gjithë populli shqiptar ta ketë kurdoherë parasysh dhe të vërsulet me tërbim kundër të gjithë atyre që do të tentojnë të përsëritin kasaphanën e tmerrshme, ku u vranë me miliona njerëz.

Vuajtjet e mundimet të mos i harrojmë, fitoret të mos na dehin, por më fort se kurrë i gjithë populli të bashkohet rreth pushtetit, rreth Qeverisë Demokratike, të grumbullohet i tërë në organizatën e vetme të Frontit Nacional-Çlirimtar dhe me parimet e qarta e të drejta që na cakton pushteti, të bindur e me disiplinë të vetëdijshme, të shkojmë përpara në çdo lëmë aktiviteti, të thyejmë çdo rezistencë që mund të na dalë, të dërmojmë çdo armik që do të guxojë të na pengojë në qëllimet tona, në ndërtimin e një Shqipërie të re dhe të përparuar.

Duke forcuar ushtrinë e tij heroike, duke mbrojtur dhe duke konsoliduar pushtetin e tij demokratik, populli shqiptar do të realizojë të gjitha ëndrrat e tija, të gjitha aspiratat e tija ekonomike, sociale e kulturale.

Enver Hoxha

*Botuar për herë të parë në
«Bashkim» numër i posa-
çëm, nëntor 1944*

*Botohet sipas tekstit të
gazetës «Bashkim»*

«LEGALITETI» — ORGANIZATË TRADHËTARE

[Nëntor 1944]

«Legaliteti» ishte organizata tradhëtare që përfaqësonte regjimin e Zogut dhe luftonte për kthimin e këtij në Shqipëri. Vetë emri i kësaj organizate përfaqëson një epokë të tërë mjerimi, vuajtjeje dhe terrori mbi kurriz të popullit tonë; kujtimi i kësaj kohe që të ngjeth mishtë i sjell ndër mend popullit tonë shtypjen e tmerrshme pesëmbdhjetëvjeçare, e cila pregeti invazionin e Shqipërisë prej Italisë fashiste.

Ahmet Zogu, që erdhi në Shqipëri me bajonetat e reaksionit ndërkombëtar, i hodhi themelat mbi gjakun, djersën dhe vuajtjet e një populli të tërë. Për të sunduar mbi popullin dhe për të siguruar fronin e tij dhe klikën e banditëve që kishte rrotull, ai e lidhi Shqipërinë ngushtë, si politikisht ashtu edhe ekonomikisht e ushtarakisht, me Italinë fashiste. Ahmet Zogu dhe njerëzit e tij, agjentë të fashizmit italian, i lanë dorë të lirë këtij të vepronte si të donte në tokën tonë. Këshilltarë, organizatorë, spiunë që të gjithë të SIM-it dhe të OVRA-s fashiste, organizuan në Shqipëri rrjetat e tyre. Bujqësia, blegtoria, ekonomia, financat, ushtria e të gjithë sektorët e tjerë, u bënë gjahu i këmishëve të zeza. Regjimi i korruptionit dhe i ryshfetit filloi të vepronte nga të

katër anët e vendit tonë, duke pasur për objektiv pre-gatitjen e invazionit. Gjithë pasuria e nëntokës shqiptare: Kuçova, Patosi, Rubiku, Pogradeci etj. ju dhanë koncesion italianëve, të cilët menjëherë filluan shfrytëzimin e tyre. Fitimet e nxjerra nga kjo pasuri e mreku-llueshme e tokës shqiptare shkuan të gjitha në favorin e luftës grabitqare që pregetiste fashizmi. Pasuria e po-pullit tonë shkoi në xhepat e banditëve italianë dhe agjentëve të tyre shqiptarë, klikës sunduese të oborrit të Ahmet Zogut. Nga ana tjetër, bujqësia dhe blegtoria arritën në një dekadencë të madhe dhe u vunë në një shfrytëzim të tmerrshëm. Bujqit tanë rëgjimi i Zogut, vegël e italianëve, i shtypi dhe i shfrytëzoi tmerrsisht për t'i pasur këta raja e në një gjendje të vajtueshme, që kësisoj të mos ngrinin krye e ai të mos kishte kokë-çarje. Jo vetëm që rëgjimi i Zogut s'i dha asnje përkrahje këtij sektori kaq të rëndësishëm të vendit, por ai lëshoi mbi ta feudalët gjakpirës për t'i shtypur më mirë dhe për t'i mijelur pa mëshirë. Italianët nga ana e tyre filluan të blenin toka dhe ferma të gjera për t'i pasur këto si një pikënisje, nga do të fillonte kolonizimi i vendit tonë. Në këto toka dhë ferma u vendosën kolonë italiane me mjete moderne, u vendosën ente dhe shoqëri të shtetit italiano, të cilat pak nga pak thithnin të gjitha tokat që gjendeshin rrëth e rrotull koncesioneve të tyre. Spekulatorët dhe latifondistët shqiptarë nga ana e tyre, me njëmijë poshtërsi dhe me terror e me grabitje, të cilat mbroheshin prej ligjeve të regjimit, grumbullonin në zotërimet e tyre toka të konsiderueshme të bujkut shqiptar, i cili i zhveshur, i uritur e në pikën e hallit detyrohej t'i jepte për një kafshitetë bukë. Rëgjimi i Zogut

dhe fashizmi italian, në bashkëpunim të plotë, dërmoinin shtresat prodhuese dhe luftëtare të popullit tonë për të ngritur themelitë e regjimit të tyre plutokrat, fashist dhe barbar. Në ushtrinë e Zogut, ëmbajtur në këmbë për të vetmin qëllim që të mbronte regjimin dhe klikën gjakpirëse, agjentët italianë kishin fjalën e parë. Në shtatmadhorinë e kësaj ushtrie ishin agjentët e gjermanëve dhe të italianëve, ishin Mirdashët, Gjilardët, Kishinerët, Parianët e të tjerë. Kjo ushtri parade përfaqëson korrupsionin, xhahillëkun dhe tradhëtinë. Çdo e fshehtë e kësaj ushtrie ishte në duart e italianëve: planet e mbrojtjes, sekretet e fortifikatave është që gjë tjetër që i përket fshehtësisë ushtarake, ndodheshin në arkivat e Ministrisë së Luftës në Romë. Që andej vinin urdhërat dhe direktivat, që andej vinin planet e preqitjeve të fortifikatave kundër fqinjëve tanë dhe popullit shqiptar, andej vinin urdhërat për preqitjen e terrenit për 7 prillin. Regjimi i Zogut i zbatonte me përpikëri të gjitha këto urdhëra që preqitnin ditët e zeza të vendit tonë. Financat dhe tregëtia jonë ishin krejt nën varësinë e Italisë fashiste. Banka Kombëtare, arma më e fortë ekonomike e preqitjes së invazionit, thithi gjithë floririn dhe pasurinë e popullit tonë, ndihmoi në financimin e spekulatorëve, ndihmoi në ndreqjen e rrugëve dhe të kazermave që do t'i shërbën më vonë ushtrisë italiane për sulmin e saj në Ballkan e në Evropën Juglindore. U hapën rrugë me karakter strategjik, u bënnë plane qytetesh për të strehuar miliona njerëz, të cilët pa dyshim do të vinin nga Italia për të skllavëruar vendin. U krijuan Banka e Napolit, dhe ajo e Punës, me qëllim që të thithnin edhe atë pasuri të pakët që kishte

ngelur si dhe tokat e bujqve që kishin shpëtuar pa u grabitur. Tregëtia jonë varej kryekëput nga ajo e Italisë. Tregu ynë ishte në mëshirën e tregut fashist italian dhe vlefta e mallrave ulej e ngrihej sipas urdhëresave të dala nga ekonomia fashiste e Italisë. Gjithë kyçet e tregëtisë dhe të industrisë sonë ishin në duart e italiannëve, dhe këto ja kishte shitur regjimi i Zogut.

Politikisht regjimi i Zogut vendin tonë e lidhi ngshtë me Italinë fashiste dhe e izoloi me botën e jashtme. Në shkolla, në zyra, po futej fryma e qelbur e fashizmit. Profesorë italianë filluan të vijnë me shumicë dhe të zëvendësonin të gjithë profesorët e vjetër e patriotë, ata profesorë që përpinqeshin të mbanin gjallë frymën e demokracisë. Organizata «Dante Aligieri», qendër spiunazhi dhe korrupzioni, e fshehur nën maskën kulturale, propagandonte dhe preqitiste kuadrot shqiptare fashiste, përpiquej të shkombëtarizonte shkollat tona. Organizimin e djalërisë, regjimi i Zogut u përpoq ta bëjë në modelin e fashizmit. Mësues dhë instruktorë u dërguan në kurse në Itali, për të nxënë si korruptohej rinia, dhe erdhën me i aplikue ato parime te rinia jonë e pastër dhe e shëndoshë.

Me një ritëm të vazhdueshëm dhe me një konshencë të plotë për tradhëtinë që po preqatitnin, Zogu dhe regjimi i tij sollën përfundimet e 7 prillit. Zogu dhe regjimi i tij i terrorit i hodhën zinxhirët popullit shqiptar, pasi e varfëruan, e gjakosën, e torturuan, e internuan dhe e burgosën. Në kurrizin e popullit tonë u mahën Ahmet Zogu dhe këlyshët e tij. Këta politikanë aventurierë ishin modeli i tradhëtarëve, i kompromisaxhinxjve, i atyre që shitnin nderin dhe atdheun

për një lek. Klika e Zogut, që preqatiti invazionin, shtypi çdo tentativë përparimtare, çdo preqatitje që bëhej kundër kërcënimit të jashtëm. Regjimi i Zogut internoi dhe burgosi të gjithë ata punëtorë dhe intelektualë që e shihnin rrrezikun që kërcënonte vendin dhe që organizonin frontin popullor antifashist. Lufta që bëhej prej patriotëve kundër agjentëve të preqatitur prej Xhiovani Xhiros shtypej prej agjentëve të Musa Jukës. Dhe në ditët e zeza të prillit, kur populli ynë i tërë në këmbë, me shpirt në dhëmbë e me zjarr në zemër, kërkonte të vdiste, duke luftuar zaptuesin e atdhëut, kur populli ynë anë e kënd kërkonte armë nga regjimi tradhëtar i Zogut për të luftuar fashizmin, Zogu dhe gjithë hajdutët e tjerë që e rrethonin, duke grumbulluar floririn e grabitur, frytet e tradhëtisë së tyre dhe gjakun e popullit tonë, u arratisën, duke u mbrojtur nga ajo ushtri, të cilën e kishin krijuar jo për të mbrojtur vatanin, por për të mbrojtur kusëritë e tyre.

Një pjesë e banditëve zogistë kaluan kufirin me padronin e tyre që të hanin në arrati paret e vjedhura. Këta njerëz shkuan jo pse kishin frikë nga italianët, miqtë e tyre të ngushtë dhe bashkëpunëtorët në rjepjen e popullit tonë, por frika e popullit dhe mëria që ushqente ky kundër tyre i detyroi të largohen. Pjesa tjetër e plehrave të Zogut qëndroi në vend, e sigurt se s'do ta gjente gjë nga zaptuesi, përkundrazi: ata do të rifillonin aktivitetin e mëparshëm, por këtë herë nën një flamur tjetër, nën një padron tjetër më të fortë se i pari. Për këtë s'kishte asnjë dyshim dhe kështu ngjau. Ish-ministrat e vjetër të Zogut, ish-diplomatë, hajdutë me çizme e njerëz të korruptuar si Fejzi Alizoti me

shokë, përnjëherësh u bënë fashistë të orës së parë. Xhafer Ypi lëshonte lot gjëzimi nga ballkoni i Bashkisë së Tiranës për padronin e ri të tij gjenial, Musolinin. Asambleja e prillit, që i dha kurorën mbretit të Italisë, ishte e përbërë prej njerëzve të Zogut dhe një të tradhëtisë së mëvonshme, krerëve dhe ekspONENTËVE të «Ballit Kombëtar» e të organizatave të tjera tradhëtare. Dhe filloj një tragjedi e madhe për popullin tonë, i cili gjatë kësaj robërie të rëndë duhej të bënte luftën e madhe të historisë së kombit.

Njerëzit e «Legalitetit» të vjetër fillojnë të legalizohen në regjimin e ri. Ata e kanë harruar padronin e vjetër burracak, tani ata i këndojnë hosana Musolinit dhe Hitlerit, se këta janë të fortë, se këta robëruan popujt e Evropës, se këta, ngadhnjyes e me urë në dorë, po sulmojnë Bashkimin Sovjetik, «kuçedrën bolshevike», të cilën ata kujtojnë se do ta gjelltin brenda një muaji. Këta tradhëtarë zënë ofiqe të larta: kush bëhet ministër i «Partisë Fashiste», kush në zanatin e tij të vjetër, që i ka sjellë kaq fitime xhepit të tij dhe kaq mjerime popullit tonë, bëhet ministër i financave, kush kuestor o prefekt, kush gjeneral i ushtrisë, kush bejtexhi i Musolinit e i Konte Çianos. Pseudointelektualë, pseudodemokratë, njerëz që hiqeshin intègre¹ dhe të ligjit, ata që i hidhnin lule regjimit të Zogut, se i mbante në sekretari të përgjithshme të ministrive, i bënë po ato shërbime regjimit të ri, bile zelli i tyre ishte edhe më i madh, ata, me besnikërinë më të madhe ndaj fashizmit, firmosnin internimet dhe burgosjet e djemve

¹ Intègre (frëngj.) — i panjollë.

tanë luftëtarë. Njerëzit, pra, e regjimit të Zogut që qëndruan në Shqipëri ju përveshën punës në këtë mënyrë, pa kurrfarë rrahje zemre ose ndërgjegjeje. Zaten në trupin e këtyre ujqërve s'mund të ketë zemër dhe as ndërgjegje.

Ç'bënë banditët e tjerë të regjimit të «Legalitetit» që ikën tok me Zogun në arrati? Ata vazhduan punën e tyre antikombëtare. Zogu, tok me Gjeraldinën, në pallate luksoze të Londrës, i rrethuar me plehrat e tij dhe disa plehra të reaksionit të jashtëm, shkrinte në qejfe e në kërcime gjakun e popullit tonë. Kur populli ynë po lëngonte dhe me shpirt në dhëmbë rezistonte nën peshën e madhe të fashizmit, «mbreti gjenial» i Abdurrahman Krosit¹ urdhëronte shërbëtorët e tij, që i kishte të shpërndarë në Evropë, të ndalonin e të luftonin qdo shqiptar të emigruar që i dhimbej atdheu dhe që përpinqej nga jashtë të ndihmonte me sa mundë rezistencën e popullit tonë. Ahmet Zogu dhe agjentët e tij, në kohën kur Shqipëria lëngonte dhe kur lypsej bashkimi i gjithë shqiptarëve jashtë, futnin grindje në mes të tyre, dhe këta shqiptarë të mjerë, në vend që të bashkonin energjitet e tyre, ziheshin dhe luftonin për mustaqet e Zogut. Këtë bënte Zogu jashtë në kohërat më të rënda dhe të vështira që kalonte populli ynë. Këlyshët e tij jashtë u bënë spiunët e fashizmit dhe të reaksionit të jashtëm. Një nga këta ishte edhe Abaz Kupi, alias Bazi i Canës.

Të shkuarën e turpshme të këtij xhandari të

¹ Bajraktar, njeri intrigant dhe me influencë në oborrin e Zogut.

Ahmet Zogut e di gjithë populli shqiptar, e njohin për së afërmi popullsia e mjerë e rretheve të Krujës, të Ishmit, të Mamurasit, të Durrësit, të Kavajës e të Shijakut. Vegël e verbër e Zogut, ky analafabet e kriminel u ngjit në gradë nga padroni i tij, se ishtë i bindur ndaj tij dhe se vepronët në vijën e krimtit, të grabitjes, të shtypjes, që ishte parimi i atij regjimi. Bazi i Canës u pasurua në kurrizin e katundarëve të rretheve të Krujës, ai vrau e gjakosi fshatarët e mjerë, ai shfarosi gjithë atë gjind që s'u bindej urdhërave të poshtra të tija dhe të padronit. Bazi i Canës dhe xhelatët e tij që kishte pas ishin bërë gogol i popullsisë së atij rrathi, ai përfaqësonte mesjetën me të gjitha tmerret, krimet, torturat dhe shtypjet. Ai ishte shërbëtori besnik e gjakatar i feudalit barbar të Matit.

Në rrethin e Zogut ai ishte i plotfuqishëm, se ishte njeriu i besës i satrapit, ekzekutuesi i veprave «të larta» të mbretit.

Në ditët e zeza të 7 prillit Ahmet Zogu e zgjodhi si njeriun më të besuar për t'i mbrojtur tërheqjen. Bazi i Canës shkoi në Durrës për t'i fituar ndonjë ditë Ahmet Zogut që po ngutej të bënte teshat gati, se deri në kohën e fundit Zogu kishte shpresë të binte në ujdi me Musolinin. Dhe bijtë e popullit të mjerë, që u buçiste zemra për të luftuar, e goditën ushtrinë fashiste. Por qëllimet e luftëtarëve që luftuan në Durrës s'ishin të njëjta me ato të komandantit të Zogut, Abaz Kupit. Djemtë e popullit luftuan për të shpëtuar atdheun, kurse Bazi i Canës për të mbrojtur tërheqjen e Ahmet Beut.

Në Jugosllavi, ku u struk, Abaz Kupi priste urdhërat e padronit. Atje ai ishte në shërbim direkt të spiu-

nazhit ndërkombe tar dhe agjent i reaksionit të jash-tëm, të cilët e shpërblenin me shuma të mëdha floriri.

Kur rezistenca e popullit tonë kishte filluar dhe demonstratat e para të popullit kishin shpërthyer, Abaz Kupi mori urdhër nga Zogu të kthehej në Shqipëri për të peshkuar në ujëra të trubullta. Me xhepet plot stërlina, Bazi i Canës hyri nga malësitë dhe u vendos në fshatrat e Krujës, i struktur si një gjahtar që pret gjahun t'i bjerë në shteg për ta shfrytëzuar. Shefqet Vërlaci, kryeministri i fashizmit, s'mungoi t'i dërgojë agjentin e tij Tasim Bishqemin me propozime konkrete. Bazi i Canës, dhëlpër dinake, s'binte kollaj në kurth. Ai e njihte mirë Shefqet Vërlacin, konkurrentin dhe armikun e padronit të tij. S'është çudi që Bazi vetë të ishte ai që dikur, në kohën e regjimit të Zogut, të kishte shtë-në mbi Beun e Elbasanit për ta vrarë. Dhe Beu s'e harronte atentatin që i kishte kurdisur Zogu, por dhe Bazi i Canës s'binte lehtë në pusi. Megjithkëtë Bazi i Canës botërisht ka pohuar me gojën e tij se me Tasim Bishqemin, agjentin e Vërlacit e të Xhiovani Xhiros. ranë dakord që «as mos t'i ngiste italianët dhe as mos ta ngitnin». Në kohën e Shefqet Vërlacit fashizmi italian kishte nevojë të fitonte kohë, të konsolidonte pozitat, të hidhte kyçet e vendit në dorë, të organizonte rrjetat. Demonstratat kishin filluar dhe Itali s'i leverdiste të hapte një plagë, duke dërguar një skuadër ndëshkuese kundër Abaz Kupit, prandaj e la për një moment në heshtje. Me ardhjen e Mustafa Merlikës në fuqi, punët ndryshuan edhe për Italinë, edhe për Bazin. Çizmet e gjakosura të Hitlerit po kërcitnin në akullin e stepave të Rusisë. Italia fashiste kishte sjellë në fuqi xhelatin

më të egër të popullit tonë, agjentin e saj të vjetër Mustafa Merlikën. Arroganca e Italisë fashiste dhe e Mustafa Merlikës s'kishte kufi. Bazi i Canës duhej të mbante qëndrim: ose të bëhej spiun direkt i Italisë fashiste nën urdhërat e Mustafës, ose armik. Në pjekjen që bënë në Krujë, të dy xhelatët e Krujës s'ranë në ujdi. Por në bisedimet që u zhvilluan në mes të tyre në rendin e ditës s'ishte çështja e shpëtimit të atdheut, por ishte interes i tyre personal, ishte xhepi i tyre, ishte mbrojtja e klikës së tyre. Të dy protagonistët e tradhëtisë e njihnin shoqi-shoqin. Nga njëra anë ishte Zogu që përpiquej të kthehej, duke pregetitur terrenin dhe nga ana tjetër ishte Mustafa Kruja që kishte shitur shpirtin e tij te i huaji për t'ja mbërritur ditës së ëndërruar. Sikundër që Zogu deri në ditën e fundit tentoi të qëndronte në fuqi, ashtu edhe Merlika s'e lëshonte aq lehtë fronin që e kish fituar me tradhëti. Mustafa Kruja s'ishte Shefqet Vërlaci; ai s'duronte që Bazi i Canës të vepronte rehat nën bajonetat e tija për t'i pregetitur terrenin Ahmet Zogut. Merlika kishte hesapet e tija të ndryshme nga të atij që jetonte në pallatet e Londrës. Dhe Merlika e goditi Bazin e Canës, vrah e gjakosi dhe e detyroi të shpërngulej nga bazat ku ai priste gjahun. I duhej Bazit të Canës të ndërronte planin e punës, të ndërronte metodën për një kohë. Abaz Kupi dhe njerëzit e tij e shfrytëzuan goditjen e Mustafës për ta nxjerrë atë si një kundërshtar të italianëve dhe të okupacionit. Ata zunë të pëshpërisin andej-këtej se Bazi i Canës ishte i vendosur të luftonte fashizmin. Lëvizja nacional-çlirimtare, e përbërë nga ajka e popullit shqiptar, e përbërë nga patriotët e papërkulur dhe armiq

për vdekje të okupatorit, s'mungoi ta ftonte Abaz Kupin në Konferencën e Pezës, ku u hodhën themelat e para e të shëndosha të frontit tonë ngadhnjimtar. Bazi i Canës erdhi në këtë mbledhje, por ai kujtonte se ajo mbledhje do të ishte si ato mbledhje bairaktarësh dallaveraxhinj që bëjnë itifake për të rjepur popullin, o për të bënë llogje e muhabete. Atij s'ja merrte kurrë mendja se atje hidheshin bazat e shëndosha të një lëvizjeje të madhe të një populli të tërë, bazat e një pushteti demokratik, përparimtar, të një ushtrie të fortë, që do t'i bënte ballë çdo stuhie e çdo furtune dhe do të shporrte nga vatrat armiqtë më të egër që ka parë deri sot njerëzimi. Abaz Kupi kujtoi se vendimet që u muraren në Pezë do të mbeteshin të vdekura në kartë dhe se ata djem të rinj që ishin mbledhur atje, ata komunistë dhe patriotë të vendosur, që i lidhët gjaku dhe vuajtja e një populli të tërë, s'do të ishin kurrë në gjendje të bënин atë që shohim dhe gëzojmë sot. Qëllimet e fshehta të Abaz Kupit ishin të ndryshme nga ato të patriotëve të Pezës. Abaz Kupi s'ishte as burrë i fjalës, as burrë i pushkës, ai ishte dhe mbeti njeriu i errët i tradhëtisë së përjetshme. Vendimet historike të Pezës ai i pranoi, por perspektivat e këtij xhahili s'ishin të njëlllojta me ato të Konferencës së Pezës. Vendimet historike të Pezës ai s'i zbatoi kurrë. Ai s'hodhi kurrë një pushkë kundër armikut, ai s'preu asnjë shtyllë telegrafi, ai vetëm përpiquej që heroizmat dhe gjakun e trimave që binin ndër qytete e ndër fshatra t'i përvetësonte. Ai kujtoi se atë që s'e bëri dot nën bajonetat e Italisë fashiste dhe të Merlikës do ta bënte nën armët e lëvizjes nacional-çlirimtare. Kur të tjerët luftonin nën

një terror të madh kundër një force kolosale, Abaz Kupi strukej në fshatra të Krujës dhe të Matit, lidhte dhe zgjidhje aleancat e vjetra të Zogut me myflizët e tij, duke mos përfillur as lëvizjen, as pushtetin e këshilla-ve që po ngriheshin e që po bëheshin organet e vërteta të luftës; aktiviteti i Abaz Kupit në këtë drejtim ishte zero. Me daljen e «Ballit Kombëtar» në skenë lindën dhe shpresat e Abaz Kupit për një fitore më të plotë të tij. Ai ndodhej në mes të dy rrugëve: nga njëra anë ishte një lëvizje e madhe që po ngrihej me njerëz të vendosur e trima, se ishin pjella e popullit që ai dhe regjimi i Zogut e kishin gjakosur me kamxhik e me plumb, ishin demokratët e vërtetë e të papërkulur, ishin kundërshtarët e ashpër të kompromisit e të fashizmit, ishte një popull i ri që qe çuar në këmbë për të fituar një jetë të re, nga ana tjetër ishte bota e vjetër, bota pseudodemokrate, ishin kompromisi, tradhëtia, ishin njerëzit e hurit dhe të litarit, ishin ata që ndërronin këmishë dhe flamur, ishin ata që shitnin nderin dhe atdheun për një lek, ishte bota e korruptionit, e reaksionit, që mbronte me mish e me shpirt kohën e vjetër, interesat shekullore të feudalizmit dhe të gjakpi-rèsve, ishin ata që me çdo kusht përpinqeshin ta mbanin popullin në errësirë për ta tërhequr nga hunda, për ta bërë rajá, për ta mijelur më mirë, ishte gjithë bota e Abaz Kupit. Abaz Kupi përpara këtyre dy rrugëve s'kishte asnjë dyshim që do të zgjidhje atë që i përshtatej shpirtit dhe profesionit të tij, do të zgjidhje rrugën e tradhëtisë, rrugën e reaksionit për të stabilizuar edhe një herë pushtetin e padronit të tij, nën urdhërat e të cilët ai vepron. Por Abaz Kupi donte të sigurohej se ç'mendo-

nin njerëzit e «Ballit», se në këtë organizatë të tradhëtisë kishte turli njerëzish, kishte nga ata që dikur ishin kundërshtarë të Zogut, se ky u kish rrëmbyer koltruqet, kishte nga ata që hiqeshin si kundërshtarë, por kundërshtarë në muhabete të kafehaneve, kishte nga ata që bile ishin dënuar me vdekje nga Zogu, kishte njerëz të lidhur me fashizmin, me Mustafa Krujën, me Shefqet Vërlacin, kishte kriminelë të regjur e ordinerë, dhe në këtë organizatë mbretëronte një anarki e madhe.

Bazi i Canës mendoi të luante rolin e arbitrit, të luante nga të dy anët derisa të vinte momenti oportun për të thënë fjalën e tij të fundit. Me traktin e tij të hedhur në datën 19.9.1943, Abaz Kupi në mes të tjerave thotë: «Ndëgjohen andej-këndej sulmime reciproke nér mes partinash, kjo gja ka qenë dhe asht kundër dëshirës semë». Bazi i Canës fillon të shohë më qartë rrugën e tij, kur dobësimi i Italisë ishte iminent. Deri atëherë Bazi i Canës për sy e faqe qëndronte në rreshtat e lëvizjes nacional-çlirimtare, qëndronte në Shtabin e Përgjithshëm, qëndronte në Kryesinë e Këshillit Nacional-Çlirimtar. Por, me gjithë përpjekjet e frontit për me e bindë këtë të hynte në luftë kundër okupatorit, ky s'luante asnje milimetër nga qëndrimi i tij i mëparshëm. Miku i tij i ngushtë dhe njëkohësisht i padronit të tij Zogut, Mehdi Frashëri, që ende s'kishte dalë në skenë, po i preqiste terrenin në «Ballin Kombëtar». Politikanët aventurierë të «Ballit», si Ali Këlcyra, Lumo Skëndo, Kolë Tromara, Bahri Omari dhe shokët e tyre i harruan armiqsitë që mund të ekzistonin në mes të tyre dhe Zogut. Ata ishin gati të bashkëpunonin me Abaz Kupin deri në fund kundër lëvizjes nacional-çli-

rimtare. Qëllimi i tyre ishte të shtypnin lëvizjen dhe të merrnin fuqinë me ndihmën e bajonetave gjermane. Pastaj në mes të tyre i rregullonin hesapet mbi kurrizin e viktimës së tyre të përhershme — Shqipërisë.

Mukja ishte hapi i parë që bëri Bazi i Canës për shkëputjen e lidhjeve me lëvizjen nacional-çlirimtare. Ky aventurier, që s'kishte hedhur asnjë pushkë kundër armikut, ky që kishte përfituar nga lëvizja e popullit tonë, duke u dëgjuar emri i tij, ishte protagonisti i bashkimit fals me baza të kalbura, ishte mbrojtësi i bashkimit të të gjithëve pa përjashtuar plehrat, tradhëtarët, spiunët e «Ballit Kombëtar». Kapitullimi i Italisë e dehu më tepër dhe ai ra po në atë grackë që ranë «politikanët e mëdhenj» të «Ballit Kombëtar»: ata kujtuan se ishim në prakun e çlirimt. Në Mukje Bazi i Canës bëri pjekjet zyrtare me krerët e tjerë të tradhëtisë, si Lumo Skëndo, Ali Këlcye ra dhe Hasan Dostët. Ai bëri kontaktet që do ta lidhnin ngushtë me gjithë reaksionin shqiptar dhe mbasandaj me gjermanët. Në Konferencën e Labinotit¹, ku ai u thirr të merrte pjesë dhe të shpjegonte qëndrimin e tij karshi luftës dhe lëvizjes, ai s'erdhì, por dërgoi një letër, ku thuhet tckstualisht: «Unë jam dakord me të gjitha vendimet që do të merren në atë konferencë; disa punëra më ndalojnë të vi». C'ishin këto punëra kaq me rëndësi, që e ndalonin bajraktarin dallaveraxhi të vinte në një mbledhje kaq me rëndësi të popullit tonë? Ishin lidhjet dhe marrëveshjet e vëçanta në hesap të lëvizjes së «Legalitetit», që ai po pre-gatiste jashtë kontrollit dhe pëlgimit të lëvizjes nacional-

¹ Konferenca e dytë Nacional-Çlirimtare, shtator 1943.

-çlirimtare, për zbatimin e direktivave dhe principeve të së cilës ky pseudonacionalist ishte betuar përpara gjithë Këshillit Nacional-Çlirimtar mbi nderin e flamurit të Shqipërisë.

Bazi i Canës shëtit malësitë, shkon në Dibër, shkon në Lurë, shkon në Mat, atje piqet me njerëz të shitur kokë e këmbë te armiku, ai shpérndan andej-këtej stërlinat që kishte sjellë nga Jugosllavia, ai përpinqet t'i lidhë miqësitë në mënyrën e regjimit të vjetër, ai blen bajraktarët dallaveraxhinj me pare dhe me pretime ofiqesh, sikundër që vepronte padroni i tij dikur. Kur ushtria italiane u dorëzua dhe kolonat gjermane filluan të vinë në Shqipëri, Abaz Kupi dhe larot e tij u vërsulën mbi gjahun e ngordhur për ta zhveshur e plaçkitur dhe për të armatosur mercenarët e tyre. Bazi i Canës ende s'i kishte këputur marrëdhënjet me lëvizjen nacional-çlirimtare dhe atje ku i leverdiste hiqej si njeri i lëvizjes dhe kërkonte të jepet urdhëra në emër të Shtabit të Përgjithshëm. Këtë gjë e bëri në Dibër për të ndaluar luftën tonë kundër italianëve dhe bashkëpunëtorëve të tyre, tradhëtarëve Fiqri Dine, Ali Maliqi me shokë. Në luftën e Krujës Bazi i Canës u ftua nga Shtabi i Përgjithshëm të merrte pjesë në çlirimin e Krujës. Ai refuzci, por kur pa se forcat nacional-çlirimtare nën komandën e Haxhi Lleshit dhe Beqir Ballukut marshuan mbi Krujë, ai, për të mos mbetur pas, u shkoi mbrapa pa zbrazur një dysek.

Në shtatorin e 1943-s «Balli Kombëtar» lëshon një trakt të bujshëm «për vendimet me rëndësi që u muarën në malet e Shqipërisë së Lirë» nga bajraktarët dallaveraxhinj. Ky trakt, përveç firmës së «Ballit», kishte dhe

firmsat e shumë tradhëtarëve të tjerë, në mes të të cilëve figuronin Abaz Kupi, Fiqri Dine, Hysni Dema, Myftar Kaloshi, Ali Maliqi, Uke Cami, Bilal Kola, Murat Basha. Në këtë trakt thuhet në mes të tjerave: «Ky manifestim i burrave të maleve shfaqet në Shqipërinë tonë të fortë sa herë që në qellin e saj ngrihen retë e zeza të rrezikut». «Balli Kombëtar» dha kushtrimin e rrezikut dhe «burrat e maleve», «ata burra që kanë mbetur të paprekur nga propaganda e huaj, u mblodhën në një kuvend për të dhënë Besën Shqiptare». Ç'ironi, q'poshtërsi karshi popullit tonë! Këta njerëz, që «s'u prekën kurrë nga propaganda e armikut», lidhën besën të shpëtojnë Shqipërinë nga rreziku! Cili ishte ky rrezik? Lëvizja nacional-çlirimtare, lëvizja e popullit tonë. Koalicioni i Abaz Kupit me tradhëtarët e «Ballit Kombëtar» dhe me «krerët» e Dibrës filloj të bëhet i dukshëm. Abaz Kupi mendoi se erdhi koha të luajë hapët lodrën e tij. Ai formoi «Legalitetin», të cilin e kualifikoi në trakin-program që hodhi si vazhdimësi të regjimit të Zogut të dëbuar nga Shqipëria prej fashizmit italian. Bazi i Canës, kryetar i lëvizjes së «Legalitetit», s'mungon të fillojë të propagandojë hapët me fletushka e me gazetën «Atdheu» mbretin «gjenial», «veprën e tij të madhnueshme, kujdesin që ka pasur ai për djalerinë shqiptare, kujdesin e princeshave për popullin shqiptar! Agjentët e huaj, me të cilët ka pasë lidhje me kohë në Jugosllavi, i sjellin Abaz Kupit fotografitë e naltmadhnisë e të princeshave kur bëjnë shëtitjen e mëngjezit në «Haid Park». Këto shtypen në gazeten «Atdheu», që populli ynë të «shmallet» për këtë familje mbretërore, që i bëri aq «të mira» Shqipërisë! Ga-

zeta «Atdheu» del dhe shtypet legalisht në Tiranë, ku sundon terrori gjerman. Në gazeten «Atdheu» s'ka as edhe një fjalë të vogël kundër okupatorit, kundër gjermanit shkelës e barbar. Për Bazin e Canës Shqipëria është indipendente, e lirë, e okupuar përkohësisht për nevojat strategjike të Gjermanisë, e cila do të iki shpejt. Kjo është teza e mikut të tij të ngushtë, kuslingut Mehdi Frashëri. Mehdi Frashëri dhe Bazi i Canës janë dakord. Mehdi Frashëri është nuni i Bazit të Canës pranë gjeneralit Shmoll dhe pranë fon Shaigerit¹. «Balli Kombëtar» tani është vegla qorre e Gestapos. Krejtë c «Ballit» janë nën urdhërat direkte të saj, fjalë e Mehdi Frashërit tani atje është ligj. «Balli» s'ka më privilegje të manevrojë në politikë, por të ekzekutojë krimet. Karta e Zogut është në rendin e ditës, dhe ky ndër i bie Abaz Kupit. Në mbledhjen që u bë në Shëngjergj në mes disa udhëheqësve të lëvizjes nacional-çlirimtare dhe Abaz Kupit², që kërkonte të luante rolin e arbitrit të madh, me fjalë bombastike, Bazi i Canës tentoi të luante lodrën e madhe të «diplomacisë së hollë». Ai kërkonte të fliste dhe të mirrej vesh me një farë «partie nacional-çlirimtare», nën hijen e regjimit të Zogut, nën hijen e naltmadhnisë, regjim dhe mbret legal që kishte të drejta të plota të sundonte mbi këtë vend. Të drejtat e Zogut për Bazin e Canës ishin të përjetshme. Por regjimi i Zogut dhe Zogu vetë, sipas tezës së Bazit të Canës, kishin bërë transforma-

¹ Fon Shaiger, funksionar i Ministrisë së Jashtme të Gjermanisë hitleriane.

² Takimi me Abaz Kupin në Shëngjergj u bë më 7 dhjetor 1943.

cione. Mbreti «gjenial» tani ishte një «demokrat i bindur» dhe me një «shpirtmadhësi» që s'ka shoqe, ai lejonte të kishte parti të ndryshme demokrate dhe denjonte që e quajtura «parti nacional-çlirimtare» të mund të ekzistonte brenda në lëvizjen e «Legalitetit»! Kjo ishte teza e «famshme» e Abaz Kupit që ja kishin mësuar Shaigeri, Mehdi Frashëri dhe miqtë e tij të reaksionit ndërkombetar. Por ana tjetër s'flinte. Lëvizja nacional-çlirimtare ja vuri qartë problemin këtij renegati: shpëtimi i atdheut bëhej vetëm me luftë të paprerrë kundër okupatorit gjerman. Kjo luftë bëhej duke qëndruar brenda në front, dhe çështjen e formës së regjimit të ardhshëm ta vendoste vetë populli, mbasi të çlirohet atdheu, por edhe në rast se ai dilte jashtë frontit, lëvizja e këshilloi që të largohej nga rruga e poshtër që kishte zënë. Bazi i Canës u nxuar jashtë dhe ai vazhdoi rrugën e tradhëtisë që kishte nisur.

Gjermanët u vërsulën mbi ne tok me ballistët dhe me njerëzit e Bazit të Canës në ofensivën e madhe të dimrit, ku forcat tona me një heroizëm të madh në momente më kritike, zhveshur dhe zbathur dhe me bark të zbratët, rezistuan deri në fund dhe dualën fituese. Ishte koha kur Mehdi Frashëri dhe Abaz Kupi kishin rënë dakord që të dy, njëri përpëra dhe tjetri më vonë, nën bajonetat gjermane të shtypnin lëvizjen tonë dhe të ngrinin në këmbë forcat që do të shërbenin për sjelljen e Zogut dhe të regjimit të tij të urryer. Propaganda për Zogun, për institucionet e tija, po bëhej hapët. Rexhep Mitrovica, gjoja kundërshtar i Zogut për 15 vjet jashtë, merrte për model organizimin e Zogut, regjimin e Zogut, merrte për model terrorin e Zogut

dhe e ekzaltonte me fjalë pompoze. Xhandarmëria, e organizuar si në kohën e Zogut, ishte në urdhërin e ditës. Gushëkuqët e Zogut ishin në tablon e nderit. Bazi i Canës ishte furnizuesi kryesor i këtij materiali njerëzish. Deri salutimet në mënyrën zogiste u vunë në zbatim. Bazi i Canës me mercenarët e tij dhe me xhandaarët e regjimit patrullonin Matin dhe ndiqnin brigadat tonë: të dytën e të tretën, në malet me borë. Ai sulmonte batalionin tonë të Dajtit, batalionin tonë të Ishmit. Automobila plot me ushqime dhe me veshmabathje që i vinin nga gjermanët dhe Mehdi Frashëri, shkarkonin në Burrel dhe ndaheshin ndër mercenarë. Fshatrat e Shijakut, të Ishmit, të Krujës ishin nën një terror të zi. Bazi i Canës ishte në kulmin e forcës. Ai kujtonte se lëvizja jonë s'do të dilte dot e gjallë nga dimri dhe nga gjermanët. Pjekjet e Bazit të Canës dhe të gjermanëve po bëheshin të dendura. Gjenerali Shmoll dhe Xhafer Deva u poqën me Bazin në fshatrat e Krujës dhe lidhën paktin e mossulmimit me njëri-tjetrin dhe të luftës së pamëshirshme kundër forcave tona. Një demagogji e madhe u përdor prej armikut kundër lëvizjes sonë dhe në favor të Bazit të Canës. Njerëzve tanë, që kapeshin rob, e shpëtonin nga plumbi, gjermanët u thoshin se po të dëshironin të shkonin me Abaz Kupin, mund t'i lironin. Gjermanët, «Balli», «Legaliteti», të bashkuar, në dimrin e madh kujtuan se e shfarosën ushtrinë tonë. Bazi i Canës përdori çdo dredhi për të gënjer pcullin. Trakte false ose copa gazetash të huaja të paguara nga Zogu po qarkullonin në-për qytete dhe thoshin se Zogu kishte favorin e Ingilterës dhe të aleatëve, se Zogu ishte takuar me kryemi-

nistrin Çërçill dhe ky i kishte premtuar se do ta ndihmonte në kthimin e tij në Shqipëri dhe në fitimin e të drejtave të tija. Këto u përgënjeshtruan prej traktit që lëshoi nga Gjirokastra me dorë të tij majori anglez Tillman. Nga ana tjetër, qëndrimin e misioneve ushtarake angleze në çetën e tij Bazi i Canës e përdorte për të forcuar dhe ca më shumë iluzionin në popull, duke i lënë të kuptojë se Inglitera ishte me të dhe e aprovonte për gjithshka ai bënte. Aeroplanë anglezë e furnizonin me material këtë bajraktar tradhëtar, që s'kishte kurrë ndër mend të luftonte gjermanët, por që kishte qëllim të tij të vetëm të shuante lëvizjen nacional-çlirimtare, alcaten e papërkulur të të tri fuqive të mëdha: Ingliterës, Bashkimit Sovjetik dhe Amerikës. Mirëpo ofensiva mbaroi dhe erdhi vera, çeli gjethi, dhe Ushtria Nacional-Çlirimtare doli më e fortë se kurrë. Gjermanët e shihnin se puna s'u shkoi mbarë, bashkë me ta edhe tradhëtarët ishin të shqetësuar. Atëherë filloi pregatitja me kujdesin më të madh e ofensivës së verës. Në qeveri kanë ardhur njerëz të rinj, njerëz të «Ballit Kombëtar», tradhëtarët Kolë Tromara, Bahri Omari dhe Koço Muka. Këta pseudopatriotë, njerëz që bënë çmos për të organizuar bandat terroriste të «Ballit» nëpër male, tani luanin kartën e tyre të fundit. Organizimi i ofensivës ishte i shumanshëm, kombëtar dhe ndërkombëtar. Nga njëra anë, qeveria kuislinge, «Balli Kombëtar» dhe «Legaliteti» po pregatitnin forcat për sulm, duke grumbulluar gjithë mercenarët dhe, nga ana tjetër, organizonin që të kishin gati gjithë aparatin qeveritar dhe policor që do ta vendosnin në tërë Shqipërinë, mbasi të na kishin shfarosur ne. Gjermania

e shihte se i afrohej fundi në Ballkan. Ajo duhej të mbronte dhe të siguronte ritiratën dhe njëkohësisht të linte pas organizimin e saj, i cili do t'i shërbente edhe për hakmarrjen e nesërme. Tri divizione gjermane mbërritën në Shqipëri për këtë ofensivë, tri divizione nga më të egrat, të regjura në barbarizma dhe në plaçkitje. Nga ana tjetër, zotérinjtë kuisingë, «Balli Kombëtar» dhe «Legaliteti» po organizonin koalicionin interballkanik të reaksionit nën bajonetat gjermane. Delegat i «Legalitetit» për marrëveshjen me Ralin dhe me Zervën ishte caktuar banditi i vjetër Koço Kotta¹. Në rrjedhimin e ngjarjeve shohim qartë qëllimin e fashizmit dhe të reaksionit ndërkombëtar: bashkimin e klikeve reaksionare për të shtypur lëvizjet e popujve. Në këtë akt tradhëtie, që e provon dokumenti i famshëm i Mithat Frashërit, «Balli Kombëtar», «Legaliteti», kuisingët dhe shovinistët kosovarë vinin në dispozicion të ushtrisë reaksionare greke shërbimet e tyre dhe ishin gati të luftoton lëvizjet nacional-çlirimtare në Ballkan nën flamurin e ushtrisë greke. Ky është fillimi i bashkëpunimit të «Legalitetit» me reaksionin ndërkombëtar. Zogu këtë herë i ka prerë shpresat nga miqtë e tij serbomëdhenj dhe e ka vënë shpresën në reaksionarët grekë. Dhe delegat i tij për këtë punë është «i mirënlohuri» Koço Kotta. Dhjetë ditë pas nënshkrimit nga Mithat Frashëri të këtij dokumenti me kaq rëndësi kryetari i «Ballit Kombëtar», Lumo Skëndo, u lëshon një qarkore me numër 325 datë 20.5.1944 gjithë komiteteve krajinore të «Ballit» me këtë përbajtje:

¹ Kryeministër në qeverinë reaksionare të Ahmet Zogut.

«Ju lajmërojmë se nderimi i «Ballit Kombëtar» është ay që ka pasë Shqipëria para 7 prillit 1939, domethënë tue vumë në zemër dorën e djathtë të shtrime horizontalisht».

Kjo qarkore provon se «Balli Kombëtar», vegël e verbër e Gestapos, kishte pranue programin e Mehdiut dhe të Bazit të Canës. I gjithë reaksiuni punonte nën flamurin e Zogut. Bashkëpunimi i hapët i «Legalitetit» dhe i gjermanëve doli sheshit gjatë ofensivës së verës. Kur Divizioni ynë I kaloi në Shqipërinë e Mesme e të Veriut, Bazi i Canës, me shtatmadhorinë e tij me në krye Murat Bashën, filluan luftën e hapët me forcata tona. Të tmerruar nga kundërofensiva jonë, gjermanët dhe kuislingët filluan me ngutësinë më të madhe mobilizimin e forcave të tyre. Nënprefekti i Matit, Ismail Jakupi, me shkresën e tij Nr. 25-8, Rezervat, datë 29.7.1944 i drejtohet Ministrisë së Brendshme (Zyrës politike) si vijon: «Mësime fuqia partizane ka kalue në rajonin e Peshkopisë, ku thuhet se atje po zhvillohen luftime të përgjakshme për të mundur me pre hovin e një mësymjes së dytë, këtu kemi fillue me ba një mobilizim tue rekrutue të gjithë personat që ndodhen ma tepër se një në shpie. Kjo fuqi për tash do të jetë nën komandën e parisë së vendit me kryetar Z. Abaz Kupin». Abaz Kupi është nën soldën e qeverisë kuislunge. Në shkresën Nr. extra, prot. Rezer. datë 17 korrik 1944 zëvendëskomandanti i përgjithshëm i xhandarmërisë, kolonel Tasim Bishqemi, i përgjegjet Jakup Kurtit¹: «U vu në dijeni komanda gjermane, e cila urdhnoi

¹ Komandant i xhandarmërisë kuislinge në nënprefekturën e Matit.

komandën gjermane që gjindet në Perlat për të pasë ndërlidhje me to dhe me ju dhanë municion si juve edhe kapiten Ali Gjocit, që ka zbritë andej afër në Gjoçaj ose në tjetër vend e që telegrafonte nga Shënpali i Mirditës për municion. Abaz Kupi si nga ana e Qafës së Shtamës dhe në Ketë e Gur të Bardhë ka lëshue kushtrimin e asht tue marshue nga prapa në drejtëm të Matit. Bani ç'asht e mundun në marrëveshje të plotë me gjermanët për çdo nevojë dhe me shokët e tjerë që janë rrjeshtue në vijën tuej».

Lidhjet e Abaz Kupit me gjermanët, me qeverinë kuislinge, ishin të qarta, sektorët ishin të ndarë, Abaz Kupi, nën urdhërat e gjermanëve dhe të Mehdi Frashërit, vepronte në koncert me ta për të shuar lëvizjen nacional-çlirimtare shqiptare, lëvizjen e popullit tonë. Këtë bashkëpunim të «Legalitetit» me gjermanët e vërteton dhe dokumenti i mëposhtëm, i kapur prej forcave tona marinës gjermane me qendër në Durrës. Zëvendësministri i Punëve të Brendshme, Fiqri Dine, me shkresën e tij Nr. 1782 datë 28 korrik 1944 lajmëron zyrën III të Komandës së Përgjithshme të Xhandarmërisë: «Në lidhje me shkresën Nr. 1104 — 215/I datë 28.7.944, qu asht drejtue nga Komanda e Qarkut të Tiranës rreth datës 28—29 të këtij mueji që ushtria gjermane ka me ba manovra rreth Tiranës, lutemi të lajmërohen menjëherë fuqitë e Abaz Kupit»¹.

Botohet për herë të parë, si pas originalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

¹ Artikulli është i papërfunduar.

**URDHËR DITE DREJTUAR USHTRISË NACIONAL-
-ÇLIRIMTARE ME RASTIN E ÇLIRIMIT TË
TIRANËS**

18 nëntor 1944

VDEKJE FASHIZMIT

LIRI POPULLIT

URDHËR DITE USHTRISË N.-ÇI.

**PARTIZANË E PARTIZANE, KOMANDANTE
E KOMISARË!**

Kur aleatët tanë të mëdhenj: Bashkimi Sovjetik, Anglia dhe Shtetet e Bashkuara po shtërngojnë darën e hekurt mbi Gjermaninë hitleriane, kur ushtria jugosllave dhe ushtritë e tjera nacional-çlirimtare të popujve të shtypur po luftojnë nga të katër anët, dhe po dërmojnë e asgjësojnë divizione të tëra hitleriane, ushtria jonë heroike po shkruan faqe të lavdishme të luftës së saj të papërkultur dhe ngadhnjimtare.

Gati pesë muaj me radhë ushtria jonë është në ofensivë të parreshtur në të gjitha anët e Shqipërisë. Me mijëra gjermanë janë vrarë, me qindra robër janë në duart tonë, automjete të panumërtë i janë shkatërruar armikut dhe nga fitore ushtria jonë

çlroi gati të gjithë Shqipërinë. Rrugët dhe qytetet e Shqipërisë, që prej Shkodre deri në Gjirokastër, dëshmojnë luftën e ashpër dhe heroike të partizanëve tanë.

Lufta e lavdishme e reparteve tona çlroi Tiranën, çoi në këmbë gjithë Shqipërinë me një entuziazëm të papërshkrueshëm.

Ushtria jonë, e mbuluar me lavdi, është mburojë e popullit shqiptar!

PARTIZANË E PARTIZANE, KOMANDANTE E KOMISARË!

Detyra juaj s'ka mbaruar.

Duhet të çlrojhmë gjithë Shqipërinë dhe të ndjekim këmba-këmbës armikun gjerman të egër dhe të dërmuar, që përpinqet të tërhiqet drejt Shkoadrës dhe Podgoricës.

Detyra jonë është të mos lëmë të dalë i gjallë asnje gjerman nga tokat tona.

Ata duhet t'i asgjësojmë!

Të gjitha repartet e ushtrisë sonë që veprojnë në Shqipërinë e Veriut kanë marrë urdhërat e Marrura. Armët tona të pathyeshme t'i japin atdheut lirinë e plotë. Ato të godasin deri në fund dhe pa mëshirë armikun dhe me prova gjaku të kontribuojnë deri në fund për kauzën

Të zbatohen me shpejtësinë më të madhe dhe me heroizmin tradicional urdhërat e marrura. Armët tona të pathyeshme t'i japin atdheut lirinë e plotë. Ato të godasin deri në fund dhe pa mëshirë armikun dhe me prova gjaku të kontribuojnë deri në fund për kauzën

e përbashkët aleatë, që është zhdukja përgjithmonë e murtajës fashiste.

LAVDI HERONJVE TANË TË RËNË NË LUFTËN
PËR ÇLIRIMIN E ATDHEUT!

Komandanti i Përgjithshëm i Ushtrisë NÇSH
Gjeneral-Kolonel

Enver Hoxha

*Botuar për herë të parë në
«Buletinin e Shtabit të Përgjithshëm
të UNÇSII», Nr. 13,
dt. 20.XI.1944*

*Botohet sipas tekstit të «Bu-
letinit të Shtabit të Përgjith-
shëm të UNÇSH»*

**PËRSHËNDETJE DREJTUAR
POPULLIT TË TIRANËS ME RASTIN
E ÇLIRIMIT TË KRYEQYQTETIT**

18 nëntor 1944

VDEKJE FASHIZMIT

LIRI POPULLIT

POPULLIT TË TIRANËS

Në emër të Qeverisë Demokratike, të Shtabit të Përgjithshëm dhe të Ushtrisë N.-Çl., përshëndes popullin trim të Tiranës, që diti qysh në ditët e para të rreshtohet me bijtë e tij përkrah luftës kundër okupatorit dhe tradhëtarëve, të marrë pjesë heroikisht në luftën tonë çlirimtare, që diti t'u bëjë ballë plot vetëmohim veprave të terrorit të armikut dhe të tradhëtarëve dhe që i kapërceu pa u përkulur ditët e përgjakshme si ajo e 4 SHKURTIT.

Tirana u çlirua prej brigadave heroike të Ushtrisë N.-Çl. të ndihmuara prej popullit të Tiranës. Në luftën e përgjakshme rrugë më rrugë e shtëpi më shtëpi kundër një armiku të vendosur e të egër, të armatosur me mjetet më moderne, vullneti i hekurt i ushtrisë sonë dhe i popullit të Tiranës triumfoi. Gjaku i bijve

të popullit tonë, që ranë në këtë betejë për çlirimin e kryeqytetit tonë, shkroi një nga faqet më të shkëlqyera të luftës sonë ngadhnjimtare.

Lufta jonë, që shpërtheu e papërkulur, u kurorëzua me çlirimin e Tiranës, do të kurorëzohet dhe me çlirimin e gjithë Shqipërisë. Populli heroik i Tiranës, që diti të luftojë kaq trimërisht gjatë 5 vjet e gjysmë robërie të rëndë, do të jetë tani në pararojë për ndërtimin e Shqipërisë sonë të dashur, ai do të jetë krahu i fuqishëm i pushtetit demokratik të vendit tonë.

RROFTË SHQIPËRIA E LIRË DEMOKRATIKE!

RROFTË POPULLI HEROIK SHQIPTAR!

**RROFTË POPULLI HEROIK I KRYEQYTETIT
TË SHQIPËRISË SË RE DEMOKRATIKE!**

Kryeministri, Komandanti i Përgjithshëm i UNÇSH
Gjeneral-Kolonel

Enver Hoxha

*Botuar për herë të parë në
«Dokumenta të Shtabit të
Përgjithshëm dhe të Koma-
ndës së Përgjithshme të
Ushtrisë Nacional-Çli-
rimtare Shqiptare»
vëllimi II,
Tiranë, 1966*

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

USHTRIA JONË NACIONAL-ÇLIRIMTARE

Nëntor 1944

Kur atdheu ynë kërcënohej nga rreziku më i madh që mund të kish të parë gjatë shekujve, bijtë më besnikë e më të dashur të popullit tonë rrokën armët për të luftuar okupatorët e egër dhe të armatosur me mjetet më moderne. Ndërmarrja e tyre ishte një ndërmarrje aq e guximshme sa dhe e shenjtë, se luftonin një grusht njerëzish në një kohë krize të madhe kundër armiqve të fortë e në kulmin e fitoreve të tyre. Por patriotët shqiptarë, që ndërmuarën këtë vepër gjigante, kishin besimin e plotë në veten e tyre dhe në popullin tonë, nga gjiri i të cilit ata kishin dalë. Mbi supet e këtyre njerëzve rëndonte robëria shkeulllore e gjithë popullit tonë, rëndonte mjerimi dhe zgjedha e huaj, rëndonin vuajtjet, dhimbjet e popullit shqiptar. Të dalë nga gjiri i popullit të vuajtur, këta njerëz s'dyshonin asnjë sekondë në forcën e madhe të popullit shqiptar, në shpirtin liridashës të tij, në pathyeshmërinë e tij përparrakatastrofës dhe në vullnetin e hekurt, i cili do ta çonte atdheun tonë në rrugën e shpëtimit e të fitores.

Dhe lufta filloi e ashpër dhe e pamëshirshme; pessimistët bërtitnin: «Do të derdhet gjaku kot dhe pa

asnjë shpresë e fitim!». Tradhëtarët ju përveshën pûnës së tyre të përhershme, por populli ynë u çua, i forcoi radhët e veta, u hodh pa u kursyer në luftë. Ai e dinte se pa djersë e mundim nuk fitohej buka dhe se pa luftë e pa gjak nuk fitohej liria, nuk shpëtohej atdheu. Vetëm tradhëtarët dhe oportunistët, parazitët e jetës sonë shoqërore, ishin të predestinuar të hiusheshin matanë barrikadës, se tërë jetën e tyre ata kanë thithur gjakun e popullit, ata kanë rrojtur në kurrizin e tij, duke e bërë këtë plaçkë tregu tek të huajt. Ata patjetër do të merrnin anën e okupatorit, qëllimet e të cilit ishin të tyret dhe në kundërshtim të hapët me ato të popullit shqiptar.

Ushtria jonë, shpëtimtarja glorioze e atdheut shqiptar, e edukuar dhe e fryshtuar në një mënyrë krejt të kundërt me atë të Zogut, e cila ju nënshtrua armikut, lindi dhe u rrit në luftë, u formua dhe u udhëhoq prej djemve të popullit, në shpirtin e të cilëve vlonë në një mënyrë të papërshkrueshme entuziazmi i pafrenuar, trimëria e pasembullt, vetëmohimi i madh, që janë faktorë vendimtarë të fitoreve tona. Këta faktorë u rritën dita-dilës, u mbrujtën dhe u çelnikosën në përpjekje të përgjakshme, të cilat i bënë luftëtarët tanë të pjekur në mendime e në vepra, i bënë të rinjtë tanë të kuptojnë rëndësinë e momentit dhe detyrat e rënda që rëndonin mbi supet e tyre të njoma.

Po këto supe dolën prej graniti, dhe ushtria jonë kapërceu rreziqe të mëdha dhe doli fitimtare. Në fillim kundër italianëve ajo ndërmori aksionet më të guximshme, megjithëse e vogël në numër dhe pa armë të mjaftueshme. Nën okupacionin gjerman ajo u armatos

me armët e armikut dhe shkroi epopenë e shkëlqyer.

Në këtë luftë të madhe ushtria jonë mësoi të organizohet, dhe ky organizim kaloi në etapa të ndryshme. Nga çetat dhe njësitë luftarake të fillimit u organizuan batalionet, brigadat, divizionet, korparmatat. Dhe këto njësite të formuara me punëtorë, katundarë, intelektualë, bij të popullit dhe të lidhur ngushtë me të, u udhëhoqën me aq guxim e zgjuarësi prej oficerëve që lindën nga lufta dhe nga gjiri i ushtrisë.

Karakteri i ushtrisë sonë është popullor dhe vetë lufta partizane e fillimit, e bërë me reparte të vogla që mbaheshin dhe ushqeheshin në popull, që flinin në kasollet e katundarëve, e theksoi më së miri këtë karakter dhe i lidhi partizanët tanë ngushtë nje masat e gjera të popullit. Në partizanët tanë entuziazmi dhe vullneti për luftë s'u ulën kurrë, por, përkundrazi, u shtuan dita-ditës; dashuria për udhëheqësit gjithashtu. Kjo dashuri dhe kjo bindje ndaj udhëheqësve dhe urdhërave të tyre dilte përsëri nga shpirti dhe manifestohej në mënyrë të thjeshtë, se udhëheqësi i dalë nga gjiri i tyre ishte kurdoherë tok me ta, e shihnin orë e çast, për arësy se njësiti ishte i vogël. Gjithashtu dhe disiplina e fillimit nuk ishte një disiplinë me të vërtetë ushtarake, por një disiplinë që i përngjiste më shumë disiplinës së kohërave të kaluara, të çetave të gjyshërvë tanë. Lufta e sotme, me një karakter të ndryshëm, të egër e brutal, e bërë me mjete moderne të perfeksionuara, lypte patjetër nga ana jonë një kujdes më të madh për t'u bërë ballë armiqve të egër e të pajisur me një taktkë ushtarake të perfeksionuar. Na duhej që ushtrisë sonë, që po krijohej e po rritej, t'i jepnim

karakterin e vërtetë të një ushtrie moderne dhe rrëth cilësive të saja të shkëlqyera, guximit, entuziazmit dhe karakterit popullor të ngrinim në një shkallë të lartë ndjenjën e disiplinës së hekurt, pa të cilën nuk mund të shkojë përpara një ushtri e vërtetë që ka në kurri z një barrë kaq të rëndë. Duhej të ngjallnim ndjenjën e përgjegjësisë të gjithsecilit ndaj vetes dhe ndaj komandave, duhej të zhvillonim ndjenjën se ushtria jonë duhej të kalonte nga faza e çetave në fazën e një ushtrie të rregullt e moderne e të zhvilloheshin në të vlerat e pashteruara që do të organizonin me përpikëri e në mënyrë të perfektionuar të gjitha degët e aktivitetit të saj, që e bëjnë ushtrinë të pathyeshme.

Duhej, në radhë të parë, që udhëheqësit të kuptonin rolin e tyre të rëndësishëm dhe të shumanshëm, të kuptonin se lufta s'bëhej vetëm me guxim e me entuziazëm, — sido që pa këto nuk mund të shkchej përpara, — porse për të fituar kundër armikut duhej përdorur një taktikë e hollë, që të përballonë taktikën ushtarake të tij dhe të mos lihej kurrë që armiku të na impononte taktikën e vet. Ushtria jonë duhej të ishte kurdoherë në ofensivë, të sulmonte armikun përhera dhe kudo, t'i priste lidhjet, furnizimet, t'i godiste shtabet, t'i shkatërronte prapavijat dhe t'ja prishte kësisoj planet e tija. Me gjithë karakterin e luftës sonë të lëvizshme, luftë e zhvilluar në tokat tona, në gjirin e popullit tonë, që na mbante e na donte si një pjesë të pandashme të tij, duhej patjetër që disiplina në radhët tona të forcohej, rrjeta informative ushtarake të ishte e fortë dhe e përsosur, që udhëheqësit tanë të lartësoheshin ushtarakisht e politikisht, që të

mësoheshin që nga partizani më i thjeshtë gjer te komandanti më i lartë të përdornin më së miri armët që kishin në dorë. Me një fjalë, të gjithë të kuptionin rëndësinë e momentit, të njihnin mirë armikun që kishin përpala dhe ta çonin ushtrinë tonë drejt organizimit të përsosur, ta bënин njëkohësisht një ushtri politike.

Zhvillimi i luftës, ashpërsimi i saj, shkaktoi zgjerimin dhe zmadhimin e ushtrisë sonë dhe, si rrjedhën të domosdoshënë të këtyre faktorëve, përmirësimin në shkuarjen drejt një organizimi më të mirë, drejt një ushtrie moderne. Por jemi larg rezultatit të dëshiruar, dhe detyra jonë kryesore është të shkojmë përpala përt'i dhënë me të vërtetë ushtrisë sonë një karakter modern, jo vetëm në formë, por sidomos në brendi. Dhe kjo detyrë e madhe rëndon mbi të gjithë pjesëtarët e ushtrisë sonë e veçanërisht mbi udhëheqësit e vegjël e të lartë. Ata udhëheqës, ushtarake e politikë, që quan ushtrinë tonë në fitore, ata që mundën oficerët italiane e gjermanë, që ishin të pajisur me njohuri të mëdha ushtarake, ata duhet ta modernizojnë ushtrinë tonë, ta perfektionojnë dhe ta bëjnë një ushtri model, një ushtri të pajisur me të gjitha cilësitë e vlefshme, që të jetë e denjë të vazhdojë më së miri luftën për çlirimin e plotë të atdheut dhe përtë mbrojtur popullin dhe pushtetin e tij të ngritur me kaq sakrifica e gjak.

Pikësëpari duhet të mbrojmë dhe të ngremë akoma më lart entuziazmin dhe moralin e shëndoshë që karakterizon ushtrinë tonë, dhe këto do t'i mbrojmë e do t'i ngremë me luftë të paprerë kundër okupatorit dhe me një edukatë të shëndoshë ushtarake e politike. Vlera të paçmueshme ndodhen në radhët e ushtrisë so-

në, vlera që do të jenë baza të patundura të ushtrisë dhe të pushtetit. Këto vlera duhet t'i vëmë në dritë e t'i lartësojmë, duhet të krijojmë, të edukojmë, të shtojmë kuadrot tona. Në rast se ne neglizhojmë këtë, ne do të jemi të detyruar të biem në gjunjë.

Oficerët tanë duhet të edukohen me njohuri ushtarake të luftës moderne; të pajisen me njohuritë e nevojshme për të drejtuar një ushtri moderne. Për këtë duhet të krijohen kurse në çdo repart; do të krijohen shkolla posaçërisht.

Duhet të krijohen kurse për stërvitjen e ushtrisë në përdorimin e armëve moderne dhe mjeteve të ndërlidhjes nga më modernet. Të gjithë duhet të dinë t'i përdorin këto armë, dhe këtej të krijohen reparte të specializuara. Të forcohet struktura e reparteve, jeta atje të bëhet e gjallë dhe të gjithë të ndjcjnë kësisoj se atje punohet dhe luftohet për të modernizuar ushtrinë.

Të luftohet sektarizmi i vjetër dhe i dëmshëm, të luftohet oportunizmi, të luftohet shpirti i repartit i ekzagjeruar dhe i dëmshëm, të forcohet disiplina, kjo të bëhet e hekurt dhe e vetëdijshme. Pa një hierarki ushtarake dhe pa një disiplinë të tillë nuk mund të ecim përpara, nuk mund të zbatohen e të respektohen urdhërat, dhe kush nuk zbaton e nuk respekton urdhërat e superiorëve, s'ka vend në ushtrinë tonë popullore.

Të organizohen dhe të forcohen në mënyrë moderne të gjitha seksionet e ndryshme ndër reparte, që nga ai i informacionit gjer tek i intendencës. Të kuptojmë mirë se format e mëparshme të organizimit duhen perfksionuar, duhen modernizuar dhe drejtuar sipas rr Ethanave që na janë krijuar.

Të zhvillohet në maksimum dashuria për popullin, në njërën anë, dhe urrejtja për armikun e tradhëtarët, në anën tjetër. Të përjetësohet në ushtrinë tonë kujtimi i heronjve që dhanë jetën për atdheun.

Të zhvillohet në popull dashuria e madhe për ushtrinë tonë dhe të kuptohet prej të gjithëve se për çdo qytetar, të aftë të mbajë armë, duhet të jetë një detyrë e shenjtë dhe një çështje nderi të marrë pjesë në Ushtrinë Nacional-Çlirimtare.

Të gjitha këto reforma, të gjitha këto organizime të shumanshme, që do të forcojnë ushtrinë tonë, janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, dhe lëshimet në këtë drejtim do të na lënë prapa.

Në të gjithë ushtrinë tonë duhet të ndjehet një jetë e re, një frysme e re. Ushtrinë tonë heroike, që me luftën e saj ngadhnjmëtare fitoi dashurinë e admirimin e popujve ta bëjmë që nga çdo pikëpamje të qëndrojë në atë radhë që ajo e ka merituar dhe fituar me gjakun e saj ndër beteja të lavdishme.

Enver Hoxha

**Botuar për herë të parë në
«Buletinin e Shtabit të Përgjithshëm
të UNÇSH», Nr. 1.
nëntor 1944**

**Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë**

**URDHËR DITE DREJTUAR USHTRISË NACIONAL-
-ÇLIRIMTARE ME RASTIN E FESTËS KOMBËTARE
TË 28 NËNTORIT**

28 nëntor 1944

URDHËR DITE

Me rastin e festës së 28 Nëntorit përshëndes gjithë komandantët, komisarët, partizanët dhe partizanet e ushtrisë sonë heroike, të cilët për tre vjet rresht, pa marrë parasysh asgjë, me guxim dhe vetëmohim luftuan për të çliruar atdheun, për të shpëtuar popullin nga një robëri e rëndë. Ushtria jonë Nacional-Çlirimtare u bë mburja e popullit tonë, se ajo në luftime të përgjakshme kundër fashizmit dhe tradhëtarëve e mbajti lart flamurin e lirisë, i cili s'u përkul kurrë, por kaloi nga fitorja në fitore. Qytetet, fushat dhe malet tona të mbuluara me borë janë dëshmitarët e kaq heroizmave, ku partizanët dhe partizanet tona, në shi e në borë, ngrënë e pa ngrënë, suleshin mbi armiqjtë me një trimëri të jashtzakonshme.

KOMANDANTE, KOMISARE, PARTIZANË DHE PARTIZANE!

Detyrat që keni përpala janë të mëdha, qyteti i Shkodrës ndodhet ende në duart e okupatorit, ne du-

het ta çlirojmë dhe të mos lëmë asnje gjerman të dalë i gjallë nga tokat tona, duhet t'i shfarosim. Besnikë të aleancës së madhe antifashiste dhe për solidaritetin dhe vëllazërimin e madh që na lidh me popujt e Jugosllavisë, ta ndjekim armikun në tokat e Malit të Zi dhe krasas me ushtrinë jugosllave ta shpartallojmë rezistencën në atë vend.

Duhet që ushtria jonë të bëhet një ushtri model dhë e zonja të mbrojë popullin, të mbrojë pushtetin për të cilin ajo derdhi kaq gjak. Ushtria jonë duhet të modernizohet dhe të pajiset me të gjitha kualitetet ushtarake dhe armët moderne, ajo duhet të bëhet një ushtri politike, se në këtë mënyrë ajo do të dijë t'i mbrojë si duhet interesat e popullit shqiptar. Kjo varret nga ju, dhe unë jam i bindur se ushtria jonë heroike, komandantët, komisarët, partizanët dhe partizanet, ashtu si ditën të luftonin heroikisht, do të dinë të përbushin edhe këto detyra.

Rroftë Ushtria jonë e pathyer Nacional-Çlirimtare!

Komandanti i Përgjithshëm i
Ushtrisë Nacional-Çlirimtare
Gjeneral-Kolonel

Enver Hoxha

*Botuar për herë të parë në
«Buletini i Luftës nacional-
-çlirimtare», Nr. 52,
30 nëntor 1944*

*Botohet sipas tekstit të «Bu-
letinit të Luftës national-
-çlirimtare»*

FJALIM ME RASTIN E DITËS SË PAVARËSISË DHE TË ARDHJES SË QEVERISË DEMOKRATIKE NË TIRANË

28 nëntor 1944

Popull shqiptar,

Në një ditë të shënuar si kjo, më 1912, pas aq kohë robërie, lindi Shqipëria indipendente. Kur vendi ynë kërcënohej nga të katër anët nga armiqjtë e jashtëm, kur për popullin tonë po farkëtoheshin zinxhirë të rindërobërie, plaku Ismail Qemali, me një grusht trima patriotë, e ngriti lart flamurin e lirisë në Vlorë, dhe populli shqiptar mori frymë. Ne dualëm fitimtarë, por valë të egra kaluan mbi popullin tonë të mjeruar, ai flamur i lirisë u muar nëpër këmbë. Ai u shpërdorua, u bë plaçkë tregu prej satrapëve të regjimit të kaluar, ai u përdor për të mbuluar turpësitë e hajdutllëqet që bëheshin në kurriz të popullit tonë. Por flamuri i popullit, flamuri i Ismail Qemalit, qëndronte i panjollosur në shpirrat e patriotëve shqiptarë, dhe ai flamur u ngrit lart, u mbajt nga duart e çelnikta të luftëtarëve të popullit dhe kaloi nëpërmes rrebeshesh dhe furtunash i pathyer, i papërkulur, simbol i lirisë dhe i indipendencës.

Pas kaq luftërash heroike kundër fashizmit, flamuri

i kuq i Vlorës, i lyer me gjakun e heronjve të popullit të rënë në këtë luftë antifashiste, valon sot krenar në qielin e Shqipërisë së lirë. Pesë vjet kanë kaluar nga robëria e rëndë fashiste, pesë herë nëpër rrugët e qyteteve të Shqipërisë, në çdo 28 Nëntor është derdhur gjak i bijve heroikë, që përllesheshin me bajonetat e okupatorit e të tradhëtarëve. Dita e Flamurit u bë dita dy herë e shenjtë, dita e pavarësisë dhe e bashkimit të popullit shqiptar.

Më 7 prill të 1939-s na pllakosi robëria, një robëri e rëndë, na shkeli fashizmi, armiku më i madh yni dhë i njerëzimit. Lufta e madhe po pregatitej, po pregatitej kasaphana nga Hitleri dhe Musolini. Ng paguam haracin e parë. Horizonti ndërkombëtar ishte i errët. Evropa armatosej me një ethe të tërbuar, për ne nuk u ngrit një zë, përveç britmave të popullit tonë të tradhëtuar nga qeveritarët e asaj kohe, britma që kërkonin armë për të luftuar italianët. Tradhëtia ishte e madhe. Dallaverraxhijtë politikanë, spekulatorët ishin në këmbë, ata i dhanë dorë okupatorit, u përqafuan për të shtypur popullin, për ta bërë rajá, mish për top. Sistematikisht u punua prej fashizmit dhe tradhëtarëve që të shuhej çdo rezistencë, që të shuhej çdo ndjenjë patriotike, të shkelej nderi i vendit tonë, zakonet dhe gjuha të zhëdukeshin, të kolonizohet Shqipëria dhe italianët të derdheshin nga vendi ynë mbi popujt fqinjë e mbi Bashkimin Sovjetik. Por në mes të një terrori të madh lindi rezistenca e madhe e popullit tonë, i cili u quan më këmbë për të fituar lirinë e grabitur. Përpara fashizmit barbar, i armatosur deri në dhëmbë me armët më moderne dhe i ndihmuar nga tradhëtarët, dualën

gjokset e luftëtarëve tanë, ku buçiste ndjenja e lirisë e ku zemra ishte mbrujtur me një vullnet të hekurt e një vetëmohim të pafund. U çuan bijtë e popullit, që u dhimbej atdheu e që mbanin mbi supet e tyre vuajtjet, mjerimet, brengat e një populli të tërë. Shumë nga ata që në orët e para të luftës, ranë dëshmorë për atë popull që ata e donin aq shumë, ata ranë me këngë në gojë e të lumtur, se dinin përsë luftonin dhe se me gjakun e me eshtrat e tyre ata do të ngrinin Shqipërinë e re. Ky ishte zëri i kushtimit dhe i alarmit që po i jepoj popullit nga pararoja e saj e që i thoshte se vendi kërcënohej për vdekje, se duheshin rrokur armët, dhe me luftë të pamëshirshme e të paprerë të çlirohej atdheu. Populli shqiptar e dëgjoi kushtimin e djemve të tij, gjaku që po derdhej nëpër rrugët e qyteteve dhe të fshatrave ishte gjaku i tij, dhe populli rroku armët.

Lufta jonë e lavdishme nacional-çlirimtare filloi. Ishte një luftë e pabarabartë, ishim pa armë, ishim të zbathur e me bark të zbrazët, por ishim të fortë, se luftonim për një çështje të madhe, luftonim për çlirimin e popullit, për t'i dhënë këtij ditë të lumtura, për t'u hakmarrë mbi armikun, që kërkonte të na mbyste në gjak. Ishim një popull i vogël karshi një bishe të madhe; por ishim të fortë, se ushqenim në zemrat tona një urrejtje të madhe për ata që na shkelën vatrat e na grabitën pasurinë. Rrokëm armët dhe u hodhëm në luftë, se ishim të sigurt në fitore, se drejtësia ishte me ne, se në këtë luftë s'ishim vetëm. Gjithë bota përpërimtare dhe antifashiste në një blok të shëndoshë ishte në luftë kundër të njëjtët armik, armikut të njerëzimit: nazizmit dhe fashizmit.

Popull shqiptar,

Tre vjet lufte të armatosur, faqesh glorioze të historisë së vendit tonë, faqesh të shkruajtura me gjakun më të kulluar të bijve dhe të vashave shqiptare. Lëvizja jonë nacional-çlirimtare u rrit e u forcua në një luftë të ashpër, të armatosur, në një luftë politike. Armiqtë ishin të fortë e dinakë, ata përdorën terror e demagogji, ata vunë të gjitha forcat për ta shuar rezistençën tonë. Tradhëtarët e vendit tonë, Mustafa Kruja, Mehdi Frashëri, Ali Këlcyra, Mithat Frashëri, Abaz Kupi, Shefqet Vërlaci e gjithë kuislingët e tjerë, përdorën çdo taktkë për të përçarë popullin tonë; demagogjia e tyre ishte e fortë dhe në fillim një pjesë nga populli u mashtrua deri diku prej këtyre bandilëve, vegla të verbëra dhe të përhershme të armiqve të brendshëm dhe të jashtëm. Organizata e «Ballit Kombëtar», «Legalitetit» dhe gjithë organizatat e tjera terroriste u bënë arma aktive e okupatorëve dhe ato, me një egërsi të jashtzakonshme, u vërsulën tok me gjermanët mbi popullin dhe vranë e prenë në masë njerëz të pafajshëm, gra, pleq e kalamaj, grabitën e shnderuan. Këta katilë lëshuan zjarr e vrer mbi lëvizjen tonë nacional-çlirimtare, mbi ushtrinë tonë, por lëvizja jonë nuk u thye, se ajo i kishte bazat të forta, se ajo ishte një lëvizje popullore, se ajo ishte një lëvizje demokratike përparimtare. Në Frontin tonë Nacional-Çlirimtar u grumbullua populli i ndershëm, populli që punon, populli që fiton bukën me djersë dhe jo me dallavere dhe me tradhëti. Fronti ynë Nacional-Çlirimtar grumbulloj gjithë elementët demokratë, pa dallim tendence politike dhe fetare, ai u bë trupi i shëndoshë dhe i për-

shtatshëm për t'i dalë mbanë kësaj pune të vështirë dhe të shenjtë. Ushtria jonë Nacional-Çlirimtare, që u rrit dhe u forcua në luftëra të përgjakshme, ishte ushtri e popullit, ku katundarët, punëtorët, intelektualët, të bashkuar si një trup, luftonin për një qëllim, për një Shqipëri të lirë, për një Shqipëri indipendente, për një demokraci popullore. Dhe pas tre vjet përpjekjesh heroike, pas kaq gjaku të derdhur, pas kaq vuajtjesh e sakrificash, ne dolëm fitues; ne thyem barbarin gjerman dhe shërbëtorët e tij tradhëtarë.

Gjatë këtyre tre vjet lufte, Fronti ynë Nacional-Çlirimtar u bë një realitet, u krijuan këshillat nacional-çlirimtare, organe të luftës dhe bazat e pushtetit dhe këto u forcuan e u bënë pushteti i vërtetë demokratik i popullit. Ky pushtet i ri popullor flaku tej pushtetin e vjetër, i cili u bë vegla qorre e okupatorit dhe e tradhëtarëve. Për krijimin e frontit dhe të pushtetit ranë kaq mijëra bij të Shqipërisë, të cilët me vetëmohim luftuan, se ishin të sigurtë për një të ardhme të lumtur të popullit tonë. Lëvizja jonë, me platformën politike të drejtë, i hapi popullit perspektiva të gjera, i tregoi këtij rrugën e fitores. Lëvizja jonë nacional-çlirimtare, që kishte për qëllim bashkimin e gjithë popullit shqiptar, me prova gjaku u përpoq t'u jipte të kuptonin të gabuarve se rruga që ndiqnin ishte e dëmshme për atdheun tonë. Komiteti Antifashist Nacional-Çlirimtar dhe Kryesia e Këshillit Antifashist të Shqipërisë, me thirrjen që u bënë elementëve që ndodheshin ende në radhët e armikut dhanë edhe një provë tjetër të gjallë të qëllimeve të lëvizjes sonë.

Pas tre vjet përpjekjesh heroike, pas kaq gjaku të

dërdhur, ne dolëm fitimtarë. Armiku gjakpirës gjerman u shporr prej gati gjithë vendit tonë, u thyen bandat e reaksionarëve, shkaktarët e vëllavrasjes, dhe sot 28 Nëntori festohet me një entuziazëm të papërshkrueshëm nga populli shqiptar, i cili e fitoi lirinë me gjak. Sot në Tiranën e çliruar, pas një lufte të ashpër, rrugë më rrugë e shtëpi më shtëpi, sot në kryeqytetin e Shqipërisë së lirë e demokratike dhe në gjirin e atij populli heroik, që qëndroi i patundur në pararojën e luftës sonë, që masakrat e gjermanëve dhe të tradhëtarëve nuk e përkulen, por e forcuan më tepër, erdhi Qeveria Demokratike e Shqipërisë.

Popull shqiptar,

Lufta jonë ngadhnjimtare e ngriti lart prestigjin e vendit tonë, bëri të nderohet emri i Shqipërisë dhe i shqiptarit nga bota përparimtare, bëri që të flitet për ne me respekt, se ne i qëndruam dhe do t'i qëndrojmë besnikë aleancës së madhe të blokut antifashist, se ne derdhëm gjak si rrëke përkrah aleatëve tanë që luftonin me heroizëm për të shpëtuar njerëzimin nga thonjtë e nazizmit gjerman.

Lufta jonë heroike ishte e lidhur ngushtë me luftën e aleatëve tanë të mëdhenj: Bashkimit Sovjetik, Anglisë dhe Amerikës, ishte e lidhur ngushtë me luftën e popujve të robëruar. Në përpjekjet tona ne kishim një besim të patundur në fitore, se kishim mbështetjen e madhe të aleancës anglo-sovjeto-amerikane. Kur Ushtria e Kuqe lavdiplate, e udhëhequr nga strategu i madh i kohërave moderne, Mareshali Stalin, dërmonte pa mëshirë hordhitë hitleriane, çlironte to-

kat e saja dhe ngadhnjimtare po marshon drejt Perëndimit për sulmin vendimtar mbi kështjellën e fundit hitleriane, në popullin tonë përtëriheshin edhe shumëzoheshin energjitet e luftës, shtohej forca dhe besimi. Fitoret e shkëlqyera të Ushtrisë së Kuqe ishin dhe fitoret tona e të botës mbarë, se ato ishin faktori kryesor i shkatërrimit të nazizmit. Në saje të këtyre fitoreve, luftërat nacional-çlirimtare të popujve të robëruar u forcuan; këto fitore të Ushtrisë së Kuqe ndihmuan ardhjen e kësaj dite që sot ne po e festojmë kaq madhniشت. Dhe populli ynë i vogël, por i pathyer, u drejton popujve heroikë të Bashkimit Sovjetik dhe Ushtrisë së Kuqe famëmadhe mirënjohjen e tij të parfund. Në këtë luftë të madhe, Anglia dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk u përkulen përpara nazi-zmit gjerman, ato luftuan dhe luftojnë me trimëri përkauzën e përbashkët. Lufta e tyre në det, në tokë e në ajër, që i shkakton kaq dëme maqinës luftarake gjermane, është një ndihmë e çmueshme për popullin tonë. Hapja e frontit të dytë dhe shpartallimi i rezistencës gjermane në Francë do të thotë shpejtim i fitores së fundit.

Në Luftën e tij nacional-çlirimtare, populli ynë ka pasur përkrahje nga lufta heroike e popujve të Jugosllavisë. Popujt tanë fqinjë e vëllezër që në ditët e para të okupacionit të tyre u hodhën në një luftë të vendosur çlirimtare. Ushtria jonë dhe ajo jugosllave po derdhin gjakun krah për krah në fushat e Kosovës dhe të Metohisë: ushtarët tanë e jugosllavë po lidhin plagët e shoqi-shoqit në beteja të ashpra kundër të njëjtë armik dhe me gjak po mbruhet miqësia; brigadat tona, që kanë marrë urdhër të mos lënë të dalë gjallë këmbë

gjermani nga vendi ynë, po kapçrcejnë në Mal të Zi, ku së bashku me brigadat jugosllave do t'i japid fund rezistencës gjermane në këto vise. Me gjak e me vuajtje po lidhet miqësia në mes të popullit tonë dhe popujve të Jugosllavisë. Ne u çojmë në këtë ditë festë të madhe për vendin tonë përshtendetjet tona popujve vëllezër të Jugosllavisë.

Me popullin fqinjë grek kemi luftuar dhe derdhëm gjak së bashku, i kemi lidhur plagët shoqi-shoqit në këtë luftë të përbashkët antifashiste, dhe dëshira jonë është që kurdoherë t'i kemi marrëdhënjet të mira me këtë popull bujar. Me keqardhje shënojmë se bandat shoviniste dhe reaksionare të Zervës po martirizojnë minoritetin shqiptar, u grabitin këtyre pasurinë dhe i nxjerrin jashtë truallit të tyre. Elementë të Zervës tinëz kalojnë kufirin tonë dhe na vrasin e na gjakosin partizanët tanë. Akte të tilla ne nuk do t'i tolerojmë në vendin tonë. Kryeministri grek Papandreu ka shfaqur pretendime aneksimi mbi krahinat tona të Gjirokastrës dhe të Korçës, mbi Vorio-Epirin, si i pëlqen ta quajë ai. Pretendime të tilla natyrisht nuk lehtësojnë marrëdhënjet e mira më fqinjët e Jugut. Kufitë tanë janë të padiskutueshëm, se brenda tyre s'ka përveçse toka tona, toka që na kanë lënë stërgjyshërit dhe që i kemi vaditur me gjakun tonë. Askush nuk do të guxojë të na i prekë, se ne do të dimë t'i mbrojmë.

Minoritetit grek në Shqipëri lëvizja jonë nacional-çlirimtare i ka dhënë të drejta të barabarta me ato të popullit shqiptar. Qeveria Demokratike e Shqipërisë do t'i garantojë minoritetit grek në vendin tonë liritë dhe të drejtat demokratike dhe nacionale, për të cilat

kanë luftuar heroikisht në brigadat nacional-çlirimtare djemtë e minoritetit.

Popull shqiptar,

Sot po hapet një faqe tjetër e historisë sonë, një faqe që është në dorën tonë ta bëjmë dhe do ta bëjmë po aq të lavdishme, sa edhe luftën tonë kundër okupatorit, dhe kjo është lufta për rindërtimin e Shqipërisë, për ngritjen e ekonomisë, për ngritjen e kulturës dhe të arësimit të popullit tonë, për ngritjen e nivelit shoqëror, ekonomik dhe politik të tij. Lëvizja jonë ndërmori në momente të kritikshme atë luftë vigane e të parabartë dhe doli fitimtare, se populli ynë u bashkua si një trup rreth Frontit Nacional-Çlirimtar. Lëvizja jonë nacional-çlirimtare do të ndërmarrë edhe këtë luftë të dyti dhe do të dalë fitimtare, se këtë gjë na e kanë lënë amanet ata që ranë në fushën e nderit, se kjo ështëjeta e tërë popullit dhe e ardhmja e tij. Nazistët gjermanë dhe tradhëtarët kanë mbjellur kob e zi në vendin tonë, krahina të tëra janë djegur, është shkretuar bujqësia, është dëmtuar shumë ekonomia e vendit, me mijëra familje janë jashtë pa strehë dhe pa bukë, duhen çelur shkollat, duhet ruajtur shëndeti i popullit. Të gjitha këto detyra të rëndësishme do t'i kryejmë, në qoftë se ne forcojmë pushtetin tonë dhe në pushtet do të sjellim ata njerëz që u dhimbet populli. Prandaj na vihet përpara detyra që të japid qdë gjë për pushtetin, këtë ta bëjmë të fortë, dhe që të mund t'i kryejë këto detyra vitale rreth pushtetit të mobilizohet i gjithë populli. Të forcojmë Frontin tonë Nacional-Çlirimtar dhe ky të grumbullojë të gjithë

popullin tonë, të cilin ta ushqejë me politikën e drejtë tonën, ta lidhë ngushtë me pushtetin dhe ta bëjë konshient të detyrave që i vihen përpara. Duhet të kuptojmë edhe këtu, ashtu si e kuptuam në luftën e armatosur, se për t'i kryer këto detyra, për t'i dhënë popullit një jetë më të lumtur dhe më të begatshme duhet që populli i tërë të jetë faktori i kësaj vepre të madhe. Asnjë shqiptar i ndershëm të mos mbetet jashtë frontit, asnjë energji të mos vejë kot. Me rastin e festës së 28 Nëntorit, me rastin e çlirimit të Tiranës, Kryesia e Këshillit Antifashist Nacional-Çlirimtar të Shqipërisë bën një amnisti të përgjithshme për të gjithë pjesëtarët e «Ballit Kombëtar», të «Legalitetit» dhe të organizatave të tjera që bashkëpunonin me okupatorin; përashtohen nga kjo amnisti të gjithë kriminelët e luftës, ata që kanë vrarë, djegur, shnderuar dhe plaçkitur pasurinë e popullit. Ky është një fakt tjetër që dëshmon qëllimet e larta të lëvizjes nacional-çlirimtare, të asaj lëvizjeje që luftoi dhe do të luftojë për popullin, të asaj lëvizjeje që ka për princip drejtësinë më të madhe.

E gjithë Shqipëria të jetë një kantier pune, ku i madh dhe i vogël të kuptojë se nuk punon për të huajt, por punon e ndërton vendin e tij. Për atë vend që s'kursyem as jetën nuk duhet të kursejmë djersën dhe mundin tonë. Duhet të vëmë tërë forcat që ushtria jone, faktori i madh i këtyre sukseseve, të forcohet dhe të bëhet një ushtri moderne me tërë kuptimin e fjalës. Ajo të jetë mbrojtësja e vërtetë e popullit dhe e pushtetit të tij. Për ta përmbrushur këtë detyrë kryesore duhet që ushtrinë tonë ta bëjmë një ushtri konshiente

dhe politike, se vetëm kësisoj ajo do të jetë në gjendje ta mbarojë luftën me suksesin më të madh dhe të bëhet mburoja e gjallë e interesave të popullit.

Popull shqiptar,

Frytet e luftës tënde heroike duhet t'i mbledhësh vetë, se ty të përkasin, ti i ke paguar me gjak. Që të mos na i rrëmbejnë dhe të na i vjedhin hajdutët, spekulatorët, intrigantët dhe politikanët dallaveraxhinj, ata që janë mësuar të rrojnë në kurrizin tonë dhe që na kanë pirë gjakun, të shtërngojmë radhët tona më fort se kurrë, të grumbullohemi të gjithë rreth pushtetit, rreth frontit, rreth Qeverisë Demokratike dhe kështu të bashkuar të shkojmë drejt objektivave të dëshiruara, që janë përmirësimi i jetës sociale dhe ekonomike të vendit tonë.

Rroftë Shqipëria e lirë demokratike!

Rroftë populli shqiptar!

Rroftë Ushtria Nacional-Çlirimtare!

Rrofshin aleatët tanë të mëdhenj: Anglia, Bashkimi Sovjetik dhe Amerika!

Rroftë vëllazërimi i popujve liridashës të Ballkanit!

Rroftë populli heroik i Tiranës!

*Botuar për herë të parë në
«Buletini i Luftës nacional-
-çlirimtare», Nr. 52,*

30 nëntor 1944

*Botohet sipas tekstit të
«Buletinit të Luftës national-
-çlirimtare»*

LËNDA

PARATHËNJE PËR VËLLIMET 1 DHE 2 V—VII

1943

- DIREKTIVA PËR FORCIMIN E LIDHJEVE ME BASHKIMIN SOVJETIK, PËR QËNDRIMIN KUNDREJT «BALLIT KOMBËTAR», «LEGALITETIT» DHE MISIONEVE USHTARAKE ANGLEZE, PËR FORCIMIN E FRONTIT, TË KËSHILLAVE DHE TË USHTRISË NACIONAL-ÇLIRIMTARE, PËR FORCIMIN E PARTISË DHE TË ORGANIZATAVE TË TJERA ANTIFASHIISTE (3 nëntor 1943). 1—32
- LETËR DREJTUAR KOMITETIT QARKOR TË PKSH PËR BERATIN, ME ANËN E SË CILËS DËNOHEN LIDHJET E DOBËTA ME KOMITETIN QENDROR DHE KOMPROMISI ME GJERMANËT NË BERAT (5 nëntor 1943) 33—34
- LETËR DREJTUAR KOMITETIT QARKOR TË PKSH PËR ELBASANIN MBI PREGATITJEN E KUADRIT DHE MBI FORCIMIN E PUNËS POLITIKE NË USHTRI (8 nëntor 1943) 35—36
- LETËR DREJTUAR KOMISARIT POLITIK TË BATALIONIT TË BËRZESHTËS NË LIDHJE ME SIGURIMIN E USHQIMEVE DHE ME RRITJEN E FRYMËS LUFTARAKE TË BATALIONIT (8 nëntor 1943) 37—40
- LETËR DREJTUAR KADRI HOXHËS MBI DOBËSITË NË ORGANIZIMIN E USHTRISË NACIONAL-

-ÇLIRIMTARE NË QARKUN E ELBASANIT DHE MBI PËRGJEGJESITË E TIJ PËR KËTË GJENDJE (16 nëntor 1943)	41—45
LETËR DREJTUAR BABA MUSTAFA XHANIT MBI SITUATËN LUFTARAKE BRENDA VENDIT, MBI QËNDRIMIN E ABAZ KUPIT SI DHE MBI VEPRIM- TARINË SABOTUESE TË MISIONEVE USHTARAKE ANGLEZE (21 nëntor 1943)	46—50
LETËR DREJTUAR KOMITETIT QARKOR TË PKSH PËR VLOREËN MBI QËNDRIMIN NDAJ «LEGALITE- TIT», MISIONEVE USHTARAKE ANGLEZE, «BA- LLIT KOMBËTAR» DHE MBI FORCIMIN E PUNËS SË ORGANIZATËS SË PARTISË (22 nëntor 1943) ..	51—59
LETËR DREJTUAR KOMISARIT TË GRUPIT TË PE- ZËS MBI GJENDJEN USHTARAKE E POLITIKE NË PEZË, MBI QËNDRIMIN NDAJ MISIONEVE USHTA- RAKE ANGLEZE DHE MBI GJENDJEN NË DIBËR, NË VLORE E NË BERAT (22 nëntor 1943)	60—67
LETËR DREJTUAR SHOKUT NAKO SPIRU MBI ORGANIZIMIN E BRIGADËS II SULMUESE (Nën- tor 1943)	68—70
LETËR DREJTUAR SHOKUT NAKO SPIRU NË LI- DHJE ME KRIJIMIN E BRIGADËS II SULMUESE (Nëntor 1943)	71
LETËR DREJTUAR SHOKUT NAKO SPIRU PËR DREJTIMIN E «ZËRIT TË POPULLIT», PËR RRIT- JEN E INICIATIVËS NË KUADROT E PARTISË DHE PËR ÇËSHTJEN E ZOGUT (Nëntor 1943)	72—76
LETËR LIDHUR ME BASHKËPUNIMIN E MISIONIT ANGLEZ ME KRERËT E REAKSIONIT KUNDËR LUFTËS ANTIFASHISTE TË POPULLIT SHQIPTAR (Nëntor 1943)	77—79
LODRAT E NAZISTËVE OKUPATORË (Nëntor 1943)	80—90
LETËR DREJTUAR KOMANDËS SË BRIGADËS III SULMUESE MBI GJENDJEN E KRIJUAR NË QAR-	

KUN E ELBASANIT GJATË OPERACIONIT ARMIK TË DIMRIT 1943—1944 DHE MBI RRETHIMIN E SHTABIT TË PËRGJITHSHËM TË UNÇSH (19 dhjetor 1943)	91—94
LETËR MBI PËRGJEGJËSINË E KADRI HOXHËS PËR GJENDJEN USHTARAKE TË KRIJUAR NË QARKUN E ELBASANIT GJATË OPERACIONIT ARMIK TË DIMRIT (Dhjetor 1943)	95—98

1944

LETËR DREJTUAR SHOKUT NAKO SPIRU MBI GJENDJEN E KRIJUAR NGA OPERACIONI ARMIK I DIMRIT DHE MBI NEVOJËN E FORCIMIT TË PRO- PAGANDËS DHE TË SHTYPIT TË PARTISË (Shkurt 1944)	99—106
LETËR DREJTUAR KOMITETIT QARKOR TË PKSH PËR TIRANËN MBI QËNDRIMIN NDAJ ELEMEN- TËVE DEZERTORE E TRADHËTARE TË PARTISË DHE MBI FORCIMIN E ORGANIZATAVE TË PARTI- SË NË FSHAT (2 mars 1944)	107—109
LETËR DREJTUAR SHOKUT NAKO SPIRU MBI DALJEN E SHTABIT TË PËRGJITHSHËM TË UNÇSH NGA RRETHIMI DHE MBI KUNDËRMËSYMJEN E UNÇSH (Mars 1944)	110—114
LETËR DREJTUAR SHOKUT NAKO SPIRU NË LI- DHJE ME PËRBALLIMIN E VËSHTIRËSIVE TË KRIJUARA NGA OPERACIONI ARMIK I DIMRIT (Mars 1944)	115—120
LETËR KUADROVE DREJTUESE TË BRIGADËS I SULMUESE MBI PREGATITJEN E KUADROVE USHTARAKE, MBI FORCIMIN E PUNËS POLITI- KE DHE RRITJEN E FRYMËS LUFTARAKE (24 mars 1944)	121—123
UDHËZIM DREJTUAR KOMITETIT QARKOR TË PKSH PËR GJIROKASTRËN MBI RUAJTJEN DHE	

FÖRCIMIN E UNITETIT TË RADHËVE TË PARTISË (2 prill 1944)	124—128
LETËR DREJTUAR SHOKUT HYSNI KAPO NË LIDHJE ME RUAJTJEN E KUADROVE KRYESORE POLITIKE DHE USHTARAKE (14 prill 1944)	129—131
LETËR DREJTUAR SHOKUT MEHMET SHEHU NË LIDHJE ME RUAJTJEN E KUADROVE KRYESORE POLITIKE DHE USHTARAKE (14 prill 1944)	132—134
QARKORE NË LIDHJE ME VENDIMIN PËR MBLEDHJEN E KONGRESIT I ANTIFASHIST NACIONAL-ÇLIRIMTAR DHE ZGJEDHJET E DELEGATËVE PËR NË KONGRES (16 prill 1944)	135—138
LETËR DREJTUAR SHOKUT HYSNI KAPO MBI ZGJEDHJEN E DELEGATËVE NGA BRIGADA V SULMUESE PËR NË KONGRESIN I ANTIFASHIST NACIONAL-ÇLIRIMTAR (17 prill 1944)	139—140
LETËR DREJTUAR ZËVENDËSKOMISARËVE TË BRIGADAVE MBI DETYRAT NË TERENET KU KALON BRIGADA (17 prill 1944)	141—143
LETËR DREJTUAR SEKSIONIT POLITIK TË BRIGADES I SULMUESE MBI EDUKIMIN DHE KALITJEN IDEOPOLITIKE TË KOMUNISTËVE E PARTIZANËVE (22 prill 1944)	144—147
LETËR DREJTUAR ZËVENDËSKOMISARËVE TË BRIGADAVE MBI NGRITJEN IDEOLOGJIKE TË KOMUNISTËVE NË USHTRI DHE MBI ORGANIZMIN E PUNËS POLITIKE ME RASTIN E 1 MAJIT (24 prill 1944)	148—150
UDHËZIME MBI FUNKSIONIMIN DHE DETYRAT E ORGANIZATAVE TË PARTISË NË USHTRINË NACIONAL-ÇLIRIMTARE (Prill 1944)	151—166
RAPORT PËRPARA PLENUMIT I TË KOMITETIT QENDROR TË PARTISË KOMUNISTE TË SHQIPËRISË (15 maj 1944)	167—205
RAPORT NË KONGRESIN I ANTIFASHIST NACIO-	

NAL-ÇLIRIMTAR (24 maj 1944)	206—224
URDHËR DITE DREJTUAR USHTRISË NACIONAL-ÇLIRIMTARE ME RASTIN E FORMIMIT TË KOMITETIT ANTIFASHIST NACIONAL-ÇLIRIMTAR (28 maj 1944)	225—228
URDHËR DITE DREJTUAR USHTRISË NACIONAL-ÇLIRIMTARE SHQIPTARE PËR SHPARTALLIMIN E OPERACIONIT ARMIK TË QERSHORIT (14 qershori 1944)	229—233
QARKORE PËR POPULLARIZIMIN E VENDIMEVE TË KONGRESIT I ANTIFASHIST NACIONAL-ÇLIRIMTAR TË PËRMETIT (15 qershori 1944)	234—240
QARKORE DREJTUAR KOMISARËVE DHE ZËVENDËSKOMISARËVE TË UNÇSH MBI FORCIMIN E PUNËS POLITIKE EDUKATIVE NË USHTRINË NACIONAL-ÇLIRIMTARE (16 qershori 1944)	241—246
LETËR ME ANËN E SË CILËS U HIQET VËREJTJA KADRI HOXHËS DHE GJIN MARKUT PËR LIDHJET E DOBËTA ME KOMITETIN QENDROR DHE PËR DOBËSI TË THEKSUARA NË BRIGADËN VII SULMUESE (17 qershori 1944)	247—250
LETËR DREJTUAR SHOKUT RAMIZ ALIA, MBI KRIJIMIN E KOMITETEVE TË RINISË DHE FORCIMIN E GJENDJES NË BRIGADËN VII SULMUESE (17 qershori 1944)	251—256
PËRVJETORI I TRETE I LUFTËS HEROIKE TË URSS-it 22 QERSHOR 1941 — 22 QERSHOR 1944 (22 qershori 1944)	257—262
LETËR KUADROVE DREJTUESE POLITIKE TË DIVIZIONIT I TË UNÇSH LIDHUR ME NGURRIMIN NË ZBATIMIN E URDHËRIT TË SHTABIT TË PËRGJITHSHËM PËR KALIMIN E DIVIZIONIT NË VERI DHE ME FORCIMIN E PUSHTETIT TË KËSHILLAVE NACIONAL-ÇLIRIMTARE (1 korrik 1944)	263—271

PÉRGJEGJE NOTËS SE GJENERALIT UILLSON, KOMANDANT I SHTABIT ALEAT TË MESDHEUT (12 korrik 1944)	272—275
LETËR DREJTUAR ZËVENDËSKOMISARIT TË BRI- GADËS VIII SULMUESE MBI EDUKIMIN IDEOPO- LITIK TË KUADROVE DHE MBI FORCIMIN E RO- LIT TË ORGANIZATAVE BAZË TË PARTISË NË BRIGADE (18 korrik 1944)	276—278
NGA KONGRESI I PËRMETIT NË ÇLIRIMIN E PLO- TË TË SHQIPËRISË (Korrik 1944)	279—288
DALLAVERAXHINJTË E VJETËR DHE ARMIQTË E POPULLIT PO LIDHIN MIQËSI TË REJA (Ko- rrik 1944)	289—296
LETËR DREJTUAR KOMITETIT QARKOR TË PKSH PËR KORÇËN NË LIDHJE ME RISHIKIMIN DHE REDAKTIMIN E REZOLUCIONIT TË AKTIVIT TË PARTISË TË ATIJ QARKU (1 gusht 1944)	297—301
QARKORE NË LIDHJE ME ORGANIZIMIN E SE- KSIONEVE TË EKONOMISË PRANË KËSHILLAVE NACIONAL-ÇLIRIMTARE DHE ME ZGJIDHJEN E ÇESHTJEVE EKONOMIKE TË KOHËS SË LUFTËS (3 gusht 1944)	302—303
LETËR DREJTUAR ZËVENDËSKOMISARIT TË BRI- GADËS II SULMUESE NË LIDHJE ME FORCIMIN E PUNËS IDEOPOLITIKE TË ORGANIZATAVE TË PARTISË DHE FORCIMIN E PUSHTETIT POLITIK DHE USHTARAK (4 gusht 1944)	304—307
FJALIM NË KONGRESIN E PARË TË RINISE ANTI- FASHISTE SHQIPTARE (8 gusht 1944)	308—316
QARKORE NË LIDHJE ME DISA NDRYSHIME NË FORMAT ORGANIZATIVE TË PARTISË NË USH- TRINË NACIONAL-ÇLIRIMTARE (17 gusht 1944) ..	317—324
FJALA NË MBLEDHJEN E KOMITETIT QENDROR TË RINISE KOMUNISTE SHQIPTARE (21 gusht 1944)	325—327
LETËR KUADROVE DREJTUESE POLITIKE TË KORPARMATËS I MBI KRIJIMIN E KORPARMA-	

TËS I TË UNÇSH MBI ORGANIZIMIN E PUSHTETIT TË KËSHILLAVE NACIONAL-ÇLIRIMTARE NË SHQIPËRİNË E VERIUT DHE MBI KONSPIRACIONIN (Gusht 1944)	328—335
RAPORT PARA MBLEDHJES SË DYTË TË KËSHILLIT ANTIFASHIST NACIONAL-ÇLIRIMTAR TË SHQIPËRISË (20 tetor 1944)	336—361
DEKLARATE E QEVERISE DEMOKRATIKE TË SHQIPËRISË, BËRË PËRPARA MBLEDHJES SË DYTË TË KËSHILLIT ANTIFASHIST NACIONAL-ÇLIRIMTAR TË SHQIPËRISË (23 tetor 1944)	362—365
URDHËR DREJTUAR SHTABIT TË KORPARATËS I PËR ÇLIRIMIN E TIRANËS (30 tetor 1944) ..	366—367
FJALIM NË KONGRESIN E PARË TË BGASH (4 nëntor 1944)	368—372
VENDIMET HISTORIKE TË MBLEDHJES SË DYTË TË KËSHILLIT ANTIFASHIST NACIONAL-ÇLIRIMTAR MBAJTUR NË QYTETIN E BERATIT (Nëntor 1944)	373—383
«LEGALITETI» — ORGANIZATE TRADHËTARE (Nëntor 1944)	384—406
URDHËR DITE DREJTUAR USHTRISË NACIONAL-ÇLIRIMTARE ME RASTIN E ÇLIRIMIT TË TIRANËS (18 nëntor 1944)	407—409
PËRSHËNDETJE DREJTUAR POPULLIT TË TIRANËS ME RASTIN E ÇLIRIMIT TË KRYEQYTETIT (18 nëntor 1944)	410—411
USHTRIA JONË NACIONAL-ÇLIRIMTARE (Nëntor 1944)	412—418
URDHËR DITE DREJTUAR USHTRISË NACIONAL-ÇLIRIMTARE ME RASTIN E FESTËS KOMBËTARE TË 28 NËNTORIT (28 nëntor 1944)	419—420
FJALIM ME RASTIN E DITËS SË PAVARËSISË DHE TË ARDHJES SË QEVERISE DEMOKRATIKE NË TIRANË (28 nëntor 1944)	421—431